

Universiteti i Ekonomikës Organizative

**PJETËR BUDI**

Instituti për Studime – Përkohësisht



**LOGOS**

Nr. 1 / 2008



Universiteti i Shkencave Organizative  
"P J E T Ë R B U D I"  
Instituti për Studime - Prishtinë

# LOGOS

Nr.1/2009

Botuesi:  
**Universiteti i Shkencave Organizative “Pjetër Budi”**  
**Instituti për Studime - Prishtinë**

Kryeredaktore:  
**MSc. Evliana Berani**

Koordinatorët:  
**Prof.Dr. Klime Popovski**  
**Afërdita Maliqi**

Bordi editorial:  
**Prof.Dr Sofronija Miladinovski, PhD**  
**Prof.Dr. Ilijas Useini**  
**MSc. Evliana Berani**  
**MSc. Ibish Mazreku**  
**Prof.Dr. Jove Kekenovski**  
**Prof.Dr. Naume Marinovski**  
**Prof.Dr. Klime Popovski**

Redaktore gjuhësore:  
**Afërdita Maliqi**

Dizajni:  
**Fazli Nrecaj**

Tirazhi:  
**300**

## PËRMBAJTJA

<b>Kapitulli I</b> .....	7
Transkript nga punimet e Konferencës Shkencore të organizuar nga Universiteti i Shkencave Organizative – Instituti për Studime “Pjetër Budi” në Prishtinë, “Liberalizimi i tregut të sigurimeve në kontestin e politikave dhe legjislacionit të Bashkimit Evropian”	
Sesioni i panelistëve:	
Liberalizimi i tregut të sigurimeve - sfida për vendet në tranzicion <b>MSc. Ibish Mazreku</b> .....	15
Tregu i sigurimeve në Kroaci <b>Hrvoje Paukovic</b> .....	23
Sigurimi i detyrueshëm në Shqipëri dhe përfaqja me legjislacionin e Bashkimit Evropian <b>MSc. Violanda Theodhori</b> .....	31
Procesi i liberalizimit të sigurimeve të detyrueshme duhet të jetë i kontrolluar <b>Prof. Trajce Latinoski</b> .....	35
Liberalizimi duhet me qenë i kontrolluar dhe i menaxhuar <b>Fatmir Gashi</b> .....	38
Fillimi i liberalizimit të kontrolluar largon nga koncepti i mbikëqyrjes <b>MSc. Hashim Rexhepi</b> .....	41
<b>Sesioni i debatit</b> .....	47
<b>Kapitulli II</b> .....	71
<b>Banka dhe Sigurime</b> .....	71
Norma aktive e interesit të bankat kosovare <b>MSc. Tefik Halili</b> .....	73
Implikimi Bazeli II për jo-anëtarët në Komitetin e Bazelit në vendet me mbikëqyrje bankare <b>MSc. Jordan Koseski, Ph.D. Jovan Stojanoski, Ph.D. Klime Poposki</b> .....	79
Siguria, likuidimi dhe rentabiliteti si kategori ekonomike në sigurim <b>Docent. Dr. Bratislav Milosheviq, Stevco Meceski</b> .....	90

Karakteristikat e tregut të sigurimeve në Ballkan <b>MSc. Sherif Gashi</b> .....	100
Aspektet e sigurimit të terrorizmit <b>Prof. Dr. Ivica Smilkovski</b> .....	104
Beneficione eklatante dhe volitshmëri më të mëdha në sigurimin jetësor <b>Docent. Dr. Bratislav Milosheviq</b> .....	114
Identifikimi i rrezikut të sigurimi – faza në udhëheqjen me rrezikun <b>MSc. Vera Karaxhova</b> .....	123
Organizatata ndërkombëtare transportuese dhe shpeditere <b>MSc. Aleksandar Trajkov, Stevco Meceski</b> .....	130
<b>Kapitulli III</b> .....	143
<b>Turizëm dhe Hoteleri</b> .....	143
Ndikimi i krizës në zhvillimin turistik të zonave rurale <b>MSc. Eleina Qirici, Ph. D Student, MSc. Mamica Nene, Ph. D Student</b> .....	145
Menaxhimi i sektorit turistik në Shqipëri për të minimizuar efektet negative të recesionit <b>MSc. Oriola Theodhori, Ph.d Student, MSc.Esmeralda Shkira, Ph.d Student</b> .....	154
Ndikimi i recesionit dhe dinamika e investimeve në tregjet turistike <b>MSc. Çiljeta Papakozma, Ph.D Kandidate</b> .....	164
Kriza ekonomike dhe modelet e investimeve në tregun turistik në Shqipëri <b>MSc. Mamica Nene, Ph. D Student, MSc. Eleina Qirici, Ph. D Student</b> .....	174

# Kapitulli I

Transkript nga punimet e Konferencës Shkencore të organizuar nga Universiteti i Shkencave Organizative – Instituti për Studime “Pjetër Budi” në Prishtinë, “Liberalizimi i tregut të sigurimeve në kontestin e politikave dhe legjislacionit të Bashkimit Evropian”





Pamje nga punimet e Konferencës shkencore "“Liberalizimi i tregut të sigurimeve në kontestin e politikave dhe legjislacionit të Bashkimit Evropian”, të mbajtur më 4 Maj 09, në ambientet e Universitetit "Pjetër Budi"





Të nderuar miq!

Mirë se erdhët në konferencën e parë rajonale “Liberalizimi i tregut të sigurimeve në kontest të politikave dhe legjislacionit të Bashkimit Evropian”.

Kam kënaqësi të veçantë që në këtë konferencë nga katër shtete, ky universitet ka arritur që t’i grumbullojë, nëse mund të them, “mendjet” më të ndritura nga fusha e shkencave të sigurimeve, që të japin kontributin e tyre dhe me këtë të arsyetojnë drejtimin për çka fusha e sigurimeve sot në botë mbijeton në një formë të zhvillimit, e cila është bërë domosdoshmëri.

Veçanërisht për mysafirët tanë, ky universitet është i ri dhe me rritjen e tij katërvjeçare, sot paraqet një shtyllë të kësaj shkence, si dhe të shkencave të turizmit, doganës dhe resurseve njerëzore, si dhe hotelierisë dhe gjithçka që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo në mënyrë indirekte është e lidhur me atë për të cilën ne do të flasim sot.

Në të vërtetë, sot gjendemi në një situatë botërore, në të cilën ndoshta çdo përparim pozitiv është i mirëseardhur, prandaj edhe kësaj radhe ju do të shfaqni fakte, argumente dhe sugjerime, do të bëni një shërbim individual, që t’i japim edhe një impuls pozitiv institucioneve shtetërore dhe subjekteve meritore në gjetjen e zgjidhjeve adekuate, për tejkalimin e këtyre vështirësive apo krizën botërore, e cila është shfaqur në këtë periudhë kohore.

Unë, në emër të organizatorit, së pari ju falënderoj për kohën që e keni gjetur për pjesëmarrjen në këtë konferencë rajonale, duke ju falënderuar për mundin të cilin e ofroni, dhe njëherit ju dëshiroj punë të suksesshme, për çka besoj se atë që ne, si universitet, do të bëjmë, do të shkojë në veshin e publikut të gjerë.

Nëse nuk mundemi në mënyrë të drejtpërdrejtë të ndikojmë, atëherë mundemi të stimulojmë, të sfidojmë dhe me këtë sigurisht diku do t’i nxisim mekanizmat e prapambetura për të cilën na nevojitet njohuri më e gjerë nga fusha e praktikës dhe shkencës.

Prandaj, kontributi ynë le të jetë një kontribut për zhvillimin e gjithëmbarshtëm dhe në fund le të jetë një kontribut, i cili do të ndërtojë marrëdhënie të mira dhe të afërta dhe të trasojë të ardhmen tonë. Për këtë ju dëshiroj sukses edhe më të madh në këtë konferencë rajonale.

**Prof.Dr.Sofronija Miladinovski, Rektor i Universitetit “Pjetër Budi”**



## **Sesioni i panelistëve**



**MSc. Ibish Mazreku**  
**(Punim i dërguar paraprakisht, i prezentuar në Konferencë)**

## **LIBERALIZIMI I TREGUT TË SIGURIMEVE - SFIDË PËR VENDET NË TRANZICION**

### **A b s t r a k t**

Liberalizimi është ndër temat, që ka një histori në vete dhe ka të bëjë më një kohë prej disa dekadave. Kosova, gjegjësisht industria e sigurimeve në Kosovë, ka filluar të mendojë në lidhje me tendencën që të jetë në hap me kohën dhe njëkohësisht të përcjellë të gjitha përvojat dhe zhvillimet e shumë vendeve që na rrethojnë. Kjo tendencë është pjesë e orientimit si shoqëri që të harmonizojë legjislacionin e saj me atë të BE-së.

Kosova ka filluar me ndryshime para një viti, me zbatimin e liberalizimit të kontrolluar, për të cilin proces ka një kohë që po bisedohet në lidhje me hapat që do të duhej të ndërmerren në të ardhmen.

Kosova do të finalizojë këtë proces në harmoni me interesat e industrisë dhe me praktikatat më të mira të zbatuara deri më tani nga industritë e zhvilluara sidomos ato evropiane.

### **Liberalizimi si proces**

Liberalizimi është pjesë përbërëse e të gjitha ndryshimeve në disa dekada të fundit. Këtu do të përmendim liberalizimin e tregëtisë, lëvizjes së lirë të njerëzve, ndërsa pjesë përbërëse në këto ndryshime ishte edhe sektori financiar.

Kur flasim për liberalizimin e sektorit financiar kemi të bëjmë me koncepte, tregje dhe filozofi të ndryshme si brenda një kontinenti ashtu edhe në kontinente të ndryshme. Liberalizimi si koncept në industrinë e sigurimeve ka për qëllim mundësimin e operimit të kompanive të jashtme në tregjet vendore, pa kurrfarë pengesash apo limitesh nga autoritetet e brendshme.

Në industritë e vendeve të ndryshme kishte barriera dhe pengesa të ndryshme të hyrjes së kompanive të jashtme në industritë lokale. Ato pengesa dhe barriera paraqiteshin përmes mosmundësimit të hyrjes në tregjet vendore të vendeve përkatëse, pastaj asaj të kufizimit të pjesëmarrjes në pronësi deri në një limit të caktuar.

Në shumë ekonomi, sidomos ato të mbyllura apo ekonomive që i përkisnin një sistemi jobashkëkohor, pronësia ishte vetëm shtetërore dhe shteti kishte interesa për të kontrolluar sektorin e sigurimeve, si pjesë përbërëse e sektorit financiar, të cilat për shtetin ishin të një rëndësie të veçantë.

Duke parë presionin e globalizimit në përgjithësi edhe ky sektor nuk kishte mbetur pa u përfshirë në negociata, të cilat zhvilloheshin në mes tregjeve të SHBA, BE, Japonisë apo tregut aziatik. Këto negociata zhvilloheshin edhe nëpërmes organizatave të ndryshme si GATT pastaj OBT etj.

Organizata më e zëshme dhe më aktive në liberalizimin e sektorit financiar, sidomos atij të sigurimeve, ishte Organizata Botërore e Tregtisë ( OBT).

Por, për vendin tonë është shumë me rëndësi procesi i liberalizimit në vendet e Bashkimit Evropian. Prosesi i liberalizimit në BE ishte shumë aktiv sidomos pas gjeneratës së tretë të direktivave evropiane.

### **Liberalizimi dhe Bashkimi Evropian**

Për të sqaruar më mirë ne do të bëjme një përshkrim të shkurtër të tërë procesit të liberalizimit deri te finalizimi i rregullativës që e rregullon këtë çështje.

Bashkimi Evropian kishte punuar shumë dekada në krijimin e tregut unik të sigurimeve (single insurance market), ku kishte ndërmarrë shumë aktivitete politike, ekonomike dhe juridike për të rrumbullaksuar këtë projekt.

Gjatë këtij procesi, BE-ja kishte krijuar apo nxjerrë direktiva të ndryshme, që njihen si gjenerata të direktivave e në tërësi njihen si tri gjenerata të direktivave:

1. Gjenerata e parë e direktivave të sigurimeve apo hapi i parë drejtë liberalizimit të industrisë së sigurimeve.
2. Gjenerata e dytë e direktivave të sigurimeve, e cila njihet si liri e limituar e lëvizjes së shërbimeve.
3. Gjenerata e tretë e direktivave evropiane apo krijimi i tregut unik të sigurimeve (SIM).

Në të gjitha këto faza të krijimit të këtyre direktivave qëllimi ka qenë që të minimizohet ndërhyrja e shtetit në industrinë e sigurimeve, e cila ndërhyrje bëhej përmes ndërhyrjes apo rregullimit përmes kufizimeve të ndryshme të aktiviteteve të caktuara. Ky qëllim ishte që nga rregullimi të kalohej në derregullim si proces drejtë liberalizimit të tregut të sigurimeve.

Me rregullim (regulation) kuptojmë që shteti përmes akteve të caktuara ligjore kufizon konkurrencën e lirë apo orienton aktivitete të caktuara të kompanive të sigurimeve, ndërsa derregullim (deregulation) nënkupton të kundërtën e rregullimit, ku ndërhyrja e shtetit (organit rregullator dhe mbikëqyrës) është minimale dhe krijon hapësirë adekuate për konkurrencë të lirë dhe si rezultat të derregullimit vijmë deri te liberalizimi.

Gjatë negociatave dhe udhëheqjes së këtij projekti shumë vende kanë pasur opinione të ndryshme në lidhje me rëndësinë e zbatimit të liberalizimit.

Shumë shtete ishin kundër këtij projekti, sepse mendonin që përmes zbatimit të këtij projekti kompanitë vendore do të ishin në disfavor në krahasim me fuqinë e kompanive të jashtme, si në ofrimin e produkteve kualitative gjithashtu edhe në aspektin e fuqisë financiare.

Procesi i zbatimit të këtij projekti është imperativ i kohës dhe secili vend është i interesuar të zbatojë këtë projekt në tërësi apo gradualisht.

Efektet e liberalizimit në secilin vend do të reflektoheshin në:

- Rritjen e prezencës së kompanive të huaja në industrinë vendore.
- Llojllojshmëri dhe produkte të reja të sigurimeve.
- Plotësimi më i mirë i nevojave të klientelës.
- Kualitet më të madh të shërbimeve.
- Sjellja e eksperiencës dhe dijes në tregun vendor (know how)
- Liberalizimi i politikave të investimeve.
- Aktivitetet të tjera varësisht nga specifikat e tregut

### **Liberalizimi i tregut të sigurimeve në Kosovë**

Liberalizimi i tregut të sigurimeve ishte njëri ndër prioritetet e Bankës Qendrore të Kosovës, për shkak të synimeve të Kosovës drejt harmonizimit të legjislacionit të saj me direktivat evropiane.

Shkak tjetër ishte edhe përcjellja e trendeve në industrinë e sigurimeve si në rajon ashtu edhe më gjerë. Të gjitha këto ndryshime shtyn autoritetet në Kosovë të marrin hapat konkret drejt liberalizimit.

Karakteristikë e liberalizimit në Kosovë është liberalizimi i TPL-së, sepse industria e sigurimeve në Kosovë është treg i hapur, ku nuk ka kurrfarë kufizimesh në strukturën e pronësisë së kompanive, si dhe nuk ka kufizime tjera, të cilat, në një mënyrë apo tjetër, do të favorizonin kompanitë vendore në krahasim me kompanitë e jashtme.

Në industrinë e sigurimeve mund të operojnë edhe operatorë të jashtëm, ndërsa stuktura e pronësisë brenda një kompanie nuk ka kurrfarë limiti në relacion pronar të brendshëm apo të jashtëm.

Sa i përket investimeve, në bazë të rregullativës në fuqi, ato janë të liberalizuara, sepse çdo kompani mund të investojë varësisht politikave dhe filozofisë së investimit të saj.

Kufizimet në relacion me risiguruesin kanë të bëjnë me nivelin e mbajtjes së rrezikut jo në cedimin e detyrueshëm në tregun e brendshëm, siç është rasti me vende të ndryshme, ku imponojnë kompanitë vendore dhe të jashtme të cedojnë nivel të caktuar në kompani risiguruese vendore.



Në Kosovë çdo kompani do të jetë e obliguar të cedojë çdo risk, i cili kalon shumat e 10 për qindshit të kapitalit plus/minus fitimi apo humbja. Ky kufizim bëhet për shkak të kapaciteteve të kompanive për të përballuar risqe më të mëdha se sa kjo vlerë.

### **Modeli i liberalizimit të TPL-së në Kosovë**

BQK kishte studiuar përvojat e Greqisë në liberalizimin e tregut të saj dhe përvojat aktuale të tregut kroat, atij slloven etj., dhe në fund kishte krijuar një model adekuat, i cili njihej si Liberalizim i kontrolluar, që do të ishte adekuat dhe i përshtatshëm për zbatim, duke mos krijuar parakushtet për një dështim të industrisë së sigurimeve.

Ky model quhej i kontrolluar me vetë faktin që Riskun Sigurues e caktonte BQK, si masë mbrojtëse nga qasja e gabuar e kompanive drejtë tendencës së zvogëlimit të çmimeve, kjo masë ishte nga frika që do të shkaktohej kaos sikur në liberalizimin e tregut grek të industrisë së sigurimeve, ku kompanitë kisin qasje drejtë uljes së çmimeve me synim përfitimi të një mase më të madhe të tregut të sigurimeve.

### **Ky model bazohej në formulën:**

$RS+SHO+Pr+Tatimi (7 \text{ për qind})+TVSH(15 \text{ për qind})= Primi$

Risku sigurues caktohej nga BQK si vlerë e 65 për qind të neto tarifave paraprake të caktuara nga BQK, ndërsa Shpenzimet Operative (SHO) do të duhej të paraqiteshin real në aktivitetet e kompanisë.

Shkalla e profitit do të duhej të paraqitej real me qëllimet e menaxhmentit të kompanisë, kurse kategoritë e tatimeve janë pjesë përbërëse të përcaktuara nga shteti.

Qëllimi kyç në modelimin e kësaj formule ishte që përmes riskut sigurues të caktohej një nivel minimal, ku kompanitë do të duhej të ndërtonin primin e tyre në njërin anë si dhe presioni që kompanitë përmes kësaj formule të bëjnë zvogëlimin e shpenzimeve të tepërta operative.

Fillimi i zbatimit kishte pengesa dhe shtyrje për shkak të shumë faktorëve teknikë të kompanive. Ky proces filloi me dy muaj vonesë, ku kompanitë kishin prezentuar tarifën e tyre, të cilat dallonin në një shkallë të madhe, ngase kishte kompani që kishte propozuar tarifën deri në nivelin – 20 për qind në krahasim me tarifën paraprake të caktuara nga autoriteti deri në nivelin +10 për qind në krahasim me tarifën paraprake.

Kjo diferencë shkakëtoi shumë pakënaqësi, të cilat në një mënyrë e cenonin aktivitetin e tyre sigurues për një periudhë të caktuar, sepse kompanitë kishin të drejtën që brenda vitit dy herë të propozonin ndryshimin e tarifave. Tarifën ishin të kontrolluara edhe nga aktuarët e kompanive, që duhej të siguronin tarifën adekuate të kompanisë përkatëse.

Duke analizuar këto lëvizje jemi në dyshim që aktuarët e kompanive nuk janë bazuar në metodologji adekuate të verifikimit të tarifave, sepse supozohej që presioni i

menaxhmenteve ishte të përcaktoheshin tarifa të tilla, të cilat do të ishin konkurrentë në treg dhe përmes saj të përfitonin klientelë të re.

Kjo politikë e disa menaxhmenteve ishte shumë shkurtëpamëse sepse impononte edhe kompanitë tjera të vepronin në drejtimin e njëjtë. Aktuarët do të duhej të verifikonin se tarifat e propozuara, të bazuara në formulën e caktuar nga BQK, a janë të mjaftueshme dhe adekuate.

Liberalizimi i kontrolluar në Kosovë ka kaluar një vit. Ky projekt ishte i përkohshëm dhe pas një periudhe prej 6 deri 12 muaj do të duhej kaluar në liberalizim të plotë.

Parashtrohet pyetja a do të duhej të kalonim në liberalizimin e plotë, ku kompanitë do të ishin të lira në përcaktimin e tarifave të tyre, duke u bazuar në vlerësimet dhe kalkulimet e aktuarëve të certifikuar.

Për të vazhduar më tutje, industria e sigurimeve në Kosovë ka disa rrugë që mund të ndjek:

1. Të kthehet në sistemin e vjetër, që nënkupton që tarifat të përcaktohen nga Rregullatori.
2. Të vazhdohet me liberalizimin e kontrolluar edhe për një periudhë të caktuar.
3. Të kalohet në liberalizim të plotë.

Opsioni i parë nuk do të kishte me qenë adekuat dhe i aplikueshëm, për arsye se rregullatori nuk do të bënte hap prapa, sepse të gjitha trendet janë në atë drejtim, që sektori i sigurimeve duhet të ecë drejtë rrugës së liberalizimit në njërën anë, ndërsa në anën tjetër ndoshta kjo qasje mund të bie ndesh me Ligjin mbi konkurrencën në Kosovë.

Opsioni i dytë është më i preferuar edhe për një periudhë të caktuar me vetë faktin që kompanitë me këtë qasje dhe tendencë të zbritjes së tarifave pa asnjë kalkulim të mirëfilltë dhe limiti minimal, i caktuar përmes riskut sigurues, do të krijojnë një bazë solide, që procesi mos të degradojë.

Mirëpo, për të forcuar liberalizimin e kontrolluar apo tërë procesin ndoshta rregullatori do të duhej që të analizojë një vit të liberalizimit të kontrolluar dhe të krahasojë apo analizojë një element kyç nga formula e liberalizimit të kontrolluar gjegjësisht kategorinë e shpenzimeve operative (SHO).

Pse do të duhej të bëhej kjo, me të vetmen arsye që kompanitë, përmes zvogëlimit të koeficientit të pjesëmarrjes së SHO, në primin e propozuar dhe aprovuar, të ulë primet për të qenë me çmime më të favorshme se sa konkurrenca.

Qëllimi i pranimet nga ana e Rregullatorit ka qenë që në një mënyrë të bëjë presion në kompanitë e sigurimeve, që të zvogëlojnë shpenzimet reale.

Pasi të krahasohet koeficienti i këtyre shpenzimeve edhe pas një viti dhe nëse konstatohet që realisht nuk ka pasur kurrfarë tendence të zbritjes dhe nëse SHO kanë mbetur në një

nivel të njëjtë apo kanë pasur tendencë të rritjes parashtrahet pyetja se cila ka qenë arsyeja e propozimit të SHO me një koeficient më të vogël se sa shpenzimet operative nga pasqyrat financiare, të cilat konsiderohen reale.

Çfarë masash do të duhej të ndërmerre Rregullatori në lidhje me këtë çështje:

1. Të anulohet tarifat e aprovuara dhe kalimi në tarifa paraprake.
2. Të kërkojë nga aktuari që profesionalisht të bëjë kalkulimin e tarfiave dhe njëkohësisht të verifikohet nga aktuari i rregullatorit.

Hapi i ndërmarrë nga autoriteti, pika e parë, nuk do të kishte qasje logjike, ndërsa nga pika e dytë autoriteti, nëse vjen në përfundim që vlerësimet e aktuarit të kompanisë nuk janë të qëndrueshme, duhet të ndërmarrë masa të ashpra ndaj aktuarit dhe kompanisë, duke mos pranuar asnjë vlerësim në të ardhmen në lidhje me vlerësimet aktuariale.

Nëse nuk do të ndërmerrej një masë e tillë nga rregullatori do të vihej në rrezik tërë procesi (liberalizimi i kontrolluar) në njërën anë, si dhe do ta rrezikonte industrinë, që përmes tarifave jo adekuate të krijohen dubioza përmes vështirësimit të fuqisë financiare apo edhe përmes falimentimit të kompanive, që do të ishte çmim që do të duhej të paguhej nga industria.

Tarifat joadekuate do të krijojnë vështirësi në pagesën e obligimeve, që rrjedhin nga kërkesat për dëme. Kompanitë, duke u ballafaquar me këtë problem, do të mundohen që përmes shtyerjes së pagesave të dëmeve të fitojnë në kohë në njërën anë, ndërsa në anën tjetër do të mundoheshin që të bëjnë kalkulim jo real të rezervave teknike, si dhe mosraportimin e dëmeve reale në numër dhe vlerë.

Me paraqitjen e këtij problemi kompania do të duhej të ballafaqohej me masat drastike nga autoriteti, i cili nënkupton falimentimin apo shtimin e kapitalit nga pronarët e kompanive.

Është shumë me rëndësi të parashtrahet pyetja se deri kur kompanitë do të mund të operonin në këtë mënyrë, që nënkupton se mashtrojnë veten për një ditë më të mirë.

Pyetja tjetër shumë me rëndësi është që menaxhmentet a kanë qasje apo informata në lidhje me trendin e lëvizjes së tyre dhe a kanë ndonjë plan rehabilitues në momentin e ballafaqimit me problemin.

Sipas parashikimeve të mia, kjo gjendje mund të zgjasë deri në fund të vitit dhe pasojat do të paraqiteshin tek mbas pranimit të pasqyrave financiare të vitit 2009, të cilat kompani, sipas ligjit, duhet të kenë deri në fund të prillit të vitit vijues.

Opsioni i tretë është ende heret të aplikohet, sepse kompanitë do të duhej të shëronin dubiozat aktuale, në mënyrë që të kalohet në liberalizim të plotë të TPL-së. Kjo do të duhej të planifikohet, që zbatimit i liberalizimit të plotë të fillonte diku në janar 2011.

Parashtrahet pyetja sepse në vitin 2011? Përgjigja është sepse në mes të vitit 2010 kompanitë do të kuptonin pozicionin real të tyre financiar dhe pasi Rregullatori të ketë këto informata do të duhej të përgatitë industrinë hap pas hapi, për të zbatuar në tërësi liberalizimin e plotë.

Cilat do të ishin ndoshta hapat e Rregullatorit për të përgatitur industrinë në të ardhmen për të qenë në hap me kërkesat e procesit në tërësi:

- Hapi i parë, siç e cekëm më lartë, është vlerësimi i vlerësimeve aktuariale për produktin e TPL-së nga aktuari i kompanisë dhe ndërmarrja e masave drastike ndaj atyre, që nuk janë bazuar në metodat aktuariale të vlerësimit adekuat të tarifave.
- Rivlerësimi i tarifave për të gjitha produktet jo- TPL, të cilat, sipas informatave në treg, janë të caktuara sipas ndonjë shablloni të kopjuar dhe që nuk kanë ndonjë mbështetje reale në aktuaristikë.
- Të ndërmirren masa direkte të topmenaxhmenti i kompanive, që nuk kanë njohuri në lidhje me menaxhimin adekuat të kompanisë, të bazuar në praktikat më të mira, sepse gjeneratori i të gjitha këtyre dobësive dhe dubiozave lind nga topmenaxhmentet e jopërgjegjshëm, ku në të shumtën e rasteve nuk bëjnë me dije me gjendjen reale as bordet e tyre as pronarët e tyre.
- Analizimi i mënyrës së menaxhimit të risqeve në tërësi dhe mënyra e cedimit të risqeve të risiguresit, sipas ligjit në fuqi. Kontratat e risigurimit në të shumtën e rasteve paraqesin një tendencë vetëm të plotësimit të formës, që nënkupton tendencë për të plotësuar kërkesat ligjore pa analizuar mënyrën e bashkëpunimit me risiguresit etj.
- Aktivitete tjera, të cilat do të ishin me interes për të rregulluar tregun në tërësi, mënyrën e menaxhimit nga stafi i përgjegjshëm dhe profesional, ku kjo do të ishte specifike e kompanive në veçanti, sepse secila kompani ka specifikat e veta, që bëjnë për t'u dalluar nga konkurrenca tjetër, si në aspektin pozitiv ashtu edhe në atë negativ.

## **Konkluzion**

Industritë e sigurimeve në vendet e zhvilluar dhe ato në zhvillim po kalojnë nga një formë e rregulluar në atë të derregulluar, që nënkupton në tregje të liberalizuara. Duke përcjellur këto ndryshime edhe industria e sigurimeve në Kosovë është orientuar për të qenë pjesë e botës së zhvilluar dhe të jetë në hap me kohën. Duke përcjellur këto ndryshime, Kosova para një viti ka filluar procesin e liberalizimit të sektorit të sigurimeve. Kosova është në një fazë, e cila duhet të vendosë në lidhje me rrugën, që do të ndjekë në lidhje me liberalizimin e industrisë në tërësi.

Duke përcjellur të gjitha këto ndryshime, Rregullatori në Kosovë do të duhet të ndërmerret disa hapa drejt finalizimit të këtij procesi, në një kohe jo shumë të shkurtër.

Hapat nga Autoriteti do të duhet të vendosin:

- Duke analizuar detajisht industrinë dhe procesin e deritanishëm do të vendosë që industria të shkojë drejt kthimit mbrapa në sistemin që kemi lënë pas.
- Do të përcillet dhe modifikohet ky proces pra liberalizimit të kontrolluar.
- Do të kalohet në liberalizim të plotë.

### **Literatura**

1. Maciej Sterzynski, The European Single Insurance Market: Overview and impact of the liberalization and deregulation processes
2. Jennifer M. Oetzel, Market Liberalization and Insurance Firm Performance in Emerging Markets & Developing Countries
3. Welf Werner Multilateral Insurance Liberalization, 1948-2008
4. Joseph Francois Ian Wooton, Market Structure, Trade Liberalization and the Gats
5. ICC, The world business organization, The liberalization of trade in insurance Services, Prepared by the Commission on Financial Services and Insurance
6. Stephen Woolcock, Liberalisation of Financial Services
7. Klime Poposki, Globalization of the Insurance Industry and Emerging Markets
8. Christian Noyer, "The Challenges of financial liberalisation for Emerging Market Economies" International Chamber of Commerce

## **Hrvoje Paukoviç, Drejtor gjeneral i Byrosë Kroate të Sigurimeve në Kroaci**

### **TREGU I SIGURIMEVE NË KROACI**

Para së gjithash e falënderoj organizatorin për ftesën. Më vjen mirë që jam prezent në mesin tuaj sot këtu, në këtë shoqëri të këndshme. Shpresoj se me këtë ligjëratë timen sadopak do t'i kontribuoj sqarimit të situatës, si në Kroaci, dhe ju të njiheni me përvojat pozitive dhe negative të Kroacisë dhe të shikoni se cilat nga ato do t'ju ndihmojnë e të cilat do të ishin të dobiprurëse për juve.

Unë jam Drejtor i Byros Kroate të Sigurimeve dhe Shoqatës së Siguruesve të Kroacisë, gjithashtu edhe Byros së Kartelës së Gjelbërt të Kroacisë dhe Fondit Garantues të Kroacisë.

Unë do të provoj t'ua sjell disa përvoja tona, kryesisht rreth konceptit, i cili sot këtu po përmendet.

### **Liberalizimi i tregut**

Liberalizimin e tregut e shpjegoj në dy mënyra, sikurse foli z.Mazreku mbi tri gjeneratat e urdhrave (direktivave), për lirinë e themelimit. Nëse e shohim shërbimin e futjes së lirë të kapitalit dhe nxjerrjes së lirë të atij kapitali, lirinë e realizimit të po atij kapitali, tutje derregullimin në një mënyrë të caktuar të dispozitave të formimit të lirë të tarifave, çmimeve të sigurimeve dhe ky gjithsesi është një aspekt i rëndësishëm.

Sa i përket Kroacisë, mund të them se me miratimin e Ligjit në vitin 2005, Ligjit mbi sigurimin dhe Ligjit mbi sigurimin e obligueshëm në komunikacion, do të thosha se e kemi filluar etapën e fundit të zbatimit të urdhëresave-udhëzimeve (direktivave) të Bashkësisë Evropiane (BE-së) dhe në atë drejtim konkretisht kemi hyrë në afërsi të BE-së.

Sikurse e dini ne e kemi Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit dhe unë shpresoj se do t'i përfundojmë bisedimet, ndoshta madje këtë vit, por edhe nëse i zgjidhim disa çështje kontestuese me fqinjët. Po ashtu, besoj se do të hyjmë në BE, sipas disa pritjeve, në vitin 2011. Së paku kështu thonë politikat, ndërsa si do të jetë në të vërtetë do të shohim.

Sidoqoftë, në vitin 2008 ne e kemi ndërruar Ligjin mbi sigurimin. Para, një apo dy muajve e kemi ndërruar edhe Ligjin mbi sigurimin e obliguar në komunikacion. Mirëpo, kjo nuk mjafton. Në këtë pranverë përsëri do e ndërrojmë Ligjin mbi sigurimin dhe do të nxjerrim Ligj të ri mbi sigurimin.

Unë jam anëtar i Grupit Punues pranë Ministrisë së Financave, ndërsa për vjeshtë është lënë zëvendësimi i ri i Ligjit mbi sigurimin e obligueshëm në komunikacion, por nuk kemi të bëjmë me farë ndryshimesh drastike.

Në të vërtetë, sa i përket zbatimit të gjithë këtyre lirive të tregut, kapitalit, nxjerrjes së fitimit, sidoqoftë këto i kemi miratuar, kështu që në raport me BE-në nuk kemi kurrfarë problemesh. Ligjet tona në atë kuptim me të vërtetë janë të harmonizuara mirë në këtë etapë të përgatitjes për t'iu bashkuar BE-së.

Ajo që dikush, nëse unë e kam kuptuar drejtë, tha se është qëllim i këtij tubimi, që juve ju intereson dhe për ju është aktuale, është i ashtuquajturit liberalizim i tregut të sigurimeve të obliguara në komunikacion. E kjo është, pastaj, sidomos çështja e “NTPM”-it.

Pra, nëse ju kam kuptuar drejtë, ju intereson sigurimi i obliguar në komunikacion dhe sidomos “NTPM”-i, që do të thotë sigurimi nga përgjegjësia për përdorimin e automjeteve.

Në Kroaci ekziston Ligji mbi sigurimet e obligueshme në komunikacion, i cili është aprovuar në muajin dhjetor 2005 dhe ka hyrë në fuqi më 01 janar 2006. Dikush tha se janë të obligueshme sigurimet në komunikacion, pastaj sigurimi i udhëtarëve të aeroplanëve në bartje, sigurimi i pronarëve të anijeve të vogla (pronarë të cilët i drejtojnë ato anije në lumenj, liqene dhe në det).

Sigurimi i përgjegjësishë në transportin ajror të udhëtarëve dhe sigurimi më i rëndësishëm ai i sigurimit të obligueshëm nga përgjegjësia e përdorimit të automjeteve. Ligji mbi sigurimin e obligueshëm në komunikacion parasheh, po ashtu, me nenin 68 që, për të gjitha sigurimet e obligueshme, të nxirren kushte të përbashkëta, premi të përbashkëta dhe çmime të përbashkëta nëpërmjet Byros Kroate të Sigurimit.

Ky është neni 68, i cili po me të njëjtin Ligj është caktuar të përfundon të vlejë më 31 dhjetor 2007.

Pra, ne kemi pasur më 01 janar 2008 një kthesë të caktuar. Deri atëherë të gjitha shoqatat në kuadër të Zyrës Kroate të Sigurimeve kanë qenë të obligueshme të aprovojnë tarifën e përbashkëta, çmimet e përbashkëta, kushtet e përbashkëta të sigurimit dhe gjithashtu t'i aplikojnë në treg.

Mirëpo, posaçërisht në kuadër të sigurimit nga përgjegjësia, më duhet të them se në tregun kroat, para të ashtuquajturit liberalizim dhe mundësisë së formimit të lirë të tarifave, ka dominuar një çrregullim i vogël. Në vitin 2006, premia e jonë ka qenë rreth 330 milionë euro, vetëm nga sigurimi i përgjegjësishë së automjeteve. Do të thotë kemi pasur një shumë të çmuar të premisë. Mirëpo, ka dominuar një çrregullim në kuptimin që tarifa dhe kushtet nuk janë zbatuar sa duhet. Sidomos kjo ka të bëjë me aplikimin e bonusit të sistemit të vogël, do të thotë sistemit, i cili e penalizon siguresin në rast se ai shkakton një apo më tepër dëme gjatë vitit që shqyrtohet.

Kësisoj kemi ardhur në situatë që në vitin 2006, kemi pasur të gatshme 90 për qind: 10 për qind të portofolit të gjithëmbarshtëm të automjeteve dhe kemi pasur bonusin maksimal prej 50 për qind. Kjo do të thotë se të gjithë kanë paguar gjysmën e çmimit. Çfarë ka ndodhur?

Ka ardhur deri te ngopja e disa garuesve në treg në kuptimin e pjesëmarrjes në treg. Disa e kanë kuptuar se më tepër nuk mund të rriten, kurse të tjerët e kanë kuptuar se munden vetëm të pësojnë. Nuk mund t'ua them emrat e atyre shoqërive/shoqatave të sigurimit, por njohësit e mirë të këtij tregu do t'i njohin dhe kuptojnë se për cilët është fjala.

Në përfundim të vitit 2006, siguruesit nënshkruajnë Marrëveshjen kontradiktore, të cilën e quajnë Marrëveshje për sanksionim më të ashpër të shitësit e sigurimeve. Kjo është Marrëveshje me të cilën siguruesit janë ra në ujdi se nuk ka më dhënie të bonusave të rrejshëm.

### **Bonusin mund ta meritosh, por nuk mund ta fitosh**

Më parë ke mund që për të ardhur në vendin e shitjes ke thënë a bënë bonus prej 50 për qind dhe të janë përgjigjur se mundet.

E, atëherë kemi thënë se kështu më nuk ka me qenë. Gjegjësisht, këtë nuk kemi guxuar me e quajtur ashtu, sepse atëherë do të mund të na thonë: 'E po pse deri tash keni punuar asisoji'. Nuk keni punuar me ligj. Por, kemi thënë: Ne do të sanksionojmë më ashpër ata që atë e bëjnë (që ashtu veprojnë). Është formuar organi ynë mbikëqyrës, i cili e ka intensifikuar mbikëqyrjen e vet.

Unë kam ardhur në Entin Kroat për Sigurime dhe kemi arritur të krijojmë një vetërregullim dhe marrëveshje, brenda Byros Kroate të Sigurimeve, që disa gjërave do t'iu përmbahemi. Cili është rezultati i tërë kësaj?

Ne vetëm në vitin 2007 e kemi zbritur portofolin me 50 për qind zbritje në 73 për qind të "portofolit".

Do të thotë nga 90 në 73 atyre që kanë 50 për qind zbritje e kemi ngritur preminë për 11 për qind gjithsejt, ndërsa preminë mesatare të përgjegjësisë automobilistike e kemi ngritur për 8.5 për qind, që do të thotë rreziku i njëjtë, çmimi më i lartë dhe neve na mbeten me diskutuar më shumë për dëme. Do të thotë siguruesit vetvetes i kanë shkaktuar dëme në garën e tregut. U kuptua se ashtu më nuk shkon për shumë shkaqe.

Për shkak të Organit Mbikëqyrës, kjo është shumë me rëndësi. Unë përshëndes prezencën këtu të kryesuesit të Organit Mbikëqyrës, që është organ shumë i rëndësishëm, pa të nuk bënë. Në këtë kuptim unë mendoj se çështja e mbikëqyrjes është imperativ.

Vetërregullimi në kuadër të Shoqatë që ta kuptojmë të gjithë, njeriu i fortë i Shoqatës, i cili do t'u tregojë se ai veprim i vetërregullimit dhe zbatimi strikt i tij është interes. Rreziku i njëjtë me më shumë para. Ky vetërregullim neve na ka mundësuar që tani kemi arritur në afro 400 milionë euro premi dhe jemi përgatitur për të ashtuquajturin Liberalizim 2007.



Byroja Kroate e Sigurimit e ka porositur një analizë të tregut, ku unë u rekomandoj të gjithëve, tek e ashtuquajtura HAD (“Hrvatsko auktersko drushtvo”), sepse doja të tregoj se premia e jonë, çfarëdo që ishte ajo atëherë, nuk mjafton për të mbuluar të gjitha dëmet.

Nuk është, po ashtu, e mjaftueshme për të mbuluar fondet gjegjëse dhe rezervat. Ne kemi ardhur deri te llogaria që neve kuota e kombinuar na i ka zgjidhur çështjen 104...107..., varësisht se për cilën kategori të automjeteve. Atë dokument ia kemi dhënë Organit Mbikëqyrës, i cili mbajti qëndrim relativ.

Mirëpo, ai i pranoi te konstatimet e asaj analize. Dhe çka ndodhi? Në vend se më 1 janar 2008 të fillojmë rregullimin e plotë për secilin nga 14 siguruesit, ne kemi 14 sigurime, të cilat bëjnë sigurime të obligueshme të përgjegjësive nga përdorimi i automjeteve, që janë shumë (14 sigurime).

Keni parasysh që në Slloveni janë 6. Në Serbi janë më pak se 10 sigurime, kurse te ne ka shumë dhe vazhdimisht vijnë lojtarë të ri. Kjo jep me kuptuar se njerëzit janë të interesuar për ndarjen e ëmbëlsirës prej 400 milionë eurosh. Dhe kjo është në rregull!. Mirëpo, si reagon Organi ynë Mbikëqyrës?

Duhet të dini se te ne tani nuk ka evidentues të përbashkët të tarifave, por çka thotë Ligji. Ai thotë se secila shoqatë sigurimi është e obliguar 60 ditë para zbatimit të çmimoreve së re t’ia jep çmimoren dhe kushtet Organit Mbikëqyrës në dorëzim, Organi Mbikëqyrës nuk është i obliguar të kontrollojë dhe të jap lejën. Ai është i obliguar vetëm ta shikojë dhe nëse nuk reagon në afat prej 60 ditësh ajo Shoqatë e Sigurimeve mund të fillojë aplikimin e asaj tarife dhe çmimorje.

Në të kundërtën, Organi Mbikëqyrës, nëse e konsideron se tarifa është në kundërshtim me Ligjin, rregullat e lëmisë së profesionit dhe parimeve të ashtuquajtura “aktuale”, atëherë Organi Mbikëqyrës mund të ndërmarrë masën e ndalimit të tarifës së tillë.

Do të thotë, Ligji, Rregullat e lëmisë së profesionit dhe të ashtuquajturat parime “aktuale”. Mos më pyetni çka do të thotë kjo? Kjo do të thotë po atë që e thashë: As unë nuk e di sa çka do të thotë kjo, vetëm se në Ligji ashtu shkruan!

Do të thotë Ligji m’u ato tri gjëra i thekson. Çka ndodh? Organi Mbikëqyrës dërgon delegacionin në Byronë Kroate të Sigurimeve, e thërrasim mbledhjen e të gjithë siguruesve në muajin e dhjetor 2007.

Tre muaj para realizimit Organi Mbikëqyrës thotë: “Ju mund të shkoni me çmimore të reja, me tarifa të reja, me kushte të reja, nuk ka pengesë. Nëse unë ua kthej, nëse janë në kundërshtim me ligjet, me të ashtuquajturat parime ‘aktuale’ dhe rregullat e profesionit, ekziston mundësia që më 1 janar ju nuk do të shitni sigurime të përgjegjësive së përdorimit të automjeteve”.

Natyrisht që krijohet stagnimi. Si do të rrezikoj unë tani duke vendosur tarifën e re dhe ta dërgojë atë në Organin Mbikëqyrës? Çka nëse unë më 1 janar nuk mund të shesë

përgjegjësi të automjeteve. Por, nëse e dorëzon tarifën e vjetër si tarifë tëndën, d.m.th. e përvetëson të përbashkëtën si tëndën, të cilën edhe deri tani të gjithë së bashku e kanë përdorë, atëherë sigurisht që do të shitësh edhe më 1 janar.

Unë (Organi Mbikëqyrës) sigurisht se nuk do të bëjë vërejtje. Çka ndodhi? Më 01 nëntor që të gjithë (të 14 siguruesit) dorëzojnë kushtet e njëjta, çmimoret e njëjta, përveçse tani secilit i shkruan titulli i firmës së vetë, ndërsa çmimet e kushtet e tjera i kanë që të gjithë të njëjta. Të gjithë shesin njëjtë!

Më 1 janar, startojmë me të vjetrën, kështu që në vend të kushteve, çmimeve e tarifave të njëjta, i kemi 14 sosh të ndryshme.

Dallimi është në të ashtuquajturën “rezhi” shtesë. Do të thotë premia funksionale është ajo që merret për mbulesë të dëmeve etj., ndërsa “rezhi shtesa”, e cila mund të varion silllet diku ndërmjet 10 e 20 për qind.

Kështu ka mundur me qenë edhe më parë. Ne hymë në vitin 2008 me tarifa dhe çmimore të njëjta, mirëpo kjo nuk mjafton. Alijans dhe Gjeneralit në shkurt të 2008, pasi tani janë të sigurt se mund të punojnë me sigurimin e obliguar, thonë po shkoj ta provojmë me çmimoren e re.

Të dytë ia dorëzojnë Tarifën e re Organit Mbikëqyrës dhe pritet 30 ditë. Mirëpo, Organi ynë Mbikëqyrës nuk jep. Bëhen letërkëmbime ndërmjet Organit Mbikëqyrës dhe “Alijansës” e “Gjeneralit”. Këmbimi i shkresave zgjatë një vit dhe Organi Mbikëqyrës kurrë nuk e ka lejuar tarifën as çmimoren e re.

Ne edhe tani (sot) punojmë me tarifat dhe çmimore e vjetra të përbashkëta. Pse është kjo në një farë dore mirë? Të gjithë, së pakut nga përvoja, e dini: Ne e kemi organizuar një Konferencë mbi Liberalizimin e tregut në Zagreb, në vitin 2007, ku kemi dëgjuar shumë përvoja negative të disa vendeve.

Në Austri humbja në 7 vjet ishte 400 milionë euro. Mua drejtori i Shoqatës së atjeshëm (austriaku) më ka thënë se ata kur i kanë ngritur çmimet janë fundos si në “Kasko” ashtu edhe në automjete. Kur i kanë ngritur çmimet për mesatarisht 12 euro në vit kanë qenë lajmi i parë në Ditar TV. Kur njëherë fundoseni shumë vështirë ktheheni (ngjalleni).

HUO (Sigurimi i Kushtëzuar Kroat) është angazhuar të tregojë se çmimi i tanishëm i premisë në kufi nuk guxon të ulet, ndërsa disa shoqëri kanë kërkuar zvogëlim të çmimit.

Mirëpo, përvoja e Austrisë tregon se po që se do t’i zvogëloni çmimet (kam frikë se kjo po ndodh tani te ju) ose do t’ju ndodh në të ardhmen, përbindja e pjesëmarrjes së konkurrentëve në treg mbetet njëjtë.

Nuk ka përvetësim të tregut me ulje të çmimit. Të gjithë ankohen, të gjithë e kanë vështirë dhe të gjithë më pak përfitojnë, por përmasat e pjesëmarrjes në treg mbeten të njëjta. Këtu jeni më afër Greqisë dhe e dini më mirë se sa problemet kanë qenë.

Pikërisht për këto shkaqe, Organi ynë Mbikëqyrës na ka dhënë vërejtje të gjithëve neve (në Kroaci) duke na thënë: “Ju nuk keni të dhëna. Hartoni kushtet dhe çmimoret e reja”. Organi Mbikëqyrës i ka thënë edhe Byros Kroate të Sigurimeve dhe kompanive apo shoqërive të sigurimeve: ”Filloni grumbulloni të dhënat”.

Ne me një shoqëri sigurimi kemi hartuar projektin, kemi tubuar të dhëna e standarde që nevojiten për ta hartuar çmimoren.

Mirëpo, nëse doni të veproni në të ardhmen, nuk mundeni t’i tuboni ato të dhëna të së kaluarës, sepse ajo punë është veçanërisht e vështirë. Shoqëritë e sigurimeve këtyre gjërave edhe tentojnë t’ju ikin. Vijnë në situatë kur të mëdhenjt nuk dëshirojnë t’i ndajnë të dhënat me të vegjlit. Disa thonë unë dijtë të hartoj çmimin, të vlerësojë rrezikun, të çmojë dëmin etj.

Të mëdhenjtë thonë ti nuk dinë, ti prit! Këto na sjellin që në aso situatë të rrezikohet të rritet sigurimi i automjeteve madje 7 për qind, mandej që edhe më tepër të na stabilizohet ai 50 për qind i atij “molus-it”.

Edhe më tutje, edhe sot, në kuadër të Burosë Kroate dhe Organit Mbikëqyrës ne gjithnjë detyrohemi t’i zbatojmë dhe fusim rend në treg. Kjo është shumë vështirë. Ne jemi tani për tani mirë pasi nuk kemi rënë. Mua një koleg nga Shoqata më tha, kur e pyeta si ta pengoj në liberalizim uljen e çmimeve dhe të mbetesh në garë? Nuk mundesh assesi me evituar, sepse ai është mekanizëm i tregut.

Unë shpresoj se te ne kjo megjithatë nuk do të ndodh. Ne e kemi bërë një analizë të tregut. Ne nuk do ta zbresim preminë. Mirëpo, liberalizimi megjithatë nuk ka ndodhur. Organi Mbikëqyrës është pozicionuar gjithashtu mirë. Nëse do ta ndërrosh tarifën mundesh këtë ta bësh vetëm një herë në vit, sepse për t’i ndërruar përsëri duhet të kalosh një vjet përvojë.

Vlerësimi kontestues, vendimi po ashtu kontestues, por ata (Organi Mbikëqyrës) asisoj janë pozicionuar. Bazat teknike ata në mënyrë laksative i kanë paracaktuar. Dhe, nga ana tjetër, neve na e kanë gjuajtur një kockë dhe na kanë thënë: “Ju nuk keni të dhëna, ju nuk keni këtë, ju nuk keni atë e atë”.

Kjo nuk është e vërtetë se kompanitë e mëdha të sigurimeve kanë të dhëna gjithsesi. Ato janë që moti në treg dhe veprojnë kohë të gjatë. Mirëpo, Organi Mbikëqyrës, nga shkaku i frikës për Fondin Garantues edhe për gjithfarë arsyesh, po stopon. Fatkeqësisht, më duhet të them se nga perspektiva ime ky qëndrim i Organit Mbikëqyrës është i mirë.

Dihet se për Fondin Garantues janë si për kërthize të lidhura të gjitha kompanitë e sigurimeve. Dhe po që se një kompani shkon në likuidim ajo automatikisht e tërheq tjetrën pas veti.

Atëherë, do të kishim që të gjithë probleme të mëdha, për këtë arsye kjo situatë është e mirë. Ajo që tani ka ndodh, pa ndërlydhje ndoshta në këtë temë, por dëshiroj t'ua sjell ndërmend, edhe ju ndoshta të ruheni kur një ditë do të hartoni ligjin.

Neve liberalizimi na është pamundësuar nga një arsye tjetër.

Ligjvënësi e ka aprovuar Ligjin për sigurim shëndetësor dhe ka caktuar që premitë e përgjegjësive automobilistike 10 për qind duhet të ndajnë për financimin e sistemit shëndetësor në emër të dëmeve, që i shkaktojnë të siguarit në komunikacion, që do të thotë se nëse dikush ia mëshon dikujt ai shkon në spital të shërohet.

Nuk e di si funksionon te ju. Enti ynë për Sigurim Shëndetësor ato shpenzime ia faturon kompanisë së sigurimeve. Këtë deri tani e kemi paguar. Kemi paguar 7 deri 8 milionë euro në vit.

Tani në mungesë të mjeteve ligjvënësi thotë nuk mjaftojnë 7-8 milionë, m'i jep 35 milionë euro në vit. Ne jemi në shok. "Alijansa" dhe "Gjenerali" po i tërheqin çmimoret e reja. Po mundohen t'i dorëzojnë, sikurse edhe të gjithë të tjerët, t'i dorëzojnë çmimoret e rritura për atë 10 për qind. Mirëpo, për shkak të rrethanave të caktuara objektive dhe politike siguruesit më të mëdhenj, "Kroacia Sigurimi" thotë "nuk guxoj t'i rrisë çmimet".

Tani shikoni këtë situatë. Lideri i sigurimeve nuk mund të rrisë çmimin. Të gjithë vuajnë. Nuk ka mjete për të mbuluar shpenzimet. Por, tjerët luftojnë t'i rrisin çmimet për cilat shkaqe? Si do të shitësh sigurime dhe të jesh 10 për qind më i shtrenjët se "Kroacia Sigurimi", e cila është kompani nacionale e sigurimit (lider).

Vështirë, shumë vështirë!

Dhe tani jemi në situatën e vërtetë. S'ka liberalizim të drejtë, s'ka rritje të çmimit. Presim vendimin e "Kroacia Sigurimit", që të mundet me i rrit çmimet dhe luftojmë duke u thirrur edhe në Gjykatën Kushtetuese që ta vlerëson kushtetutshmërinë e Ligjit mbi sigurimin e obliguar shëndetësor.

Ta anulojmë atë Ligj në mënyrë që të na lejohet formimi i lirë i çmimeve. Kjo ndoshta ju duket që nuk ndërlydhet, por megjithatë ndërlydhet me diçka që është mjaft aktuale dhe shpresoj të mos ju pengon në funksionimin normal.

Ne në Byron Kroate të Sigurimeve është miratuar e ashtuquajtura Rregullore për përjashtimin e përbashkët, sipas të cilës kompanitë e sigurimeve për disa gjëra lejohet të merren vesh e për disa jo. Rregulla mbi përjashtimin e përbashkët thotë se mund të nxjerrim të ashtuquajturat "kushtet, mostra për sigurim".

Janë aprovuar udhëzimet se si duhet të jenë kushtet e sigurimeve dhe të njëjtat për atë se si duhet të duken çmimoret.

Krejt këtë për të provuar me e evituar në treg një sjellje amerikane e humbjes. Tani është lajmëruar një fletëparaqitje anonime kundër Byrosë Kroate të Sigurimeve. Ka ndodhur

paradoks, i cili nuk ka ndodhur më parë askund. Organi Mbikëqyrës është ngritur në mbrojtje të siguruesit.

“HAMPA” (Institucion kroat i kësaj lëmie), ka thënë se ata nuk janë marrë vesh, nuk i kemi detyruar të merren vesh, respektivisht siguruesit disi të gjithë së bashku kanë arritur marrëveshje mes veti.

Hedhet poshtë fletëparaqitja kundër Byrosë kroate, dhe, megjithatë, duhet rritur bazën e të dhënave, duhet me e siguruar statistikën, edhe atëherë të fillohet me liberalizimin. Dhe m'u në këtë drejtim them se mund t'ju vlejë përvoja kroate. Ja, pra kjo është situata kroate!

Mendimi im personal është se këtu ka ndodhur një e papritur nga Organi Mbikëqyrës dhe jemi në një pat pozicion, nga i cili nuk dimë se si të dalim.

Nga njëra anë, për shkak të Entit të Sigurimit Shëndetësor na duhet ta rrisim çmimin, e nga ana tjetër disa edhe më tutje mendojnë se me segmentimin e tregut dhe rreziqeve më të mira do të arrijnë në një mënyrë të caktuar ta përvetësojnë tregun. Kjo nuk do të ndodh!

Në këto dy vite kemi rritur preminë. Kemi rreth 1 milion e 930 mijë polica të sigurimit. Aq kemi vetura, por gjithashtu kemi gati 400 milionë premi nga sigurimet e përgjegjësive për automjete. Mendoj se kjo është udhërrëfyes dhe bazë e mirë për të shkuar më tutje. Ja kjo ishte përafërsisht. Unë shpresoj se kjo pjesë ishte interesante.

Ne e kemi kaluar një miliard me preminë e gjithëmbarshme dhe shkojmë tutje. Ky do të jetë vit posaçërisht i vështirë. Nuk kemi pas ndonjë rritje të veçantë. E para herë brenda gjashtë vjetëve që siguri jetësor është rritur më dobët se tjetra formë e sigurimit.

Prandaj, them se kriza po vjen edhe në Kroaci. Unë e tregoj një anekdotë për këtë dhe them se sikurse që asgjë nuk ka sukses në Kroaci, as kriza nuk do të ketë sukses. Shpresojmë të jetë kështu.

**MSc. Violanda Theodhori**

**(Punim i dërguar paraprakisht, i lexuar në Konferencë)**

## **SIGURIMI I DETYRUESHËM NË SHQIPËRI DHE PËRQASJA ME LEGJISLACIONIN E BASHKIMIT EVROPIAN**

“Në mes të trazirave financiare që po vazhdojnë, tregu global i risigurimeve ka qëndruar relativisht i fortë dhe elastik përkundrejt goditjeve të drejtpërdrejta të deritanishme, çfarë ka kontribuar si në stabilitetin e tregjeve globale të sigurimit, ashtu edhe në qëllimin e mbrojtjes dhe sigurisë së të siguruarve”.

Tregu i sigurimeve dhe të gjitha veprimtaritë e sigurimit, të risigurimit, ndërmjetësimit dhe operacionet, që rrjedhin nga këto veprimtari, rregullohen e mbikëqyren në Shqipëri nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka filluar veprimtarinë në tetor të vitit 2006 , pas bashkimit të tre autoriteteve të mëparshme në fushat e sigurimeve, letrave me vlerë dhe pensioneve private suplementare.

Gjatë këtyre viteve, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka rritur dhe forcuar pozicionin e tij në rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve financiare jo bankare, si dhe ka vazhduar të mbështesë misionin themelor të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve dhe publikut në tërësi, të lidhur ngushtë me stabilitetin financiar të operatorëve të mbikëqyruar.

Autoriteti i ka kushtuar rëndësi të madhe dhe bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare financiare për ndërtimin e sistemeve bashkëkohore të rregullimit e mbikëqyrjes.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, si dhe të mbikëqyrjes ndërkufitare në sektorin financiar jobankar, Marrëveshja e Mirëkuptimit, lidhur midis AMF-së dhe Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, i shërben pikërisht shkëmbimit të përvojave të ndërsjellta.

Prioritet i të dy rregullatorëve të mësipërm mbetet përafrimi i kuadrit ligjor dhe procedurave e metodologjive të mbikëqyrjes në të dy vendet. Në Kosovë aktualisht ushtrojnë veprimtarinë tri shoqëri shqiptare të sigurimit të jojetës.

Spektori i sigurimeve në Shqipëri mban peshën kryesore në tregun financiar jobankar. Në tregun e sigurimeve ushtrojnë aktivitet 10 shoqëri sigurimi, gjashtë shoqëri kanë pronësi vendase, ndërsa katër të tjerat kanë njëkohësisht pronësi vendase dhe pjesëmarrje influencuese të huaj.

Gjatë vitit 2008, numri i kontratave të sigurimit u rrit me 27 për qind. Të ardhurat nga parimet e sigurimeve arritën në rreth 7 miliardë lekë, ose 19 për qind më shumë se në vitin 2007, dhe duke u krahasuar me mesataren e vendeve në zhvillim është më e lartë (11.8 për qind).

Kjo rritje ka ardhur si rezultat i rritjes së numrit të klientëve dhe tregut në tërësi, ndërsa tarifatat e sigurimeve të detyrueshme nuk patën asnjë rritje, madje në sigurimin kufitar tarifatat pësuan ulje në krahasim me vitin 2007.

Sigurimet e detyrueshme motorike vazhdojnë të dominojnë tregun, por struktura e produkteve është përmirësuar ndjeshëm në favor të sigurimeve vullnetare, që arritën të kenë 44 për qind të totalit të primeve, kundrejt 35 për qind që kishin në vitin 2007. Viti 2008 shënoi rritjen e pranisë së grupeve të huaja në Shqipëri, nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes në investimet ekzistuese.

Sfida kryesore për AMF, mbetet rritja e cilësisë së shërbimit nga shoqëritë e sigurimit kundrejt klientëve dhe publikut në tërësi.

Një nga prioritetet e punës së Autoritetit kanë qenë dhe nismat ligjore dhe projektet e ndërmarra dhe të realizuara nga Autoriteti, si projektligjet dhe aktet nënligjore, apo nxitja e produkteve të sigurimit në sektorë të rëndësishëm të ekonomisë.

Autoriteti, në kuadër të Planit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe përbushjes së detyrimeve që rrjedhin për përafrimin e legjislacionit, në të gjitha ndryshimet ligjore në sektorin financiar jobankar të propozuara apo miratuara, ka pasqyruar kërkesat e direktivave evropiane.

Një nga këto nisma është edhe ligji i ri në fushën e sigurimeve të detyrueshme, Ligji nr.10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i cili erdhi si nevojë e rishikimit të ligjit të mëparshëm të sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësisë së mbajtësve të mjeteve motorike ndaj palëve të treta.

Nisma për hartimin e këtij ligji ishte rezultat i zhvillimeve në tregun e sigurimeve të detyrueshme në Shqipëri dhe tendencave ndërkombëtare të rregullimit të sigurimeve të detyrueshme.

Në hartimin e ligjit ka ndihmuar edhe legjislacioni i hartuar në vitet e fundit në vendet evropiane si Kroaci, Bullgari, Itali etj., si dhe kuadri rregullator i Këshillit të Byrove. Në këtë ligj janë përfshirë kërkesat e direktivave evropiane, përvojat e përparuara të vendeve të tjera të rajonit, si dhe janë mbajtur në konsideratë edhe kushtet specifike të tregut shqiptar të sigurimeve.

Ligji i ri ka zgjeruar skemën e sigurimeve të detyrueshme, ka përcaktuar procedura të shpejta dëmshpërblimi, si dhe parashikime të tjera në favor të konsumatorëve:

1. Përfshirja në skemën e sigurimeve të detyrueshme motorike të:
  - a) Sigurimit të pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik:
    - transportin urban, interurban dhe ndërkombëtar;
    - transportin taksi;

- transportin nëpërmjet mjeteve lundruese detare, lumore dhe liqenore edhe për qëllime turistike;
- transportin nëpërmjet avionëve;
- transportin e mjeteve mbi shina dhe teleferikë

b) Sigurimit të përgjegjesisë për dëmin e shkaktuar palës së tretë nga përdorimi i mjeteve të transportit ajror dhe mjeteve lundruese.

2. Përmirësimi i procedurave për mbulimin e dëmeve dhe shërbimin ndaj konsumatorit, që lidhen me:

a) Lehtësimin e procedurave për marrjen e dëmshpërblimit nga të aksidentuarit prej mjeteve motorike, që kanë kontratë sigurimi të detyrueshëm, në rastet kur ka marrëveshje ndërmjet shoqërive përkatëse të sigurimit. Parashikimi në ligj i rimbursimit të drejtpërdrejtë në rastin e dëmeve materiale të përgjegjesisë motorike.

b) Saktësimin e llojeve të dëmeve që mbulon kontrata e sigurimit të detyrueshëm, të cilat kategorizohen në dëme pasurore dhe jopasurore, si dhe koncepti i dëmit jopasuror ose i ashtuquajtur “dëmi moral”, “dëm biologjik” dhe “ekzistencial”.

c) Vendosjen e afateve për trajtimin dhe pagesën e dëmeve nga shoqëritë e sigurimit në përputhje me direktivat evropiane. Këto afate shmangin zvarritjet, pasi përcaktohen afate të shkurtëra kohore: për dëme jopasurore brenda 30 ditëve nga data e plotësimit të dokumentacionit, për dëme pasurore brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për dëmshpërblim.

3. Krijimi i Qendrës së Informacionit, si strukturë institucionale për mbledhjen, ruajtjen dhe përpunimin e informacionit për sigurimet e detyrueshme.

Qendra do të ndihmojë në përmirësimin e cilësisë së informacionit, kryerjen e analizave paraprake të zhvillimit të tregut të sigurimeve, si dhe rritjen e rolit mbikëqyrës e monitorues të këtij tregu.

Përfshirja dhe përditësimi i informacionit të dëmeve në këtë qendër do të mundësojë monitorimin më të mirë të procesit të dëmshpërblimeve dhe krijimin e sistemeve moderne të tarifimit bonus malus, në funksion të një tregu të liberalizuar me standarde të larta.

Liberalizimi i primeve të sigurimeve të detyrueshme mundësohet nga ky ligj dhe do të realizohet menjëherë pas përfundimit të projektit të ngritjes së plotë të Qendrës së Informacionit që kalon në tre faza:

Faza 1: Krijohet regjistri i policave të shitura të sigurimit të detyrueshëm motorik.

Faza 2: Krijohet regjistri i dëmeve, dëmet e ndodhura raportohen on line në regjistër.



Faza 3: Bazuar në informacionet historike të mbledhura fillon zbatimi i sistemit bonus malus, që nënkupton shitjen e policave me zbritje, në rast të një historiku pozitiv dëmsh të të siguruarit dhe me një çmim të rritur në rastet kur i siguruari ka patur dëme në të shkuaren.

Qendra e Informacionit do të lehtësojë shkëmbimin e informacionit me autoritetet vendase publike të transportit dhe policisë.

4. Përmirësimi i strukturave dhe funksioneve mbikëqyrëse të tregut të sigurimeve nëpërmjet:

a) Kompetencave të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiar për nxjerrjen e rregullave dhe metodikave për përlllogaritjen e tarifave të primit të sigurimeve të detyrueshme, rregullat për trajtimin e dëmshpërblimeve, etj.

b) Rregullimit të funksionimit të Byrosë Shqiptare të Sigurimit dhe mbikëqyrjes nga Autoriteti, raportimit mujor të Byrosë në Autoritet mbi gjendjen financiare dhe detyrimet e saj, mënyra e krijimit dhe administrimit të fondit, kompensimit dhe atij të Kartonit Jeshil.

5. Përcaktimi i sanksioneve për rastet e shkeljes së dispozitave të këtij ligji, në përputhje me natyrën e shkeljes, me qëllim rritjen e shkallës së zbatueshmërisë.

Për herë të parë në këtë ligj janë përcaktuar sanksione deri në 300.000 lekë, ndaj shoqërive të sigurimit për shkeljen e procedurave të trajtimit dhe të pagesës së dëmeve, për mospagim kontributesh kundrejt Fondit të Garancisë së Kartonit Jeshil dhe Fondit të Kompensimit, si dhe ato ndaj buxhetit të Byrosë Shqiptare të Sigurimeve, sanksione ndaj pronarit të mjeteve të transportit, apo drejtuesve të këtyre mjeteve.

Zbatimi i Ligjit të ri për sigurimet e detyrueshme në Shqipëri do të sjellë uljen e numrin të të pasiguarve, sigurimin e të gjithë avionëve dhe anijeve, përmirësim në trajtimin e dëmeve nga shoqëritë, rritjen e efektivitetit dhe bashkëpunimit të të gjithë strukturave shtetërore, mbrojtje më të mirë të interesave të konsumatorëve.

**Prof. Trajçe Latinoski, Drejtor gjeneral i Kompanisë "Vardar Osiguranje" në Maqedoni**

## **PROCESI I LIBERALIZIMIT TE SIGURIMET E DETYRUESHME DUHET TË JETË I KONTROLLUAR**

Ju falënderoj për ftesën që më keni bërë për pjesëmarrje në këtë konferencë. Mendoj se interesi nga kjo konferencë, në bazë të asaj që u prezantua dhe të pjesëmarrësve në këtë konferencë, meriton vëmendje, pasi që njerëzit që janë pjesëmarrës në këtë konferencë vijnë nga rajoni dhe shtete të ndryshme, të cilat gjenden në faza të ndryshme të procesit të liberalizimit.

Disa prej shteteve kanë ecur më përpara, disa janë në fillim e disa janë diku në mes, për këto arsye për mua liberalizmi është një proces evolutiv, i cili çdo herë duhet të përmirësohet dhe të kërkohen mundësi për ndonjë kalim të lehtë dhe harmonizim me direktivat evropiane.

Unë në pika të shkurtëra do të isha ndalur në situatën në Republikën e Maqedonisë, në procesin e përputhjes së rregullativës ligjore. Në periudhën prej vitit 2002, për herë të parë filluam që ta përmirësojmë dhe të përshtatemi me direktivën e parë të Bashkësisë Evropiane e kjo do të nënkuptonte se janë krijuar tre kritere, që janë të rëndësishme për liberalizimin e tregut. Kriteri i parë është krijimi i bazës ligjore për pjesëmarrjen e kompanive të huaja të sigurimeve.

Në vitin 2002, në Republikën e Maqedonisë, në tregun e sigurimeve ishin prezent tri kompani, kurse me ndryshimin e Ligjit të sigurimeve janë krijuar kushte për të pasur mundësi të futen në treg edhe kompani të sigurimeve edhe nga jashtë.

Me plotësimin e Ligjit për sigurime më 2005 e 2006, në tregun e Republikës së Maqedonisë ishin prezente 9 kompani të sigurimeve, kurse në 2008 me ndryshimin e Ligjit të sigurimeve dhe ndryshimin e Ligjit për sigurimet e detyrueshme, tani më në treg janë prezente 12 kompani të sigurimeve, prej të cilave 10 kompani të sigurimeve të jojetës, dy kompani të sigurimit jetësor, si dhe dy kompani tjera presin të marrin licencën nga Ministria e Financave nga fusha e sigurimeve të jojetës.

Në këtë proces që nga viti 2002 deri në vitin 2008 paraqiten 14 kompani, flet se tregu në Republikën e Maqedonisë, i shikuar nga rregullativa ligjore, është në proces të vazhdueshëm të harmonizimit dhe përafrimit me rregullativën ligjore të anëtarëve të Bashkimit Evropian.

Megjithatë, çfarë ndodh në këtë periudhë kur fillon të dinamizohet procesi? Ndodh që proceset e papërfunduara, që kishin të bënin me përputhjen e rregullativës ligjore, të kontribuojnë që rregullativa ligjore të mos marrë zbatimin praktik gjegjësisht joadekuat dhe me siguri duhet të shtohen edhe disa rregullativa ose ligje të caktuara nga segmente të caktuara, që të mund të themi që procesi i liberalizimit të plotë të tregut ka mbaruar.

Në fakt, në pjesën e rregullativës ligjore, që flasim për liberalizimin e plotë, sipas disa vlerësimeve nga ana e ekspertëve të rregullativës ligjore të Republikës së Maqedonisë, duhet të bëjë përshtatjen e plotë të më shumë se 50 ligjeve, të cilët janë të përcaktuar dhe e përcjellin biznesin e sigurimeve.

Nuk janë vetëm Ligji për auditim të sigurimeve apo Ligji i sigurimit të detyrueshëm, por janë një kompleks ligjesh, që duhet të përshtaten në mënyrën më adekuate, që të krijohen mundësi për qasje të plotë të kapitalit të kompanive, që vijnë nga jashtë.

Dhe, në këtë periudhë ndodh që liberalizimi në sigurimet jo të obligueshme, ka bërë që lojtarë të caktuar në tregun lokal, me raportin e tyre në mënyrë joparimore ndaj profesionit të sigurimeve, kanë bërë që tregu në vend të mos rritet në pjesën e sigurimeve jo të detyrueshme.

Në tregun e sigurimeve të pronës, që nga viti 2002 deri në vitin 2007, ka pasur një ulje permanente të premisë së përgjithshme. Në pjesën e sigurimeve të obligueshme, mendoj se qasja për liberalizim të shpejtë në pjesën e sigurimit nga autopërgjegjësia do të bëjë gjithashtu edhe në Republikën e Maqedonisë probleme të caktuara, siç edhe z.Poukoviç foli për tregun në Kroaci.

Çfarë ndodhi, për shkak të asaj se sigurimi nga autopërgjegjësia në tregun e përgjithshëm në Republikën e Maqedonisë ka 55 për qind, për shkak të asaj se të gjithë këta lojtarë (pjesëmarrës) të rinj, që ishin futur në treg dëshironin shpejt të arrijnë deri te një segment i caktuar i tregut.

Duke pasur parasysh se nuk kishte rritje të premisë te llojet tjera të sigurimeve, ndodhi që në një moment, duke filluar nga viti 2007 edhe gjatë vitit 2008, si edhe më 2009, u krijua një gjendje kaotike në treg.

Për këtë arsye, them se procesi i plotësimit të ligjeve duhet të ecë më shpejt në shtetin tonë, për arsye se mosrespektimi i caktuar apo mospërfundimi i rregullativës ligjore kontribuon që pjesëmarrës të caktuar në treg të krijojnë një gjendje kaotike, duke mos respektuar rregullat apo profesionin e sigurimeve edhe te ky lloj i sigurimeve të autopërgjegjësive.

Çmimi për sigurimin e autopërgjegjësive në Republikën e Maqedonisë është definuar dhe është nën kontrollin e organit qeveritar, përkatësisht Komisionit, i cili merret me përcaktimin e çmimeve për sigurimet, i cili në të vërtetë bën përpjekje përmes profesionit adekuat të aktuarëve apo përmes Byrosë Ndërkombëtare të Sigurimeve, që të përcaktohen çmimet adekuate të sigurimeve që i përgjigjet lartësisë së dëmit.

Ky komision ka përcaktuar çmimin minimal të sigurimit, si dhe ka përcaktuar shpenzimet e sigurimit që janë të parapara.

Çfarë ndodhi në vitin 2008? Duke mos respektuar Ligjin për auditim, për shkak se nuk është plotësuar deri në fund, gjegjësisht nuk është formuar Agjencioni Mbikëqyrës,

respektivisht organi që merret me sigurimet, disa kompani, edhe pse është përcaktuar çmimi minimal me të cilën është marrë leje adekuate nga komisioni gjegjësisht, duke ju ofruar klientëve çmime më të ulëta, kanë shkuar nën çmimin minimal për sigurime.

Por, kjo bumerang do t'u kthehet këtyre kompanive, sepse të gjithë ne e dimë se shpenzimet për dëmet vijnë mesatarisht 8 deri 12 muaj pas momentit të arritjes së sigurimit.

Ky problem te disa kompani ndihet dhe nga analiza e fundit që është bërë është 112 për qind. Mendimi im personal është se procesi i liberalizimit të sigurimet e detyrueshme duhet të jetë i kontrolluar nga arsyet se gjithkund në rajon dhe Evropë është i kontrolluar, për arsye se në këto shtete të rajonit, që i përmenda më herët, ku bizneset tjera nuk janë me ligj të detyrueshëm, nuk ka rritje.

Periudha e tranzicionit, e cila i ka përfshirë investimet e dobëta, me siguri do të vazhdojë edhe në këtë periudhë të krizës ekonomike edhe më tepër, por u mbetet kompanive, në njëfarë mënyre, që me çfarëdo çmimi të kyçen në tregun e sigurimeve, që ka të bëjë me sigurimin e autopërgjegjesisë.

E gjithë kjo sjell deri te moszgjidhja e mënyrës dhe mjeteve, duke mos e vlerësuar profesionin, që në afat sa më të shkurtër të pushtojnë një përqindje të madhe të tregut të sigurimeve.

Për kompanitë është me rëndësi se në Republikën e Maqedonisë disa vendime ligjore të caktuara janë të aprovuara dhe shkojnë në atë drejtim të përafrimit me nevojat e sistemit të liberalizimit të tregut.

Kurse, tani në fazën e krijimit është edhe Agjencioni për Auditim, që ka një vend të rëndësishëm në rregullativën ligjore, i cili mundëson që procesi i liberalizimit, them kushtimisht, të mos ketë “rrëshqitje”.

**MSc. Fatmir Gashi, Kryetar i Bordit të Kosovës për Standardet e Raportimit Financiar pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave****LIBERALIZIMI DUHET ME QENË I KONTROLLUAR DHE I MENAXHUAR**

Ne në vitin 2007 filluam të mendojmë lidhur me liberalizimin e tregut të autopërgjegjësive, sepse ne e kemi vetëm atë produkt të detyrueshëm. Gjatë atij viti kemi ngritur një komision, së bashku me Bankën Qendrore dhe kompanitë e sigurimit, nëpërmes shoqatës, dhe kemi punuar në një projekt për liberalizim.

Specifikat e Kosovës në atë kohë kanë qenë shumë të ndryshme prej të tjerëve. Gjithë tregu i sigurimeve në Kosovë ishte mbi 92 nga autopërgjegjësia dhe ishte një përgjegjësi jashtëzakonisht e madhe e njerëzve, të cilët punojshin. Në këtë projekt ishin përcaktuar metodat, të cilat do të zgjidhen për liberalizim.

Përgjegjësia ishte aty se nëse këtu lejojnë që të ndodhë një gjendje e Greqisë nga liberalizimi, ku kishin falimentuar 30 kompani të sigurimit, ka falimentuar Fondi i Garancisë, i cili me kredite të mëdha mezi është dalë nga kriza.

Duke parë atë dhe përvojat tjera, që i përmendi z.Paukoviq, në Austri 400 milionë euro, në Gjermani kanë falimentuar një pjesë e kompanive të vogla, edhe ka pasur humbje, mbi 2 miliardë euro këto rrethana na kanë shtyrë që të nisemi nga një qasje, e cila ka qenë pak a shumë, të quhet liberalizim i kontrolluar, liberalizim i cili së bashku të gjithë e kemi pranuar. Mirëpo, asnjëri nga ne që ishim në atë komision nuk kemi besuar që më vonë do të kthehet në një garë në çmime.

Kemi besuar që vetëdija e kompanive do të jetë aty që të nxjerrë produktet në bazë të kushteve të sigurimit dhe jo të shkojë në ulje të çmimit. Kjo ka ndodhur te ne dhe në periudhën njëvjeçare dhe ne kemi zbritur çmimet, diku mesatarisht për 24 – 25 për qind. Dhe kjo garë në treg, tregon atë që nuk mund të përfitojë asnjë kompani, asnjë centimetër hapësirë më të madhe në treg se sa që e kishte përpara.

Me këtë kemi bërë që të zvogëlojmë preminë TPL për tremujorin e parë të vitit 2009 për 16 për qind dhe të zvogëlojmë pjesën e pagesës së dëmeve për 17 për qind. Kjo është ajo pjesë e cila duhet ulur dhe analizuar. Ne duhet të bëjmë një grup të aktuarëve, për të bërë një analizë të detajizuar të primit dhe të dëmeve.

Ne e dimë që në Kosovë disa kompani kanë shënimet, disa nuk kanë dhe duhet krijuar shënimet e sakta për historiatin e dëmeve dhe në bazë të të këtyre shënimeve dhe rekomandimeve të aktuarëve të vjimë deri te një material, në bazë të cilit kishim mundur me nxjerrë konkluzione lidhur me liberalizimin.

Në Kosovë sot mungon Ligji mbi sigurimet e përgjithshme. Ne kemi Regulloren e UNMIK 2001/ 25, e cila rregullore me qasjen e sotme, si funksionojnë kompanitë e sigurimit, është joadekuatë.

Për këtë duhet të nxjerret një ligj, i cili do të bazohet në standardet evropiane dhe do të jep saktë ekonominë e kapitalit në bazë të kodit, që e kanë kompanitë e sigurimeve, që të jep çka ka në obligime dhe të ketë asetet.

Të gjitha këto duhe t'i rregullojë ligji i përgjithshëm dhe më pastaj të nxirret Ligji mbi sigurimet e detyrueshme, ligj i cili do t'i përcaktojë këto dhe më pastaj të krijojë një platformë edhe ligjore, të bazuar në ligj dhe në çështjen e rregullatorit, që i jep në fuqi rregullatorit për me mbikëqyrë.

Shumica kanë menduar se në qoftë se ndodh liberalizimi shteti heq dorë prej tarifave dhe humb rolin e rregullatorit. Kjo është tërësisht gabim. Në këto raste kur vjen deri te liberalizimi Rregullatori duhet me qenë shumë rigoroz, që të kërkojë besueshmërinë e kapitalit, të kërkojë rezervat tona, llogaritjet e rezervave të dëmeve. Duhet të rregullohet edhe një çështje që është Fondi i Garancisë.

Fondi i Garancisë është brengosës për arsye se nëse nuk është përgjegësia te një kompani e sigurimit mund të tërheqë edhe kompani tjera të sigurimit të dëmit individual. Nëse ndodh që policmbajtësit e një kompanie, që shkon në likuidim, nuk mund të kryhen nga çështjet likuiduese, asetet likuiduese të cilat i ka kompania, atëherë këto gjëra duhet të kompensoheshin nga Fondi i Garancisë dhe të gjitha kompanitë komplet do të kishin humbje.

Për këtë arsye, roli i Rregullatorit në këto momente duhet me qenë strikt. Më lartë përmenda Gjermaninë, e cila pasi që ka vërejtur çka ka ndodhur në liberalizim atëherë roli i Rregullatorit të Mbikëqyrësit e ka në ngritur. Liberalizimi i tepruar ka sjellë krizën financiare.

Liberalizimi në çdo moment duhet me qenë nga shteti i kontrolluar dhe i menaxhuar, sepse duhet të ketë rregulla. Sot vijnë idetë dhe rregullat globale financiare për mos me lënë me ndodh krizat si çfarë kanë ndodhur tash.

Unë kisha thënë se të kthehet varianti i Ibishit i pari, që të kthehemi në pozicione për arsye se kompanitë momentalisht, me tarifatat që i kanë, me kërkesat ndaj dëmeve që vijnë, kanë probleme.

Është formuar një komision nga aktuarët, të cilët janë duke dhënë arsyeshmërinë aktuariale, për ta bindur Rregullatorin se duhet të mbrohet diçka në këtë politikën momentale që kemi dhe gjatë këtij viti të punohet më analizë, të bëhet një analizë e aktuarëve, të bëhen një indikator statistikor dhe pastaj të shkohet në vitin 2010, pas përmirësimit edhe të infrastrukturës ligjore më një librealizim, i cili do të jetë më i menaxhueshëm.

Po ashtu, Kosova specifike deri tani e ka pasur portofolin 92 për qind të autopërgjegjesisë. Shtetet tjera e kanë portofolin pak më ndryshe dhe në qoftë se në një pjesë të autopërgjegjesisë ndodh diçka dhe kompania duhet të merret me sigurime tjera të jetës dhe jojetës, kanë mundut t'i mbulojnë të dyja bashkë.

Te ne është shumë vështirë se 90 për qind marrin prim në prim, prej autopërgjegjesisë në krahasim me periudhën mars 2009 është një ngritje shumë kualitative e sigurimeve, jo TPL që kemi një rritje gati dy herë e gjysmë, që jep një shpresë se Kosova është kah hyn në trende të portofolit sikurse e kanë të gjitha shtetet tjera.

**MSc.Hashim Rexhepi, Guvernator i Bankës Qendrore të Kosovës**

## **ME FILLIMIN E LIBERALIZIMIT TË KONTROLLUAR LARGOHEM NGA KONCEPTI I MBIKËQYRJES**

Kam kënaqësinë të jam pjesëmarrës në këtë tryezë të rrumbullakët dhe shfrytëzoj rastin të falënderoj Universitetin “Pjetër Budi” për organizimin e kësaj tryeze në temën e liberalizimit të sigurimeve, e cila është aktuale dhe më shumë rëndësi për zhvillimin e mëtejshëm të industrisë së sigurimeve në Kosovë.

Gjithashtu, përshëndes miqtë e respektuar nga vendet fqinje për pjesëmarrjen e tyre në punimet e kësaj tryeze. Besoj se përvojat e tyre janë të çmueshme për ne.

Konsideroj se është e tepërt dilema: liberalizim apo rregullim administrativ të primeve të sigurimeve. Me Kushtetutën e Republikës së Kosovës jemi përcaktuar për ekonomi të tregut të lirë dhe të hapur, prandaj është plotësisht e kuptueshme që edhe industria e sigurimeve duhet të ecë në këtë drejtim.

Korniza ekzistuese ligjore e sigurimeve, Rregullorja 2001/25, është bazuar apo mbështetur në praktikat më të mira të ligjeve ndërkombëtare dhe është e përafërt me direktivat e Unionit Evropian sa i përket organizimit të sigurimeve në Kosovë.

Kjo rregullore ka krijuar një treg të hapur të sigurimeve, ka siguruar lirinë e hyrjes së siguruesve në tregun e sigurimeve të Kosovës, ka siguruar lëvizjen e lirë të kapitalit, shpërndarje të lirë të dividendës, ka siguruar pozicion të barabartë të të gjithë siguruesve, pa marrë parasysh vendin e origjinës, a janë vendorë apo të jashtëm.

Me rregulloren 2001/25 dhe rregullat përkatëse për sigurimet e aprovuara nga BQK janë përcaktuar standardet e licencimit dhe të mbikëqyrjes së sigurimeve në Kosovë.

Dilemat që u hapen sot në këtë tryeze liberalizim apo jo i tregut të sigurimeve në Kosovë mendoj që është e tepërt. Tregu i sigurimeve në Kosovë është i liberalizuar. Këtë e dëshmojnë të dhënat në vijim: në Kosovë sot operojnë 10 kompani të sigurimeve jojetë apo të sigurimeve të përgjithshme dhe një kompani e sigurimit të jetës.

Struktura e pronësisë se tyre është mbi 50 për qind në pronësi jashtë Kosovës (nga Austria, Sllovenia, Kroacia, Shqipëria dhe Turqia) dhe nën 50 për qind në pronësi vendore.

Konsideroj se legjislacioni i sigurimeve ka mundësuar që sot në tregun e sigurimeve të Kosovës të kemi akterë të rëndësishëm, të cilët kanë eksperiencë evropiane, nga aspekti i vizionit të biznesit të sigurimeve, të qeverisjes, të dizajnit të produkteve, të transparencës së aktiviteteve të tyre dhe të menaxhimit të rreziqeve në sigurime.



Të gjitha primet për klasat e sigurimeve vullnetare janë të liberalizuara, ashtu që kompanitë e sigurimeve, bazuar në vlerësimet aktuaristike dhe rregullat e profesionit, në mënyrë të lirë i përcaktojnë ato, BQK e bënë aprovimin apo mosaprovimin e tyre.

E vetmja klasë e sigurimeve primet e së cilës, nga viti 1999, janë përcaktuar në mënyrë administrative nga ana e BQK-së ka qenë sigurimi i detyrueshëm ndaj palëve të treta nga autopërgjegjësia.

Vitin e kaluar, pas një konsultimi të gjerë me industrinë e sigurimeve dhe me mbështetjen teknike të Fondit Monetar Ndërkombëtar, BQK ka aprovuar rregullin e caktuar dhe ka bërë liberalizimin e kontrolluar edhe të primeve të kësaj klase të sigurimeve.

Sot, pas një viti eksperiencë me liberalizimin e kontrolluar të kësaj klase të sigurimeve, jemi në situatë që të vlerësojmë efektet e liberalizimit të kontrolluar në Kosovë.

Që të analizojmë anët e forta dhe të dobëta të tij dhe të përcaktohem për rrugën, që duhet ndjekur në të ardhmen, a të vazhdojmë edhe më tej me modelin e liberalizimit të kontrolluar apo të përcaktohem për liberalizimin e plotë të kësaj klase të sigurimeve?

Në këtë debat presim një rol angazhues dhe kontribut të industrisë së sigurimeve, Shoqatës së Kompanive të Sigurimeve, Qeverisë, Agjencionit për Konkurrencën, të shoqërisë civile, të ekspertëve të lëmisë, por edhe të ekspertëve të Bankës Botërore, Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe USAID.

Me lejoni të vlerësoj se rezultatet e arritura në vitin 2008, me gjithë zbatimin e liberalizimit të kontrolluar, kur çmimet e primeve të sigurimit të autopërgjegjësive mesatarisht ishin ulur për rreth 20 për qind, ishin pozitive. Primi i shkruar i sigurimeve në vitin 2008 ka qenë më i lartë për 11 për qind në raport me vitin 2007.

Primi i shkruar i sigurimit të detyrueshëm të autopërgjegjësive ka pasur një ngritje të lehtë në vitin 2008 krahasuar me vitin 2007 në lartësi prej 2 për qind. Gjithashtu, në vitin 2008 krahasuar me vitin 2007 ka pasur një rritje prej 72 për qind të sigurimeve vullnetare.

E vlerësoj se kjo rritje ka qenë edhe rezultat i zbatimit të liberalizimit të kontrolluar të produktit të autopërgjegjësive, sepse disa kompani të sigurimeve kanë ndërruar strategjitë e tyre, duke u orientuar drejt zhvillimit të tregut të sigurimeve vullnetare.

Kjo tregon se liberalizimi i kontrolluar i TPL ka ndikuar që kompanitë të fillojnë të mendojnë ndryshe, që kompanitë të fillojnë të ecin vetë, që kompanitë të mos ndjehen si fëmijë i vogël, ku dikush duhet t'i mbajë për dore apo që dikush t'i mësojë se si duhet ta bëjnë biznesin.

Si Autoritet nuk jemi të interesuar të kthehemi në rregullimin administrativ të primeve të sigurimit të palëve të treta nga autopërgjegjësia, thjeshtë sepse konsiderojmë se rregullimi administrativ është një etapë e kaluar në zhvillimin e industrisë së sigurimeve në Kosovë.

Rregullimi administrativ i tarifave të TPL në njëfarë mënyre ka nënkuptuar angazhimin e autoritetit rregullator në mbrojtjen e interesave të kompanive të sigurimit.

Tregu i liberalizuar nënkupton angazhimin e Rregullatorit në mbrojtjen e interesave të konsumatorit, të policëmbajtësit.

Prandaj, me rregullën 8 të BQK, është ridizajnuar roli i mbikëqyrjes së sigurimeve duke kaluar nga koncepti i mbikëqyrjes të bazuar në rregulla në mbikëqyrjen apo rregullimin e kompanive të sigurimit bazuar në risk.

Janë ridizajnuar format e raportimit për njësinë e monitorimit nga jashtë dhe janë dizajnuar manualët e inspektimeve në vende të kompanive të sigurimit, ku vend qendror zënë: funksionimi i qeverisjes kooperative, të sistemit të kontroleve të brendshme, të sistemit informativ të menaxhmentit, mirëmbajtja e nivelit të solvencës të kërkuar, mirëmbajtja e rezervave teknike, aplikimi i drejtë i standardeve të raportimit financiar dhe të standardeve të kontabilitetit, mirëmbajtja e nivelit të likuiditetit, vlerësimi i sistemeve të menaxhimit të riskut siguroes dhe të riskut operacional, të vlerësimit të programeve dhe kontratave të risigurimit, të vlerësimit dhe implementimit të rekomandimeve të raporteve të auditorëve të jashtëm dhe në veçanti të korrektësisë së raporteve me policëmbajtësit dhe të trajtimit korrekt të dëmeve.

BQK si objektivi ka përgatitjet për fillimin e implementimit të kërkesave të Solvencës II.

Me qasjen e re, në fokus të Rregullatorit nuk është rregullimi i tregut, por krijimi i standardeve për një garë korrekte në treg, sepse tregu është ai që duhet ta rregullojë pozitën e secilës kompani veç e veç, duke u bazuar në konkurrencën dhe kualitetin e shërbimeve dhe në transparencë.

Rritja e konkurrencës nënkupton zhvillim të kompanive të sigurimeve, zhvillim të kapaciteteve të tyre menaxhuese, rritje të cilësisë së shërbimeve të tyre, vënie në epiqendër të klientit dhe të interesave të tij. Kompanitë e sigurimeve ekzistojnë, për shkak të klientëve dhe mbulimit të rreziqeve të tyre.

Prandaj, trajtimi adekuat i klientëve dhe të drejtave të tyre për kompensim të dëmit, në rast të ndodhjes së rastit të siguruar, meriton një qasje dhe trajtim më cilësor. Pra, rritja e konkurrencës nënkupton dinamizëm, zhvillim, përgjegjësi dhe transparencë.

Prandaj, në këtë aspekt ne nuk kemi dilema dhe unë mendoj që duhet të ecim më guximshëm në këtë drejtim, sepse kjo qasje do ta mundësojë zhvillimin dhe rritjen e tregut të sigurimeve në Kosovë.

Personalisht jam për liberalizimin e plotë të primeve të sigurimeve të autopërgjegjësive. Por, në këtë drejtim duhet të ecim me kujdes, duke u mbështetur në analiza dhe vlerësime profesionale. Për këtë qëllim, BQK ka kërkuar asistencë nga Banka Botërore. Do të kemi disa misione të ekspertëve të Bankës Botërore, të cilët do të vlerësojnë aspekte të veçanta të kësaj çështjeje.

Aktualisht është angazhuar eksperti, i cili do të bëjë vlerësime aktuaristike të adekuatshmërisë së primeve të sigurimeve TPL, të adekuatshmërisë së rezervave teknike të secilës kompani, si dhe të fuqisë së tyre financiare.

Ne presim që pas marrjes së raportit dhe rekomandimeve të tij të vlerësojmë më saktë se a duhet të fillojmë me liberalizimin e plotë apo të vazhdojmë edhe për një kohë me liberalizimin e kontrolluar. Sigurisht se në këtë përcaktim industria e sigurimeve do të jetë e kyçur në mënyrë aktive.

Ky vendim duhet të merret para se të finalizohet puna e filluar në përgatitjen e Ligjit të ri për sigurimet. Objektiv kryesor i BQK në përgatitjen e ligjit të ri për sigurimet është që të përafrohemi me direktivat e Bashkimit Evropian, duke respektuar veçoritë e Kosovës.

Gjithashtu, me ndihmën e ekspertit të Bankës Botërore jemi duke përgatitur edhe Ligjin mbi sigurimet e detyrueshme. Në këtë fazë është kyçur edhe industria e sigurimeve, si dhe palët tjera të interesuara në Kosovë, Qeveria dhe ministrinë përkatëse.

Sigurisht se ky është një rast i mirë që bashkërisht të përgatitim një ligj të mirë, i cili do ta rregullojë çështjen e sigurimeve të detyrueshme.

Përveç kësaj përmes ligjit duhet të rregullohet themelimi i Byrosë së Kartonit Jeshil, sepse ne realisht presim se Kosova do ta rregullojë çështjen e anëtarësimit në Byronë ndërkombëtare të Kartonit Jeshil, i cili do t'u sigurojë qytetarëve të Kosovës lëvizjen e lirë dhe tejkalimin e barrierave dhe ngarkesave financiare, që iu bëhen sot atyre përmes pagesave të sigurimeve kufitare.

Duhet ta rregullojmë më mirë dhe ta fuqizojmë funksionimin e Fondit të Garancisë, si dhe themelimin e Qendrës Informative të Sigurimeve, e cila do të rritë transparencën e punës dhe edukimin e policëmbajtësve.

Dua të përgjigjem në dilemën që u shtrua se Fondi i Garancisë mund të preket nga falimentimi i ndonjë kompanie të sigurimit. Është e vërtetë se ligji apo rregullat ekzistuese e ofrojnë këtë mundësi.

Mirëpo, dua t'ju siguroj se kompanitë në Kosovë kanë kapitalin themeltar në shumë prej 3 milionë euro të ngurtësuar gjatë gjithë aktivitetit të tyre siguroes dhe i cili mund të aktivizohet vetëm në rast të likuidimit apo ndërprerjes vullnetare të aktivitetit të tyre.

Vetëm pas përmbushjes së detyrimeve të kompanisë ndaj dëmeve dhe kreditorëve të tjerë pjesa e mbetur e kapitalit i transferohet pronarëve. Prandaj, si mbikëqyrje kemi përgjegjësi që të sigurohemi që kjo barrë të mos bie në Fondin e Garancisë.

Sigurisht se te Fondi i Garancisë ka disa çështje tjera që duhet rregulluar, si: zgjidhja e çështjes së pagesave të dëmeve kur fajtor janë motoristët nga Serbia dhe Mali i Zi, e të cilët nuk kanë mbulesë siguroese për Kosovë, që paguhet nga Fondi i Garancisë, i cili financohet nga kompanitë e sigurimit të licencuara në Kosovë.

Pse në vazhdimësi kemi rritje të dëmeve në Fondin e Garancisë, a është kjo pasojë e rritjes së automjeteve të pasiguruara në Kosovë, apo cili është problemi? Apo ndikojnë në këtë rritje të automjeteve të pasiguruara edhe kushtëzimet e disa administratave komunale për regjistrimin e automjeteve me pagesën e tatimeve në pronë?

Po e përmbyll fjalimin, duke vlerësuar edhe njëherë se për mua dilema është artificiale ndërmjet liberalizimit dhe rregullimit administrativ të primeve të sigurimeve për produktin TPL.

Sigurisht se socializmi si sistem nuk do të ishte shkatërruar në qoftë se do të ishte dëshmuar se rregullimi administrativ i çështjeve është më i mirë se sa ekonomia e tregut të lirë. Kompanitë e sigurimeve duhet të marrin përgjegjësitë e veta. Ekonomia e tregut nënkupton hyrjen në treg dhe daljen nga tregu.

I inkurajoj kompanitë e sigurimeve të Kosovës, Shoqatën e Kompanive të Sigurimeve të Kosovës që më fuqishëm dhe më guximshëm të përvetësojnë vlerat e ekonomisë së tregut.

Si Bankë Qendrore, si rregullator dhe mbikëqyrëse e industrisë së sigurimeve, jemi të vendosur që të ecim fuqishëm në këtë drejtim dhe të sigurojmë qëndrueshmëri dhe prosperitet të industrisë së sigurimeve në Kosovë.



## **SESIONI I DEBATIT**

## NË KOSOVË NUK KA BAZË QË MENJËHERË TË MENDOHET PËR LIBERALIZIM

**Besnik Nikçi, ekspert i pavarur**

Pritet që në Kosovë së shpejti, përfundimisht, lëmi i sigurimeve të detyrueshme të rregullohet me ligj. Duket se një pjesë (disa dispozita ) të këtij ligji do ta rregullojnë edhe çështjen e mbikëqyrjes së këtij lloj sigurimi. Andaj, tema e parashtruar për trajtim dhe debat rezulton si tepër aktuale.

Pas asaj që tha Guvernatori, posaçërisht kisha potencuar se nuk ka vend për dilema në pyetjen e parë: Plotësisht pajtohem se nuk ka dilema të ketë liberalizim apo jo. Kjo (liberalizimi) nuk është vetëm në trend, siç thotë Ibishi, por është edhe më shumë kërkesë. Sikur të ishte trend mund ta zgjidhnim edhe me ndonjë improvizim, por pasi që është kërkesë duhet qasje serioze lidhur me atë si ta përmbushim.

Lidhur me liberalizimin në Kosovë shtrohet pyetja - kur dhe në cilat kushte? Kur i referohemi Kosovës lidhur me liberalizimin, duke pasur parasysh problemet, sfidat dhe përvojën e vendeve në rajon, posaçërisht lëmisë së sigurimeve të detyruara, duhet kushtuar rëndësi të posaçme dhe kujdes të theksuar.

Kjo çështje në Kosovë parashtrohet si shumë delikate dhe këtë duke pasur parasysh natyrën e posaçme juridike dhe funksionin shoqëror që ka sigurimi i detyruar, por edhe nga vetë fakti se portofoli i sigurimeve të Kosovës kryesisht përbëhet nga ky lloj sigurimi, që deri vonë participon me afro 90 për qind në portofolin e gjithëmbarshtëm të sigurimeve kosovare.

Kur jemi te sigurimet e detyruara duhet të nisemi edhe nga vetë koncepti (kuptimi) i sigurimeve të detyruara. Nuk është diçka vullnetare, por diçka që imponohet prej vetë shtetit, si një sistem i posaçëm sigurimi për mbrojtje të automobilistëve dhe palëve të dëmtuara.

Sistem që duhet të funksionojë dhe në asnjë mënyrë të mos dështojë – për çfarë mbikëqyrja permanente dhe kualitative është e domosdoshme. Kjo në asnjë mënyrë nuk përjashton liberalizimin në këtë lëmi, por rezulton se ai duhet të jetë i një regjim i posaçëm.

Çdo intervenim i shtetit në këtë lëmi nuk duhet kuptuar si mohim i iniciativës apo kërkesës për realizim të liberalizimit, por në këto relacione duhet të ketë bashkërenditje dhe akordim. Dhe shkurt, qëndrimi im lidhur me liberalizimin në lëmin e sigurimeve të detyruara është: liberalizim të plotë në këtë lëmi nuk mund të ketë, por një lloj i liberalizimit të kontrolluar. Sa i kontrolluar do të jetë liberalizimi varet nga zhvillimi social e ekonomik i një vendi, kërkesat që shoqëria i parashtron para këtij sistemi mbrojtës dhe gatishmëria e tregut të sigurimeve për ofrimin e këtij servisi.

Nëse e shikojmë rezultatin financiar apo rezultatet teknike të sigurimeve të detyruara në Kosovë, në këto dhjetë vjet, shtrohet kërkesa urgjente se duhet të ketë liberalizim. Pse? Sepse rezultoni se çmimet e servisit të sigurimit (primi) janë përcaktuar me administrimin e kësaj çështje nga shteti ( BQK) gabimisht - prime shume më të larta se që duhej.

Dëmet në sigurimet e Kosovës pariticipojnë në primin e realizuar diku 30 për qind, që mund të konsiderohet rezultat i jashtëzakonshëm apo një rekord botëror në sigurimet e detyruara. Andaj, logjike do të ishte kërkesa që shtetit ( BQK) t'i thuhet mjaft në rregullimin e çmimeve dhe vetëm liberalizimi të kërkohet si zgjidhje.

Mirëpo, nuk besoj se ky përfundim logjik është edhe i drejtë. Kjo nga arsyeja se përfundimi i ynë mbështetet në disa të dhëna mbi të cilat nuk mund të fitohet përshtypja për rezultatin real meritot teknik.

Andaj, pranimi i një kursi krejtësisht tjetër me një autonomi të pakufizuar të sigurveve mund të ketë pasoja të paevitueshme. Duhet siguruar parakushte dhe lypset edhe pak kohë, që të mund t'u lejojme sigurveve, që ta bëjnë përcaktimin e çmimit (primit të sigurimit).

Parakushti elementar për llogaritje të një primi meritot konsiston në një bazë të shënimeve kualitative statistikore sipas standardeve të mirënjohura.

Pra, jo vetëm të evidencës kualitative të primit dhe pagesave të dëmeve, por edhe shënime meritore për dëmet e raportuara, frekuencën e dëmeve dhe të varieteteve të dëmeve, dëmet e rezervuara, primet e bartura etj.

Sa për ilustrim i referohemi vetëm një segmenti të këtyre shënimeve statistikore në Kroaci, ku p.sh. dëmet e rezervuara kontestuese nga ato ordinere janë deri 4-5 herë më të larta.

Ky pozicion është komplet relativ apo i panjohur në Kosovë, në mungesë të shënimeve adekuate. Andaj, në këtë situatë, duhet kuptuar rezervën time për çdo përfundim lidhur me rezultatin real teknik të sigurimeve të detyruara në Kosovë.

Përmenda rekordin botëror në rezultatin teknik prej 30 për qind të pjesëmarrjes së dëmeve në premi sigurimi, por është ilustrative, bazuar në shënime të disponueshme, në të cilat nuk mund të mbështesim përfundimet tona.

Aq sa dikush ka të drejtë në konkludimin se rezultati teknik në sigurimet e detyruara në Kosovë është tepër profitabil dhe me prime të larta, po aq ka të drejtë tjetri të shprehë rezerva lidhur me rezultatin teknik, duke pohuar se primi është i pamjaftueshëm!

Pra, për një kohë, duhet lidhur me politikën e primeve të sigurimeve të detyruara në Kosovë të ngelë në aplikim rregullimi administrativ me pershpejtim të inkorporimit të elementeve të liberalizimit.



Pra, një model i kombinuar, i cili veç aktualisht është në aplikim, por me një trajtim në avancim dhe perfeksionim të metutjeshëm.

Duke pasur parasysh interesin shoqëror të ruhet sistemi i sigurimeve të detyruara nga dështimi eventual, konkretisht, propozimi im koniston që për një periudhë disavjeçare duhet përcaktuar primin minimal teknik (primi funksional) dhe në pjesën shtesë të saj kompanitë siguroese të punojnë në individualizimin e primit.

**Halit Shabani, Anëtar i Bordit të Komisionit të Konkurrencës së Kosovës**

## **LIGJI PËR KONKURRENCËN E KOSOVËS OBLIGON QË ÇMIMET TË PËRCAKTOHEN NGA TREGU**

Unë vij nga Autoriteti i Konkurrencës së Kosovës, që jemi aprovuar nga Parlamenti në 2008, dhe zbatojnë ligjin 2004/36. Nuk do të hyjë në format e kalkulimit apo të rrisqeve në industrinë e sigurimeve, ani pse dëgjova ekspertë të ndryshëm dhe kam kënaqësinë që të gjithë të thirrurit për industrinë e sigurimeve dhe pikërisht Guvernatori me Drejtorin e Mbikëqyrjes së Sigurimeve që janë prezent.

Mirëpo, unë do të thirrem vetëm në Ligjin mbi Konkurrencën në Kosovë. Ky ligj tani bazohet kryesisht në tri shtylla, që janë: abuzimi me pozitën dominuese, marrëveshjet e ndaluara apo forma kartel, bashkimi ose përqendrimi i ndërmarrjeve. Kur them ndërmarrjet e kam parasysh të gjitha format dhe llojet e bizneseve në Kosovë.

Realisht nga kjo fushë e këtij ligji do të kishim mundur të inkuadrohem te përcaktimi apo formimi i çmimit shitës. Dëgjova të gjithë pjesëmarrësit këtu dhe në veçanti Guvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës.

Siç e dini, edhe unë kam qenë një pjesëmarrës i industrisë së sigurimeve dhe duhet të them se jam njëri nga akterët e dikurshëm në industrinë e sigurimeve, mirëpo pa e njohur atë dhe pa e konsultuar Ligjin mbi konkurrencën, të cilin sot e zbatoj. Realisht bisedat të cilat u dëgjuan nga pjesëmarrësit shpeshherë bien ndesh me Ligjin për Konkurrencën e Kosovës.

Ne të këtij Autoriteti jemi ithtar apo zbatues të këtij ligji, i cili obligon që konkurrenca të jetë e lirë dhe çmimet të mos përcaktohen nga individë apo grupe, mirëpo çmimet të jenë të lira dhe të përcaktohen nga tregu.

Ne komplet vijmë nga ish-shtetet e sistemit socialist dhe e përkrahi Guvernatorin kur thotë se kjo ‘me qenë mirë do të ishte jetuar’. Po shihet se çmimet e caktuara apo të dirigjuara janë çmime, të cilat nuk mund të funksionojnë dhe nuk janë të drejta, ngase e ndrydhin konkurrencën mes kompanive dhe në veçanti e dëmtojnë edhe vetë konsumatorin.

Ne kemi konsultuar edhe autoritetet e rajonit. Para pak kohe ishim për vizitë edhe në Shqipëri ku realisht kemi një ndihmesë të madhe të Autoritetit të Konkurrencës së Shqipërisë dhe po ashtu edhe të Kroacisë.

I gjithë rajoni bazohet në nenin 81 dhe 88 të Traktatit, d.m.th. në unifikimin e ligjeve të Unionit Evropian, në veçanti dhe më gjerë. Ne si Autoritet kemi menduar dhe kemi disa marrëveshje memorandumi apo të mirëkuptimit sidomos me Ministrinë e Tregtisë, atë të Financave, me Bankën Qendrore e kemi përgatitur, por ende nuk kemi arritur te nënshkrimi i kësaj marrëveshje.

Me Doganat e Kosovës, Administratën Tatimore, Odën Ekonomike të Kosovës, Entin Statistikor të Kosovës, Aleancën për Biznes, të gjitha gjykatat e Kosovës, si dhe organet tjera rregullative të Republikës së Kosovës.

Autoriteti i Konkurrencës së Kosovës është në muajt e parë të fillimit të punës dhe jemi duke u përgatitur me staf profesional, i cili do të mirret me fushat e cekura me lartë. Aty ku ka prejke të çmimit vjen në fushën e këtij ligji.

Përfitoj rastin që t'i ftoj akterët rregullativ apo përpilues të ligjeve, që të kemi një bashkëpunim, që ligjet në një të ardhme të shpejtë mos të bien ndesh njëri me tjetrin, por të jenë të harmonizuara dhe kjo do t'i shkojë në favor zhvillimit ekonomik në një ekonomi të tregut në Kosovë.

**Fatmir Gashi, Kryetar i Bordit të Kosovës për Standardet e Raportimit Financiar pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave**

## **LIBERALIZIM I TEPRUAR NË KUSHTE TË BALLKANIT ËSHTË SHUMË VËSHTIRË**

Dua të sqaroj dy gjëra. Më duket si pakeqkuptim u lidhën me liberalizimin dhe kthimin pas. Unë me atë që thashë nuk isha të kthehemi pas, por të ecim përpara, të ecim me një platformë, e cila është e qëndrueshme dhe na mban mirë, e jo të ecim në dërrasa të kalbta, në të cilat mundemi m'u rrëzuar.

Kërkova që të ngritet niveli ligjor, legjislacioni ambiental i Kosovës në lidhje me liberalizimin e kësaj pjese të sigurimit. Liberalizimi apo sigurimet e obligueshme nuk mund të thuhet, as nuk mund të quhen "hajde po bajna si po shesim specat në treg". Tregu, oferta dhe kërkesa po na përcaktojnë. Ajo nuk bën ashtu, d.m.th duhet të përcaktohet një minimum ligjor, ku do të mbrohen policëmbajtësit.

Këtu është qëllimi m'i mbrojtur njerëzit dhe nuk është shitje dhe plaçkitje. Këtu kemi me mbrojt qytetarin, d.m.th qëllimi kryesor i shitjes është mbrojtja. Tërë ato pare që i mbajnë kompanitë e sigurimeve nuk janë pare të tyre. Këto çështje kur mbrohen, duhet me pas shumë kujdes.

Ai liberalizim duhet me qenë jo i kontrolluar, por më shumë se i kontrolluar. Në daç të doket sistemi i Enver Hoxhes në daç mos të doket, ama duhet m'u kontrolluar.

Në qoftë se paraaja publike nuk kontrollohet atëherë je anarki, nuk je liberalizëm. Në qoftë se bankat nuk kontrollohen dhe lënë që depozitat të humbin ato nuk kanë lidhje me liberalizim. Në qoftë se kompanitë e sigurimit i lëshon me bërë kush çka të dojë e nuk i kontrollojnë atëherë nuk ka liberalizim.

Liberalizim i tepruar në kushte të Ballkanit është shumë vështirë. Nuk jemi Bashkim Evropian. Këto janë gjëra të cilat duhet shumë serizosht m'i menduar. Për atë arsye, po them se duhet të kemi kujdes, liberalizim po, ama një liberalizim, i cili ka bazë ligjore, i cili nuk lejon që të shkojë një kompani, e të gjitha kompanitë tjera të likudohen si në Greqi dhe pastaj çka do të bëjmë, do të ngritim sistem të ri në Kosovë.

Unë jam për atë që duhet të ketë një lojë. Është paraqitur kërkesa, që i kemi bërë çmimet më të ulëta, kjo është e vërtetë dhe të gjithë e dimë.

Në qoftë se i analizojmë mirë, më vonë po shihet se janë gabimet e menaxherëve edhe atyre që i kanë paraqitur ato kërkesa, që në momente të caktuara kanë qenë për shkak të konkurrencës së tregut.

Unë kërkesën e parë e kam pasur 3.49 çmimin dhe jam ra drastik në treg, sepse e kanë pasur të tjerët 25 për qind. Duhet me qenë real kështu ka qenë loja dhe pastaj kemi luajtur të gjitha nga 25, për me mund me mbet në treg gjallë siç jemi.

Por, Rregullatori nuk do të thotë m'i marrë licencën dikujt. Në qoftë se unë i kam paraqitur çmimet dhe më vonë është konstatuar se kjo kompani ka probleme me këto çmime, ka probleme të Solvencës, duhet me ia tërheqë ato çmime dhe m'i thënë se këto nuk pranohen dhe prej sot duhet m'i ndërruar çmimet.

Këto janë ato kërkesat e mia për rregullim ligjor, si Autoritet Rregullativ me ia dhënë pjesën qendrore ku ajo e merr përgjegjësinë e vet ndaj qytetarëve, jo ndaj kompanive të sigurimit. Ky është mendimi im, e jo që ne mos me pas liberalizim, larg asaj, por në një fazë kontrolli.

Mua po me pëlqen shumë puna e kroatëve. Merrni tranzicionin apo liberalizimin në Slloveni, që as edhe një dridhje se ka bërë. As nuk e kanë prekur Ligjin për konkurrencën, as kanë bërë asgjë. Ne kemi shkuar në garë 'alla greke'. Nuk bën! Kjo është ajo që ne duhet të ulemi e të disiplinohe mi.

Unë prej nisem prej vetit, ne kemi thënë se ne jemi ata akterët që duhet m'i pasur kamxhikët në dorë dhe me na ndalë, duhet me qenë kështu, sepse nuk bën ndryshe. Të shkojmë njëri pas tjetrit dhe pastaj është dëm aq i madh, sa nuk na duhet më asgjë me na shkuar në sistem financiar. Mos më keqkuptoni që jam kundër, gjithsesi jam për liberalizim, ama të shkojmë në hapa të sigurtë.

## MOS FRIKOHENI NGA PROCESI I LIBERALIZIMIT

### MSc. Hashim Rexhepi, Guvernator i Bankës Qendrore në Kosovë

Sigurisht që në fjalët që kishim më herët, për shkak të kohës së limituar, nuk kemi mundur të përfshijmë të gjithë aspektin e liberalizimit, në veçanti rolin e Rregullatorit dhe kornizën ligjore dhe mbikëqyrëse, e cila duhet të përcjellë mirë procesin e liberalizimit.

Nuk nënkupton liberalizimi krijim të kaosit, nuk nënkupton që sigurimet nuk janë edhe asnjëherë nuk mund të jenë si tregu i gjelbërt, po janë shitje e diçkaje që qiguron, që në qoftë se qytetari është siguruar ai duhet të jetë i sigurt që kompensohet, për shkak të vlerës së policës së sigurimit.

Në cilin aspekt duhet ta shohim liberalizimin! Unë asnjëherë nuk mendova që është tendeca e kthimit në rregullimin administrativ të primit dhe çfarë ka qenë dikur. Ne duhet të ecim në drejtim, në të cilën sot janë ekonomitë e zhvilluara, industritë e zhvilluara të sigurimeve.

Normal që kjo punë nuk do të ndodhë nesër, kërkohet një punë sistematike dhe do të ketë debat gjithëpërfshirës me gjithë akterët, në mënyrë që të kemi një kornizë ligjore, e cila është e qëndrueshme dhe siguron zbatimin e liberalizimit të tregut të sigurimeve.

Ne kemi një koncept në të cilin drejtim është duke udhëhequr Unioni Evropian. Ne jemi anëtarë me të drejta të plota në IAYE dhe e shohim se në çfarë drejtimi është duke ecur industria e sigurimeve në botë.

Ne pak a shumë kemi filluar të jemi familjar në konceptin e Solvencës II, dhe kërkesat që parashtron Solvenca II, e cila kupton një qasje krejt tjetër, një biznes sigurimesh, i cili menaxhohet krejt ndryshe, si dhe një pozicion të Autoritetit Rregullativ, i cili e ka qasjen krejt ndryshe, me atë se si ka qenë deri sot.

Kështu që mos të ekzistojë ndonjë brengë që ne do ta bëjmë këtë nesër, pa e trajtuar çështjen në mënyrë serioze dhe e pa e krijuar kornizën adekuate ligjore dhe mbikëqyrëse për të qenë e sigurtë se nuk do të ndodhë ajo, nuk do të ndodhë kaosi. Është përgjegjësia jonë që mos të ndodhë ajo.

Ne më shumë seriozitet e marrim këtë pjesë të përgjegjësisë. Mendoj se Besnik Nikçi në diskutimin e tij pati qasje profesionale dhe shumë tenkike, që duhet ta kemi parasysh të gjithë. Në qoftë se raporti dëme-prime aktualisht sillet rreth 34 për qind tregon edhe më tej se primet janë të larta.

U fol se nuk kemi të dhëna, nuk kemi informacione në veçanti rreth dëmeve, rreth rezervave teknike, rreth primit të bartur etj., por unë konsideroj se kemi ndërtuar një sistem mjaft të mirë informativ dhe statistikor sa i përket dëmeve.

Të gjitha dëmet raportohen në sistemin online dhe raportohen sipas ligjit në periudha të caktuara.

Nga të gjitha inspektimet tona, që kemi bërë në kompanitë e sigurimit, kemi hasur shmangie shumë të vogël midis gjendjes së dëmeve të raportuara te ne dhe ajo se si qëndron reale në kompani. Kjo tregon se kemi ndërtuar një sistem të qëndrueshëm të raportimit.

E dyta, normal që vërehet një trend i mospërgjegjshëm te kompanitë e sigurimit në trajtimin korrekt dhe pagesën me kohë të dëmeve. Prandaj, në qoftë se i merrni analizat statistikore dhe pasqyrat tani vjetore, kur bëhen sa i përket dëmeve, ju duhet të vëreni se raporti i dëmeve të paguara dhe dëmeve pezull, apo që janë në proces, është përafërsisht 1 me 2.

Kjo do të thotë se kompanitë shkaktojnë vonesa në trjatinin e dëmeve. Por, klientët janë edukuar gjithnjë më shumë dhe nuk pranojnë më çfarëdo formë të kompensimit të dëmit dhe kërkojnë të drejtën e tyre të garantuar, qoftë me ligjin detyrimor, qoftë me atë rregullin tonë të paaprovuar ndonjëherë, po flas për kriteriumet minimale.

Mirëpo, e kemi edhe një fenomen në treg edhe në këtë ambient, ku zhvillohet biznesi i sigurimeve, që tani është krijuar një shtresë e avokatëve, të cilët e shohin më shumë përfitim trajtimin e lëmisë së dëmeve.

Shpeshherë dëmet shkojnë në gjykata, pa u paralajmëruar në kompani të sigurimit, apo zvarriten në gjykata, në mënyrë që të dalë fitimi më i madh për avokatët, sepse gjykatat gjithmonë sjellin disa vendime që janë më të larta për kompensim të dëmit, se sa e bëjnë kompanitë e sigurimit.

Prandaj, ndoshta dhe ky faktor është shkaktar që të kemi këtë raport të dëmeve. Rezervat teknike të kompanive janë të qëndrueshme dhe mbulojnë detyrimet e tyre.

Situata është e ndryshme varësisht prej kompanisë në kompani. Kjo është edhe efekt i liberalizimit të kontrolluar, që disa kompani të sigurimeve veç kanë filluar të ballaqohen me probleme serioze, që të përmbushin detyrimet e tyre ligjore në aspektin e afarizmit të sigurimeve.

Dilema se a duhet ngutur, të cilën e parashtrori Besniku dhe a duhet pasur një Autoritet Rregullativ, i cili pak më ndryshe operon dhe mbikëqyrë, unë mendoj që është me vend.

Ne asnjëherë si Bankë Qendrore e Kosovës nuk kemi marrë vendime të njëanshme të shpejta pa konsultim shumë serioz me kompanitë e sigurimeve dhe me akterë tjerë që janë të interesuar. Andaj, unë ju them se mos frikoheni nga procesi i liberalizimit.

Mendoj se një nga ata pjesëmarrësit, i cili sot udhëheq një kompani të sigurimit, z.Gashi, më së miri e ka kuptuar këtë proces dhe ka parë reformat strukturore brenda kompanisë, që t'i përshtatemi kohës, kushteve dhe kërkesave, në të cilat kalon sot tregu i sigurimeve.

Në këtë mënyrë jeni bërë faktor nxitës i lëvizjeve brenda tregut të sigurimeve. Konkurrenca është ajo që ju ka detyruar m'u zvilluar, jo Autoriteti Mbikëqyrës, jo rregullimi administrativ. Ku qëndrojnë rezervat?

Neve për herë të parë në këtë vit e kemi raportin e kombinuar të shpenzimeve diku 88 për qind, që flet se kompanitë me investimet si asete kanë një fitim të konsiderueshëm. Por, në qoftë se figuron raporti i shkallës se shpenzimeve 100, do të thotë se ju jeni duke punuar me humbje.

Prandaj, çështja e parë që parashtrohet është çështja e nikorqillëkut të udhëheqjes së biznesit. Për herë të parë na kanë rënë shpenzimet administrative, apo shpenzimet operacionale të kompanive në masën 49 për qind.

Ne në kontinuitet kemi pasur pjesëmarrjen e shpenzimeve operacionale të kompanive të sigurimit në masën deri në 70 për qind, që flet për dy aspekte: faktori abuziv brenda kompanisë, shfrytëzimi i pozitës së profitabilitetit të madh për shkak të primeve të larta dhe marrja e rrogave luksoze, kerreve luskoze, telefonave, shëtitjeve etj., që duhet ndaluar dhe ndarë fatin e sektorit real të kompanisë, sikurse duhet ndarë edhe bankat.

Për shkak të rregullimit administrativ, të cilin të gjitha kompanitë individualisht dhe kolektivisht e kanë akuzuar, për shkak të dhënies se zbritjes së çmimeve në mënyrat e veta se i kanë ditur t'i bëjnë. Dhe çka kemi krijuar?!

Kemi krijuar një masë tërë të ashtuquajturve agjentë, të cilët kanë qenë përfituesit më të mëdhenj nga rregullimi administrativ, që u bënë gati edhe drejtues të kompanive të sigurimeve.

A duhet ndërprerë këtë trend, duhet ndërperë! Prandaj, paraja e fituar nga sigurimi në radhë të parë duhet të jetë e dedikuar për mbulimin e dëmeve të sigurimit. Ajo është alfa-omega e sigurimeve.

Kostoja operative e kompanive në tregje të zhvilluara ndërkombëtare sillet mes 12 për qind, jo 49. Raporti dëme –prime në shtete, nuk di në Kroaci, sigurisht është nga 70-80 për qind, ne e kemi 30 për qind, prandaj këtu duhet gjetur motivin pse ka hapësirë për rritje të efektivitetit në përgjithësi, të uljes së koston operative dhe të fuqizimit dhe kapitalizimit më të fuqishëm të kompanive të sigurimit, në mënyrë që të mund t'i përgjigjen sfidave të ardhshme të zhvillimit të këtij tregu, për shkak se ne jemi në fazën fillestare.

Jemi duke operuar me tregun e sigurimeve të detyrueshme të autopërgjegjësishë. Prandaj, kompanitë duhe përgatitur që të kenë kapital të mjaftueshëm në mënyrë që të ballafaqohen nesër me rrisqe shumë më të mëdha.

Në atë drejtim, unë në fillim e parashtrova dilemën, që s' duhet të ketë dilemë midis liberalizimit si koncept, si nocion edhe rregullimit administrativ.

Për mua kjo është e qartë, jemi plotësisht për atë që të ecet fuqishëm bashkarisht në adaptimin e ligjit të ri, të rregullës së re dhe përgatitjes suaj për liberalizim të plotë të sigurimit të TPL, por edhe ngritjes së kapaciteteve të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimit, që të mund ta mbikëqyrë në mënyrë cilësore sigurimin.

Nga kjo do të përfitojë mbi të gjitha konsumatori, klienti, do të përfitojë ekonomia, sepse sigurimet do të jenë më akumulative dhe do të sigurojnë fonde për zhvillimin ekonomik, do të përfitojë shteti, për shkak se shumë rrisqe, të cilat në forma të ndryshme shteti i ka mbuluar në kohën e socializimit apo edhe tani, do të barten te individit dhe te kompanitë e sigurimeve, kështu që rruga e zhvillimit është shumë më e drejtë dhe më prosperuese.

**H. Shabani:** Ne në parim të gjithë po pajtohemi për diçka, por është shumë interesant të dihet se ku duhet Autoriteti ta bëjë mbikëqyrjen.

Realisht, Autoriteti Mbikëqyrës jo vetëm te sigurimet, por në çdo vend tjetër ku duhet të ndërhyjë, ai duhet të ndërhyjë (më falni pasi është fjala për industrinë e sigurimeve, duhet të kuptohemi).

Autoriteti në këtë rast duhet të ketë vëmendje pikërisht te Solvenca e kompanisë, likuiditetin e kompanisë apo, siç tha Guvernatori, te shpenzimet e kompanisë. Të mbikëqyrën të gjitha këto, pra atëherë edhe nga kompanitë do të jetë një vizion tjetër për tregun, e jo që të kërkohet nga Autoriteti që të ndërhyhet te çmimi.

Çmimet do t'ia lëmë ofertës dhe kërkesës. Kompania mund ta kalkulojë një çmim të vetin në bazë të llogarive të kompanisë, e cila e bën vetë kalkulimin e një çmimi, e pastaj të dalë në treg me çmim, por jo që çmimi të jetë një çmim i përcaktuar nga Autoriteti dhe Autoriteti pastaj ta monitorojë atë çmim, kush e prish çmimin apo kush e then. Realisht, me një formë të tillë ne po biem ndesh edhe me ligjin në fuqi, por edhe me vetë parimet, të cilat dalin nga ato që u thirren dhe u thanë deri më tani.

## **LIBERALIZIMI NUK DO TË THOTË ÇMIMI ULËT**

### **Hrvoje Paukovic, Drejtor gjeneral i Byrosë kroate të Sigurimeve në Kroaci**

Në një anë shohim interesin e të siguruarit, mandej interesin e Organit Mbikëqyrës, i cili është i angazhuar për konkurrencë. Si qytetar, po. Unë do ta kisha thënë një gjë: Liria dhe të drejtat e individit si konsumator i shërbimeve të sigurimit janë të kufizuara me liritë dhe të drejtat e konsumatorëve tjerë.

Nëse për shkak të formimit të lirë të çmimeve të shërbimeve të sigurimit vjen deri të rrënimi i veprimtarisë, megjithë që unë besoj se Organi Mbikëqyrës do të bëjë presion, që kjo të mos ndodh, jemi të vetëdijshëm se barrën do ta bartin konsumatorët tjerë, me ç'rast, deri në dy vjet, shoqëritë siguruese do të jenë të detyruara të paguajnë në të ashtuquajturin Fond Garantues, për t'i kompensuar dëmet, kështu që çmimet gjithsesi do të rriten.

Prandaj, nuk do të thotë se duhet të drejtat e konsumatorëve të trajtohen vetëm në afat të shkurtër dhe të shikohet që çmimi për konsumatorët të jetë i ultë. Liberalizimi fare nuk do të thotë çmim i ulët. Kjo është si te ju, edhe te ne. Kjo është normale. Tani unë do ta parashtroj një pyetje.

Nëse keni pasë rënie të premisë prej 25 për qind, nëse e kam kuptuar mirë, atëherë a ju është përmirësuar rreziku 25 për qind? Jo, nuk ju ka përmirësuar! Rrezikun e keni të njëjtë, si atëherë kur e keni pasur preminë 100 si edhe tani, kur e keni preminë 80.

Liberalizimi do të thotë segmentimi i riskut. Do të thotë që dikujt t'i caktohet çmimi 110, sepse ai është vozitës i ri, 22 vjecar, rreziku është i madh, nuk ka përvojë. Mendon se ai tani është vozitësi më i mirë në botë.

Pra, çmimi për të duhet të jetë 110. Ndërsa, tjetrit, që ka moshë 35 vjeçare, ende është mirë me shëndet, dhjetë vjet nuk ka dëme, kështu që çmimi për këte do duhej të ishte 90, por çmimi duhet të jetë 100. Pse?

Ndoshta te ne është dhe ne e kemi konstatuar se çmimi duhet të jetë 104. Ne që tani punojmë nën çmim, d.m.th se të gjitha rreziqet janë prezente në treg. Çështja është se kush ta marrë atë më të mirin.

A do të kujdeset “Dukagjini“ të shet, a don ai rreziqe të këqija dhe t'i paguajë 110 apo do të synojë atë 90-shin dhe do të thotë: “Këto janë rreziqe të mira, unë nuk i dua ato rreziqet e këqija”.

Por, të gjithë do të merrni të gjitha rreziqet. Tregu i juaj nuk ka ndryshuar gjatë një viti që menjëherë të jenë vozitësit më të mirë, rrugët më të mira, veturat më të mira. Nuk është kjo. Nuk ka ndodh diçka e tillë. Diçka e tillë ndodh pas 10, 20 apo 30 vjetësh. Do të thotë të gjithë do të merrni të gjitha rreziqet. Kjo nduhet t'u jetë e qartë.

Dhe premia mesatare nuk ka guxuar t'u zvogëlohet, përveç nëse e ka me të drejtë dikush që thotë se keni punuar me ekstra profit dhe përfitim. Unë ua uroj nëse keni pasur sukses.

Ne në Kroaci nuk mundemi, nuk kemi sukses të tillë. Por, do të dëshironim, sepse interesi i siguruesit është që të ketë fitim. Nuk jemi ne këtu të ndajmë popullin. Të jemi objektiv. Siguruesi duhet që të punojë me përfitim.

Prandaj, ku mund të kursejnë shoqëritë siguruese? A janë në shpenzime operative “klins“ menaxhment më të mirë, po që se kanë shërbime më të mira për të siguruarit etj. Në këto gjëra duhet të bëni gara e jo në çmime më të ulëta.

Pra, duhet të fokusoheni në të siguruarin dhe atëherë konsumatorët do të fitojnë atë që e vlerësojnë. Vetëm zvogëlimi i çmimeve në afat të gjatë nuk do të zgjojë interesimin e konsumatorëve. Do të përmendi vetëm veturat e pasiguruara.



Për shkak të veturave të pasiguruara në Evropë premia është 21 € më e shtrenjtë se sa që do të duhej të ishte. Do të thotë ata që janë normal paguajnë në llogari të atyre që nuk janë. E njëjta do të ndodhë edhe këtu. Nëse një shoqësi shkatërrohet, dikush tjetër do të detyrohet t'i nxjerrë ato të holla.

Gjithmonë është, këtu te Organi Mbikëqyrës, pikëpyetja e kapitalit adekuat. Por, nëse është kryesor vetëm kapitali adekuat, e unë shpresoj se nuk është, atëherë s'jemi të obliguar të kryejmë sigurim.

Atëherë premia mund të jetë 1 €, ndërsa kapitali mund të vjenë nga Gjermania, nga Austria. Çka do t'i sjellë kjo tregut tuaj? Nëse vjen një sigures i madh dhe thotë unë do të jem adekuat me kapital, ao të shesë nga 1 €?! A është kjo me rëndësi për konsumatorin?

Dikush do të thotë-super konsumatori paguan 1 €. Mirëpo, ku na çon kjo?. Atëherë humb ai principi dhe rregullat e profesionit dhe atëherë të gjithë mund të shkojmë në shtëpi dhe të bëjmë gjumë.

Prandaj, Organi Mbikëqyrës, premia duhet të jetë konform me rrezikun, ndërsa kapitali duhet në afat të gjatë t'i plotësojë obligimet ndaj të siguarave. Nga ajo që unë edhe më parë e kam ditur dhe që po dëgjoj tani jam i sigurt se Organi juaj Mbikëqyrës vëzhgon dhe kujdeset dhe e keni sistem shumë të mirë.

Edhe Organi ynë Mbikëqyrës dëshiron të shoh diçka të tillë në Kroaci. Mirëpo, po ashtu duhet të jeni të vetëdijshëm se duhet opinionin publik ta sensibilizoni. Agjencionet shtetërore duhet të jenë të vetëdijshme se liria e tepërt shpie deri te rrezikimi i lirisë së subjekteve ekonomike ose të atyre të siguarave, për të cilët përfundimisht konsideroni se do të ishte mirë t'ju ndihmoni.

Nuk është mirë që ju ka ulur çmimi. Dyshoj se keni pasur çmim adekuat (të përgjegjshëm). Ne, në Kroaci tani jemi në preminë 215 €. Ky është nivel i mirë. Kemi qenë në 170.

Në një pjesë të madhe unë e konsideroj këtë ngritje që e kemi arritur edhe sukses timin personal. Por, dëmin mesatar e kemi 1700 €. Në Evropë, sipas të dhënave të CEN (Federatës Evropiane të Siguruesve dhe Risiguruesve), dëmi mesatar është 3300 €, në Finlandë 5000 €, në Sllovaki 1100 €.

Ndërsa ju e dini se veturat e reja, gjykatat, avokatët, të gjitha këto do të ndodhin sikurse te ne. Unë kam qenë avokat më parë dhe e di se si bëhen këto. Te ne në Kroaci ka qenë 5000 €, ndërsa në Slloveni ka qenë 500 (pesëqind) €, përderisa nuk kemi arritur t'i evitojmë, kështu që edhe te ne tani është 1500 €. Do të thotë çmime të reja të pjesëve rezervë.

Nuk ka më riparime, mjeshtër nëpër punëtori. Vetëm Folsvagen, pjesët e reja.

S'ka, dëmet të shtrenjta. Pra, neve në Kroaci çmimet po na shtrenjtohen. Çmimi i një ore punë e servisit po rritet. Çdo gjë po shtrenjtohet!.

Nëse fortifikoheni tani në premi të ulta, vështirë do të mund të ngriteni më. Vështirë se mund t'i thoni popullit duhet të paguani më shumë. Kush do t'ia shpjegojë këtë? Askush.

Dhe, atëherë Organit Mbikëqyrës do t'i thuani nevojitet më shumë kapital: "Kroacia Sigurimi" dërgoni mjete financiare. E ky me gjasë nuk do të jetë princip i mirë. Këtë desha t'ua them. Ne ende nuk e kemi zbuluar recetën sekrete se si duhet vepruar, se si duhet bërë. Desha ta ndaj edhe me juve atë që ua them edhe personelit tim atje te ne (në Kroaci).

**B.Nikçi:** Dua t'i potencoj dy momente lidhur me rezydenë, që argumentojnë edhe më shumë qëndrimin tim se edhe për një kohë, më tutje, të punohet në liberalizim të kontrolluar mirë në sigurimet e detyruara.

#### 1. Harmonizimi i legjislaturës në sigurimet e detyruara me direktivat e BE

Kjo nuk vlen vetëm për Kosovën, por për të gjithë rajonin. Të gjithë janë duke punuar, duke filluar prej Kroacisë, që shpejt pret të hyjë në Evropë, në harmonizimin e rregullativës juridike në kuptim të direktivave, që automatikisht konsiston, nuk është trend, rritje apo begatim i mbulesës sigurorese.

Gjithnjë e më shumë zgjerohet kategoria e personave me të drejtë zhdëmtimi, llojet e dëmeve që zhdëmtohen, si dhe shuma minimale sigurorese. Në kësilloj situatë tranzicioni, kur mbulesa sigurorese është në ndryshim e sipër, pa përfunduar konsolidimi i harmonizimit, do të ishte avanturë të kemi liberalizim të pakontrolluar, kur shumë elemente që determinojnë rrezikun janë të panjohura apo të pallogaritura.

Kjo ka të bëjë edhe me shtrirjen territoriale në rajon, ku rrisi është më evident, kurse larmia e mbulesës sigurorese me dallimet e mëdha. P.sh. shuma e sigurimit në Slloveni kap shumën prej 3.700.000 euro, ndërsa në Maqedoni vetëm 200.000 euro.

Harmonizimi konsiston në arritjen e shumës minimale të sigurimit prej 5.000.000 euro dhe në kësilloj situatë të harmonizimit permanent vështirë është të mendohet për një liberalizim të pakontrolluar.

#### 1. Kosova është si territor mjaft i vogël për disa zona rreziku dhe individualizim evident i primit

Kur bëjmë krahasime me rajonin, sistemet në aplikim etj., duhet pasur në konsiderim faktin se Kosova është diku 10 përqindëshi i Kroacisë në sigurimet e detyruara të autopërgjegjësive.

Ekziston një zonë e rrezikut shumë e vogël, ku mund të realizohet individualizimi. Më korrekte më duket se Kosova mund të shikohet vetëm si një zonë dhe portofoli me databazën e shënimeve të të gjitha kompanive të sigurimit të shërbejë si unike për determinin e primit minimal teknik.

Vetëm t'ju përkujtoj se siguruesit kosovarë kanë portofol të vogël/ mesatar prej 5.000.000 euro (sa shuma minimale siguruese për një rast të siguruar, në kuptim të direktivave të BE), prandaj individualizimi i primit në sektorin e sigurimit të detyruar në Kosovë ka probleme të shikohet për zbatim praktik, sipas standardeve të sigurimit, ku mungon disperzioni si element me rëndësi determinues.

### **Primi duhet të jetë i drejtë, objektiv dhe jo diskriminues**

**H.Rexhepi:** Duhet të cekim disa pika, të cilat sigurisht i kemi pasur parasysh gjatë debatit, por nuk hymë t'i kanalizojmë ato çështje. Principet në të cilat duhet të bazohet përcaktimi i një primi janë të qarta. Primi duhet të jetë i drejtë, objektiv dhe jo diskriminues. Ne sot kemi prime diskriminues.

Një nga format e primit diskriminues është ajo çka tha z.Paukoviç, midis vozitësit që ka një eksperiencë 10 vjeçare dhe është në gjendje të mirë shëndetësore dhe një vozitësi, i cili tek hyn në trafik. Midis primit që paguajmë për një BMW të vitit 2009 me një BMW të vitit 1984.

Ne i paguajmë të njëjtat prime dhe janë diskriminuese, andaj po flas për autopërgjegjësi. Prandaj, duhet që mos ta lejojmë këtë liri, që kompanitë e sigurimit të menaxhojnë vetë rriskun.

Në këtë drejtim i kanë edhe primet, të cilat dallojnë njëri nga tjetri, nga i cili përfiton qytetari i kujdesshëm që nuk ka aksidente etj.

Po e përsëris, ne asnjëherë nuk paragjykuam, ndoshta paragjykimi doli nga raporti midis dëmeve dhe primit, që është 34 për qind në Kosovë, që realisht tregon se primi është i lartë. Mirëpo, kjo nuk nënkupton që primet janë edhe më të larta në krahasime me ato që janë tani.

Është çështja e politikave dhe vlerësimit të rriskut nga kompania në mënyrë individuale dhe profilizimit të kompanisë. Ne nuk dëshirojmë si Autoritet Rregullativ të jemi arbitër dhe të përcaktojmë diçka, që ju mund ta përcaktoni shumë më mirë, sepse jeni për çdo ditë në kontakt me konsumatorin, klientin tuaj dhe jeni të interesuar t'i ofroni shërbimet kualitative, që ta keni një mbështetje afatgjate të biznesit tuaj.

Na duhet shumë punë, na pret shumë punë, në veçanti kompanitë e sigurimeve. Po jap një vlerësim tûmin: qeverisja kooperative në kompanitë sot dhe menaxhimi i rriskut dhe aftësitë menaxheriale, kompanitë që dinë të menaxhojnë rriskun në mënyrë të pavarur dhe të veprojnë drejtë me kërkesat ligjore, është mjaft i limituar.

Na presin shumë punë që të ngrisim kapacitetet e kompanisë në këtë drejtim. Jam i sigurt që mjaft të limituar jemi edhe nga aspekti i mbikëqyrjes së sigurimeve në kuadër të Bankës Qendrore. Kështu që na duhet shumë investim, shumë energji, shumë kohë në strehimin, aftësimin dhe përgatitjen për një fazë të tillë të liberalizimit.

### **Kushtet minimale, preminë minimale, kjo është baza**

**F.Gashi:** Për me mund me ardhur deri te ofrimi i autopërgjegjësive në faza të ndryshme, kishte me qenë e nevojshme, siç tha Besniku, që të kemi të rregulluara kushtet minimale me një prim minimal, ndër të cilën asnjë kompani nuk guxon të shkojë. Të gjithë tjerat pastaj zhvillojnë produkte tjera. Mundet çdo kompani t'i ketë nga tri katër produkte të autopërgjegjësive që ofron klientin: p.sh të sigurojë xhamat, vjen në pyetje vjetërsia e vozitësve, ka nëpër shtete të ndryshme që ndikojnë edhe ngjyrat e autmojeteve në caktim të premive.

Ka edhe gjëra tjera, të cilat mund të bëjnë një llogaritje, mirëpo në qoftë se nuk e kemi një minimum, me kushte minimale me prim minimal shumë vështirë është m'i prodhuar kërkesat, sepse del dikush që e bën minimalen dhe ofron, dhe njerëzit e blejnë atë që është më e mira.

Prandaj, duhet me ua dhënë të gjitha mundësitë qytetarëve, pastaj mundësitë për zgjidhje. Unë mundem m'i pas tri katër oferta dhe i ofroj për këtë kategori dhe them për ata që jetojnë në territorin e Gjakovës, kanë kaq prim, por atëherë mund të bëjmë analiza dhe të nxjerrim rrisqe në bazë të atyre që shesin polica. Sot në Evropë punohet më të madhe marrja në sigurim në përcaktimin e kushteve për TPL.

Ndoshta është më e mundishme për krejt klasët e tjera të sigurimit. Sot, momentalisht, anglezë, gjermanët punojnë shumë, kanë shënime dhe nxjerrin këto çka tha z.Pavkoviç. Por, nuk mundemi në qoftë se nuk i kemi ato që thotë Besniku: kushtet minimale, preminë minimale, kjo është baza, të tjerat vazhdojmë vetë.

Atë rregulloni për një kohë 3-4 vjeçare pastaj vimë duke u zhvilluar dhe vimë deri te liberalizimi i plotë. Unë e thash edhe më herët se nuk kam besuar se do të shkojmë në gara të çmimeve, unë kam besuar se do të shkojmë në gara të kushteve.

Mirëpo, është shkuar si ka shkuar dhe ky është fakt i gjallë, që jemi shkuar në gara të çmimeve. Për me thyer këtë trend duhet ndërprerë, sepse me vonë do të kemi probleme të gjithë. Duhet sa më parë të ndërpritet ky trend, sepse nuk është trend pozitiv dhe të vazhdohet asesi mos të ndërpritet liberalizimi. Të vazhdohet për një kohë liberalizimi.

## **DUHET TË KRIJOHET NJË TREG I PËRGJEGJSHËM I INDUSTRIË SË SIGURIMEVE**

### **Ivica Pezo, drejtori gjeneral i kompanisë "Kroacia Osiguranje"**

I nxitur nga ky debat shumë i mirë, i cili si duket po nxjerrë në shesh edhe iniciativa të reja, më duhet të them, se kompanitë tona nuk janë ato që kanë shkaktuar gjendjen ekzistuese në tregun kosovar. Po përpiqem të jap këtu vrojtimit e mia. Unë ka pesë vite që punoj në këtë treg, dhe e them me përgjegjësi, se duhet të krijohet një treg i përgjegjshëm i industrisë së sigurimeve përmes krijimit të kushteve bazë të funksionimit.

Ky treg, përkatësisht kjo industri në Kosovë, është shumë e re dhe kemi arritur shumë gjatë kësaj periudhe. Madje, mund të them shumë. Mirëpo, mundemi dhe duhet të punojmë më mirë.

Po keqkuptohet se me ngritjen e çmimeve po e dëmtojmë klientin. Po krijohet përshtypja e gabuar, se ne po e rrezikojmë klientin. Jo, ai dëmtohet nëse kompanitë tona nuk janë në gjendje të operojnë në mënyrë rentabile.

Prandaj, duhet të mësojmë nga leksionet e nxjerra nga vendet fqinje, të cilat nuk do të dëshiroja t'i përsëris këtu, që në fund nuk kanë pasur zgjidhje tjetër, pas shumë përpjekjeve janë detyruar të ulen të gjithë bashkë dhe në një tryezë të vetme për t'u marrë vesh për çmimet dhe koston.

Prandaj, ju lutem, nuk është rritja e çmimeve tona, ajo që po e dëmton klientin, kjo është e para, kurse e dyta, Kosova, Serbia dhe tregu ka edhe një problem, të cilin ne nuk po e shohim.

Fjala është për autopërgjegjësinë, e cila në shumicën e vendeve në botë është buzë rrënimit ose ballafaqohet me humbje të mëdha, mirëpo në Kosovë gjatë katër viteve ky sektor i industrisë ka qenë profitabil. Nuk do mend, kjo ka ndodhur, para së gjithash, për shkak se në treg ka qarkulluar numër i madh i vetura të vjetra.

Mirëpo, sot në rrugët e Kosovës sigurisht kemi 10 për qind të veturave të reja, gjë që e ndryshon gjendjen ekzistuese në këtë sektor, sepse vlera është në rritje.

Së këndejmi, është e domosdoshme që Rregullatori, i cili në këtë rast është Departamenti përkatës i Bankës Qendrore të Kosovës, duhet të monitorojë edhe më tutje, si solvencën e rezervës teknike po ashtu edhe dëmet.

Unë jam për një liberalizim të plotë, mirëpo që të mund të mbijetojmë në tregun ekzistues. Rrethanat aktuale shtrojnë nevojën e një liberalizimi të kontrolluar, përndryshe nesër mund të shuhemi të gjithë. Tjetër, ne jemi duke folur për shembullin e ngjashëm me atë kur kemi një pacient dhe dihet se në rastet kur ndonjë pjesë e trupit të tij është e dëmtuar, kirurgët shpesh detyrohen ta amputojnë të njëjtin.

Prandaj, duhet të kuptojmë se industria e sigurimeve në tregun botëror ka shoqëritë e sigurimeve, të cilat po shkrihen në njëri tjetrin, por ka edhe subjekt të tillë që nuk mund të mbijetojnë, pra ngjashëm si te lojërat sportive, dalin nga loja.

Po ashtu, në këtë treg ekzistojnë edhe subjekt (kompani), që po e pengojnë funksionimin e tjerëve, e megjithatë po funksionojnë. Unë kujtoj se ne duhet të vazhdojmë të punojmë si duhet dhe duhet t'i zgjedhim problemet ekzistuese, në mënyrë që kompanitë edhe më tutje të ekzistojnë së funksionuari.

Edhe më tutje insistoj se ne duhet të punojmë në përfundimin me legjislacionet e Bashkimit Evropian, për atë që është e mundur dhe për atë që ne kemi mundësi për një gjë të tillë.

**H. Rexhepi:** Unë dua të shpjegoj me pak fjalë cili ka qenë modeli i liberalizimit. Primi i mesëm dikur ka qenë i rregulluar në mënyrë administrative.

Ne kemi përcaktuar rrishtin e sigurues, që ka qenë vlera 60 për qind e primit me atë të shkruar, kur primit kanë qenë të rregulluara në mënyrë administrative.

Ne ju kemi krijuar kompanive hapësirë, që në mënyrë të pavarur të kalkulojnë pjesët e shpenzimeve operative të veta, që të kalkulojnë interesat e aksionarit, që ka investuar kapitalin dhe se ai dëshiron të ketë eventualisht profit. Nga rrishtin e sigurues, që ka qenë 60 për qind e ish- primit të mëparshëm, ne kemi lejuar që të paguhen vetëm disa dhe risigurimi.

Ne kemi menduar që ky është faktor shumë i fuqishëm veprues, që kompanitë të paguanë më shumë dëme, në mënyrë që mos të akumulojnë mjete në llogari përkatëse, që të bartet në vitin tjetër. Efekti ka qenë i caktuar, sepse dëmi i paguar ka qenë 30 më shumë se sa vitin paraprak. Njëkohësisht e kemi penguar rrishtin e sigurues për vitin 2007, në mënyrë që kompanitë të kenë rezerva teknike, për me mund m'i mbuluar detyrimet.

Tani cila është ajo ideja që Fatmiri dhe Besniku e përmenden, platoni është rrishtin e sigurues, detyrimet që dalin nga kompania ndaj klientëve. Ne e kemi përcaktuar në mënyrë administrative 60 për qind e ish-primit neto. Ndoshta akuari i juaj, për historikun e dëmeve të juaja, mund ta kalkulojë më drejtë se sa ne ta kalkulojmë në mënyrë administrative. Duhet sigurisht që në diskutimet e nivelit shumë teknik të bëjmë një analizë afatgjate në mënyrë që të përcaktojmë objektivat

### **Prof.Dr.Klime Poposki, Universiteti “Shën Klementi” Ohër, Maqedoni**

Është një diskutim mjaft interesant dhe aktual për gjithë rajonin, gjithashtu edhe për Republikën e Maqedonisë.

Unë do të tregoj disa argumente pro ose kundër vetë idesë. Por, para se të jap ndonjë koment kam një pyetje drejtuar kompanive të sigurimeve dhe Autoritetit të Auditorit. Mua më intereson se sa aktuarë të licencuar apo të autorizuar keni në kompanitë e sigurimeve dhe prej nga dhe në çfarë mënyre e kanë marrë licencën për aktuar? A është

kjo nga ndonjë modul interno, që e keni organizuar ju këtu në Kosovë apo ana e ndonjë programi jashtë vendit?

**H. Rexhepi:** Ne i kemi mbështet fuqishëm kompanitë e sigurimeve, që të dërgojnë njerezit e tyre për aftësim për aktuarin në një trajnim një vit e gjysmë, që është mbajtur në Autoritetin e Mbikëqyrjes së Shqipërisë, organizuar nga Banka Botërore. Për fat të keq vetëm dy veta nga Kosova e kanë kaluar me sukses dhe janë licencuar nga ky trajnim si aktuar.

Aktualisht në Kosovë kemi tre aktuarë, një për kompanitë e sigurimeve që operojnë në Kosovë, të cilat e kanë kompanitë amë. Në vende tjera normal që kanë aktuarë të kualifikuar. Është një problem pa të cilin është vështirë të mendohet dhe imagjinohet se kompanitë menaxhojnë më mirë dhe janë në gjendje të vlerësojnë saktë risqet dhe premitë.

### **Elementi bazë për përcaktimin e një çmimi është përvoja statistikore nga dëmet**

**K.Popovski:** Unë në pika të shkurtëra do të ndalem në diskutim, sepse vetë lëndën të cilën e ligjëroj “Hyrja në Sigurime”, në kapitujt e parë, bëhet fjalë për njohjen e natyrës së riskut, menaxhimi me riskun dhe funksionet e kompanive të sigurimeve.

Çmimi i produktit të sigurimeve e dimë se si formohet, nuk ka kërkesë dhe ofertë, produkti i sigurimeve është jashtë çdo mekanizmi tjetër dhe në formimin e çmimit nga produktet tjera, nuk vlen oferta dhe kërkesa.

Siç tha edhe z.Paukoviç, elementi bazë për përcaktimin e një çmimi është përvoja statistikore nga dëmet dhe mundësia se sa është e besueshme të parashikoni dëmet e ardhshme. Sipas mendimit tim, këtë mund ta bëjnë vetëm aktuarët e licencuar.

Në kushtet kur kemi të bëjmë me një kapacitet të vogël të aktuarëve të autorizuar mendoj së nëse kompanitë e sigurimeve ua përcaktojnë vetë çmimin dhe liberalizimin e çmimeve atëherë do të jenë humbës.

Megjithatë që kuptova, liberalizimi i çmimeve do të shpie deri te një politikë e zvogëlimit të çmimeve. Tash do të tregoj për përvojën tonë në Republikën e Maqedonisë, ku edhe liberalizimi është politikë edhe atë në administrim.

Jemi dëshmitarë të një momenti historik, ku po ballafaqohemi me një rën ndërkrisat më të mëdha botërore. Vetë kriza ekonomike ka ardhur si pasojë e krizës financiare, vetë kriza financiare ka ardhur si pasojë e liberalizimit të tepruar dhe globalizmi.

Ky liberalizim ishte një instrument politik në mesin e viteve të 80-ta dhe 90-ta, në SHBA, për arsye të ofertave politike, kur njëra nga strategjitë paraqiste “shtëpi për çdo njeri” ka sjellur deri te liberalizimi i plotë i kushteve financiare, me të cilat bankat i lëshonin kreditë hipotekare, duke mos mbajtur llogari për standardet e rrezikut dhe ka sjellur deri tek ajo për të cilën sot ne jemi dëshmitarë.

Kjo krizë financiare përmes globalizmit u bart në tërë botën dhe në sektorin real. Në kushtet e një tregu të vogël të pazhvilluar të sigurimeve dhe kur keni të bëjmë me një numër të madh të kompanive të sigurimeve, sapo të shfaqura, të cilat kanë një përvojë të vogël me dëmet dhe nga autopërgjegjësia, si produkt i sigurimeve të disa prej kompanive, marrin pjesë diku rreth 80 deri 90 për qind.

Të gjitha përvojat botërore tregojnë se autopërgjegjësia është produkt, që punon me rezultat negativ teknik, përveçse Kosova është përjashtim, ku unë sot për herë të parë dëgjova se në Kosovë ka një rezultat teknik pozitiv.

Ndoshta ky është rezultat i disa faktorëve, që nuk janë evident në Kroaci e në Republikën e Maqedonisë, siç tha edhe kolegu, se racio e kombinuar me Kroacinë ishte 104, kurse me Maqedoninë 112, çka do të thotë se s'bëhet fjalë për rezultat jo teknik, meqenëse edhe më e shprehur, që e dimë nga shkenca.

Autopërgjegjësitë në momentin kur përmbajnë termin përgjegjësi janë produkte, të cilët kanë të ashtuquajturin "Long Tale". Long Tale do të thotë: nëse keni një dëm, i cili ka ndodhur në vitin 2009, periudha mesatare e pagimit të të njëjtit dëm përfshin kohën deri 10 vjet.

Të gjitha ato produkte që kanë të bëjnë me përgjegjësinë, që hyjnë edhe autopërgjegjësia, kanë të bëjnë me produkte të cilët janë Long Tale, me një periudhë shumë të gjatë të pagesës përfundimtare të atij dëmi. Kjo do të thotë nëse ju mbani statistika vetëm për 15 vjetësh ajo statistikë nuk do të jetë valide dhe nuk do të jetë e mjaftueshme për çfarë do analizë.

Propozimi im është se në kushte të tregut të vogël të pazhvilluar duhet pritet edhe një periudhë e caktuar kohore, që mjaftueshëm të grumbullohen të dhëna statistikore kualitative dhe se secila kompani e sigurimeve të ketë aktuarin e saj të autorizuar dhe më pastaj të mendohet për liberalizimin, pasi që liberalizimi në themel, sipas meje, do të thotë presion i kompanive, të cilat dëshirojnë të kenë qajse në treg me çmime më të ulëta.

Në rastin tjetër, kur bëhet fjalë për Maqedoninë, edhe pse ne i kemi të përcaktuara çmimet me ligj, ekziston dhënia e jashtëligjshme e provizioneve të mëdha, të të gjithë atyre ndërmjetësuesve, të cilët shesin autopërgjegjësi, çka do të thotë se prapë vjen deri te ndonjë lloj çmimi, i cili do t'i përgjigjet ndonjë liberalizimi të plotë.

Megjithatë, kësolloj raste shfaqen vetëm te ato kompani të sigurimeve, te të cilat portofoli në autopërgjegjësi merr pjesë me 80 deri 90 për qind. Kjo nuk mund të ndodhë në një Vardar, te të cilat portofolio e strukturuar nuk dominon autopërgjegjësinë në një deri 80 deri 90 për qind.

Megjithatë, motivi kryesor i këtyre kompanive të sigurimit të posashfaqura kryesisht ka të bëjë me targetimin e autopërgjegjësive, i cili sjell në të vërtetë para kesh, sepse pagesa e autopërgjegjësive është më e madhe dhe me ato para kesh ato kanë mundësi të bëjnë investime afatshkurtëra me norma të larta të kamatës, që i ofrojnë bankat, dhe në atë



mënyrë që të ardhurat që i realizojnë nga ato investime t'i kompensojnë rezultatet eventuale negative teknike.

Por, nga ana tjetër, të dhënat që ne i kemi nga pjesa e Auditorit (ne nuk kemi Agjencion të Auditimit, por në kuadër të Ministrisë së Financave ekziston sektori për rregullimin e fushës së sigurimeve) tregon se numri i pazgjidhur i rasteve të autopërgjegjësive, është në rritje me ankesa nga ana e të siguarve pikërisht te ato kompani, që në portofolion e tyre të autopërgjegjësive marrin pjesë me 80 deri 90 për qind.

Sugjerimi im, përkaj asaj që e thash dhe atë që e ka bërë edhe Kroacia, të cilin e përmendi z. Pavkoviç, është që të bëhet një analizë më e gjerë. Paramendoni në Kroaci janë të kyçur rreth 60 aktuarë, ndërsa në Kosovë janë vetëm tre aktuarë të licencuar, andaj mendoj se duhet të kalojë edhe pak kohë e ju të punoni shumë në analizë dhe komparacion.

Nëse në Slloveni, Kroaci, Austri, Maqedoni, Greqi, të gjitha shtetet që i cekët, kanë pasur përvoja të këqija në raport liberalizimin të plotë, duhet të mbahet llogari për këtë.

Megjithatë, ajo çka është shumë me rëndësi, në të cilën duhet të vihet theksi nga ana e kompanive të sigurimit, për të cilat folën z. Hashim dhe z. Pavkoviç, është i ashtuquajtur problem i selektimit të gabuar, do të thotë: Kur ju ofroni të njëjtin produkt me kushte të njëjta për profil të ndryshëm të subjekteve të riskut atëherë ju bëni një zgjidhje të gabuar.

Grupizimi i të siguarve potencialë në kuadër të tarifave të ofruara për një produkt të njëjtë paraqet aspekt kompetent të funksionit të marrjes së rrezikut dhe kjo është kuptimi themelor i ekzistimit të bonusit dhe mallusit.

Bonusi në të vërtetë duhet që ta zgjidhë atë problem të selektimit të gabuar. Kapaciteti i menaxhimit me rrezikun në të vërtetë është kapaciteti që të merreni me problemin e zgjidhjes së gabuar, meqenëse ajo sjell deri te problemi i dytë të riskmenaxhmentit dhe ai është "Hazardi moral".

**H.Rexhepi:** Mendoj se në pjesën ku foli z.Klime oferta dhe kërkesa dhe ekonomia e tregut nuk vlen te sigurimet, respektivisht te sigurimet e detyrueshme, është e paqëndrueshme.

Unë nuk shoh si ftesë të ekonomisë se tregut dhe ofertës dhe kërkesës vetëm çmimin. Po është një komponentë pak më e gjerë, që ka të bëjë me ofertën dhe kërkesën dhe veprimin e faktorëve korrekutes të tregut në ofrimin e shërbimeve.

Mendoj që kriza aktuale botërore financiare nuk ka të bëjë vetëm me rregullimin dhe liberalizimin e tepruar të sektorit financiar, por ka të bëjë me kundërthëniet e mëdha, të cilat ekzistojnë midis tregu global financiar botëror dhe dallimeve të nënpjesëve të kësaj tërësie të sistemit.

Kemi sisteme jokompatibile financiare, duke filluar prej atij në SHBA, BE, Rusi në Kinë etj., që kanë kushtëzuar që tregu financiar të ecë në këtë drejtim. Kështu që nuk është argument i cili do ta forconte perfeksionizmin.

Edhe takimi i G-20 në Londër e dëshmoi këtë, që duhet rritur përgjegjësitë dhe duhet adresuar saktë çështjet dhe transparenca në sistem. Liberalizimi nënkupton mbikëqyrje dhe më strike, por me parametra me të cilat duhet mbikëqyrë. Ne duhet të afirmojnë lirinë e biznesit, lirinë e siguresit në dizajnimin e politikave dhe menaxhimit të riskut total.

Edhe në Maqedoni primi i autopërgjegjesisë është i përcaktuar në mënyrë administrative dhe sigurisht në mungesë të një autoriteti të mirëfilltë mbikëqyrës, i cili do t'i shpalosë problemet e brenda sistemit. Sigurisht që shumë probleme në industrinë e sigurimeve të Maqedonisë nuk kanë dalur në sipërfaqe në masën e nevojshme, sikur të kishte një autoritet të pavarur mbikëqyrës, i cili do ta mbikëqyrte në mënyrë profesionale industrinë.







## **Kapitulli II**

Banka dhe Sigurime



**MSc. Tefik Halili**

## **NORMA AKTIVE E INTERESIT TE BANKAT KOSOVARE**

Të gjitha bankat afariste-komerciale në Republikën e Kosovës janë themeluar në bazë të Rregullores nr.1999/21 të datës 15.11.1999, si dhe në bazë të ndryshimeve dhe plotësimeve të mëvonshme, që kanë pasur për qëllim përcjelljen dhe aplikimin e atyre ndryshimeve, të cilat kanë ndodhur në procesin e evoluimit të shoqërisë kosovare.

Pra, edhe bankat, si institucione financiare, në një mënyrë apo në mënyrën tjetër kanë përcjellur në hap ndryshimet ekonomike dhe ligjore, që kanë ndodhur në Kosovë prej vitit 1999 e posaçërisht prej vitit 2002, e deri më sot, duke tentuar që të bëhen njëra ndër hallkat më të rëndësishme të zhvillimit të gjithmbarshëm të Kosovës, e dalur nga lufta e vitit 1999 me plotë probleme, kontradikta dhe me ekstra nevoja për formimin e kushteve elementare (në fillim) bazike për një jetë të qëndrueshme në tokën e djegur.

Pasojat dhe traumat e luftës ishin shumë të tmerrshme dhe për këtë arsye bashkësisë ndërkombëtare iu deshtë një kohë relativisht e gjatë (gati thuajë tri vjet), që të formojë klimë dhe bazë ligjore për themelimin e bankave afariste komerciale, nga parime dhe principe krejt tjera karshi atyre që ekzistonin para lufte.

Një rajon i shkatërruar dhe një popullatë e rraskapitur nga shfrytëzimi i pamëshirshëm shumëvjeçar dhe nga plaçkitjet e të gjitha formave të pasurisë, nuk pritej që do të ishin në gjendje që të kenë kapital vetanak ose të bashkuar për themelimin e bankave afariste komerciale.

Një hap të tillë në vitin 2000-2002 e ndërmorën njerëzit afaristë dhe biznesmenët nga Evropa (Gjermania, Austria, Sllovenia), dhe kështu filluan procedurat e para të themelimit të bankave afariste në bazë të rregulloreve të caktuara, të cilat nuk ishin asgjë tjetër por rregulla, norma, standarde, teknologjia të shteteve të zhvilluara perëndimore, ku niveli i perfeksionimit të parimeve dhe qëllimeve të afarizmit bankar është moto kryesor.

Paralel me formimin e bankës së parë Procredit Bank (me tjetër emër), filluan të formohen edhe procedurat dhe standardet e afarizmit bankar në baza krejt tjera nga ish-përvojat e bankave të kaluara.

Për këtë moment ishte nevojë kyçe formimi i mekanizmave dhe procedurave, të cilat do t'u mundësonin në radhë të parë qytetarëve dhe asaj pjese të mbetur të ekonomisë që të kyçet në rrjedhat normale financiare, sipas standardeve të ekonomisë së lirë të tregut.

Tani në një distancë kohore gati prej 8 (tetë) viteve, prej themelimit të bankës së parë afariste në Kosovë, shumëçka ka ndryshuar. Në tregun e vogël kosovar janë themeluar banka afariste, janë perfeksionuar mekanizmat, normat, rregullat e afarizmit të gjithmbarshëm të sistemit bankar.



Paraja tani më të madhe qarkullon nëpër mjete të sistemit bankar dhe shumë pak nëpërmes duarve, siç ishte dikur.

Çdo formë e këmbimit të mallrave dhe shërbimeve tani zhvillohet nëpërmes llogarive bankare, të gjitha të hyrat dhe obligimet e kompanive, të punësuarve në të gjitha sferat e ndryshme të veprimtarisë ekonomike, gjithashtu zhvillohen nëpërmes kanaleve të bankave afariste.

Pra, paraja tani lirisht mund të konstatojmë se gjendet në një mënyrë apo në mënyrën tjetër (si para e kursyer, si depozitim në të parë) në llogaritë e ndryshme të bankave afariste.

Kosovarët në një përqindje shumë të lartë komplet veprimtarinë e tyre ekonomike dhe jetësore e kanë lidhur me sistemin dhe rrjedhjet e bankave afariste. Këtë konstatim mund ta vërtetojmë me numrin relativisht të lartë të llogarive të ndryshme të qytetarëve të bankat afariste.

Sipas paracaktimit dhe strukturës bilansore, bankat në Kosovë (edhe gjetiu) zhvillojnë kryesisht tri lloje të ndryshme të aktiviteteve, që kanë ndikim të ndryshëm implikues në bilancat e tyre.

- Punët pasive bankare (punët dhe veprimet në mbledhjen dhe grumbullimin e mjeteve financiare nga subjektet e ndryshme ekonomike dhe qytetarët)
- Punët aktive bankare (punët e kreditimit dhe punët e plasmanëve të produkteve bankare).
- Punët bankare komisione (punët e ndryshme ndërmjetësuese për komitetet e bankës).

Meqenëse, lëndë qendrore e këtij shqyrtimi-punimi profesional është norma e interesit në punët aktive të bankave kosovare, në fillim të këtij shqyrtimi do të tentojë të prezantojë në pika të shkurtëra kush janë kredikërkuesit, respektivisht nga cila branshë e veprimtari ekonomik shoqërore janë kërkuesit më të shpeshtë të kredive dhe produkteve tjera bankiere.

Bazuar në të dhënat e Ministrisë për Industri dhe Tregti, si dhe të Odës Ekonomike të Kosovës për vitin 2006 (31.12.2006), struktura e bizneseve të regjistruara duket si vijon:

Sektorët	Aktiviteti Ekonomik	Numri i ndërmarrjeve-Viti 2006	Përqindja (%)
A	Bujqësia, gjuetia dhe pylltaria	892	1.59
B	Peshkimi	26	0.04
C	Industri nxjerrëse (nxjerrja e qymyrit, linjtit dhe mineraleve)	230	0.41
D	Produktet ushqimore, pijeve dhe duhanit	5179	9.36
E	Furnizim elektrik, gaz dhe ujë	50	0.08
F	Ndërtimtaria	2948	5.27
G	Shitjet me shumicë dhe pakicë	26712	47.79
H	Hotelet dhe restorantet	5168	9.24
I	Transporti, magazinimi dhe trafiku	7734	13.83
J	Ndërmjetësimi financiar	173	0.30
K	Aktivitetet me pasuri të patundshme, qiradhënie dhe shërbime biznesi	2004	3.58
L	Administrata publike dhe mbrojtja, sigurimi i detyrueshëm social	99	0.17
M	Edukimi	632	1.13
N	Mbrojtja sociale dhe shëndetësore	1079	1.93
O	Aktivitete dhe shërbime të tjera personale shoqërore (pastrimi, largimi i ujërave të zeza)	2956	5.28
P	Aktivitetet tjera të ekonomisë private familjare me persona të punësuar	2	0.003
Q	Organizatat dhe organet ndërkombëtare	0	0
	Totali	55884	100

Nga numri i përgjithshëm i të gjitha bizneseve përqindjen dukshëm më të lartë zënë ndërmarrjet tregtare me shumicë dhe pakicë, me 47.8 për qind, me një laramani tepër të madhe të deklarimeve për sasinë dhe strukturën e kapitalit vetanak, si dhe për nivelin e organizimit.

Posaçërisht vërehet numri shumë i vogël dhe struktura tejet e varfër kualifikuese e të punësuarve, e cila në esencë nuk premtion zhvillim të hovshëm afatgjatë karshi ambicieve që ekzistojnë në fillim të themelimit të këtyre ndërmarrjeve, si i vetmi shpëtim për të ikur nga lista e të papunëve.

Duke marrë parasysh se këto ndërmarrje, që në fillim kanë probleme të shprehura në mungesë të mjeteve dhe të kuadrit të mirëfilltë profesional, ato pas një periudhe relativisht të shkurtër hasin në probleme të natyrës financiare dhe organizative.

Për t'i zgjidhur këto dy probleme, e në veçanti mungesën e mjeteve financiare, ata me plot të drejtë dhe elan i drejtohen bankave afariste (duke mos pyetur kurrë për lartësinë e normës së interesit-kamatës) për kredi zakonisht afatshkurta (deri në një vit), ose për garancione bankare, me qenë se produktet tjera që bankat afariste i ofrojnë janë relativisht të vogla ose për binzesmenët kosovarë të panjohura.

Gjithashtu, bie në sy fakti se të gjitha bankat afariste kosovare, pa përjashtime, (kushtimisht po i quajmë kosovare, në realitet pronarët apo aksionarët e bankave më të mëdha në Kosovë janë qytetarë të huaj), kreditimin e ekonomisë dhe qytetarëve kosovarë thjeshtë e bëjnë nga pasiva e tyre, e cila në tërësi (me përjashtim të kapitalit themelues) formohet nga depozitet e ekonomisë dhe qytetarëve kosovarë.

Të dhënat e Bankës Qendrore të Kosovës, të publikuara për tremujorin e parë të këtij viti, vërtetojnë konstatimin tonë të mëparshëm.

Pra, sipas të dhënave, ekonomia dhe qytetarët kosovarë, në përfundim të këtij tremujori, kanë pasur gjithsej mjete të depozituara në shumë prej 1.444.582.000 euro, përderisa bankat afariste i kanë kredituar në të gjitha format (me përjashtim të kredive investicionale afatgjate, me të cilën formë të kreditimit bankat në Kosovë fare nuk merren) në shumë prej 1.204.732.000 euro, me norma të ndryshme të interesit, të cilat për fat të keq nuk publikohen dhe kanë karakterin e sekretit afarist, i cili më të madhe "ruhet", duke u bartur dhe transmetuar ndërmjet vetë afaristëve dhe qytetarëve kosovarë.

Për vitin e kaluar (2008), në bazë të raporteve të Bankës Qendrore, normat e interesit në mjetet e depozituara kanë qenë 3.89 për qind, përderisa norma e interesit të kredive ka qenë 15.10 për qind, apo 3.88 herë më e lartë se sa norma e interesit në mjetet e depozituara.

Një ndryshim kaq i lartë në mes të normës së interesit pasiv dhe normës së interesit aktiv nuk do koment, përveçse i ushqen interesat e të huajve dhe atyre pak kosovarëve (aksionarëve të bankave), të cilët në kurriz të qytetarëve të varfër, pasurohen në mënyrë legale.

Republika e Kosovës është shtet i dalë nga lufta, relativisht i pazhvilluar dhe tejet i varur nga ndihmat e huaja dhe nga importet e shumë produkteve, e në radhë të parë atyre ushqimore, të importuara nga shtetet e jashtme (punë të cilën e bëjnë ndërmarrjet tregtare, të cilat janë shfrytëzuesit më të mëdhenj të kredive me normë interesi mbi 15 për qind) për nevoja të përditshme.

Kështu, kjo normë e lartë e interesit bëhet pjesë e çmimit të produkteve dhe artikujve esencial për jetën e qytetarëve kosovarë, duke ndikuar kështu në mënyrë të drejtpërdrejtë në zvogëlimin e standardit jetësor dhe fuqisë blerëse edhe po ashtu të vogël.

Ripërsëritja e pandërprerë e këtij fenomeni inkurajon bankat afariste për veprimet e tyre, ku në një mënyrë konkurrenca e mirëfilltë kualitative thuajse nuk ekziston, falë politikave

restriktive që bankat i aplikojnë me rastin e zgjedhjes së shfrytëzuesve të ardhshëm të kredive.

Pra, këtu kemi fenomenin e mosbarazisë latente në mes të dy agregatëve themelorë të tregut-ofertës dhe kërkesës për produktet bankare.

Kërkesa dominon mbi ofertën dhe duke u nisur nga ky parim, bankat kosovare tani me vite të tëra jetojnë dhe veprojnë në tregun financiar-kreditues dhe, me përjashtime shumë të vogla, kanë nivelin më të lartë të normës së interesit aktiv në eurozonën valutore.

Është për t'u habitur se si një numër i caktuar i bankave kosovare, të cilat janë degë të bankave të ndryshme nga Evropa, i lejojnë vetes një grabitje të tillë, kur e dinë se në shtetin e tyre amë, norma e interesit është disa herë më e vogël dhe gjithmonë nën kontrollin e autoritetit monetar, gjersa këtu një veprim të këtillë bankat e "argumentojnë" me ekzistimin e rreziqeve të shumta e në radhë të parë të rrezikut të shtetit.

Që absurdi të jetë më i madh, pikërisht këto shtete mbështesin politikat afariste të Kosovës dhe në të njëjtën kohë janë garantues të sigurisë dhe integritetit të popullatës dhe ekonomisë kosovare (NATO, BE).

Pra, shtohet pyetja, mos vallë këtu kemi të bëjmë me perceptime të gabuara apo me qëndrime disonante?

Fitohet një përshtypje se edhe strukturat menaxhuese të këtyre bankave janë të vetëdijshme se një nivel kaq i lartë i normës së interesit në produktet bankare nuk është proporcional me rreziqet që i kanosen bankave për moskthyerjen e obligimeve të kontraktuara.

Mirëpo, mungon guximi për ta bërë hapin e parë dhe për të pranuar faktin se njëri ndër rreziqet kryesore është edhe rreziku organizativ, që vepron brenda për brenda bankës<sup>1</sup> si dhe "kulturës së deformuar kredituese"<sup>2</sup>, e cila gjithmonë ka gjasa për të ndodhur në çdo bankë.

Për ta minimizuar efektin e rrezikut të brendshëm, për menaxhmentin bankar është më së lehti që këtë rrezik ta bartin te rreziku i shtetit, duke e ngritur në mënyrë të paargumentuar normën e interesit, e cila nën çdo kusht do të minimizonte efektin veprues eventual të rrezikut organizativ.

Indinjuese është edhe mostransparenca e të gjitha bankave kur janë në pyetje normat e interesit aktiv, gjersa normat e interesit pasiv janë kumbanjare e rregullt në të gjitha mjetet e informimit, me të gjitha detajet e mundshme.

<sup>1</sup> BIS, Basel Accord of January 2001

<sup>2</sup> Greuning Van H. and S. Brajoviq – Bratnoviq, Analyzing and Managing Banking Risk, Second Edition, The World Bank 2003.

Pse vallë kjo nuk ndodh edhe me normat e interesit aktiv? Pse ato gjithmonë janë jotransparente dhe të arsyetuara detajisht për strukturën e tyre të brendshme?

Këto dhe shumë pyetje tjera, që janë ngushtë të lidhura me mekanizmat dhe politikat kredituese, edhe më tutje mbesin fshehtësi dhe armë kryesore të mbrojtjes së strategjisë totalisht të mbyllur karshi kredikërkuesve të ardhshëm potencialë dhe auditorit të gjerë.

Çdo arsyetim se me këtë ruhet fshehtësia afariste është një përrallë për fëmijë, meqenëse gati gjithmonë brenda një afati shumë të shkurtër qarqet dhe kastet afariste i këmbëjnë informacionet ndërmjet vete.

Edhe pse bankat afariste nuk i publikojnë kategoritë e normave të interesit aktiv, nuk është aspak vështirë që edhe qytetarët e rëndomtë me kërkesat e tyre të njoftohen nga vetë bankat për këto norma-përqindje.

Si përfundim, jam i bindur se edhe bankat afariste që veprojnë dhe jetojnë në Kosovë nuk duhet të jenë në afate të gjata të orientuara në llogaritjen dhe inkasimin e normave të larta për produktet e tyre, sepse gjërat po lëvizin, tregjet për çdo ditë po hapen, kështu që kredikërkuesit kosovarë, ndoshta një ditë në një të ardhme shumë të afërt, do të jenë klientë të bankave jashtë Kosovës, ku normal se do t'i përmbushin detyrimet, por edhe kërkesat e tyre me një kosto shumë herë më të lirë se sa tani.

**MSc. Jordan Koseski**  
**Ph.D. Klime Poposki**  
**Ph.D. Jovan Stojanoski**

## IMPLIKIMI BAZEL II PËR JO-ANËTARËT NË KOMITETIN E BAZELIT NË VENDET ME MBIKËQYRJE BANKARE

### Abstrakt

Në qershor të vitit 2006, Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen e Bankave (KBMB) miratoi të ashtuquajturin versionin përfundimtar të strukturës sistematike të Bazelit II mbi “Konvergjencën ndërkombëtare të matjes kapitale dhe standardeve kapitale”.

Duke e krahasuar me origjinalin e Marrëveshjen së vitit 1988, qasja e saj trishtyllëshe (kërkesat minimale të kapitalit, procesi mbikëqyrës i kontrollimit dhe disiplina e tregut), ofron një strukturë me gjithëpërfshirëse për rregullimin dhe mbikëqyrjen bankare, derisa kontrollimi i kërkesave minimale të kapitalit lejon për të dyja një meny të mundësive dhe shtegtim për në metodologjitë më riskante dhe të ndjeshme.

Nën shtyllën I, rregullatorët dhe bankat mund të zgjedhin mes Qasjes së Standardizuar (QS), e cila përmban një rishikim të Bazelit I, dhe një qasje interne e bazuar në gradim (QIBG), dy metodologjitë e së cilës (Bazike dhe e Avancuar) janë të dedikuara për bankat me një menaxhment më të sofistikuar rreziku.

Derisa Bazelit II mbetet kryesisht i përqendruar në operimet e bankave ndërkombëtare, prania e QS-së de fakto vlerëson se, ndërkohë, rreth 100 vende kanë pranuar Bazelit I si një strukturë sistematike për sistemin e tërë bankar.

Bazelit II vazhdon të konsiderojë kapitalizimin dhe praktikën e dobishme të rrezikut si mjete kryesore që t'i bëjë bankat me aftësi më të madhe të rimëkëmbjes. Metodologjitë QIBG janë parë si hap i domosdoshëm drejt radhitjes së kapitalit rregullator me metodologjitë të avancuara riskante dhe të ndjeshme që përdoren nga bankat me rrezik të sofistikuar për të llogaritur kapitalin e tyre ekonomik.

Nga kjo perspektivë, Bazelit II, e në veçanti Shtylla e saj e parë, duhet konsideruar si mjedis dinamik i rregullatorit, i gatshëm për të pranuar metodologjitë më të avancuar të rrezikut sa më shpejt që ato paraqiten mjaft të besueshme që të inkorporohen në skemën e saj të kursimit. Kjo me sa duket tenton që të ketë autoritet të gjerë dhe të vepruarit autonom si dhe rol kyç i mbikëqyrjes së Shtyllës së dytë që është në themelim.

Rezultatet substanciale të paraqitura nga F-QIRB dhe A-QIRB janë të dedikuara të aplikohen, së paku bile në të ardhmen e afërt, te bankat ndërkombëtare. Sido që të jetë, qeverisja e pandryshuar e strukturës së KBMB-së, me delegatë nga bankat qendrore dhe autoritetet mbikëqyrëse të G-13 tës, nuk e pranojnë se një strukturë, që së pari është menduar që të aplikohet vetëm te bankat ndërkombëtare, të bëhet standard për tërë sistemin bankar, gjithashtu edhe për shumë vende jo-anëtare të KBMB-së.

Edhe pse disa përfaqësues të vendeve në zhvillim janë regjistruar si partner mësimi pas propozimit fillestar të rishikimit të avancuar më 1999, kjo ende nuk është ndryshuar as me logjikën e Marrëveshjes së Re e as karakteristikat.

Përveç kësaj, edhe pse KBMB e ka miratuar, si një rezultat i liberalizimit financiar të viteve 1990, marrëdhëniet mbikëqyrëse të vendeve nikoqire janë bërë artikulum kyç për zbatim efektiv të marrëveshjes, ujdisë relative institucionale, që kryesisht mbetet e liruar sikurse edhe origjinali nga viti 1975 të Marrëveshjes së Bazelit.

Kur të vlerësojmë implikimet e Bazel II për vendet në zhvillim, disa nga karakteristikat e saj shpesh janë vënë në kritikë, pasi që dukej të paraqiste rrezik serioz për efikasitetin dhe stabilitetin financiar të këtyre shteteve.

Qëllimi i dokumentit të prezantuar është analizimi i këtyre kritikave, duke veçuar ato që kanë të bëjnë me efikasitetin e Bazelit, si një mjet mikrorregullues, nga të cilat mendohet të jenë të pamjaftueshme si mbrojtje kundër jostabilitetit sistemik.

Mund të përfundojmë se për vendet në zhvillim nevojitet një ndryshim në qasje, duke shkuar nga fushëveprimi i nivelit rregullues të Bazelit te fushëveprimi i stabilizuar.

Kjo do të thotë se duke hapur rregulloren të mikro dhe makro karakteristikat të një shteti specifik dhe duke e bërë koherent me institucionet dhe politikat vendore mbi të cilat realisht këto vende mund të mbështeten.

Këtu vlen të merren në konsideratë skemat alternative të punuara nga versionet “më të dobëta” të rregulloreve të kursimit të shoqëruara me intervenime strukturale si për sistemin bankar ashtu edhe për atë ekonomik në përgjithësi.

Fjalët kyçe: Bazel II, qasja trishtyllëshe, vendet jo-anëtare të KBMB-së, zgjerimit të aksioneve bankare, prociklimi, marrëdhëniet mbikëqyrëse të nikoqirëve.

Mund të jetë e dobishme që të përkujtohen themelet historike të strukturës së Bazelit. Marrëveshja e parë është menduar të jetë për një periudhë në të cilën rregullorja e vjetër bankare, më vonë e quajtur si strukturale, që ishte ende në funksion, e posaçërisht në SHBA.

Themeli i rregullores së vjetër, aty ku ka ekzistuar, ishte që të adresohet natyra sistematike e (jo)stabilitetit. Përvoja e viteve 1970-ta dhe 1980-ta tregon se diçka mungonte sa i përket bankave të mëdha, që funksiononin në nivel ndërkombëtar, domeni i veprimit të cilave ka qenë vazhdimisht duke u zgjeruar.

Këto banka është menduar të jenë të menaxhuara mirë sa i përket efikasitetit të veprimit dhe shënimit të çmimit nga humbjet e pritura, por jo edhe mjaft të vetëdijshëm nga lëkundjet e mëdha ndërkombëtare, që tani janë mjaft të shpeshta dhe serioze, mund të minojnë mbijetesën e tyre dhe të vënë në rrezik funksionimin e sistemeve financiare vendore dhe ndërkombëtare.

Përvoja e lartëpërmendur tregon se sa lehtë ishte që një lëkundje serioze të rezultonte në bilancin e parave të humbura të një urdhërese me një rëndësi më të lartë se kapitalet bankare (prandaj ekziston një hapësirë mes sasisë optimale të kapitalit social dhe privat).

Studimet historike më tutje sugjeronin se për një periudhë më të gjatë kohore, bankat kishin zvogëluar kapitalizimin e tyre. Ishte e natyrshme të supozohej se duke frenuar apo kthyer këtë trend mund të përmirësonte mëkëmbjen e bankave ndërkombëtare, p.sh. aftësia e tyre që të fitojnë në kohë për të rikthyer kapacitetin e tyre.

Përveç kësaj, kërkesa për rregullimin e rrezikut të kapitalit mund të veprojë si një stimulim *ex ante* kundër rrezikimit të tepruar. Prandaj, formulimi i Bazeli I, adaptimi i gjerë i së cilës është parë, kryesisht si, mënyrë që të arrihet një fushëveprim në nivel rregullativ ndërkombëtar drejtuar kah konkurrenca e kufizuar dhe e padrejtë.

Nga koha e formulimit të Marrëveshjes së parë shumë gjëra kanë ndryshuar. Nga pikëpamja jonë, ndryshimi rrënjësor që është bërë ka qenë se shumë vende, të zhvilluara e edhe në zhvillim, e kanë adaptuar, pak a shumë në baza vullnetare, që Bazeli I të largohet nga rregullorja e vjetër strukturale në një strukturë të re kursimi.

Kjo zgjeronte domenin e saj nga veprimi me bankat ndërkombëtare tek aplikimi në tërë sistemin bankar. Ky “konsensus” i ri i Bazelit buron nga dy preambula dhe ka dy pasoja kryesore.

Në etapë të gjatë, stabiliteti vendor rrjedh nga çlirimi i forcave të tregut dhe pasi që stimulimi vjen nga konkurrenca janë parë kompatible me mikro efikasitetin dhe stabilitetin.

Në etapë të shkurtër, mbikëqyrja duhet që të shtyjë të gjitha bankat që të llogarisin kapitalin e tyre ekonomik sipas praktikave më të mira.

E sa për pasojat, së pari, nuk ishte më e mundur që të dalë jashtë kufijve të një konteksti të ri, gjithashtu i përbërë nga bankat e mesme dhe të vogla, si dhe supozimi për institucionet efikase dhe të menaxhuara mirë, prandaj është parë e nevojshme që të prodhohej në vitin 1996 një manual mbi Parimet Themelore për Mbikëqyrje Efikase Bankare dhe rol të spikatur dhënë Shtyllës së Dytë në Bazeli II.

E dyta, disa nga pengesat të shfaqura nga rregulloret e mëparshme bankare kundër krizave sistematike (siç janë kufizimet në konkurrencë), që në shumë vende nuk janë më.

Derisa përvoja me Bazeli I në vendet e zhvilluara (shumica e tyre janë anëtare në KBMB) në përgjithësi është konsideruar e dobishme për stabilitetin e sistemit të tyre bankar, dyshime serioze kanë ekzistuar se kjo ishte në të vërtetë për shkak të kapitalizimit.

Së pari, duhet të marrim me rezervë, se rritja e ngadalshme e ekonomisë në shumë këto vende ka rezultuar me përfitime të majme, edhe në sektorin financiar gjithashtu, prandaj ka rritje të kapitalizimit.



E dyta, veprimet e mbikëqyrësve në drejtim të bankave të dobëta, por jo atyre në falimentim, ka qenë përmirësuar në shumë raste, duke iu referuar ndonjë ligji ndërkombëtar, duke e përdorur atë për të shtyrë këto banka që të pranojnë përvetësimet apo të shikojnë të bashkohen.

Kur shikojmë në implikimet e tyre potenciale për vendet joanëtare të KBMB, në karakteristikat e reja të Bazeli II, sidoqoftë janë dhënë disa kritika që mund të radhiten në pesë kategori kryesore.

### **Zvogëlimi i rrezikut përmes zgjerimit**

Një kritikë e madhe nga viti 1988, Marrëveshja Kapitale e Bazeli ishte dështimi i saj për të shpjeguar reduktimet e kredive, që mund të arrihen përmes zgjerimit të aksioneve bankare. Kjo kritikë ka qenë e drejtuar vetëm deri te një pikë në Bazeli II.

- Qasja e Standardizuar e Bazeli II, në parim është version i ri i Marrëveshjes nga viti 1988 me kalibrim më të madh elaborues të rrezikut të kredive dhe në këtë mënyrë i është ekspozuar kritikave të ngjashme.
- Nën qasjen QIBG, kushtet për lidhje reciproke në formulën për peshën e rrezikut janë punuar ashtu, që të merret parasysh rreziku i zgjerimit brenda kategorive të ndryshme të asetëve të specifikuar. Ato kanë qenë të rregulluara gjatë ushtrimit të Bazeli II si reagim ndaj reprezentacioneve nga sektorët ekonomikë dhe politikanëve.
- Si rezultat i një ndryshimi tjetër nën qasjen QIBG, kushtet për lidhjen reciproke për korporatë, sovranitet, bankë dhe ekspozimeve tjera me pakicë tani janë funksione të zvogëluara të PD-së për të pasqyruar faktin se rreziku i kreditit të firmave që rrezikojnë (p.sh. ato që kanë PD-në më të madhe) janë të ndikuara më shumë nga faktorët ideosinkretikë e më pak nga faktorët sistematikë dhe makroekonomikë.

Megjithatë, në kushtet për lidhjen reciproke të QIBG të Bazeli II, mund të merren parasysh vetëm efektet e zgjerimit brenda kategorive të asetëve të specifikuar dhe jo përgjatë këtyre kategorive.

Zgjerimi përmes këtyre kategorive ka qenë i sugjeruar si automjet për reduktimin e kapitalit të nevojshëm dhe në këtë mënyrë përqindja e interesit, kreditë e bankave ndërkombëtare, që u japin vendeve në zhvillim, propozimi i bazuar në vlerësimet e reduktimit të rrezikut të kredisë, i cili mund të arrihet përmes aksioneve të shpërndara në mënyrë të duhur të huamarrësit nga vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim.

Futja e rregullit për të dizajnuar një portofolio të tillë në Bazeli II mund të përfytyrohet në parim, por duhet të ketë efekt të komplikimit të mëtutjeshëm të një marrëveshje, e cila veçse është komplekse.

Dizajni i tillë brenda parametrave të qasjes QIBG të Bazel II mundet, sido që të jetë, të ndërmerret si pjesë e zbatimit nga rregullatorët kombëtarë dhe ndoshta është veprim më i mirë që është lënë në këtë nivel.

### **Ndikimi pro-ciklikalik i Bazel II**

Kritika e dytë ka të bëjë me pro-ciklikalitetin dhe jostabilitetin. Për Bazel I, pro-ciklikaliteti nuk i referohet ndryshimeve në peshën e rrezikut, por lëvizjeve në kapitalizmin aktual rreth nivelit të vet rregullativ.

Për Bazel II, shumë analistë pajtohen mbi rrezikun e mëtutjeshëm se shumë metodologji të ndjeshëm ndaj rrezikut, të drejtuar në diferencimin e rritur të rrezikut horizontal, mund të rrisin ndjeshmërinë ndaj kohës.

Duke i dhënë më shumë jostabilitet që i karakterizon vendet jo-anëtare të KBMB-së, rezultati mund të jetë nënvizim i hua-dhënies prociklikatike të bankave ndërkombëtare ndaj këtyre vendeve.

Debati ka qenë i përqendruar në çështjet teknike, siç është metodologjia “pika në kohë” apo “përmes-rrethit” të adaptuara nga agjencitë klasifikuese dhe nga bankat gjatë vlerësimeve të tyre interne të rrezikut.

Për atë sa këto metodologji lejojnë më pak ndjeshmëri ndaj kohës, adaptimi i metodave të ngjashme për të vlerësuar rrezikun nga bankat e mëdha mund të rezultojnë gjithashtu edhe me luhatje të mëdha në dy drejtimet, duke rritur jostabilitetin.

Komiteti i Bazelit është i mendimit se lakorja e drejtë e peshës së rrezikut dhe testet e stresit që kërkohen për aprovimin nga mbikëqyrësit e modeleve interne bankare mund të garantojnë ndikim neutral të rregullores.

Debati nuk është çdoherë i qartë për të dalluar në mes të lëvizjeve “normale” ciklitike dhe ato më pak të ndryshueshme, por me ngjarje më përçarëse të krizave sistematike. Për të mbajtur kërkesat e kapitalit brenda kufijve të pranueshëm, llogaritjet VAR përjashtojnë humbjet e jashtëzakonshme.

Kjo pason, pavarësisht ekzistimit të mundshëm të metodologjive për ‘drejtim’, kurse ‘pikat katastrofale’ janë larg nivelit të tyre (për këtë më shumë në seksionin tjetër).

Ndihmesë mund të jetë rregullorja, e cila do të jetë në gjendje për të ndryshuar prociklitizmin e brendshëm të bankave, për shembull duke dhënë disa parametra një ndryshueshmëri anticiklitike.

Rezultatet së fundi varen nga niveli dhe lëvizjet e kapitalit amortizues, p.sh. teprica e kapitalit ndaj asaj rregulluese minimale, atë që e kërkon haptas Shtylla e dytë. Prapë, Bazel II u jep mbikëqyrësve një kompetencë të gjerë të intervenimit.

## Asimetria në mbikëqyrje

Lëmia e tretë e kritikës ka të bëjë me ndikimin e Bazel II në aftësinë e vendeve nikoqire joanëtare të KBMB, për të rregulluar këto banka në mënyrë të duhur. Edhe pse kjo brengë është posaçërisht dramatike për vendet e vogla joanëtare të KBMB, shqetësime të ngjashme mund të shfaqen edhe me rregullatorët mjaft të mëdhenj me të ardhura mesatare.

Sido që të jetë, mbikëqyrja e konsoliduar mund të bëhet burim i vështirësive gjatë zbatimit të Bazel II për një bankë me funksionim jashtë vendit nëse mbikëqyrësi në vendin e tij amë aprovon adaptimin e tij të QIBG-së, derisa në vendin nikoqir të njërit nga entitetet e tij të huaj, i cili ka përshkruar adaptimin e qasjes së standardizuar në legjislativin e tij, falë detyrimit në saje të kapacitetit të mbikëqyrësit, nuk është i gatshëm të pajtohet me miratimin e tillë falë frikës nga efektet konkurruese jo fort të favorshme në bankat vendore.

Efektet e tilla mund të kenë pasojë të mundësisë së pranimit nga KBMB se “një mori qasjesh për të përcaktuar mjaftueshmërinë kapitale mund të rezultojë arsyeshëm në nevojat e ndryshme të kapitalit për llojin e njëjtë të transaksionit”.

Sipas Marrëveshjes së Bazelit të vitit 1983, që përshkruan shpërndarjen e përgjegjësive për një bankë me funksion përtej kufijve vendorë, përgjegjësia për mbikëqyrjen e aftësisë së pagimit, e cila përfshinë atë të kapitalit, ndryshon nëpër degë dhe vartës.

Për një degë (e cila është pjesë integrale e pjesës amë dhe nuk ka status të ndarë legal) aftësia e pagimit kryesisht është përgjegjësi e mbikëqyrësve në vendin e bankës (edhe pse mbikëqyrësit në vendin nikoqir mbajnë përgjegjësinë e përgjithshme për monitorimin e gjendjes financiare të degëve në vendet e huaja).

Ndërsa, për një vartës (i tëri apo shumica e poseduar nga një institut i pavarur i inkorporuar në vendin nikoqir) mbikëqyrja e aftësisë së pagimit është përgjegjësi e përbashkët e mbikëqyrësve në vendin amë dhe atë nikoqir, pasi që entiteti është legalisht i inkorporuar në vendin nikoqir, por ekspoziturat e bankës jashtë vendit gjithashtu duhet të merren parasysh në mbikëqyrjen e konsoliduar të bërë nga mbikëqyrësi në vendin amë.

Sido që të jetë, këto udhëzime janë bërë për të shërbyer objektivat e mbikëqyrjes së kursimit e jo për t'u marrë me problemet e parashtruara për koordinimin e mbikëqyrjes nga elementet e konkurrencës bankare.

Në këtë mënyrë, në rastin e vartësit, mbikëqyrësi nikoqir mund të jetë edhe ushtrues detyre në pajtueshmëri me të drejtat e tij nëse insistohet në qasjen e standardizuar. Kjo mund të vë në bankën amë dhe mbikëqyrësi në vendin amë barrën (një shpenzim shtesë) të integritit të qasjes së vartësit në strukturë të konsoliduar të funksionit të saj.

Në rastin e degës, sipas interpretimit të saktë, direktivat nga viti 1983, Marrëveshja e Bazelit nuk rregullon rastin në të cilin mbikëqyrësi i grupit bankar të vendit ka pranuar

përdorimin e tij të qasjes QIBG-së, por mbikëqyrësi nikoqir në vendin e njërës prej degëve të saj ka vendosur që entitetet bankare nën juridiksionin e saj duhet përdorur qasjen e standardizuar.

Sido që të jetë, është e kufizuar direktivën si në vijim:

- Do të kërkohet bashkëpunim i shtuar mes mbikëqyrësve, posaçërisht për mbikëqyrje jashtë vendit të grupeve komplekse ndërkombëtare bankare.
- RF nuk do të ndërrojë përgjegjësitë juridike të mbikëqyrësve kombëtarë apo marrëveshjet për mbikëqyrje të konsoliduar, siç është theksuar në standardet ekzistuese të KBMB.
- Mbikëqyrësit duhet që grupeve bankare t'u komunikojnë rolet përkatëse të mbikëqyrësve të vendit amë dhe vendit nikoqir me veprime domethënëse jashtë kufijve të vendit në legjislacione të shumëfishta.
- Rekomandohet qasje pragmatike e identifikimit së dyanshëm. Kjo “përfshin identifikimin e qasjeve adekuate të kapitalit në legjislacionin e nikoqirit, gjithashtu edhe dëshirën për të minimizuar ndryshimet në rregulloret kombëtare kompetente për kapitalin në mes legjislacionit amë dhe nikoqir, ashtu që bankat vartëse të mos jenë të nënshtruara barrëve të tepërta”.

Ky udhëzim është në pajtim me atë të dokumentit të KBMB, të gushtit të vitit 2003, ku çështjet e përfshira në zbatimin e Bazeli II të mbikëqyrjes jashtë kufijve vendorë janë theksuar plotësisht: “Kur grupi bankar vepron së paku në një vend tjetër përpos vendit amë, për zbatimin e Marrëveshjes së Re mund të kërkohet që të merret aprovimi për përdorimin e qasjeve të caktuara nga mbikëqyrësit e një vendi nikoqir relevant individualisht apo nën-konsoliduar, gjithashtu nga mbikëqyrësi i vendit amë, sa i përket të mbikëqyrjes së konsoliduar”.

Dokumenti njofton se duke pasur parasysh faktin se “mbikëqyrësit nga vendi nikoqir kanë interes në pranimin e metodave dhe proceseve të pranimit në nivelin e konsoliduar, në mënyrë që të zvogëlojnë barrën e miratimit dhe t'i shmangen shitjes së njëkohshme në disa tregje,... [ata] kanë interesa tjerë legjitimë që mund t'i parandalojnë nga identifikimi i përdorimit të nivelit të nënkonsolidimit një qasje të miratuar në nivel të grupit”.

Këtu, gjithashtu, qasja e përgjithshme e KBMB-së të shpërndarja e përgjegjësive për mbikëqyrjen e kapitalit bankar bazohet në Marrëveshjen nga viti 1983, e cila tregon për shkëmbimet e shtuara të bashkëpunimit dhe informatave mes mbikëqyrësve vendorë dhe atyre nikoqirë.

Por, bashkëpunimi efektiv i mbikëqyrësve nuk arrihet çdoherë lehtë dhe vështirësitë mund të jenë më të mëdha kur ekzistojnë ndryshime substanciale mes mbikëqyrësve të involvuar, si në rastin e përkthuar më lartë, p.sh. ndryshimet në lidhje me pranimin e Qasjeve të Standardizuara dhe QIBG nën Bazeli II.

KBMB-ja, siç duket, është duke vlerësuar rastet studiuuese, duke përfshirë aspekte të ndryshme të bashkëpunimit të mbikëqyrësve në lidhje me zbatimin e Bazeli II, i cili mund

të përfshijë edhe çështjet e sapokrijuara dhe shpie deri tek udhëzimet edhe më të detajizuara, për atë se si të ballafaqohet me to.

Rreziku operacional është temë që ka të bëjë me atë se cili udhëzim është më konkret sa i përket përgjegjësive përkatëse të mbikëqyrësve vendorë dhe nikoqirë në kontekst të zbatimit të konsoliduar të Bazel II, i cili ka qenë i botuar që nga CP3, por para RF-së.

Këtu çështja është që AMA të caktojë kërkesat e kapitalit për bankat me veprim jashtë vendit, duke përfshirë edhe vartësit. Është e arsyeshme të pretendohet se këto udhëzime plotësojnë rregullat e RF-së.

Shqetësimet e rezultateve të KBMB-së nga multi-funksionaliteti i bankës së përfshirë në menaxhimin e rrezikut operues me rezultat se “në çdo grup bankar, disa nga këto funksione do të kryhen në nivel të grupit, derisa tjerat do të bëhen në nivel individual”, por kapitali nuk është e domosdoshme që të transferohet brenda një grupi bankar gjatë kohës së tensionit.

Në vijim, KBMB-ja thekson se mekanizmi i akorduar për rrezikun operues përgjatë linjave të biznesit nën AMA duhet të aprovohet nga mbikëqyrësi vendor dhe ai nikoqir, e pastaj duhet të mbajë të drejtën për të imponuar kërkesat tjera kapitale, nëse nuk është i kënaqur që kapitali i alokuar te vartësit në juridiksionin e saj është proporcional me profilin e saj të rrezikut operues.

### **Çështja e konkurrencës**

Kritika e katërt qëndron në sasinë dhe cilësinë e resurseve të nevojshme për banka dhe autoritetet mbikëqyrëse të jenë në pajtim me efikasitetin e Bazel II. Problemi gjithashtu ka të bëjë me bilancin e kostos dhe përfitimeve që dalin nga Marrëveshja e Re.

Derisa bankat e mëdha ndërkombëtare presin përfitime neto nga adaptimi i versionit të QIBG-së të Shtyllës së Parë dhe rregullatorët në vendet e pasura mund të kenë resurse të duhura për t’i mbikëqyrë në mënyrë efikase, është e qartë se nuk është rast për shumicën e rregullatorëve nga vendet joanëtare të KBMB-së dhe për bankat e mesme dhe të vogla.

Prandaj, Studimi i pestë i Ndikimit Sasior (S5NS) drejtuar nga BIS tregon se AIRB-ja, mund të sjellë reduktime të mëdha të kërtimeve kapitale për disa banka për gati 30 për qind; qasja e standardizuar mund të përfshijë rritje të konsiderueshme prej afër 40 për qind për disa banka.

Ndryshimet e këtilla të mëdha mund t’i japin bankës së huaj një përparësi të madhe konkurruese nëse adaptojnë qasjen e avancuar dhe bankat lokale mbesin në qasjen e standardizuar.

Qëllimi për të arritur një fushëveprim në nivel rregullator është pra në rrezikun, me shpërndarje të madhe të parashikuar të menysë rregullative mes vendeve dhe bankave, dhe ndryshimeve të mëdha në aftësinë e rregullatorit për të menaxhuar, gjithashtu edhe

me një pavarësi të duhur, autoritetet e fuqishme që vijnë nga paqartësia e Shtyllës së Dytë.

### **Sfidat për sektorin e korporatës**

Kritika e pestë është e lidhur me pikën e mëparshme. Është mendim i zakonshëm që bankat e mëdha dhe konglomeratët financiarë të adaptojnë opsionet më të avancuara të Shtyllës 1, dhe do të përfitojnë nga kërkesat e vogla të kapitalit sesa bankat e mesme dhe të mëdha, të detyruara që të adaptojnë qasjen e standardizuar apo versionin e rishikuar të Bazel I.

Kjo do të duhej t'i jep përparësi në dimensione të mëdha, duke shtyrë tutje procesin e konsolidimit në industrinë bankare.

Përdorimi i rrezikut bazuar në modelet QIBG nga bankat e mëdha vendore dhe të huaja për të përcaktuar sasinë e kapitalit për t'u alokuar për kategoritë e ndryshme të huamarrësve, ka mundësi të rezultojë si me kredi më të shtrenjtë dhe me këste më të mëdha dhe për huamarrësit perceptohet si rrezik më i madh, dhe kredit më i lirë për huamarrësit kuptohet si rrezik i ulët.

Për shkaqet si asimetria informative (dhe faktit se Bazel II qartë i ka dënimet e rënda, për shkak të mungesës apo informatës së kufizuar), SME ka mundësi të konsiderohet me rrezikshmëri më të lartë sesa të mëdhat, si kompanitë e mëdha. Kjo mund të shkaktojë koncentrimin e aksioneve bankare larg nga huamarrësit e vegjël dhe drejt kompanive të mëdha.

Përveç kësaj, koncentrimi i aksioneve të kuptohet se rreziku është koncentruar dhe në këtë mënyrë i bën institucionet financiare edhe më të ndijshme ndaj luhatjeve dhe rrethanave të papritura.

Kjo shkon kundër objektivave të menduara të masave të rregullatorit, e cila është të zvogëlojë rrezikun dhe ndjeshmërinë, që bankat zakonisht u janë të ekspozuara.

Nëse banka e huaj adapton qasjen QIBG, do të kenë stimulim për të përqendruar më tej aksionet e tyre në pjesën e sipërme të tregut, sikurse kjo do t'i shpëtojë atyre kapitalin, dhe në këtë mënyrë do të kishin përparësi konkurruese për t'u dhënë hua kompanive të "mira" ndaj bankave lokale, të cilat përdorin qasjen e standardizuar.

Grupi i fundit i bankave, nga kjo, do të shtyhen drejt huasë me segmente më të rrezikshme tregtare, duke i bërë potencialisht të rrezikuara. Ky trend mund të forcohet më tutje nga fakti se, sipas disa rregullatorëve nga vendet joanëtare të KBMB-së dhe zyrtarëve të IMF-së, qasja e standardizuar e Bazel mund të jetë e nënvlerësuar disi me rrezikun e huasë SME-së.

Kjo do të krijonte një ndarje të punës mes bankave lokale dhe të huaja, që nuk do të paralajmërojë lajme të mira për stabilitetin e gjithë sistemit financiar.

Është e vërtetë se ndarja e tillë e punës mund edhe të ekzistojë, ku bankat e huaja koekzistojnë me bankat tjera lokale, (dhe hulumtimet e fundit empirike në IMF qartë shihet se tregojnë se bankat e huaja shihet të japin hua më pak SME-së sesa bankave tjera).

Por, në prezantimin e regjimit të dyfishtë, Bazeli II do të përforconte këtë model.

Përveç kësaj, në vendet ku bankat e huaja janë dominuese (p.sh. Meksika, Evropa Lindore), qasja për kredi nga SME mund të jetë dekurajuese, atëherë kur qasja QIBG prezantohet. Kjo mund të kërkojë veprime plotësuese nga qeveritë apo bankat e zhvilluara për të rritur huanë publike të SME.

### **Përfundim**

- a) Zbatimi efektiv i Bazeli II në vendet joanëtare të KBMB has në shumë pengesa, ndoshta gjëja më e rëndësishme është të krijohen autoritetet mbikëqyrëse dhe të jenë mjaft të pavarura, të kualifikuara dhe resurse.
- b) Zbatimi i Bazeli II nuk do të arrijë stabilitet financiar në vendet, që kanë mungesë të parakushteve të domosdoshme strukturale dhe makro- ekonomike për stabilitet të tillë.
- c) Dhënia e tensionit të tij në kapitalin e rregullatorit, Bazeli II është veçanërisht joefektiv për vendet joanëtare të KBMB ku:
  - Përqendrimi dhe afërsia e kapitalit real dhe financiar i bën jo-efektive kërkesat kapitale.
  - Luhatjet e mëdha dhe të shpeshta të përjetuara nuk janë paguar nga sasia e arsyeshme e kapitalit bankar. Duke pasuar qasjen e rregullores së kursimeve, tentimi për të parandaluar krizat sistematike u janë shtuar disa kategori të kërkesave minimale dhe duke i forcuar ato japin kosto më të lartë dhe joefikase për bankat.
- d) Shuma e Bazeli II, veprimet bankare jashtë vendit dhe programi FSAP mund të krijojnë shtrembërime të rëndësishme, duke i shtyrë vendet joanëtare të KBMB-së të adaptojnë një standard, që nuk është në pajtueshmëri me aspektet e rëndësishme të brishtësisë së tyre specifike financiare dhe me qëndrueshmërinë gjatë rrugëtimit të tyre zhvillimor.

Këto argumente mund të shpijnë vendet joanëtare të KBMB-së, që të bashkëpunojnë, në mënyrë që të kërkohej ndërkombëtarisht të vlerësohet, jo sipas kushteve të librit të Bazelit, por sipas kushteve të adaptimit të parimeve shumë të gjëra të menaxhimit dhe matjes së rrezikut, plotësuar nga një set kompleks të masave politike dhe aranzhimet institucionale, që duhet të jenë të dyja koherente me karakteristikat e tyre specifike dhe të afta për të matur kostot e rregullatorit brenda kufirit të pranuar.

23 Rregullorja financiare duhet të shihet si pjesë e skemës koherente të strukturës së duhur politike të secilit vend.

Duke ditur që vetëm institucionet e avancuara dhe tregjet mund të llogariten që përgjigjen në mënyrë të efektshme rregullave dhe stimulimit të kursimit 24, masat strukturale të rregullores financiare duhet të merret në konsideratë dhe kur shihet si më e përshtatshme, në ndërrim apo shtim të atyre të kursimit.

Sido që të jetë, bashkëveprimi ndërmjet parakushteve, rregullores dhe mbikëqyrjes duhet që të luhen brenda kontekstit dinamik struktural; në veçanti, pasi që merr më shumë resurse për të mbikëqyrë aplikimin e standardeve komplekse sesa rregulla të thjeshta, rregullorja duhet që t'i përshtatet aftësisë së mbikëqyrësit për ta menaxhuar.

### **Literatura**

1. Basel Committee on Banking Supervision, “Core principles for effective banking supervision”, Basel, June 2006.
2. Griffith-Jones S., Segoviano M.A., Spratt S. “Basel II: Developing countries and portfolio diversification”, CEPAL Review, 83, August. 2004.
3. Bernanke B. (2004), “The Implementation of Basel II: Some Issues for Cross-Border Banking”, Federal Reserve Bank, 2004.
4. Gandy T., “The impact of regulation”, Special supplement to The Banker, September 2004.
5. Catarineu-Rabell E, Jackson P and Tsomocos DP Procyclicality and the New Basel Accord –banks’ choice of rating system. Bank of England Working Paper, No. 181. London, Bank of England. 2003.



**Dr. Brtaislav Millosheviq**  
**Stevco Meceski**

## **SIGURIA, LIKUIDIMI DHE RENTABILITETI SI KATEGORI EKONOMIKE NË SIGURIM**

### **Hyrje**

Në teorinë ekonomike shumë është shkruar dhe shënuar për prodhimtarinë, ekonomizimin, rentabilitetin dhe likuidimin. Ekzistojnë shumë definicione për këto nocione, të cilat kryesisht edhe nuk dallojnë. Për sigurinë është shkruar më pak.

Domethënia e saj në punën e shoqërive tregtare nuk është as përafërsisht siç është domethënia e prodhimtarisë, likuidimi dhe ekonomizimi, përkatësisht rentabiliteti, si parime kryesore në punë. Në këtë punim është përfshirë dhe përpunuar edhe siguria, pasi siguria në sigurim paraqet parim, i cili ka domethënie të veçantë në punën e organizatave për sigurim.

### **Siguria**

Sipas teorisë ekonomike, siguria në punë në shoqëritë tregtare nuk bën pjesë në parimet themelore të punës, por kjo është një nga mënyrat e bërjes politike të likuidimit. Siguria në punë në organizatat për sigurim (shoqëritë për sigurim) paraqet një nga parimet themelore të punës.

Bazat afariste mund të ndërtohen në bazë të parimeve ekonomike, por lëvizja jo e volitshme e dëmit në kohë (paraqitja e dëmeve të veçanta të mëdha, akumulative ose katastrofale si dhe dëmeve masive), mund të çojë deri te pamundësia për plotësimin e detyrimeve të marra ndaj të siguarurve.

Prandaj, siguruesit në praktikë të disa rreziqe, që nuk mund t'i mbulojnë vetë me kapacitetet e veta bëjnë atomizimin (ndarje) e rreziqeve të tilla dhe plasman të tepricave në risigurim.

Nëpërmjet vërtetimit të drejtë të kapaciteteve personale për bartjen e rrezikut dhe plasman i tepricës së rrezikut mbi kapacitetin në risigurim, siguruesi maksimalisht e siguron sigurinë e vet.

Ajo shihet në atë që ia mundëson siguruesit dëmet e mëdha të veçanta, dëmet kumulative, dëmet katastrofale dhe dëmet masive, të cilat eventualisht mund të paraqiten që i tejkalojnë dëmet e pritura, pa asnjë problem t'i dëmshpërblejë të siguararit.

Njëkohësisht siguria do të thotë se edhe të lëvizjet eventuale, jo të volitshme të dëmeve, në ndonjë vit afarist, për shkak të ndodhisë së të gjitha llojeve të dëmeve të paraqitura më parë, siguruesi duhet të realizojë të ardhura mbi shpenzime.

Dëmet e mëdha dhe masive mund të ndikojnë në rezultatin financiar për një vit të caktuar. Mund të jetë negativ pasi premia e sigurimit, e përcaktuar në bazë të mesatares, nuk është e mjaftueshme. Këto zbrapsje të mesatares quhen “zbrapsje të rastit” dhe mund të zgjidhen në dy mënyra:

- Nëpërmjet llogaritjes së të dhënave të larta siguruese (pagesë shtesë) të premisë së nevojshme për sigurim ose formimin e kapitalit personal dhe në përpikmëri mbajtjen e rrezikut tekniko sigurues;
- Me atë që siguruesi lider (direkt) të dikush tjetër do ta (ri)sigurojë atë rrezik, kështu që në mënyrë të njëjtë si sigurues shpenzimet e veta variable do t'i ndërrojë me shpenzime fikse.

Në praktikë nuk zbatohet vetëm një mënyrë ose tjetër për zgjidhjen e atij problemi, por ato kombinohen në varësi të mundësive. Sot lirisht mund të vërtetohet se nuk ekziston as edhe një sigurues direkt, as në vend e as në botë, i cili nuk përdorë mbrojtje risiguruese në sasi të caktuar, siç edhe nuk ekziston sigurues direkt, i cili një pjesë të rrezikut nuk e mbulon vetë.

Me siguri që në asnjë veprimtari nuk ekziston një lidhje dhe bashkëpunim i tillë si në shpërndarjen dhe durimin e rrezikut në mes siguruesit dhe risiguruesit në tregun vendas dhe atë botëror.

Kjo, në kohë të fundit, bëhet edhe më e shprehur, për shkak të koncentrimit të rrezikut dhe rritjes së madhësisë së rrezikut, për shkak të zhvillimit të teknikës dhe teknologjisë dhe ndryshimeve të mëdha në rëndësinë e rreziqeve të veçanta.

Në vitet e fundit erdhi deri te problemi i rëndësishëm në sferën e rreziqeve katastrofike, gjegjësisht në territorin e katastrofave natyrore (tornado, uragan, vërshime, tërmete) në botë, e veçanërisht në Evropë.

Të gjitha këto ndryshime, që ndodhin në territorin e fatkeqësive natyrore, iu paraqesin probleme shumë të mëdha siguruesve (dhe risiguruesve), pasi shtrohet pyetja se si dhe në cilën mënyrë të mbulohen me sigurim, si të barazohen në vend dhe kohë, si dhe si të vërtetohet premi e mjaftueshme për mbulim të detyrave të marra, që e njëjta të jetë ekonomikisht e pranueshme për kontraktuesit e sigurimit.

Por, gjatë përlllogaritjes së premisë së nevojshme duhet të merren parasysh (të vlerësohen) lëvizjet e ardhshme në vendin dhe kohën e rreziqeve të veçanta.

Në atë kuptim janë zhvilluar dhe po zhvillohen metoda të caktuara për llogaritjen e premisë së nevojshme me atë që premia e fituar gjatë llogaritjes të korrigjohet me elemente të tjera të politikës afariste të siguruesit (dhe risiguruesit).

### **Likuidimi**

Likuidimi në sigurimin ka specifika të caktuara në raport me shoqëritë tregtare. Mjetet financiare siguruesi i fiton nëpërmjet pagesës së premisë të sigurimit dhe nëpërmjet mjeteve të tjera.

Premia e sigurimit, sipas rregullit, paguhet përpara për një periudhë të caktuar të sigurimit, ndërsa dëmet mund të ndodhin, përkatësisht te një numër i madh i marrëveshjeve të sigurimit ndodhin, prej ditës së parë deri te e fundit e periudhës, për të cilën është paguar premia e sigurimit.

Dëmet në sigurim dhe afati i arritjes është vështirë të parashikohen dhe të planifikohen me siguri. Detyrimi kryesor i siguruesit është t'ia kompensojë dëmin e bërë të siguruarit në kuadër të marrëveshjes së bërë për sigurim.

Vetë ndodhia e rastit të siguruar nuk do të thotë edhe arritje e detyrimit për pagesë. Nga dita e ndodhjes së dëmit e deri te pagesa është e nevojshme të kalojë një kohë e caktuar. Koha e caktuar mund të jetë prej disa ditësh deri në disa javë, e në raste të veçanta edhe më shumë se një vit.

Sa kohë do të kalojë nga shkaktimi i dëmit e deri te pagesa varet nga shkaqet për dëmin, sasia e dëmit, llojet e pronës së dëmtuar ose interesi i pronës, madhësia e dëmit, koha e nevojshme për riparim ose sjelljen e objekteve në gjendjen e mëparshme, dokumentacioni i nevojshëm etj.

Çdo dëm ka specifikat e veta, të cilat i përcaktojnë punët e nevojshme, dokumentacionin dhe kohën. Në raste të caktuara të kërkesës së të siguruarit dëmi mund të paguhet pjesërisht.

Kjo bëhet sipas rregullit të dëmet e mëdha, ku është e sigurtë se do të duhet më shumë kohë për përpunimin e dëmit, përkatësisht caktimin e lartësisë përfundimtare. Në sasinë e madhe të punës, në bazë të përcjelljes statistikore, rastësia bëhet ligjshmëri, kështu që mund të planifikohet, përkatësisht parashikohet lëvizja globale e dëmeve materiale.

Në atë rast, me “dëme materiale” nënkuptohen dëme të vogla dhe të mesme, të cilat me siguri dhe me saktësi mund të planifikohen. Nuk është e mundur të parashikohet lëvizja e dëmeve të mëdha (dëmi veçanërisht i madh, dëmi akumulativ, dëmi katastrofal, dëmi masovik), pasi ato ndodhin në intervale kohore të gjata apo të shkurtra.

Te ato dëme në lartësi të pjesës së tyre marrin pjesë risiguruesit nëse është nënshkruar marrëveshja për risigurim.

Me realizimin rastit të siguruar në fillim paraqitet shpenzim, pastaj, pas kalimit të një kohe të caktuar pagesa e dëmit. I siguruari duhet të ketë në dispozicion mjete rrjedhëse, në atë moment kur detyrimi për pagesë të dëmit ka arritur.

Në sigurim gjithmonë ekziston vend i caktuar kohor ndërmjet pagesës së premisë të sigurimit dhe pagesës së dëmit. Kjo është arsyeja që problemet e likuidimit në sigurim janë shumë më të vogla sesa ato të ekonomisë.

Në kohën e jolikuidimeve të mëdha në ekonomi, organizatat për sigurim shpesh janë likuide, përkatësisht kanë mundësi në çdo kohë t'i shlyejnë detyrimet e arritura.

Në kohë të likuidimit të përkeqësuar në ekonomi më vështirë është të bëhet pagesa e premisë së sigurimit, përkatësisht më shumë është prezente pagesa e shtyrë, më vonë paraqitet ardhja e të hollave me shumicë, ndërsa në periudhën kur likuidimi në ekonomi përmirësohet një pjesë më e madhe e premisë paguhet gjatë arritjes së marrëveshjes për sigurim, derisa më herët paraqitet derdhja e mjeteve financiare.

Shkalla e pagesës së premisë të sigurimit nga shoqëritë tregtare më e madhe është në periudhat e likuidimit të mirë në ekonomi, ndërsa më e vogël në periudhën e likuidimit të përkeqësuar në ekonomi.

Shkalla e pagesës së premisë nga persona fizikë (nga qytetarët), sipas rregullit, është më e madhe për dallim nga shoqëritë tregtare, për shkak se dinamika e pagesës së premisë në tërësi është më e shpejtë.

Natyrisht që shkalla e pagesës së premisë varet edhe nga politika afariste, të cilën e bën siguresi në territorin e pagesës së premisë së sigurimit, pas marrëveshjeve të bëra për sigurim.

### **Elementet për vërtetimin e likuidimit**

Elementet e likuidimit në sigurim janë detyrimet e marra në bazë të marrëveshjeve të arritura për sigurim dhe detyrimet nga marrëveshjet e arritura për bashkësigurim dhe risigurim, afati i arritjes së atyre detyrimeve dhe mjetet për pagesë.

Që të arrihet likuidim, shuma e mjeteve në dispozicion duhet të jetë e mjaftueshme për shlyerjen e detyrimeve të arritura në kohën e arritjes së tyre. Kjo do të thotë se ardhja e të hollave me shumicë dhe derdhja e mjeteve financiare duhet të jetë pajtuar sipas afateve të arritjes.

Në sigurim rrjedha kryesore e derdhjes së mjeteve ndodh me arritjen e marrëveshjes për sigurim, kur bëhet pagesa e premisë së sigurimit, ndërsa rrjedha kryesore e zvogëlimit të mjeteve financiare ndodh gjatë pagesës së dëmit dhe shuma e kontraktuar në bazë të marrëveshjeve të bëra për sigurim.

### **Ardhja e të hollave me shumicë**

Ardhja kryesore e mjeteve financiare ndodh gjatë pagesës së premisë së sigurimit, pas arritjes së marrëveshjeve për sigurim.

Premia e sigurimit, sipas rregullit paguhet menjëherë, gjatë arritjes së marrëveshjes për sigurim, por mund të kontraktohet edhe pagesa me këste. Kur kontraktohet pagesa me këste detyrim është që kësti i arritur i premisë të paguhet në afat të caktuar.

Ardhjen e të hollave me shumicë siguroesi (si tërësi) e realizon në disa baza: ardhja e të hollave me shumicë në bazë të pagesës së premisë së sigurimit; ardhja e të hollave me shumicë në bazë të pagesës nga bashkësiguroesit, risiguroesit sipas pjesëmarrjes në dëmet e likuiduara dhe pjesërisht të likuiduara; ardhja e të hollave me shumicë në bazë të pagesës së mjeteve nga mjetet e investuara nga sigurimi; ardhja e të hollave me shumicë në bazë të pagesës sipas shkaqeve të tjera të mbetura.

### **Derdhja e të hollave (parave)**

Derdhja e mjeteve financiare të siguroesit në tërësi realizohet sipas disa bazave: derdhje në bazë të likuidimit dhe likuidimit të pjesshëm të dëmeve; derdhje në bazë të premisë së bashkësigurimit dhe risigurimit; derdhje sipas shkaqeve të tjera të mbetura.

### **Specifikat në ruajtjen e likuidimit rrjedhës në sigurim**

Problemi i likuidimit në sigurim tregohet në mënyrë tjetër sesa në shoqëritë tregtare. Në bazë të marrëveshjeve të arritura për sigurim, premia e sigurimit, sipas rregullit, paguhet paraprakisht për periudhën që mbulohet dhe për të cilën është llogaritur (prej skadimit deri në skadim, këste të kontraktuara për periudhë të caktuar paraprakisht ose në ndonjë mënyrë tjetër).

Marrëveshjet në sigurim vazhdimisht arrihen dhe pas tyre paguhet premia gjatë vitit kalendarik. Gjithashtu, gjatë vitit kalendarik likuidohen dhe paguhen dëmet dhe shuma të siguruara, sipas marrëveshjes së arritur për sigurim.

Në tërësinë e premisë së përgjithshme të paguar për sigurim është paguar edhe pjesa e premisë për sigurim, e cila ka të bëjë me vitet e ardhshme kalendarike.

Pjesën e premisë së paguar, që ka të bëjë me vitet e ardhshme kalendarike, me premia bartëse, pasi ajo shërben për mbulimin e detyrimeve, sipas marrëveshjeve në sigurim, të cilat fillojnë në vitin kalendarik rrjedhës, ndërsa mbarojnë në vitet e ardhshme kalendarike.

Dëmet e ndodhura në vitin kalendarik, të cilat nuk janë zgjidhur dhe paguar, sipas marrëveshjes në sigurim, hynë në shpenzimet e vitit kalendarik. Siguroesi në tërësi mund të jetë likuidues i lartë e të punojë me humbje.

Siguruesi është likuidues në rast të humbjes derisa ajo shumë nuk është më e madhe sesa pozita bartëse (premia bartëse dhe dëmet e rezervuara).

Shuma më e madhe e premisë bartëse është paguar sipas shkallës së pagesës së premive të policuara dhe kjo pjesë paraqitet si derdhje e mjeteve financiare, ndërsa dëmet e rezervuara paraqesin dëme, të cilat ende nuk janë paguar (nuk kanë arritur për pagesë), dhe ende nuk paraqiten si dalje të mjeteve financiare.

Ato do të paraqiten si të tilla në momentin e pagesës së disa dëmeve ose dëmet e paguara pjesërisht. Nën supozimin për kategoritë tjera të pamatura, me llogaritje mund të vërtetohet se:

- a) Nëse premia teknike e policave zmadhohet, në sasi të njëjtë përmirësohet edhe rezultati financiar dhe likuidimi (dhe anasjelltas);
- b) Nëse zmadhohet dëmi i paguar në shumë të njëjtë të detyrimeve (me dëmet e rezervuara), zvogëlohet likuidimi dhe anasjelltas, ndërsa rezultati financiar nuk ndryshon;
- c) Nëse zmadhohet dëmi i rezervuar në sasi të njëjtë të detyrimeve (me dëme të paguara), përmirësohet likuidimi dhe anasjelltas, ndërsa rezultati financiar nuk ndryshon;
- d) Nëse premia bartëse rritet, rezultati financiar përkeqësohet dhe anasjelltas, ndërsa likuidimi mbetet i pandryshuar.

Përfundimet më lart të shënuara janë dhënë në bazë të raportit në mes rezultatit financiar dhe likuidimit prej punës teknike.

Nëse duam që ta shohim komplet raportin atëherë gjatë vërtetimit të rezultatit financiar duhet të përfshihen të gjitha elementet e shpenzimeve dhe të ardhurave të mjeteve të sigurimit, ndërsa gjatë shikimit të likuidimit duhet të përfshihen të gjitha elementet e ardhjes së të hollave dhe derdhjes së mjeteve financiare (parave).

### **Masat e politikës së likuidimit**

Në kuadër të politikës së saj afariste siguruesi në tërësi, përkatësisht filiali (dega), sjell vendime të cilat ndikojnë në likuidimin, por në të njëjtën kohë e kanë si qëllim edhe arritjen e rezultateve më të mira afariste.

Në masa të posaçme për përmirësimin e likuidimit bëjnë pjesë ato që merren për shkak të zhvendosjes kohore të ardhjeve të të hollave dhe derdhjeve të mjeteve financiare (parave)

Masat për përmirësimin e likuidimit mund të jenë në dy drejtime:

Masa për zmadhimin e ardhjes së mjeteve dhe për zvogëlimin e derdhjes së mjeteve financiare (parave).

Në masat themelore për zmadhimin e të ardhurave të mjeteve financiare mund t'i numërojmë: zmadhimi i sasisë së punës; shpejtimi i pagesës së premisë për sigurim; zmadhimi i plasmanit për mjetet rrjedhëse.

Efekte më të mëdha në pikëpamje të përmirësimit të likuidimit mund të arrihen gjatë zmadhimit të sasisë së punës dhe përshpejtitimit të pagesës së premisë gjatë vitit.

### **Renatibiliteti në sigurim**

Rentabiliteti si një nga principet kryesore në punën e shoqërive tregtare, si nocion në literaturën profesionale (por edhe në praktikë) në sigurimin, te ne nuk përdoret ose përdoret rrallë. Ndonjëherë në materialet e shkruara për punën e siguruesit mund të gjendet, që siguruesi ka punuar në kohë të caktuar rentable ose jorentable.

Në ato raste nën nocionin punë rentable nënkuptohet realizim pozitiv i rezultatit financiar ose fitim, ndërsa nocioni punë jorentable nënkupton realizim negativ të rezultatit financiar, përkatësisht humbje. Edhe rezultatit financiar pozitiv edhe atë negativ, shprehur në tregues relevantë, e quajmë shkallë e rezultatit financiar të realizuar.

Rentabilitetin në punën e siguruesit mund ta definojmë si raport ndërmjet rezultatit financiar të realizuar (fitim ose humbje) dhe të ardhurave të përgjithshme të mjeteve të sigurimit.

Në varësi nga rezultati afarist i siguruesit për periudhën e kontrolluar, shkalla e rentabilitetit mund të llogaritet në këtë mënyrë:

$$\text{Shkalla e rentabilitetit} = \frac{\text{Fitim} \times 100}{\text{Të ardhura të realizuara}}$$

Ose

$$\text{Shklla e rentabilitetit} = \frac{\text{Humbje} \times 100}{\text{Të ardhura të realizuara}}$$

Shkalla e rezultatit financiar mund të llogaritet për siguruesin në tërësi ose për pjesët e tij të ndara. Shkalla e rezultatit financiar mund të caktohet saktë vetëm për ato pjesë të punës, për të cilat bëhet bilanc, përkatësisht vërtetohen të ardhurat dhe shpenzimet për periudhën e kontrolluar.

Shkalla e rezultatit financiar mund të vërtetohet edhe nëpër grupe të sigurimit, nëpër lloje të sigurimit ose nëpër kategori të tjera të punës.

Në ato raste paraqitet probleme rreth përcaktimit të madhësive reale dhe në numëruesin dhe emëruesin pasi nuk vërtetohen në kuadër të llogaritjes përfundimtare, të ardhurat dhe shpenzimet, si dhe rezultati financiar të ato lloje të punës.

Nëse duam të llogarisim shkallë të rezultatit financiar për ato lloj punësh, që në praktikë do të jetë e nevojshme për qarje të politikës afariste, e posaçërisht politikë tarifore, atëherë është e domosdoshme që paraprakisht të caktohet metodologjia për verifikimin e të ardhurave të përgjithshme dhe rezultatit financiar.

Në bazë të këtij lloj përcaktimi të metodologjisë për lloje të caktuara të sigurimit ose punë konkrete, llogariten të ardhurat dhe shpenzimet totale e më vonë edhe financiare.

Problem i veçantë për llogaritjen e të ardhurave të përgjithshme dhe shpenzimeve të përgjithshme paraqet caktimi i madhësive në bazë të bashkësigurimit dhe risigurimit dhe përcaktimi i të ardhurave nga mjetet e investuara në të ardhurat e përgjithshme, të cilat realizohen në lloje të caktuara të sigurimit ose punë konkrete.

Te bashkësigurimi dhe risigurimi, shumat që hynë në të ardhurat totale (pjesëmarrje në dëme dhe të ardhura të tjera) dhe shumat që hynë në shpenzime (premia e risigurimit) mund të llogariten saktë.

Shpërndarja e të ardhura të përgjithshme nga investimet mund të bëhet nëpërmjet llogarisë direkte, në bazë të një kriteri të caktuar ose në kombinim (me llogaritje ose në bazë të një kriteri të caktuar).

Për shkak të realitetit të rezultatit, duhet t'i jepet përparësi llogaritjes direkte. Nëse përdoret si kriter për shpërndarjen (në tërësi ose në veçanti) e të ardhurave nga investimet, kriteri i zgjedhur duhet të japë rezultat sa më real.

Ai do të jetë real nëse kriteri për shpërndarje caktohet në bazë të gjendjes së mjeteve financiare në grupe dhe llojeve të sigurimit.

Kriteri më i saktë fitohet nëse gjendja e mjeteve rrjedhëse llogaritet ditore. Sa më e gjatë të jetë periudha e përcaktimit të gjendjes së mjeteve (parave) aq më të mundshme janë tejkalimet e mëdha të gjendjes së fituar nga gjendja reale.

Gjithashtu, mund të paraqiten tejkalime të rëndësishme edhe të gjendjet periodike (javore, mujore, tremujore), për shkak të derdhjes dhe daljes jo të barabartë të parave dhe çka është karakteristike për sigurimin, posaçërisht në territorin e pagesës së dëmeve.

Nga kjo del se siguruuesi duhet ta organizojë punën ashtu që realisht të mund të radhiten të ardhurat nga paratë e investuara për aktivitete, të cilat i ndjekim dhe për të cilat duam të caktojmë renatibilitet.



Kjo është veçanërisht e rëndësishme, për shkak të disponimit me informacione në kohën e duhur, për atë se çfarë rezultati realizon një aktivitet i caktuar dhe te cili aktivitet (në realitet llojet e sigurimit) duhet të merren masa përkatëse, me qëllim të ardhurat dhe shpenzimet të pajtohen në kohë.

Gjithashtu, në mënyrë të ngjashme mund të vërtetohet rentabiliteti në filiale si tërësi, në grupe dhe lloje të sigurimit ose në aktivitetet e veçanta në brendësi.

Nota për punën totale ose për një pjesë të punës në bazë të lëvizjes së rezultatit financiar, përkatësisht shkallës së rentabilitetit nuk mund të jepet, për shkak të specifikave të caktuara në sigurim, pa u bërë analiza detaje.

Me atë analizë është e nevojshme që të vërtetohet nëse periudha e kontrolluar, duke parë llojet e punëve është mjaft e gjatë, që të mund të nxirren përfundime të sigurta për trendet në punë dhe lëvizjen e rezultatit financiar, pastaj edhe nëse në periudhën e kontrolluar ose në ndonjë pjesë të saj ka pasur dhe dëme masovike, të cilat kanë ndikuar rezultatin financiar.

Nëse vërtetohet se në periudhë të caktuar ka pasur dëme të veçanta të mëdha dhe masovike, të cilat me bashkësigurimin ose risigurimin nuk ka mundur në pjesë të madhe t'i rindajë në sigurues dhe risigurues të tjerë (gjë që varet nga dispozitat e marrëveshjeve konkrete), atëherë rezultatet financiare të realizuara dhe shkalla e fituar e rezultatit (deri edhe shkalla e rezultatit negativ financiar) duhet të merret me rezervë të caktuar dhe të kihet kujdes gjatë notimit të rezultateve të arritura.

Nëse në atë rast te disa lloje pune ose lloje dhe grupe të sigurimit, edhe për tërësinë, shkalla e realizuar e rezultatit negativ financiar nuk duhet të përfundojë se puna në atë periudhë nuk ka qenë e suksesshme.

Ky përfundim, në rast të realizimit të dëmeve të mëdha ose masovike, nuk mund të sillet për shkak se dëmet e mëdha dhe masovike unifikohen në periudhë më të gjatë, pritet, sipas ligjit për propabilitet, ato të mos paraqiten çdo vit, por në periudha të caktuara të shkurtra ose periudha të gjata.

Prandaj, te siguruesit rëndësi të veçantë ka ekonomizimi me pronën e përgjithshme (në atë pronë nga aspekti i siguruesit shumë më të madhe bëjnë të ardhurat nga paratë e investuara), pasi nëpërmjet të atij ekonomizimi, veçanërisht te disa grupe sigurimi, mund të ndikohet në rentabilitetin e punës.

Në kushte të ndikimit të plotë të ekonomisë së tregut, absolutisht duhet të çohet politika, e cila i jep përparësi rentabilitetit të likuidimit. Kjo nuk do të thotë që do të jetë i rrezikuar likuidimi, por që niveli i likuidimit të mjeteve do të jetë reduktuar në shumën më të vogël të nevojshme.

Siguruesi mund ta llogarisë rentabilitetin në përgjithësi ose në pjesë të veçanta. Rentabiliteti duhet të llogaritet deri në nivelin në të cilën do të mund të merren masa në kuadër të politikës së punës, me të cilat do të pajtohet ajo pjesë e punës.

### **Përfundim**

Duke u nisur prej aty që sigurimi merret me realizimin e katër shërbimeve kryesore: kompensimi i humbjeve të vlerave, trajtimi shkencor i durimit të rrezikut, shpërndarja e drejtë e dëmit në mes të siguruarve dhe largimi i humbjeve gjatë rrugës së mbrojtjes sistematike preventive të vlerave, efikasiteti i tij është i determinuar nga kapaciteti i shoqërisë për sigurim.

Ky kapacitet definohet si shuma e përgjithshme maksimale e detyrimeve që mund t'i marrë një sigurues, pa marrë parasysh nëse në atë moment do të jetë jolikuidues. Në atë bën pjesë pyetja për respektimin e parimeve të punës në sigurim.

Në praktikën e punës në sigurim më të rëndësishme janë: parimi i sigurimit, parimi i likuidimit dhe parimi i rentabilitetit.

### **Literatura**

1. Dr. R. Crnković, dr. R. Tepšić, dr. M. Hanxheković: Politika na likuidnost na pretprijatijata, botuar. Informator, Zagreb, 1973;
2. Dr. Sh. Babić: Voved vo ekonomika na pretprijatija, bot. Shkolska knjiga, Zagreb, 1962;
3. Dr. T. Jovanovski, Ekonomika na osiguruvanje, Shkup, 2005;
4. Dr. B. Marović, Dr.S. Jovanović, Reosiguruvanje, Novi Sad, 2004;
5. Dr. B. Miloshević, Voved vo osiguruvanjeto, Oher, 2006;
6. Dr. B. Miloshević, Reosiguruvanje, Oher, 2009;
7. D-r. Jelena Kocović, D-r Predrag Shulejić, Osiguruvanje, Beograd, 2002.

**MSc. Sherif Gashi**

## **KARAKTERISTIKAT E TREGUT TË SIGURIMEVE NË BALLKAN**

Hyrje

Të gjitha vendet ballkanike, përveç Greqisë, kanë pasur sistem të organizimit shoqëror socialist. Me shpartallimin e socializmit, në këtë rajon është shpartalluar edhe sistemi financiar shoqëror.

Sllovenia, edhe pse nën ombrellën e ish- Jugosllavisë, ka qenë shumë e zhvilluar dhe ai zhvillim ka qenë më tepër i orientuar nga Evropa. E njëjta gjë ndodh edhe me Kroacinë, por kjo republikë u ndesh me agresorin serb, që e shkatërroi në një masë të madhe ekonominë e vendit.

Shqipëria kishte një sistem totalitar socialist dhe vetëm në vitet e nëntëdhjeta erdhi në pozitë të shikojë nga e ardhmja, që ishte shumë e prapambetur në të gjitha segmentet. Serbia ishte zhvilluar, por edhe kjo i ndjeu pasojat e luftës, sidomos me bombardimet e NATO-s dhe embargon ekonomike.

Kosova, që nga vitet e nëntëdhjeta, kishte dalë nga rrjedhat e një sistemi të mirëfillte qeverisës dhe ekonomik. Pra, të gjitha shtetet e Ballkanit i kishin specifikat e veta në organizimin dhe funksionimin e shtetit.

Prandaj, sistemi financiar në këto vende diku ka qenë më i zhvilluar e diku më pak. Organizimi momental i sigurimeve në Ballkan karakterizohet në veri me një zhvillim të një tregu sigurimesh të përsosur, kurse në jug me një trend të zhvillimit.

- Sllovenia, Kroacia dhe deri diku Serbia kanë një treg të sigurimeve më të zhvilluar. Tregu i sigurimeve në Kosovë, Shqipëri, Mal të Zi dhe në Maqedoni tani ka trend zhvillimi, ngase tregu i sigurimeve është i ri dhe ka kapacitete të mëdha, por kërkon analizë dhe studim të hollësishëm.
- Në Shqipëri që nga vitet 1992, në Kosovë pas luftës së vitit 1999, në Maqedoni pas shkëputjes nga ish- Jugosllavia, u organizua një treg i lirë i sigurimeve.

Sllovenia dhe Kroacia arriten që jo vetëm të organizojnë dhe të menaxhojnë një treg të mirëfilltë sigurimesh në territorin e tyre, por që aktivitetin e tyre ta zgjerojnë edhe në shtete tjera të Ballkanit, sidomos Serbi, Bosnjë, Mal të Zi, Kosovë dhe Maqedoni.

- Po ashtu edhe kompanitë e sigurimeve nga Shqipëria kanë arritur që aktivitetin e tyre ta zhvillojnë jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Kosovë e Maqedoni. P.sh Sllovenia, në vitin 2007, në Maqedoni ka pasur 42 për qind të tërë tregut maqedonas.

Kompanitë e mëdha të sigurimeve nga Austria, Gjermania, Italia, Zvicra kanë depërtuar në shumë vende në tranzicion. Kompanitë e sigurimeve Aspis Group, Uniqa Austria, Vienna Insurance Group, Basler Group, Merkur etj., hyjnë si partnere strategjike në tregun e sigurimeve të vendeve në zhvillim.

Prezenca dhe interesimi në rritje i investitorëve të huaj dëshmon për mundësitë e mëdha të zhvillimit, që ky treg rezervon në të ardhmen dhe përforcon faktin se krijohet një ambient i përshtatshëm investimesh në tregun e vendeve në tranzicion.

Karakteristikat kryesore të tregut të sigurimeve në vendet e Ballkanit:

### **Dominimi i kapitalit të huaj**

Në Kosovë në vitin 2007, kapitali i huaj ka qenë 69.55 për qind, në Serbi 62.87 për qind, në Maqedoni 68.35 për qind, në Shqipëri Uniqa Group Austria pjesëmarrje influencuese në aksionet e Grupit Sigal, Vienna Insurance Group i zotëron 60 për qind të aksioneve të shoqërisë Sigma, Aspis Group pjesëmarrje influencuese në shoqërinë e sigurimeve Inter Albania.

- Pozicioni monopolist i shtetit është gjithëherë në ulje, duke i lënë vend inicatives private. P.sh në Shqipëri vetëm kompania Insig është pronë shoqërore, e cila është në procedurën e privatizimit të plotë. Në Kosovë të gjitha kompanitë janë me kapital privat, në Serbi 30.80 për qind janë ende pronë shoqërore.
- Tregu i orientuar në sigurimet e detyrueshme me përmirësime të lehta në strukturë është siç vijon: Në Slloveni kemi 68.20 për qind sigurime jojetë, ndërsa 31.80 për qind sigurime jetë në krahasim me bruto premitë, pastaj në Kroaci 71.40 për qind sigurime jo jetë, 28.57 për qind sigurime jetë e kështu me radhë.

Ndërsa, Kosova dhe Shqipëria kanë një raport shumë më të theksuar si p.sh Shqipëria 93.01 për qind sigurime jojetë, ndërsa 6.99 për qind sigurim jetë. Kosova ka 99.78 për qind sigurime jojetë, 0.22 për qind sigurim jetë.

Këto shënime rrjedhin nga raportet financiare për vitin 2006. Po ashtu, raporti i premive bruto të sigurimeve në krahasim me BPSH, është varësisht nga zhvillimi i tregut të sigurimeve në këto vende, p.sh. koeficienti më i lartë është në Slloveni 5.89 për qind, ndërsa më i ulëti në Shqipëri 0.50 për qind. Kjo d.m.th se në tregun e sigurimeve në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni dominon sigurimi i detyrueshëm.

- Portofol joheterogjen - përjashtuar Slloveninë, Kroacinë dhe Serbinë. Në Kroaci në fillim të vitit 2008 ka pasur mbi 48 lloje produkte sigurimesh, në Serbi mbi 37, kurse në Kosovë vetëm 14 produkte.

Në Kosovë dominon sigurimi i detyrueshëm me 90.89 për qind, kurse sigurimet vullnetare vetëm me 9.11 për qind. Tregu i sigurimeve në vendet e Ballkanit ka potencial të madh për të zhvilluar klasë të reja dhe produkte të reja, si ato jetë dhe jojetë. Tregu i sigurimeve ka aftësi të mëdha punësimi.

Në Kroaci kompanitë e sigurimeve kanë të punësuar mbi 8.630 punëtorë, kurse në Serbi 9.697 punëtorë, në Kosovë përafërsisht 1.670 punëtorë.

- Kompanitë e sigurimeve gjithnjë kanë një teprice të mjeteve, e cila rezulton si rrjedhojë e kohës kur paguhen primet e sigurimeve dhe kur kompensohen dëmet. Këto mjete janë kryesisht të angazhuara në formë depoziti në bankat komerciale, nga të cilat kanë një përfitim kompanitë. Në Kosovë, por edhe në vendet tjera të rajonit, shumë pak janë investuar në pasuri të paluajtshme.
- Vendet në tranzicion kanë një penetrim të ulët krahasuar me vendet në zhvillim, p.sh në Angli, Francë, Gjermani, raporti primi-dëme arrin deri në 80 për qind, ndërsa në vendet në tranzicion shkallën më të lartë 43.54 për qind në Kroaci, 39.40 për qind në Serbi, si dhe 25.20 për qind në Kosovë e kështu me radhë.
- Hyrja e kompanive të mëdha të sigurimeve në tregun e sigurimeve të vendeve të Ballkanit mundëson bartjen e një kulture dhe një kuadri të specializuar për këtë lloj aktiviteti.

Menaxhimi i kompanive të sigurimeve është menaxhim i bazuar në rrezik. Menaxhimi i mirë bazohet në 5 funksione dhe ato përbëjnë esencën në procesin e mbikëqyrjes siç janë: planifikimi, organizimi, personeli, udhëheqja dhe kontrolli. Faktorët që ndikojnë në menaxhimin e kompanive të sigurimeve janë të jashtëm dhe të brendshëm. Faktorët e jashtëm janë zhvillime në tregun botëror të sigurimeve.

- Dëshëm apo nuk deshëm duhet që edhe tregu i sigurimeve të këtyre vendeve të marrë bazat e menaxhimi proevropian. Rrumbullakësimi i Solvencës II, që bazohet në qasjen e bazuar në rrezik dhe planifikohet të zbatohet në vitin 2010, që këto vende i ka shtyrë të zhvillojnë apo të adaptojnë një qasje të tillë së bashku me FMN si asistencë teknike.
- Funksioni i transferit të riskut i sektorit të sigurimit kontribuon, nga njëra anë, për krijimin e një ambienti operacional më të qëndrueshëm për kompanitë dhe, nga ana tjetër, për një reduktim në nivelin e kapitalit nga ndërmarrjet për të mbrojtur vetveten ndaj riskut.

Duhet theksuar se në një botë të kushtëzuar nga ndryshimet sociale dhe veçanërisht nga një popullsi e vjetëruar, sigurimi bën të mundshëm, në mënyrë efikase, që të mbështetet shtetin në furnizimin e pensioneve, kujdesit të shëndetit social.

- Siguruesit kanë vërtetuar zotësinë për të menaxhuar fushat e tjera të sigurisë përveç atyre të detyrueshme, siç kemi sigurimet sociale, kompensimi dhe rehabilitimi pas

aksidenteve në punë, për të cilat siguresit e disa vendeve si p.sh Belgjikës, Portugalisë, Finlandës, Danimarkës, sigurojnë mbrojtje sociale të cilësisë së lartë.

- Në Kosovë nëse nuk kemi një përmirësim të strukturës së sigurimeve. Nuk do të kemi një rritje të mirëfilltë apo zgjerimin e aktiviteteve, sepse, sipas një statistike në Kosovë, brenda një viti regjistrohen përafërsisht 380.000 vetura. Ky është kapaciteti i tregut të Kosovës në sigurime të detyrueshme, por me zgjerimin dhe përmirësimin e strukturës së sigurimeve, Kosova ofron një treg të fuqishëm.

## Literatura

1. Tregjet financiare, Instrumentet dhe veprimet e tyre, Prof Dr.Aristotel Pano dhe Elizabeta Gjoni, Tiranë 2007.
2. Drejtimi i Portofolit Prof Dr. Sherif Bundo, Tiranë 2007
3. Ilir Hoti Industria e sigurimeve dhe menagjimi i riskut, Instituti i ingjinerisë financiare për bankë dhe biznes, Tiranë 2008.
4. Koci N.Bundo. Sh. Shallari, Pasiguria dhe Sigurimet, Tiranë 2002.
5. Raport amf Albania 15 maj 2008 Cras Montana Forum
6. Hanfa Zagreb izvjestaj, 2006
7. D.Zagorac, Osiguranje Privrede, nr.3/1984.
8. Ksenia Klasiq , Ivo Andrianiq Osnovne Osiguranja – Naqela i Praksa, Zagreb 2007,
9. Narodna Banka Srbije , vice guvernator banke Mira Eriq Joviq, Zllatibor, 30.05.2008

Prof. Dr. Ivica Smilkovski  
Prof. Dr. Jove Kekenovski

## ASPEKTET E SIGURIMIT TË TERRORIZMIT

### Abstrakt

Rreziku nga terrorizmi është përpunuar në pjesën e cila i kushtohet mbulimit ose përjashtimit të këtij rreziku nga mbulesa e sigurimit. Të mundshme janë edhe dilemat e siguruesve në lidhje me harmonizimin e këtij rreziku.

Fjalët kyçe: terrorizmi, sigurimi.

### Hyrje

Rritja e terrorizmit në botë është pritur më tepër se 20 vjet. Të gjitha indikacionet çojnë kah ajo, terrorizmi të rritet në linjën e takimeve me entitete, religjione, kultura të bashkësive të pasura dhe të varfra nga më të ndryshmet.

Mirëpo, nuk pritej se do të depërtoj thellë te mjediset relativisht kompakte. Falë përparimit teknologjik në botë, përveç mjediseve ekstremisht të mbyllura, siç është Koreja e Veriut, vende ku mund të ndjehesh i sigurt nuk ka.

Lëvizja separatiste në Çeçeni solli sulme terroriste në Moskë. Tani nuk parashtrohet pyetja se a do të zgjerohen sulmet terroriste, por në cilën kahe do të zgjerohen (Kisirev).

Problemet politike shumëvjeçare të pazgjidhura në Palestinë, Indonezi, Kashmir, Afganistan, kontribuuan për rritjen e fanatizmit fetar, i cili nxiti sulme terroriste larg vendit të konfliktit, vendet evropiane dhe SHBA.

Të gjitha religjionet në ndonjë stadium të zhvillimit të tyre janë agresive. (Karen Amstrong)

Rreziku nga terrorizmi dhe sigurimi ekzistonin edhe para sulmit ndaj Qendrës Tregtare Ndërkombëtare (QTN) në Nju Jork, në vitin 2001. Terrorizmi ndërkombëtar nuk paraqet asgjë të re për siguruesit.

Siguruesit paguan kompensime të mëdha për jetët e humbura dhe pronat e asgjësuar kur aeroplani irlandez për udhëtarë u rrëzua me bombë, e cila ndodhej në bagazhin e tij, edhe në sulmin me bomba ndaj Qendrës Tregtare në Londër, në vitin 1993.

Pas sulmit terrorist ndaj QTN, në sferën e sigurimit ndodhen ndryshime. Në vend të parë u paraqit tendenca që rreziku nga terrorizmi të përjashtohet nga premia ose të kufizohet.

U parashtrua çështja kush është i gatshëm të mbartë rrezik të panjohur ose të padukshëm. Që t'i pengojnë shtëpitë e sigurimeve nga mbulesat e tyre për sigurime pronësore,

Kongresi i SHBA-ve në vitin 2002, solli ligj me të cilin shteti pranon risigurim për këtë rrezik.

Ashtu siç përfundon zbatimi i këtij ligji, në fund të vitit 2005, në sigurimin amerikan mund të ndodhë problem i madh. Sigurimi nga terrorizmi në Evropë zbatohet përmes pulteve risiguroese: Austrian pool, YK pool, French pool, German pool, kështu që ky rrezik shpeshherë përjashtohet nga mbulesa.

Janë themeluar sigurues dhe risiguroese special për rrezikun nga terrorizmi, i cili me këtë sigurim ka filluar të merret pas sulmit të QTN, kurse pushoi së punuari në vitin 2003, me arsyetimin se asnjë nuk është i interesuar të paguajë çmim të lartë për sigurim nga ky rrezik.

Në botë ekziston interesi që ekonomia të sigurohet nga rasti terrorizëm. Më së shpeshti kërkohet sigurim për mbrojtje nga dhuna politike, e cila ngërthen edhe rrezikun nga terrorizmi. Federata e Shoqatave Evropiane për menaxhment të rrezikut tenton të vendosë instrument financiar evropian për ekonomizimin e rrezikut nga terrorizmi.

### **Kufijtë e mbulesës së sigurimit**

Me rrezik nënkuptojmë ndodhi të jashtëzakonshme, të cilat mund të shkaktojnë pasoja të dëmshme ekonomike për disa individë. Karakteristikë e tyre e përbashkët është ajo se janë në pyetje ndodhi të jashtëzakonshme, të cilat nuk mund të parashikohen.

Siguruesit kanë arritur përvojë të mjaftueshme, duke u ofruar mbrojtje të siguruarve në rast të katastrofave natyrore dhe veprimeve keqbërëse të njeriut. Mirëpo, në rast të mbulimit nga rreziku prej terrorizmit, situata është e ndërlikuar. Më lehtë është të parashikohet ardhja e uraganit sesa sulmi terrorist.

Nuk është e mundur të parashikohet intensiteti dhe pasojat nga sulmi terrorist, kurse mundësia për ndikim preventiv është e kufizuar. E gjithë kjo, mes tjerash, nuk nënkupton se rreziku nga terrorizmi nuk mund të jetë lëndë e marrëveshjes për sigurim.

### **Definicioni për rrezikun**

Më së shpeshti bëhet fjalë për sulme të parëndësishme të individëve ose grupeve të organizuara ndaj persona viktime, të cilët vetvetiu nuk kanë asnjë rëndësi, por megjithatë merren si objekte të sulmeve, me qëllim që të shkaktohet frikë, pasiguri e përgjithshme dhe të tërhiqet vëmendja e opinionit kah qëllimet e terroristëve.

Kryesit e sulmeve terroriste shpeshherë veten e shikojnë si të përvuajtur, të gatshëm për realizimin e disa qëllimeve të larta, duke i dhënë jetët e tyre gjatë së cilës pësojnë edhe njerëz të pafajshëm si dhe shkaktohet dëm i madh material.



Kërcënimi për përdorimin e forces, me qëllim të shkakimit të frikës, për shkak të arritjes së qëllimeve të parashtruara, gjithashtu llogaritet si terrorizëm. Karakteristike është se sulmi terrorist zgjatë shumë shkurtër.

Ky nuk është rast edhe me terrorizmin shtetëror siç është për shembull: bombardimi selektiv dhe i kufizuar i caqeve në shtetet tjera pa filluar sulme luftarake me përmasa më të mëdha.

Qe një sulm ta llogarisim si të armatosur, ai duhet të ketë disa karakteristika të caktuara në lidhje me vendin ku kryhet sulmi, kohëzgjatjen e tij dhe përmasat e dëmit të shkaktuar. Këta masa megjithatë nuk janë complete, por tani për tani janë të vetmet.

Dallimi mes terrorit dhe sulmit të armatosur nuk është e parëndësishme. Në rast të rrëzimit të aeroplanit për udhëtarë, në të cilin është vendosur bombë, si në rastin me Irlandën, një sigures ka refuzuar të kompensojë dëmin e shkaktuar, duke e llogaritur se është shfaqur rrezik luftarak, e jo rrezik nga terrorizmi.

Ky qëndrim i siguresit nuk mund të pranohet. Aksioni armiqësor doemos duhet të kryhet në kuadër të luftës, luftës qytetare, kryengritjes, etj.

Në praktikën e sigurimeve paraqiten rreziqe të ngjashme me terrorizmin, siç është p.sh. vandalizmi, i cili është pasojë e çështjeve malicioze. Nuk është e thjeshtë që të verifikohet se a ka qenë ndonjë person malicioz.

Nuk mund të bëhet fjalë për procedurë malicioze nëse te kryesi nuk ekziston dëshira e formuar, që dikujt t'i shkaktojë të keqe. Sipas një botëkuptimi, për dëm qëllimkeq mund të flitet atëherë kur ekzistojnë tre elemente: a) veprim kundërligjor, b) qëllimi që gjësendi i siguruar të asgjësohet ose dëmtohet, c) humbje ose dëmtim i gjësendit të siguruar d.m.th. pronësi.

Mes dëmit të shkaktuar nga malicioziteti dhe dëmit të shkaktuar nga sulmi terrorist paraqitet dëmi, i cili dallohet nga këta, sipas motivit të shfaqjes. Bëhet fjalë për dëm ku kryesi është i udhëhequr nga mëria patologjike.

Vetën në bazë të këtyre rrethanave nuk mund të thuhet se dëmi është shfaqur si pasojë e sulmit terrorist. Parashtrohet pyetja se si siguri ta mbulojë “rrezikun nga mëria”.

Do të hasim edhe nocionin “terroristë të butë”, persona të cilët me aktivizimin e pajisjeve eksplozive kanë për qëllim të shkaktojnë dëme materiale, vetëm sa t’ia tërheqin vëmendjen opinionit.

Si për shembull, vendosja e pajisjes eksplozive në bregun pranë anijes, me aktivizimin e së cilës shkaktohet vetëm dëmtimi i anijes, gjë që s’ka qenë qëllim i personit që e ka vënë eksplozivin. Ekziston rreziku të paraqiten vështirësi gjatë verifikimit të motivit të kryesit të dëmit në rast të dhunës politike, e cila mund të marrë forma të ndryshme.

Janë hasur vështirësi edhe me komentimin e policave të sigurimit, të cilat e mbulonin rrezikun nga terrorizmi. Shprehjet në policë, siç janë “afërsia” dhe “pengesa”, në raport me vendin e sulmit terrorist janë të komentuar në mënyra të ndryshme.

### **Kufizimi i hapësirës**

Mbulesa siguroese mund të jetë e kufizuar në rajon të caktuar gjeografik, në objektin, i cili mbrohet (p.sh. aeroplani) dhe në vendin e sulmit (për shembull të gjitha dëmet e shkaktuara deri në 600 metra nga vendi i sulmit).

Vështirësi mund të paraqiten gjatë komentimit të mbulesave në rast të dëmeve indirekte. Në një rast, pronari i hapësirës afariste në Aeroportin e Floridës ka kërkuar kompensim prej sigurimit për shkak të humbjes së fitimit kur puna, për shkak të vendimit të pushteteve, ka qenë e mbyllur për shkak të sulmit terrorist ndaj QTN në Nju Jork.

Komentimi i shkakut, për shkak të shkakut tjetër, shpeshherë është detyrë e vështirë, për shkak të së cilës siguroesit i shmangen klauzolës së posaçme të marrëveshjet për sigurim, të cilat përjashtojnë dëmet indirekte.

Me këtë, siguroesit tentojnë të mbulojnë vetëm dëmin e shkaktuar si pasojë e drejtpërdrejtë nga rreziku, i cili ka qenë lëndë e drejtpërdrejtë e marrëveshjes për sigurim.

### **Kufizimi kohor**

Është e zakonshme që çdo sigurim të ketë kufizim kohor. Te sigurimi në kohë të caktuar, më së shpeshti për 12 muaj, ekziston mundësia edhe për sigurim tjetër kohor. Për shembull, sigurimi i anijes i kushtohet numrit të caktuar të ditëve.

Sigurimi i mallit nga rreziqet e luftës ndërpritet nga momenti i shkarkimit të tij nga anija. Nëse rreziku nga terrorizmi mbulohet në mënyrë të posaçme me rrezikun nga lufta, që është e mundur në SHBA, sigurimi nga rreziku i terrorizmit nuk përjashtohet – për dallim nga rreziku i luftës. Sigurimin nga rreziqet e luftës, me të drejtë, siguroesit mund ta anulojnë me anë të paralajmërimit, me afat anulimi prej shtatë ditësh.

### **Sigurimi i kompensimit të dëmit**

Në pyetje është njëri nga elementet në bazë të së cilit siguroesi e cakton çmimin (preminë) e sigurimit. Para se të siguroarit të marrin rrezik të caktuar në sigurim, ata e përcaktojnë dëmin maksimal të mundshëm, i cili mund t'i godasë.

Gjatë dhënies së premisë, me të drejtë, siguroesit janë shumë të vëmendshëm. Siguroesit e anijeve detare kanë mbuluar rrezik nga terrorizmi të një dëmi deri në 400.000.000 dollarë amerikanë. Por, këtë limit e zvogëluan në 50 milionë dollarë amerikanë për anijet, të cilat hynë në pjesën greke gjatë kohës së lojërave olimpike.

Kur organizatorët e Kampionatit Botëror në Futboll dhe Gjermania, në vitin 2006, hasen në jogatishmëri nga ana e siguruesve, që të mbulojnë rrezikun nga anulimi i kampionatit, për shkak të sulmeve terroriste, fituan mbulesë të tregut të kapitalit. Ky rrezik është mbuluar me dhënie të triskave në vlerë prej 260 milionë dollarësh amerikanë.

Në praktikë, siguruesit e kufizojnë obligimin e tyre për kompensim të dëmit me klauzola, të cilat parashikojnë, në rast të shfaqjes së dëmit të paraparë, obligimi i tyre për kompensim të mos e kalojë shumën e caktuar monetare.

Komentimi i kësaj klauzole në rastin e sulmit terrorist ndaj QTN solli deri te përfundimet gjyqësore. I siguruari dhe siguruesit e tij, të cilët kanë pasur marrëveshje të ndryshme për sigurimin e QTN, nuk janë pajtuar rreth komentimit të një ngjarje të dëmshme.

Derisa i siguruari pohonte se kanë ndodhur dy ngjarje, duke e pasur parasysh se sulmi ndaj QTN është kryer me dy aeroplanë në vende të ndryshme, në kohë të ndryshme, siguruesit e pohanin të kundërtën. Nëse i siguruari ka pasur të drejtë, do të fitonte premi prej 7 miliardë dollarësh amerikanë, në vend të 3.5 miliardë dollarësh amerikanë.

Avokati i siguruesit parashitroi pyetjen se a paraqet 600 ngjarje sulmi ndaj Perl Harbor nga ana e Japonisë me 600 aeroplanë gjatë Luftës së Dytë Botërore? Rrallë vendime gjyqësore nxjerrin në pah mundësinë për komentim se sulmi ndaj QTN ka qenë vetëm një rast i dëmshëm.

Në rast të sulmeve në më tepër vende nga ana e grupeve të organizuara kriminale në SHBA, gjatë kohës së uraganit, i cili ka qenë i përcjellë me tërmet, gjyqi mori vendim se bëhet fjalë vetëm për një rast të dëmshëm.

### **Praktika në sigurim**

Pasi rreziku nga terrorizmi mbulohet me lloje të ndryshme të sigurimeve, në tregjet për sigurime të shteteve të ndryshme nuk ekziston qasje e vetme e sigurimit në këtë sferë. Në referatin e më tutjeshëm do të bëhet fjalë për qëndrimin e tregut anglez për sigurime, i cili ka përvojë të madhe me mbulesën siguruese për rreziqet e luftës dhe ata politike.

### **SIGURIMI I TRANSPORTIT**

Rreziku nga terrorizmi mbulohet vetëm me kërkesë të të siguruarit, edhe atë gjatë rreziqeve luftarake – politike.

### **Sigurimi i anijeve detare**

Kushtet e përgjithshme të sigurimit në tregun londinez të sigurimit janë të njohura me nocionin “Klauzolat institucionale”. Klauzolat parashohin që siguruesi ta mbulojë humbjen ose dëmin e shkaktuar nga ana e terroristëve ose nga motivet politike.

Sqarim mbi nocionin terrorist nuk është dhënë. Sipas dispozitave të klauzolave, të cilat shfrytëzohen gjatë lidhjes së marrëveshjeve për risigurim detar, në marrëveshje janë përmbledhur të gjitha pasojat e dëmshme të shkaktuara nga terrorizmi.

Në klauzolë sqarohet se shprehja “terrorizëm” e përfshinë secilin veprim të një individi ose organizatë, e cila shkakton pasoja të dëmshme ose kërcënim nga pasojat e dëmshme nga ana e cilësdo natyrë, si dhe të cilësdo nga mjetet ose frikës tek opinioni në rrethana, në të cilat mund të arrihet deri tek supozime të logjikshme se motivi i individëve ose organizatave në tërësi ose pjesërisht, sipas natyrës së vet ka qenë politik, religjioz, ideologjik, etj.

Zgjidhja e tillë është verifikuar më vonë. Parashtrohet pyetja se kidnapimi i tankerit “Dewi Madrim” në vitin 2003, në afërsi të Sumatrës, paraqet edhe kidnapim të ekuipazhit të anijes, kurse s’është kërkuar qira.

Më vonë është kuptuar se ekuipazhi është kidnapuar që të fitohen njohuritë e nevojshme për sulmet e ardhshme ndaj anijeve. Është dhënë mendimi se sulmi ndaj anijes është kryer në mënyrë të ngjashme, ashtu si Al Kaeda e ka përgatitur sulmin. Është përmendur se rreziku nga terrorizmi është mbuluar me rrezikun nga lufta, kurse rreziku nga kusarët me rrezikun detar.

Nga përgjigjja e pyetjes së parashtruar varet se cili sigurues është i obliguar ta kompensojë dëmin, padyshim se me kusht që përmes sigurimit të mbulohen edhe rreziqet detare edhe ata luftarake.

### **Sigurimi i aeroplanëve**

Humbja ose dëmtimi i aeroplanëve si rezultat i terrorizmit paraqet realizim të rrezikut luftarak, edhe atë me kusht që me sulmin të dëshirohet të arrihet qëllimi politik. Sigurimi i aeroplanëve për udhëtarë rregullisht mbulohet me rreziqet nga lufta.

Në policën për sigurimin e aeroplanëve, në përmbledhjen e posaçme me klauzola, janë pezulluar rreziqet që vijojnë: lufta, invazioni, veprimet armiqësore, armiqësia (qoftë e shpallur ose jo lufta), lufta qytetare, kryengritjet, revolucioni, etj.

Gjithashtu, detonimi armiqësor i çfarëdo qoftë arme që shfrytëzon energji atomike ose nukleare, veprimet e njerëzve, të cilët me qëllime politike ose terroriste shkaktojnë dëm rastësisht ose me qëllim, qoftë edhe nëse bëhet fjalë për ndonjë shtet ose jo.

Me përmbledhjen e njëjtë të klauzolave është përjashtuar rreziku nga kidnapimi dhe sipërmarrja e paligjshme e aeroplanit. Me klauzolën e posaçme janë të mbuluara disa nga këta rreziqe të përjashtuara, rreziku i të cilit është nga kidnapimi dhe rreziku i sipërmarrjes së paligjshme të aeroplanit.

Edhe rreziqet tjera të përjashtuara të përmendura dhe të numëruara në përmbledhjen me klauzola, mund të mbulohen me pagesën e premive plotësuese. Nga kjo mbulesë është

përrjashtuar përgjegjësia nga ana e operatorit ndaj udhëtarëve dhe ndaj pronarit të mallit. Siguruesit e ruajnë të drejtën që këtë mbulesë ta pezullojnë me afat pezullimi prej 7 ditë.

Në rastin e humbjes së aeroplanit “Adrija” nga Lubjana, para shumë vitesh që e nevojshme të verifikohet shkaku për eksplozimin në bagazh të aeroplanit, pas të cilës aeroplani është rrëzuar.

Nëse eksplozimi është shkaktuar prej pajisjes eksplozuese me qëllim që të rrëzohet aeroplani, dëmin e kompensojnë siguruesi / risiguruese me tregun e rreziqeve luftarake.

Nëse eksplozimi është shkaktuar nga diçka tjetër, si p.sh. nga lëndë kimike të transportuara si mallra, dëmi kompensohet nga tregu me rreziqe të rregullta. Hulumtimi në këtë rast konkretisht vërtetoi se bëhet fjalë për sulm terrorist.

### **Sigurimi i mallrave gjatë transportit**

Klauzolat institucionale për sigurimin e mallrave nga rreziqet luftarake në transportin detar e mbulojnë humbjen ose dëmin e shkaktuar nga rreziqet e rëndomta luftarake, duke e kështu edhe dëmin e shkaktuar nga ana e terroristëve ose personave, të cilët kanë vepruar për shkaqe politike.

Klauzolat institucionale për sigurimin e mallrave nga dëmet qëllimkëqija parashohin mbulesë për dëmin e shkaktuar nga ana e “terroristëve ose njerëzve, të cilët kanë vepruar për arsye politike”.

Klauzolat institucionale për sigurim të mallrave në komunikacionin ajror nga rreziqet luftarake nuk përmbajnë dispozita për mbulim nga rreziku i terrorizmit.

### **Sigurimi nga përgjegjësia**

Sigurimi i përgjegjësisë të anijet detare, i cili zbatohet përmes siguruesve specialë anglezë të përgjegjësisë (Protecting and Indemnity Clubs), nuk i mbulon rreziqet nga lufta dhe ndodhitë e ngjashme luftarake.

Rregullat ekipore në lidhje me përjashtimin çojnë kah dëmet të shkaktuara nga robërimi, zënia peng, mbajtja, minat, bombat, raketat dhe veprimet tjera luftarake. Pasi rreziqet luftarake janë anashkaluar, rreziku nga terrorizmi mund të mbulohet.

Me sigurimin e aeroplanëve pronari ose shfrytëzuesi i aeroplanit mbrohet në rast të përgjegjësisë së tij për vdekje ose lëndim të udhëtarëve gjatë kohës së sulmit terrorist. Për këtë çështje, në policën kasko për sigurim të aeroplanëve, shtohet pagesë shtesë, me të cilën mbulohet përgjegjësia e transportuesit.

Sa i përket sulmit terrorist ndaj QTN, mbisundon bindja se aerotransportuesit nuk do të mund të shmangin përgjegjësinë e tyre për humbjen e udhëtarëve, pasi nuk i kanë penguar terroristët të mos hipin në aeroplan.

### **Sigurimi i pronës**

Në sigurimin pronësor rreziqet luftarake dhe një numër i madh i rreziqeve politike nuk mbulohen. Sigurimi nga rreziqet luftarake në tokë asnjëherë nuk qe zbatuar, duke e pasur parasysh mundësinë për shfaqjen e dëmeve të mëdha, të cilat siguruesit nuk do të ishin në mundësi që t'i mbulonin.

Nuk ka mundësi të sigurohen nga rreziqet luftarake as malli, i cili transportohet përmes rrugës tokësore, në lidhje me këtë u pajtuan siguruesit anglez. Marrëveshjet për sigurim dhe risigurim pronësor, shpeshherë hasim në zbatimin e klauzolave angleze në të cilat, nga mbulesa përjashtohen rreziqet nga lufta dhe lufta qytetare, armiqësia, revolucioni, kryengritja, rebelimi, forcat luftarake dhe okupuese.

Klauzolat e tipizuara, në zbatimin në Evropë, shpeshherë shtohet edhe përjashtimi i rrezikut nga terrorizmi. Në SHBA rreziku nga terrorizmi mbulohet me sigurimin pronësor.

Në tregun anglez për sigurime, në vitin 2003, paraqitet përmbledhje e re e klauzolave (BPL GLOBAL), e cila, krahas rrezikut nga terrorizmi, kyç edhe rreziqe tjera dhune: trazira, vjedhje, kryengritje dhe grushtshteti.

Të paraparë dhe të përjashtuar nga mbulesa: lufta mes pesë shteteve anëtare të Këshillit për sigurim, luftë në të cilën shfrytëzohet arma nukleare, sulmet biologjike dhe kimike, si dhe ekspropriacioni i kryer nga ana e shtetit domicil. Kjo përmbledhje e klauzolave është e mirëseardhur, duke i pasur parasysh faktet që zvogëlohet mundësia për komentim të ndryshëm të rreziqeve politike.

### **Sigurimi i kredive eksportuese**

Sigurimi i kredive eksportuese ka rol të rëndësishëm në sistemin e mbrojtjes së eksportuesit të mallit dhe shërbimeve. Sipërmarrësi i lëndëve eksportuese në masë të madhe i rrezikon rreziqet politike në shtetin e huamarrësit.

Prandaj, sipërmarrësi punën e tij jashtë vendit e udhëheq me mbrojtjen e siguruesit, i cili i mbulon rreziqet politike. Mbrojtja përmes rrugës së sigurimit i kushtohet çlirimit nga përmbushja e obligimeve me para ndaj huamarrësit të huaj, e cila mund të shfaqet me realizimin e rreziqeve politike.

Investuesit, të cilët e kanë ndërmend të punojnë me vendet në zhvillim, kërkojnë mbrojtje përmes rrugës së sigurimit në tri sfera: eksproprijim, në valutën vendore jokonvertibile dhe në mbulimin e rrezikut politik. Sipërmarrësit, të cilët punojnë në këto vende, sigurohet në rast të rreziqeve politike, të cilat janë të parapara në marrëveshjen për sigurim, p. sh. trazirat qytetare, në të cilat asgjësohet prona e tyre.

Në lidhje me këtë, sipërmarrësit tregojnë interesim gjithnjë e më të madh që të sigurohen me sigurim, i cili përfshin edhe rrezikun nga terrorizmi. Mirë është të kihet parasysh nevoja për përdorim të qartë të kufijve të sigurimit.

Si shembull do t'i theksojmë vështirësitë në lidhje me verifikimin e asaj se a është bojkotim i mallit nga ana e konsumatorëve rrezik politik, p. sh. rasti me bojkotimin e mallit danez në disa vende arabe.

### **Risigurimi**

Marrëveshjet për risigurim nga mbulesa shpeshherë i përjashtojnë humbjet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta, dëmet ose shpenzimet e shfaqura nga rreziku prej terrorizmit. Me klauzolë të posaçme sqarohet se terrorizmi paraqet procedurë (akt), e cila nënkupton përdorimin e forcës, dhunës ose kërcënimit nga ana e ndonjë individi ose grup individësh.

Kjo vlen edhe kur individë të caktuar veprojnë individualisht ose punojnë në dobi të ndonjë organizate ose qeverie të caktua, pa marrë parasysh se a veprojnë për arsye politike, religjioze ose arsye tjera të ngjashme. Klauzola parasheh që rëndësia e dëshmimit të jetë e risiguresit në rast kur risiguresit të dëshmojnë se një dëm nuk është i mbuluar me marrëveshjen.

### **Përfundim**

Pasi rreziku nga terrorizmi mund të mbulohet në tregje të ndryshme të sigurimeve në botë, nuk duhet të pritet se ai për kohë të shkurtër do të balancohet me rreziqet tjera në kushtet e përgjithshme të sigurimit. Situata e tillë e zvogëlon kapacitetin e tregjeve për risigurime në bartjen e këtij rreziku.

Kapacitetet e risigurimit padyshim janë të mëdha dhe shfrytëzimi i rrezikut nga terrorizmi do të mund të mbulohej në tregjet komerciale të sigurimit dhe risigurimit, pa pasur nevojë që shteti vazhdimisht të paraqitet si risigures.

Kushtet e përgjithshme ekzistuese të sigurimit janë heterogjene, kurse shpeshherë lejohet edhe komentimi i tyre i ndryshëm mbi atë që siguresit e pranuan në mbulesë, e të cilën e kanë përjashtuar nga mbulesa.

Në kushtet e përgjithshme të sigurimit duhet të kufizohen rreziqet luftarake kundrejt rreziqeve nga terrorizmi, edhe atë në mënyrë që të mos mbeten zbrazëtira në mbulesë, për shkak të së cilave dëm do të pësojë vetëm siguresi. Problemi i njëjtë u kushtohet edhe dëmeve malicioze dhe terrorizmit.

Ana e dobët e mbulesës së tyre qëndron në atë se siguresit e vërtetojnë obligimin e tyre ndaj të siguararit pasi që paraprakisht do të vërtetojnë se a përputhet motivi i kryesit me mbulesën. Siguresit dëshmuar se “rrezikun nga mllefi” nuk janë të gatshëm ta mbartin.

Sulmi terrorist ndaj QTN ndodhi para do kohësh dhe ka pasoja afatgjate. Për këtë shkak, vendimi për mënyrën e mbulesës siguruese nga rreziku për terrorizëm ende nuk e ka marrë formën dhe përmbajtjen e vet përfundimtare në tregun për sigurime.

### **Bibliografia**

1. Self-insuring terrorism is risky. (Cover Story).(Congress debates terrorism insurance bills)(Government Activity)(Brief Article): An article from: National ... & Casualty-Risk & Benefits Management - (Jun 1, 2005) by Caroline McDonald
2. Terrorism views aired.(Terrorism Risk Insurance Program): An article from: National Underriter Property & Casualty-Risk & Benefits Management - (Jul 31, 2005) by Daniel Hays
3. Trends in Terrorism: Threats to the Inited States and the Future of the Terrorism Risk Insurance Act - (Oct 25, 2006) by Peter Chalk



**Docent Dr. Bratislav Milosheviq**

## **BENEFICIONE EKLATANTE DHE VOLITSHMËRI MË TË MËDHA NË SIGURIMIN JETËSOR**

Për të gjithë, të cilët mendojnë të deponojnë për sigurimin jetësor, qysh në fillim duhet të kenë të qartë se në periudhën e caktuar të sigurimit ka në disponim edhe përparësi shtuese, përkatësisht beneficione të rëndësishëm.

Veprim- sigurimi, apo sigurimi i veçantë i jetës, janë rrjedhshmëri e kohës së re. Sigurimi i jetës e mbron të siguruarin nga dy reziqe bazike: vdekja e hershme dhe jetëgjatësia, duke i plotësuar njëkohësisht më gjerësisht interesat shoqërore me sigurim shtues të sigurimit social të qytetarëve.

Nga pamja ekonomike, sigurimi i jetës është me shumë rëndësi, për shkak se siguron të holla me leje për investime dhe kreditim në zhvillimin e ekonomisë nacionale.

Për këtë arsye, në periudhën e ardhshme, edukimi dhe strategjia e marketingut në kompanitë e sigurimit duhet të jenë të drejtuar në prezentimin e të gjitha përparësive, të cilat i ofron sigurimi jetësor, si lloj i kursimit, planifikim dhe stabilitet financiar për individë.

Ne si njerëz plakemi dhe kalojmë në periudha të ndryshme të jetës, në të cilat nevojat tona, nga llojet e ndryshme të sigurimeve personale, ndryshojnë.

Kjo më së shumti vlen për sigurimin jetësor, që kanë periudhë të gjatë të sigurimit dhe në format e saja i përshtaten nevojave individuale dhe ambientit, në të cilin jetojnë.

Njëra nga nevojat bazike është statusi i individit në shoqëri. Nevojat janë të ndryshme dhe kjo varet nga ajo se a bëhet fjalë për familje të re pa fëmijë, familje me fëmijë të vegjël, familje me fëmijë të ritur etj.

Sigurisht të gjithë kanë qëllim të njëjtë, t'ju sigurojnë siguri familjeve të tyre, a vetes sigurim financiar, plakje pa brenga.

Sot, në kushte bashkëkohore të jetesës dhe punës, në kushte bashkëkohore të ekonomisë tregtare, nënshkruesi i sigurimit, përkatësisht i siguruari me lidhje të sigurimit jetësor, me siguri mundet të presë beneficione dramatike të volitshme, të cilat janë: përtëritje të marrëveshjes për sigurim, përkatësisht zvogëlimin e shumës për sigurim; blerje e sigurimit; paradhënie dhe hua; dhënia peng e policës; të qenurit fakultativ gjatë pagesës së shpërblimit; pjesëmarrja e të siguruarit në shpërndarjen e fitimit të fituar të siguresit; komulirim “shpagim” i shumës të siguar; caktimi i shfrytëzuesit të sigurimit dhe shumë të tjera.

### **Zvogëlimi (reduktimi) i shumës së siguruar**

Deri te zbritja e shumës së sigurimit vjen atëherë kur i siguruari, pas një periudhe të sigurt kohore nga lidhja e marrëveshjes, për të cilën tashmë ka paguar një numër të caktuar të shpërblimit (për dy ose tre vjetë) ndërpre pagesën e shpërblimeve të sigurimit.

Nëse ndërpre pagesën e shpërblimeve para kalimit të kësaj periudhe kohore, atëherë llogaritet se e ka prishur marrëveshjen, sigurimi nuk vlen dhe nuk kthehet pagesa e shpërblimit.

Nëse këto kushte janë të plotësuara, deri në prishje të marrëveshjes nuk do të vjen edhe nëse i siguruari nuk e zbaton obligimin më të rëndësishëm të marrëveshjes. Pasojë e vetme në lidhje me sigurimin, që vazhdon edhe me ndërprejen e pagesës së shpërblimit, shihet në zvogëlimin e shumës siguroese, te e cila arrihet sipas tabelave të veçanta.

Kërkesa që të jenë të paguara më së paku dy (përkatësisht tre) vite premi të sigurimit arsyetohet me atë se në atë mënyrë nga kjo vlerë rezerva e sigurimit mundet t'i mbulojë së paku harxhimet e përgjithshme të siguroesit: Pa këto premi siguroesi do të ishte në çdo rast i dëmtuar, nëse sigurimi vazhdon të rrjedhë edhe me obligimet e zvogëluara të tij dhe nëse ky kusht është i plotësuar atëherë vjen deri te modifikimi i marrëveshjes.

Ligji jonë për marrëdhënie obliguese llogarit se janë të nevojshme më së paku shpërblime trevjeçare, që nga ato të formohet rezervë matematikore në të cilën i siguruari mundet ta themelojë të drejtën për kthim.

Me këtë, ai parashikon të drejtë për siguroesin, në rast se siguroesi ndërpre pagesën e shpërblimeve, zvogëlon shumën e siguruar në vlerë të vlerës së blerë të sigurimit, përkatësisht prishje të marrëveshjes.

Kushti i mëparshëm, të cilin siguroesi duhet ta plotësojë për të realizuar këtë të drejtë të tij, është që ta thërret të siguroarin, që të paguajë shpërblimin (të cilën duhet ta bëjë në mënyrë të sigurtë, me letër rekomaduese, me shënimin e afatit të pagesës së shpërblimit, e cila nuk mundet të jetë më e shkurtë se një muaj, nga dita e pranimin të letres).

Nëse i siguruari edhe pranë kësaj nuk e paguan shpërblimin e duhur, siguroesi mund ta zvogëlojë shumën e sigurimit (nëse janë të paktën të paguara tre vite shpërblim), përkatësisht ta ndërpresë marrëveshjen (nëse nuk janë të paguara tri vite shpërblim).

Edhe në dy rastet duhet këtë t'ja tregojë siguroesit, të drejta këto që siguroesi mundet t'i shfrytëzojë derisa nuk ndodh rasti i sigurimit.

Nëse prapë vjen deri te kjo, para se siguroesi ta zvogëlojë shumën siguroese (përkatësisht ta ndërpresë marrëveshjen) do të merret sikurse automatikisht kanë ardhur aktivitetet e parapara me vetëplotësimin e kushteve të përmendura.

Ky ndryshim në marrëdhëniet juridike të sigurimit, sipas asaj, nga natyra e saj juridike nuk paraqet risi në marrëveshje, bëhet fjalë për marrëveshjen e njëjtë për sigurim, e cila i vazhdon veprimet.

Me përjashtim të reduktimit të shumës siguroese, të gjithë urdhërat e caktuara mbeten në fuqi: për kohëzgjatjen e marrëveshjes, shfrytëzuesi i sigurimit, kundërshtimet e siguroesit etj.

Kështu marrëveshja e modifikuar, me shumë të zvogëluar të sigurimit, mundet më vonë, me pajtueshmëri të të dy palëve të përtërihet. Të drejtat për sigurim të siguroesve tanë e parashikojnë këtë mundësi (me përjashtim në mënyrë të sigurimit vetëm në rast të vdekjes).

I siguruari, i cili don ta përtërijë sigurimin, është i detyruar të parashtrojë lutje me shkrim, t'i paguajë shpërblimet e duhura dhe t'i plotësojë kushtet për pranimit dhe sigurim, në pikëpamje të gjendjes së vet shëndetësore, të cilat siguroesi i zbaton.

Obligimi i siguroesit prapë fillon të rrjedhë derisa me shkrim e konfirmon pranimitin e kërkesës për përtëritje. Megjithatë, për dallim nga rasti i reduktimit të marrëveshjes, këtu nuk bëhet fjalë për modifikim të thjeshtë të marrëveshjes ekzistuese, por për përcaktim të veprimeve në marrëveshjen e re.

Kjo qartë vërteton disa veprime të marrëveshjes së përtëritjes për sigurim, të parashikuara me kushtet e tona të përgjithshme për sigurim: siguroesi lirohet nga sigurimi vetëm nëse i siguruari hesht (nuk jep deklaratë të saktë), p.sh. sëmundje të cilën e ka pasur në momentin kur ka parashtruar kërkesën për përtëritje, mandej, siguroesi paguan vetëm shpërblimin rezerv nëse i siguruari kryen vetëvrasje në afat njëvjeçar pas kryerjes së përtëritjes – përkatësisht veprime të njëjta sikurse edhe te lidhja e marrëveshjes së re.

### **Blerja e sigurimit**

I siguruari, i cili ka të paguar më së paku tre vite shpërblim të sigurimit dhe i cili nuk ka më interes nga marrëveshja e sigurimit, mundet të kërkojë nga siguroesi që t'ia paguajë vlerën blerëse të sigurimit.

Deri te blerja, sigurisht nuk vjen automatikisht, por me kërkesë nga personi i autorizuar. Ky ligj nuk ekziston në të gjitha llojet e sigurimeve jetësore. Llogaritet se blerja nuk mund të zbatohet:

1. Te të gjitha sigurimet jetësore, ku mbledhja e rezervës matematikore është e parëndësishme (nga shkaku i njëjtë ajo nuk është e përshtatshme as për reduktimin e shumës siguroese).
2. Në ato sigurime ku nuk ekziston shënim, se rasti i siguar përgjithësisht do të fillojë dhe se caktimi i shumës do të jetë i paguar (sikurse në sigurim në rast të ndodhjes ose sigurim afatshkurtër i jetës – përkohësisht) dhe ku siguroesit

llogarisin se gjasat për realizim të rezikut janë të zvogëluara dhe për atë janë të detyruar ta kthejnë blerjen dhe të paktën ashtu ta shpëtojnë rezervën.

### 3. Kjo për siguresit do të thotë antiselektim i rezikut.

Nga këtu edhe Ligji për Obligim të Marrëdhënieve parashikon leje për blerje të sigurimit të jetës, i cili është i lidhur për tërë jetën e siguresit, përkatësisht, aty ku rasti i siguruar shfaqet i sigurtë (dies certus an).

Pagesa e grumbullimit të vlerës paraqitet si obligim i siguresit. Në drejtësinë tonë ajo ekziston atëherë kur paraqiten kushtet e parapara. Në disa drejtësi, ligji e mbron siguresin në rast të kërkesës të njëkohshme për blerje, prej të cilit mundet të arrijë në rast krize, luftë dhe të ngjashme dhe e cila mundet ta lëvizë drejtëpeshimin financiar të saj.

Vlera, e cila i paguhet palës, me të cilën është lidh marrëveshja, vërtetohet sipas një table të veçantë e shtuar së bashku me policën e sigurimit. E drejta për blerje parimisht ekziston vetëm te sigurimi jetësor, përkatësisht aty ku rasti i sigurimit shfaqet i sigurtë.

Megjithatë, për shkak të rritjes së konkurrencës, siguresit jo gjithmonë heqin dorë nga ky rregull, duke lejuar edhe blerje për lloje të tjera të sigurimeve jetësore.

Përveç kësaj, mënyra e llogaritjes së blerjes së vlerës së sigurimit nuk është lënë ekskluzivisht në dëshirën e siguresit: në shumë drejtësi ajo është nën kontroll të legjislaturës si në shikim të prurjes, ndryshimet e mëvonshme ose të zyrtarizuara në policën për sigurim.

Ajo është e pranuar edhe në Ligjin për obligim të marrëdhënieve. Në policë duhet të jenë të shënuara kushtet, ku pala që lidhë marrëveshje mundet të kërkojë pagesë të vlerës grumbulluese, si dhe mënyra se si kjo vlerë llogaritet, në përputhje me kushtet e sigurimit.

Të gjithë personat të interesuar për shpërblim nga sigurimi, nuk kanë të drejtë të kërkojnë blerje të sigurimit. E drejta për kërkim të blerjes i takon atij, i cili ka lidhur marrëveshje.

Në Ligjin për obligim të marrëdhënieve saktësohet se cilët persona nuk mund të kërkojnë blerje (grumbullim): ata janë të besueshmit e atij, i cili ka lidhur marrëveshje për sigurim dhe shfrytëzuesi i sigurimit (me përjashtim kur caktimi i tij nuk është i rëndësishëm).

Arsyet për këto përjashtime janë këto: llogaritet prej në fillim, se e drejta për sigurim të jetës është e drejtë personale, e mandej, blerja mundet në mënyrë indirekte të sjellë deri te revokimi i shfrytëzimit të sigurimit nga personi, për të cilin është kushtuar, a këtë mund ta bëjë vetëm ai i cili ka lidhur marrëveshje për sigurim, shfrytëzuesi nuk ka të drejtë ta modifikojë marrëveshjen e lidhur në mes të siguresit dhe sigurimit (nëse më nuk ka pranuar dobi nga marrëveshja – atëherë pala, e cila ka lidhur marrëveshje nuk mundet të kërkon blerje (grumbullim)).

Veprimi i blerjes (grumbullimit) përbëhet nga ajo se marrëdhëniet ligjore të sigurimit shuhen para daljes së afatit të caktuar, apo sigurimi e paguan grumbullimin e vlerës. Me grumbullim, në të vërtetë kryhet ndryshimi i obligimeve të siguresit prej të kushtëzuara në të rëndomta, obligime të thjeshta, të cilat menjëherë arrijnë.

Të drejtat dhe obligimet nga marrëveshja, nga ajo, ndërpriten prej momentit të kërkimit të blerjes, e jo nga momenti i pagesës së vlerës grumbulluese. Nga kjo nëse pas kërkesës për blerje, apo para pagesës së vlerës së grumbulluar, ndodh sigurimi i rastit, shfrytëzuesi nuk ka të drejtë në shumën e siguruar, por vetëm në vlerën e blerjes së vlerës.

### **Akontacion i shumës së siguruar**

Në lidhje me reduktimin dhe blerjen, akontacioni ka përparësi të mëdha për siguresin: Ai fiton shumë të caktuar nga siguresi, duke i paguar për kthim shpagim në lloj të interesit (kamatës) në atë caktim, derisa njëkohësisht marrëveshja për sigurim edhe më tutje vazhdon.

Përveç kësaj, i siguruari mundet më vonë ta kthejë caktimin e pranuar me emrin avans dhe zvogëlimin e shumës të sigurimit prapë ta zmadhojë në caktimin fillestar.

Për siguresin gjithashtu mundet të ekzistojë interes për pagesën e akontacionit, për shkak se ajo është e kufizuar në vlerën e blerjes së vlerës së sigurimit, dhe me atë që ai e cakton vlerën e interesit (kamatës) dhe mënyrën e pagesës së avansit.

Më në fund, ai edhe më tutje fiton shpërblim nga marrëveshja e sigurimit. Edhe pse ekziston interesi që siguresi të paguajë akontacion edhe siguresit në kushtet e përgjithshme për sigurim i parashikojnë edhe kushtet për pagesë të saj, megjithatë nuk ekziston obligim i siguresit në atë kuptim.

“Nga kërkesa e nëshkruesit të marrëveshjes për sigurim të jetës në rast vdekje dhe dëmi (sigurim i përzier), siguresi mundet t’i paguajë palës me të cilën ka lidhur marrëveshje qysh përpara një pjesë nga shuma e siguruar, më së shumti në caktim deri më 60 për qind nga grumbullimi i vlerës së policës, të cilën pala, e cila ka nënshkruar marrëveshjen, mundet ta kthejë më vonë”.

Nga dallimi prej grumbullimit, siguresi mundet (por nuk është i detyruar) në kërkesë të palës, e cila ka lidhur marrëveshje të paguajë qysh përpara një pjesë të shumës së siguruar.

Gjithashtu, nga ana e të siguarit, i cili ka pranuar akontacion nuk ekziston obligim që t’ia kthejë siguresit, por ai mundet ta bëjë vetëm nëse dëshiron. Megjithatë, nëse i siguruari vonohet me pagimin e kamatës së caktuar për pranimin e akontacionit atëherë llogaritet se ka kërkuar blerje.

Ligji për obligim të marrëdhënieve parasheh: ”Në policën e sigurimit duhet të jenë të shënuara kushtet për dhënie të avancit, mundësia që t’i kthehet siguresit caktimi i pranuar me emrin avanc, vlera e interesit (kamatës) pasojat e mospagimit të kamatës, ashtu si është e vendosur me kushtet e sigurimit”.

## Dhënia peng e policës

E drejta e të siguarit për ta lënë peng policën për sigurimin e jetës del nga e drejta e tij e gjerë, nga e cila deri nga shfaqja e rastit të siguar, mundet në mënyrë të plotvlefshme të disponojë me të gjitha të drejtat nga lidhja e marrëveshjes së sigurimit.

Ta ndërrojë shfrytëzuesin, t'i zbrapsë të drejtat e veta apo të shfrytëzuesit, etj4.

Dhënia peng e policës mundet t'i shërbejë edhe siguruesit si mjet për të fituar kredit: i besueshmi, i cili frikësohet nga vdekja e hershme e debitorit, me policën të cilën e merr peng, fiton sigurim se do të paguhen nga siguruesi debitorit, nëse atij diçka i ndodh.

Që të ketë dhënë peng policën (veprim ndaj siguruesit), nevojitet ai të jetë i lajmëruar me shkrim: për atë se polica është e dhënë peng dhe se është e dhënë te një i besuar i veçantë.

Sipas rregullave të sigurimit të jetës, ky aktivitet i të siguarit është i detyruar vetëm nëse për atë e ka ditur para ngjarjes të rastit së siguar.

Në pikëpamje të formës së dhënies peng e rëndësishme është lloji i policës: polica me urdhër jepet peng me idosament5 .

I besueshmi i dhënies peng mundet së pari, sikur se edhe çdo tjetër i besueshëm, sipas rregullave të përgjithshme të të drejtës qytetare, t'i kryejë obligimet e debitorit (i siguruari) të kërkojë khimin e caktuar, së paku me masën me të cilën është formuar matematika reserve.

Parashtrohet pyetja a mundet i besueshmi i dhënies peng të shfrytëzojë të drejtën për blerje të policës, e cila i është dhënë peng, nëse kërkesa e tij ndaj debitorit – i siguruari ka arritur?

Llogaritet, në teori, se kjo e drejtë duhet t'i pranohet në të kundërtën të karakterit personal me të drejtën për blerje, nga arsyet që vijnë: i besueshmi i dhënies peng është më shumë sesa shrytëzues i thjeshtë i sigurimit, sepse atij sigurimi (i lënë peng) i shërben si sigurim i borxhit, që ka arritur dhe të cilën pagesë i siguruari nuk mundet ta parandalojë.

Nëse, prapë ndodh që kërkesa nga i besueshmi i dhënies peng dhe kërkesa e të siguarit nga sigurimi të arrijë në kohë të njëjtë, atëherë i besueshmi i të dhënit peng duhet të ketë padi direkte ndaj siguruesit, me të cilën do ta kishte paguar veçmë kërkesën e vet të siguar, para të gjithë të besueshmve tjerë të sigurimit.

## **Fakultative para pagesës së shpërblimit**

Në sigurimin e jetës, siguruesi nuk ka të drejtë të kërkojë pagesë të shpërblimit të arritur nëpër rrugë gjyqësore.

Obligimi megjithatë nuk bëhet natyror, për shkak se sanksionet për joplotësimin e obligimeve kryesore të siguruesit ekzistojnë: qoftë ndërpreje e veprimeve të marrëveshjes apo, prapë, (në disa të drejta) suspendimi i marrëveshjes.

Përveç asaj, siguruesi mundet që caktimin e shpërblimeve të paguara ta kompenson me caktimin, të cilin ai duhet t'ia shpaguejë të siguruarit nëse vjen rasti i siguruar.

Nga vetë obligimet, veprimet zyrtare edhe kodeksi në sigurim, i siguruari duhet me vetëdije të sillet dhe të respektohet thënia – termini është i obliguar. Në të vërtetë ai, i cili ka lidhur marrëveshje, është i obliguar ta paguajë shpërblimin me rregull dhe në afatin e duhur.

Është e njohur që siguruesi nuk ka të drejtë pagesën e vet ta kërkojë nëpër rrugë gjyqësore, megjithatë, në duar të tij janë mekanizmat ndihmës, llogaritja e kamatës, zvogëlimi i shumës së sigurimit, etj. Mirëpo, pagesa e shpërblimit të mbetur gjithmonë ka tretmanin e jopagesës së shpërblimit të parë.

Karakterit fakultativ i pagesës së shpërblimit është i qëlluar nga arsyet praktike, e jo nga disa principe të drejtësisë. Ai del nga qëllimi, që me sigurimin e jetës don të arrijë, se a janë të përshtatshëm mundësitë materiale të të siguruarit.

Ekziston jopajtueshmëri rreth asaj se ky princip vlen edhe për shpërblimin e parë, apo vetëm në shpërblimet e ardhshme. Ky “koalizim” humb në rëndësi nëse në rast se në kushtet e sigurimit është e përcaktuar se, sigurimi do të hyjë në fuqi vetëm pas pagesës së shpërblimit të parë, sikurse është ajo në kushtet e sigurimit të jetës te siguruesit tanë.

## **Në vend të përfundimit**

Pse policia e sigurimit jetësor?

1. Për shkak se sigurimi i jetës është më shumë se vetë sigurimi, ajo është deponim me mundësi për fitim më të madh, për arsye se në të njëjtën kohë realizohen të gjitha beneficionet në kursim dhe mbrojtje!
2. Për shkak se me zgjedhje të policës së sigurimit jetësor deponohet kapital, i cili më vonë, me deponim profesional të kompanisë, në çdo rast, sjell fitim!
3. Për shkak se koha është në anë të të siguruarit dhe ajo punon për të!
4. Për shkak se sigurimi jetësorë është i thjeshtë dhe fleksibil!

5. Për shkak se në të gjitha llojet e sigurimeve jetësore përmbajnë mundësi, ku për të siguruarin dhe për më të afërmit e tij garantojnë ardhmëri të mirë dhe të sigurt:

6. Deponim

7. Mbrojtje

8. Siguri

Me blerjen e policës për sigurim jetësor secili qytetar kursen për ardhmërinë e tij. Perëndimi, i cili humbet në principet e tregut shumë më herët, ka pastruar me atë se punëve të këqija duhet t'i shikohet në sy dhe t'i lihet diçka pasardhësve.

Në jetë kanë për qëllim që të kursejnë edhe në vitet e “moshuara” dhe ato të holla t'i shfrytëzojnë për udhëtime rreth botës ose për blerje të kampshtëpizave të ëndërruar rreth detit ose liqenit apo, prapë, për një kasollë të bukur nga druri në mal me pamje të bukur.

Kjo nuk është halucinacion, kjo në perëndim funksionon shumë vite më herët.

### Literatura

1. Emmett Voughan, Therese Voughan: „Fundamentals of risk and insurance“, John Wiley, New York, 1996 god.
2. Zdravko D-r Petrovi, Tomislav Petrovi: ”Osigurawe `ivota”, “Glosarijum“, Belgrad, 2003 god.
3. Tihomir D-r Jovanovski: “Ekonomika na osiguruvawe“ (Vtoro izmeneto i dopolneto izdanie), „EMK“, Skopje, 2005 god.
4. Leksikon osigurawa, Buduçnost“, Novi Sad, 2002 god.

### Revistat:

- “Osigurawe“ - Zagreb  
 “Osigurawe u teoriji i praksi“ - Beograd  
 “Svijet osigurawa“ - Zagreb  
 “Tokovi osigurawa“ - „Dunav osigurawe“, Belgrad  
 “Ekonomija i biznis“ - Skopje  
 “Kapital“ - Skopje

1 Angl. m. advance – avans, f. advance - akontacija

2. Kushte të përgjithshme për sigurimin e jetës: Shoqëria aksionare për sigurim dhe ridigurim “Kjubi Makedonija”, Shkup, Nëntor, 2003 v.,faq.9
3. Ligji për obligim të marrëdhënieve (PjesaXXX-sigurim), Shkup, 2001 v., neni 1011, pika 4, faq. 1105
4. D-r Predrag çuleji: “Pravo osigurawa“, “Misao“, Novi Sad, 1992 v. faq. 413



5. Tejbartje e kamialit të nënkuptohet edhe për policën, është veprim me të cilën polica tejbartet në person tjetër (zyrtar apo fizik) a vet tejbartja, përkatësisht ai nen, shënohet në policë. Deklarimi i personit, i cili ka lidh marrëveshje – me sigurimin (indosant) me të cilën ai e tejbartë të drejtën e tij në person tjetër (indosator) quhet indosament.
6. (Leksikoni ekonomik: „Savremena administracija“, Beograd, 1975 v., faq.725)

MSc. Vera Karaxhova

## IDENTIFIKIMI I RREZIKUT TE SIGURIMI – FAZA NË UDHËHEQJE ME RREZIKUN

### **Nevoja për identifikimin e rreziqeve**

Identifikimi i rrezikut është njëri nga hapat në procesin e udhëheqjes me rreziqet, përmes të cilit arrihet njohuria për ekzistimin e rrezikut.

Edhe pse procedura e menaxhimit me rreziqet mund të përfshijë numër të ndryshëm të hapave, identifikimi i rreziqeve zakonisht pason pas vërtetimit të qëllimeve të programit për udhëheqje me rreziqet.

Në mungesë të qëllimeve, të cilat dëshirohen të arrihen, krijohet gjendje e *ad hoc* reaksioneve momentale, të cilat shumë shpesh mund ta zhvendosin subjektin ekonomik nga shtegu në të cilin duhet të lëvizë në periudhë afatgjate.

Posaqërisht, në kushte të internacionalizimit dhe globalizimit të biznesit, gjë që shkakton kompleksitet të zmadhuar të rumbullakësimit, planifikimi dhe parashikimi si parakusht i tij, si dhe parashtrimi i qëllimeve si rezultat i parë dalës i procesit të planifikimit, paraqiten si nevojë dhe domosdoshmëri objektive.

Identifikimi ose zbulimi i llojeve të rreziqeve pason pas asaj procedure dhe nënkupton demistifikim të kushteve dhe rrethanave vështirësuese, në të cilën qëllimet paraprakisht të parashtruara do të duhet të realizohen.

Udhëheqësit me rreziqet ose menaxherët për rrezik patjetër duhet të gjejnë mënyrë për hulumtimin e veprimit të ndërmarrjes në kushte të mossigurisë dhe t'i zbulojnë rreziqet ndaj të cilave është e ekspozuar.

Gjatë saj është shumë vështirë të flitet në mënyrë të përgjithësuar për rreziqet me të cilat përballen të gjitha subjektet ekonomike, pasi rumbullakësimi më i gjerë dhe më i ngushtë, në të cilat ato veprojnë janë të ndryshme, kurse të ndryshme janë edhe fushëveprimet e punës dhe procedurat e realizimit të aktiviteteve.

Gjatë punës së tyre, subjektet ekonomike, të përfshirë edhe institucionet për sigurim, ballafaqohen me rreziqe të shumta, prej të cilave disa janë evidente dhe identifikohen pa vështirësi të mëdha, por ka edhe të tilla të cilat rëndë vërehen dhe ekziston rreziku nga mosshikimi i tyre.

Krahas kësaj, zhvillimi, përparimi dhe rezultati i cilitdo lloj, vazhdimisht krijojnë burime të reja të rreziqeve.

Edhe në këtë sferë të trajtimit të rreziqeve paraqitet specifika te sektori i sigurimeve, që mbështetet në faktin se institucionet që e përbëjnë atë patjetër duhet të gjejnë procedura dhe metoda për zbulimin si të rreziqeve, të cilat u kërcënohen atyre, ashtu edhe për rreziqet, të cilat realizojnë ndikim mbi subjektet, të cilat kanë për qëllim dhe blejnë sigurime te këta, e me këtë, ata, në mënyrë të tërthortë, sipërmarrin edhe një pjesë të këtyre rreziqeve.

Për këtë shkak riskmenaxhmenti patjetër duhet të shfrytëzojë qasje të kombinuar me përdorim sistematik të veglave të shumta për identifikimin e rreziqeve.

### **Instrumentet më të rëndësishme për identifikimin e rreziqeve**

Përdorimi i kombinimit më konsistent nga kompleti i veglave, të cilat u janë në dispozicion menaxherëve për rrezik, në masë të madhe varen edhe nga shkalla e profesionalizmit të vet menaxherit.

Në korporata gjigante menaxheri për rrezik ka specializim të ngushtë dhe mund t'u kushtojë vëmendje të plotë problemeve të rreziqeve. Te firmat më të vogla ky udhëheqës me siguri ka edhe detyra tjera dhe në mungesë të kohës ose të aftësisë për zbulimin e të gjitha rreziqeve potenciale, si rezultat mund të paraqitet humbja financiare.

Te firmat më të vogla menaxheri për rrezik mund të jetë person, i cili udhëheq në përgjithësi, gjegjësisht personi, i cili e ka funksionin udhëheqës pa specializim të ngushtë për financat, e atë pak për rreziqet dhe identifikimin e tyre dhe nevojën për të udhëhequr me rreziqet dhe identifikimin e tyre, si një nga hapat fillestar në drejtimin e tyre, që ta ndjejë si barrë ekstremisht të rëndë, pasi kjo kërkon precizitet enorm që të shmangët humbja.

Duhet të sillen vendime për atë se cilat lloje të rreziqeve duhet të sigurohen, çfarë lloji i sigurimit të blihet, sa dhe prej cilit, cilat rreziqe të mbahen dhe cilat të ndahen dhe me cilin, etj.

Për çfarëdo rast, pa marr parasysh shkallën e profesionalizmit të menaxherëve, ata patjetër duhet t'i kuptojnë dhe t'i respektojnë parimet për udhëheqje me rrezikun. Menaxheri, gjithashtu, patjetër duhet të dijë mjaftueshëm mbi udhëheqjen me rrezikun dhe sigurimin që të dijë se kur ka nevojë për ndihmë profesionale dhe të mund të përcaktojë se a i merr këshillat e vërteta nga burimet adekuat gjatë sjelljes së vendimit.

Që të arrihet siguria maksimale nga humbjet, patjetër duhet të zgjedhë instrumentin më adekuat prej për udhëheqje me rrezikun: mbajtjen, zvogëlim dhe mbartje, kurse në fazën e identifikimit të rrezikut ndonjëri nga instrumentet ose kombinimi i instrumenteve, të cilat maksimalisht do ta zvogëlojnë mundësinë për parashikimin e ndonjërit nga rreziqet.

Disa nga instrumentet më të rëndësishme për identifikimin e rreziqeve përfshijnë:

- Procedurën formale për kontrollimin e policave të sigurimit;
- Analizën e të dhënave të përgjithshme për subjektin ekonomik;
- Pyetësor për analizimin e rrezikut;
- Grafikone;
- Analizën e raporteve financiare;
- Pasqyrën e punës së firmës;
- Intervistat, etj.

Procedura për kontrollimin e policave të sigurimit i kushtohet analizimit të përmbajtjes së policave, të cilat janë të qasshme dhe të cilat jepen nga ana e siguresve dhe risiguresve të ndryshëm, e të cilat publikohen nga ana e publikimeve speciale nga lëmi i sigurimeve.

Listat e tilla përfshijnë edhe katalog të policave të ndryshme ose llojeve të sigurimeve, të cilat mund t'u duhen subjekteve afariste, kurse menaxheri për rrezik thjeshtë i kontrollon listat dhe zgjedhë polica, të cilat i përgjigjen kompanisë.

Mangësia kryesore e kësaj qasje është se përqendrohet kryesisht te rreziqet e sigureshme, duke i injoruar rreziqet e pastra të pasigureshme.

Procedura e njëjtë mund të zbatohet edhe në procedurën për risigurim nga ana e institucioneve për sigurim, por ky instrument përdoret vetëm për rreziqet e pastra të sigureshme, kurse nuk i përfshijnë rreziqet e pasigureshme dhe rreziqet tjera financiare.

Analiza e të dhënave të përgjithshme të klientit ekonomik nënkupton njohje me organizatën, e cila kërkon sigurim dhe me operacionet e tyre.

Menaxheri për rrezik duhet të ketë njohuri të përgjithshme për qëllimet dhe funksionet e organizatës, për praktikën në industrinë e dhënë dhe për aktivitetet e posaçme të vet organizatës.

Grumbullohen dhe përpunohen të dhëna statistikore për aktivitetet, të cilat i kryen organizata dhe vëllimin e tyre, të njëjtat përpunohen me metoda dhe procedura të ndryshme kuantitative dhe rezultatet e fituara paraqesin burim themelor të informacioneve për analizë të rrezikut dhe identifikim të ekspozimit të rrezikshëm.

Ky instrument i përshtatur në mënyrë adekuate mund të përdoret edhe për analizë të të dhënave personale nga ana e institucionit sigures, si në raport me rreziqet për të cilat mund të ndërmarrin aktivitetet risiguresve, ashtu edhe në raport me rreziqet e pastra të pasigureshme dhe rreziqet financiare.

*Pyetësorët për analizë të rrezikut janë instrumenti kyç në procesin për identifikim të rrezikut dhe ndonjëherë quhen edhe “zbuluesit e fakteve”.*

Pyetësorët për analizë të rrezikut janë krijuar që t'i mundësojnë menaxherit për rrezik që t'i zbuloj rreziqet përmes një sërë pyetjesh detaje dhe fillestare për organizatën, e jo rrallë te këta mund të përmbahen edhe pyetje, të cilat u kushtohen, krahas rreziqeve të sigurueshme, edhe atyre të pasigurueshme.

Moment shumë të rëndësishëm në raport me përdorimin e tyre paraqet aftësia për përdorimin e tyre, duke e pasur parasysh faktin e universalitetit në dizajnin e tyre, gjegjësisht ata janë të konceptuara të përdoren për lloje të ndryshme të bizneseve, jo gjithherë i kyçin ekspozimet e pazakonshme dhe nuk i identifikojnë sferat e humbjes, të cilat ndoshta janë unike për firmën e dhënë.

Megjithatë, ekziston mundësia edhe për konstruksionin e tyre më të detajuar, për shembull, listat më detaje të dizajnuara për industri të caktuar, janë lëshuar nga ana e Institucionit Internacional për udhëheqje me rrezikun nga Dallasi, Teksas dhe në secilin vit revidohen lista tjera detaje për industrinë e ndryshme.

Instrument tjetër plotësues në identifikimin e rreziqeve potenciale paraqet edhe e ashtuquajtura *lista e ekspozimeve*.

Duke e pasur parasysh faktin se lista e rreziqeve potenciale nuk mund t'i kyçë të gjitha ekspozimet e organizatës, pasi natyra dhe fushëveprimi i punës së organizatave të ndryshme janë të ndryshme, mund të përpilohet listë e posaçme e ekspozimeve, e cila do të jetë specifike dhe unike për organizatën e veçantë, e me këtë do të zvogëlohen mundësitë për shfaqjen e ndonjë ekspozimi të rrezikshëm serioz.

Instrumenti i tillë mund të gjejë zbatim edhe në përpilimin e listës së rreziqeve financiare në biznesin për sigurime.

*Grafikonet* si instrument për zbulimin e ekspozimit të rrezikshëm janë popullarizuar para së gjithash nga ana e menaxherëve për rrezik në kompanitë e mëdha, në të cilat ka nevojë të analizohen një numër i madh i aspekteve të punës, kurse pamjet piktoreske, që e reflektojnë grafikonet, japin mundësi për diagnostifikim të shpejtë dhe relativisht më të lehtë.

Përdorimi i grafikoneve e prezanton ndërlidhshmërinë dhe vijueshmërinë teknike të procedurave, e cila jep mundësi për identifikim më të lehtë të burimeve të ekspozimit të ndryshëm.

*Analiza e raporteve financiare* është procedurë standarde për identifikimin e ekzistimit të rreziqeve gati më tepër se gjysmëshekulli, kurse raportet financiare janë mjet primar prej të cilave fillon analiza e rreziqeve.

Bëhet fjalë për analizë të gjendjes së pronës dhe obligimeve të firmës, xhirollogarive të gatshme (rezervë), të hyrave, të dalave dhe rezultatin financiar, me çka arrihet njohuria për lëvizjen e deriatëhershme dhe gjendjen e kategorive dhe treguesve financiar kyç.

Pra, kjo është bazë shumë e mirë për ekstrepolimin e lëvizjeve të ardhshme dhe për zbulimin e dobësive dhe kufizimeve, si dhe sferat nga të cilat kanosen rreziqet kryesore.

*Pasqyra e punës së firmës* paraqet plotësim të njohurive deri te të cilat arrihet përmes analizës së raporteve financiare.

Krahas raporteve financiare ekzistojnë edhe një sërë dokumentesh dhe të dhënash tjera, të cilat janë të dobishme në procesin e identifikimit të rrezikut siç janë: raportet vjetore, procesverbalet nga këshillat drejtues, skemat organizative, doracakët, të dhënat për humbjet nga e kaluara, marrëveshjet për marrje me qira dhe huazime, urdhëresat për blerje, marrëveshjet për ndërtim, vendimet interne dhe ndalesat, listat e të punësuarve dhe struktura e të punësuarve sipas klasifikimeve të ndryshme, etj.

Praktikisht bëhet fjalë për formë të konsiderueshme të kontrollit ose inspeksionit ekstern të punimeve, me çka vizitohen hapësirat punuese dhe realizohen kontakte të drejtpërdrejta me menaxherët dhe të punësuarit, të cilët krijojnë hapësirë për zbulimin e rreziqeve, të cilat, përndryshe, do të mbeteshin të pazbuluara.

Vizita punuese kontrolluese e të siguarit potencial krijon figurë shumë më të mirë se sa leximi i faqeve të shumta nga raportet zyrtare dhe shqyrtimet financiare.

Instrument plotësues në paletën e instrumenteve identifikuese paraqesin *intervistat dhe bisedat informative* me individ të rëndësishëm nga i siguarit potencial, pasi disa të dhëna dhe informacione tepër të rëndësishme aspak nuk janë të shënuara në dokumentet dhe formularët zyrtarë dhe ekzistojnë vetëm në kokat e strukturave të menaxherëve në ndërmarrje.

Ndonjëherë janë të nevojshme intervista me sektor të veçantë në organizatë që të gjenden të gjitha informacionet e nevojshme dhe t'i shtohen informacionit të përgjithshëm, e cila përdoret për identifikimit të ekspozimit, kurse numri dhe vëllimi i këtyre intervistave varet nga situatat e veçanta konkrete.

Në varësi me rrethanat, në bisedat e tilla mund të inkuadrohen: udhëheqësi kryesor ekzekutiv, drejtori operativ, udhëheqësi kryesor financiar, udhëheqësi i sektorit të drejtësisë, inxhinieri i fabrikës, drejtori kadrovik, menaxheri për siguri, punëtorët dhe udhëheqësit tjerë, e gjithashtu mund të inkuadrohen edhe subjekte të jashtme, të cilët punojnë për nevojat e firmës dhe kanë në dispozicion informacione të dobishme për të, siç janë: avokati i kompanisë, kontabilisti i autorizuar, si dhe bashkëpunëtorë dhe këshilltarë tjerë të jashtëm.

### **Zgjedhja e instrumentit për identifikimin e rreziqeve**

Për çfarëdo rasti, edhe pse të gjitha procedurat e përmendura dhe të shumta për identifikimin e rreziqeve e lehtësojnë dhe në mënyrë cilësore e përmirësojnë procedurën e zbulimit dhe diagnostifikimit të tyre, megjithatë parashtrohet pyetja se cili nga instrumentet është më i përshtatshëm.

Ashtu si nuk ka pamje bardh e zi ndaj punëve në përgjithësi në jetë, e në këtë kontekst edhe në shkencë dhe ashtu siç nuk ekzistojnë procedura absolutisht të rregullta dhe krejtësisht të gabuara, padyshim se është normale dhe logjike që si qasje pragmatike të zbatohet qasja e caktuar e kombinuar.

Qasja e kombinuar shfrytëzohet si kombinim optimal i anëve të mira dhe tejkalimit të mangësive të secilit nga instrumentet që si procedurë ofron ndihmë enorme për menaxherin për rrezik, por zbatimi i saj përsëri varet nga aftësia e tij, imagjinata dhe aftësia për kombinime.

Qëllimi themelor i identifikimit të rreziqeve potenciale në procesin e udhëheqjes me rreziqet është menxhimi i mbajtjes së pavetëdijshme, mbajtjes jo të vullnetshme, e cila shfaqet atëherë kur rreziku nuk është i njohur dhe kur si pasojë arrihet deri te mbajtja e pavullnetshme.

Mbajtja e pavullnetshme nënkupton mbajtje të pavetëdijshme të rreziqeve, të cilat organizata nuk i ka zbuluar ose nuk ka kapacitet për t'u ballafaquar me ta, kurse ata kanë potencial për shkaktimin e humbjeve katastrofale.

Në kontest me çështjen për identifikim të rreziqeve i pashmangshëm është potencimi edhe i një aspekti tepër të rëndësishëm, e kjo është përfshirja e rreziqeve, që identifikohen nga aspekti i branshës për sigurime.

Gjatë saj, si më përmbajtësor dhe më gjithëpërfshirës, duhet të pranohet qasja e përfshirjes së gjerë e nocionit për udhëheqje me rreziqet, e kjo nënkupton udhëheqje me të gjitha llojet e rreziqeve, e jo vetëm me rreziqet e njëjta, që shpeshherë quhen edhe si rreziqe aktuale.

Më saktë, në kategorinë e rreziqeve, me të cilat udhëhiqet në sferën e sigurimeve, më së shpeshti theksohet vetëm një pjesë e rreziqeve të pastra edhe atë, ata të cilët janë të sigurueshëm dhe të njëjtit quhen rreziqe aktuale, për shkak të përpunimit të tyre me zbatimin e metodave të matematikës aktuale.

Por, krahas funksionit themelor mbrojtës të sigurimit, ai luan edhe funksion kursyes – krucial mobilizues dhe ndërmjetësues, posedon komponentë sociale, stabilizuese dhe zhvillimore në shoqëri me çka edhe paraqitet si një nga shtyllat dominante të ndërmjetësimit financiar mes sektorëve suficitarë dhe deficitarë në ekonomi, duke shitur instrumente financiare – polica dhe duke blerë instrumente financiare nga subjektet tjera.

Gjatë saj, sigurimi ballafaqohet me rreziqe afariste – financiare të shumta, të cilat janë të pasigurueshme, por është e nevojshme politika dhe strategjia adekuate financiare dhe për ballafaqimin me këta, gjegjësisht është i nevojshëm udhëheqje ose menaxhim adekuat dhe me rreziqet e tilla në kahe të optimizmit të raportit rrezik – leverdi (rendiment).

### Përfitimet nga identifikimi i rrezikut

Në fazën e identifikimit të rreziqeve financiare në institucionin për sigurime, shërbimet profesionale të institucionit e zbulojnë prezencën e rrezikut të tillë ose mundësinë për paraqitjen e tij dhe në bazë të kësaj qasemi kah realizimi i fazave në vijim në procedurën e udhëheqjes me rrezikun. Gjatë kësaj, me identifikimin e rrezikut duhet të vërtetohet:

- Se për çfarë lloji të rrezikut bëhet fjalë;
- A bëhet fjalë për rrezik, që shkaktohet nga faktorët intern ose ekstern, që të mund të determinohet shkalla e ndikimit të mundshëm ndaj tij;
- Me cilët tregues reflektohet prezenca e tij;
- A është ndikimi i tij ndaj punës së institucionit;
- A i nënshtrohet ky rrezik rregullimit shtetëror dhe cilave masa të saj;
- Cilat masa ndërmerren dhe cilat masa mund të ndërmerren për ballafaqim të suksesshëm me rrezikun e tillë;
- Zhvillimi i strategjisë për udhëheqje me rreziqet financiare dhe konkretizimin e tyre përmes masave afatmesme dhe afatshkurta për minimizimin e dëmeve të mundshme nga rreziqet.

Në literaturë hasen edhe mendime se procedura e identifikimit të rreziqeve potenciale patjetër duhet të jetë e bashkëngjitur me procedurën e vlerësimit të shkallës d.m.th. të intensitetit të rrezikut, pasi pa këtë nuk mund të vendoset në mënyrë precize vetë identifikimi, gjegjësisht zbulimi i rrezikut.

Mirëpo, krahas qasjes së tillë, një procedurë e tërësishme e udhëheqjes me rreziqet si mospasiguri, nga e cila na udhëzon ardhmëria në përgjithësi, mund të përmbajë numër më të madh ose më të vogël të fazave ose hapave të procesit të udhëheqjes me rreziqet, kurse procedura e vlerësimit të rrezikut mund të shqyrtohet si pjesë përbërëse e fazës së identifikimit ose si hap i posaçëm.

Duke e pasur parasysh llojllojshmërinë e rreziqeve të mundshme dhe ndërlikueshmërinë e procedurës për vlerësimin e tyre, nga qasjet e mundshme është qasja e vlerësimit të rrezikut si hap i posaçëm në procedurën e udhëheqjes me rreziqet.

### Literatura

1. Agarwass A. and DiRollo J., *Identifying Currency Risks*, Corporate Finan, 1988
2. Bernsten A. Leopold, Wild J. John, *Financial statement analysis (Theory, Application and interpretation)* City University of Neë York at Baruch, 1997
3. David J. Hatem, *Subsurface Conditionc: Risk Management for Design and Construction Management Professionals*, Burns & Levinson LLP 1997
4. Emmett Vaughan & Therese Vaughan, *Essentials of Insurance: A Risk Management Perspective*, Copyright © 1999 John Eiley & Sons, Inc, 1999
5. Williams C.A., Smith M.L., Young P.C., *Risk management and insurance*, Mc Graw/Hill, New York, 1995



**MSc. Aleksandar Trajkov**  
**Stevco Meceski**

## **ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE TRANSPORTUESE DHE SHPEDITERE**

### **Hyrje**

Shpedicioni sot luan një rol të madh dhe të rëndësishëm në xhiron ndërkombëtare dhe paraqet veprimtari të rëndësishme në jetën bashkëkohore ekonomike.

Megjithatë, në nivel ndërkombëtar, sot ende nuk ekzistojnë konventa, me të cilat do të mund të rregullohej shpedicioni ndërkombëtar.

Për shkak të të shfaqurit të vetëm dhe barazimit të kushteve për punë, shpeditëret bashkohen në organizata të posaçme (asociacione) si në planin vendas ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

Në kuadër të atyre asociacioneve shpeditere profesionale jepen kushtet e përgjithshme për punën e shpeditëreve, me të cilat rregullohen pozita ligjore e subjekteve, që janë pjesë e sistemit shpeditëres, sistemit transportues dhe sistemit për tregti të jashtme.

Organizatat shpeditere, si sisteme dinamik, në varësi nga karakteristikat e tyre të përbashkëta, mund të sistematizohen në të vendit dhe ndërkombëtare. Në pjesën më tej do të paraqiten disa nga organizatat shpeditere dhe transportuese, me shikim të shkurtër të aktiviteteve të tyre kryesore.

### **Asociacioni Evropian për Shërbime të Shpedicionit, Transportit, Logjistikës dhe Doganës – CLECAT**

Kjo organizatë, e cila i përfaqëson interesat e 27 organizatave kombëtare shpeditere të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian (UE), është formuar në vitin 1958 në Antwerpen, Belgjikë.

Selia e saj sot është në Bruksel, Belgjikë. Ndërmarrjet ndërkombëtare, të mesme dhe të vogla dhe përfaqësuesit e doganierëve paraqesin pjesë nga strukturat e CLECAT si shoqatat më të përfaqësuar të këtij lloji.

Rëndësia e CLECAT mund të ilustruhet nëpërmjet të të dhënave se kjo organizatë i mbron interesat të më shumë se 19.000 kompanive, të cilët punësojnë më shumë se 1.000.000 persona.

Sipas CLECAT, nëpërmjet shpeditëreve evropiane dhe përfaqësuesve të doganave, doganohen 95 për qind nga mallt në Evropë dhe organizohet 65 për qind nga transporti i mallrave nëpërmjet rrugës tokësore, 95 për qind nga transporti i mallrave në rrugë ajrore dhe 65 për qind realizohet në rrugë detare.

Kjo shoqatë ka detyrë kryesore edhe në transportin hekurudhor dhe atë të kanaleve. CLECAT i mbron interesat e anëtarëve të vet dhe promovon aktivitetet në lidhje me rregullativën, në drejtim të mbrojtjes homogjene të transportit dhe llojet e transportit, me çka formohet mjedis, që mundëson rrjedhë të lirë dhe të sigurtë të mallrave.

CLECAT bashkëpunon me Federatën Ndërkombëtare të Asociacioneve Shpeditere-FIATA dhe është përgjegjëse për pyetjet evropiane, të cilat i mundojnë shpeditërit ndërkombëtarë në kuadër të FIATA.

Gjithashtu, kjo organizatë bashkëpunon edhe me shumë shoqata të tjera profesionale nga lëmia e shpeditimit, transportit, logjistikës dhe përfaqësimit të doganave, në të cilën edhe vetë ajo merr pjesë.

### **Federata Ndërkombëtare e Menaxherëve Ndërkombëtar të Mallit - FIDI**

FIDI paraqet aleancën më të madhe globale, e cila i paraqet kompanitë e kualifikuara nga e gjithë bota, të cilët merren me përgatitje profesionale të mallit.

Për dallim nga FIATA dhe CLECAT, ku anëtare janë organizatat kombëtare shpeditere, në FIDI marrin pjesë ndërmarrje të specializuara, të cilat merren me dërgimin ndërkombëtar të mallit.

FIDI është formuar në vitin 1950 si Federatë Evropiane për t'i përfaqësuar interesat e kompanive të specializuara për dërgesë ndërkombëtare, e cila me kalimin e kohës rritet në organizatë lidere botërore në këtë lloj.

Selia ndodhet në Bruksel, Belgjikë. Sot, kjo shoqatë përfshin më shumë se 500 kompani përgatitëse, të cilat janë akredituar sipas standardeve të FIDI për menaxherë ndërkombëtarë të akredituar (FAIM - FIDI Accredited International Mover standard).

Kompanitë që janë anëtare të FIDI, shpesh janë të përfaqësuar nga ana e asociacioneve të tyre kombëtare shpeditere ose transportuese, ku ato gjithashtu marrin pjesë.

Misioni i FIDI është të sigurojë forum, ku do të përparojë integriteti, kualiteti dhe bashkëpunimi në mes kompanive – anëtare, të cilat merren me përgatitje profesionale të mallit.

Gjithashtu, në kuadër të kësaj shoqate zbatohen edhe programet dhe trajnimet të dizajnuara që t'u ndihmojnë anëtarëve në përmirësimin e konkurrencës së tyre në dërgesën ndërkombëtare dhe në magazinimin, në tregjet përkatëse.

Vizioni i FIDI është t'i pozicionojë anëtarët e veta si “zgjidhje e drejtë e menaxherëve” për dërgesë ndërkombëtare të mallit.

FIDI është strukturuar nga Këshilli FIDI, Komiteti konsultativ, zyra FIDI, Asociacioni FIDI (shoqatat e specializuara kombëtare) dhe FIDI afilialet (ndërmarrjet e kualifikuara lartë për përgatitje të mallit).

Këshilli e formon strategjinë e kësaj shoqate, mban mbledhje me kuvendin vjetor dhe i zbaton propozimet e miratuara nga kuvendi.

Komitetin konsultativ e përbëjnë kryetarët e mëparshëm të shoqatës, që ka rol supervizor në administratën dhe menaxhmentit, ndërsa përgjigjet para anëtarëve të Këshillit.

Aktivitetet ditore operative të kësaj shoqate bëhen nëpërmjet FIDI zyrës. FIDI afilialet dhe FIDI asociacionet janë anëtarët e kësaj organizate, të specializuar botërore.

### **Organizata Botërore Shpeditere - WFO**

WFO është rrjet botëror i pavarur i shpeditereve ndërkombëtarë, në të cilën marrin pjesë ekskluzivisht ndërmarrje të specializuara shpeditere me madhësi mesatare edhe atë nga një prej çdo vendi.

Si kriter i zgjidhjes merret profesionalizmi i tyre, përvoja, specializimi, stabiliteti financiar, reputacioni i kompanisë etj. Ky bashkim strategjik mundëson konkurrencë të anëtarëve dhe mundësi që të njëjtët të përgjigjen pozitivisht në kërkesat e tregut në transportin ndërkombëtar dhe tregun logjistik, nëpërmjet reduktimit të vazhdueshëm të shpenzimeve dhe përmirësimit të kualitetit të shërbimeve.

WFO ka qasje individuale në punën e klientëve dhe ofron zgjidhje kualitative të larta për problemet lokale të klientit. Kjo organizatë i zhvillon dhe promovon mundësitë afariste në industrinë globale të shpeditonit, duke i mbrojtur interesat e anëtarëve të vet dhe njëkohësisht edhe të klientëve.

Në kuadër të këtij rrjeti ndërtohen lidhje të forta ndërmjet anëtarëve me çka formohen raporte partnere në mes të të njëjtëve, dhe me qëllim përmirësimit të konkurrencës dhe të ofrohet shërbimi më i mirë i mundshëm për klientin.

Secila nga ndërmarrjet e specializuara shpeditere ekskluzivisht mbulon një pjesë të caktuar të tregut dhe me bashkëpunim aktiv dhe promovim të kompanive të mbetura, anëtare të rrjetit, kryen shërbime shpeditere, transport, logjistike, ndërmjetësim në doganë dhe shërbime të tjera operative dhe financiare në lidhje me shkëmbimin ndërkombëtar të mallit.

### **Asociacioni Ndërkombëtar për Transport Ajror – IATA**

Ky grupacion ndërkombëtar tregtar është formuar në prill të vitit 1945 në Havanë, Kubë nga ana e një grupi të kompanive të avionëve. Në fillim, ky asociacion numëronte 57 anëtarë nga 31 vende.

Selia e këtij asociacioni sot ndodhet në Montreal, Kanadë, dhe marrin pjesë më shumë se 230 kompani udhëtimesh dhe kompani ajrore kargo nga 125 vende, të cilat bëjnë 93 për qind të komunikacionit ajror.

Sa për ilustrim, kompanitë ajrore, të cilat janë anëtare të këtij asociacioni, në vitin 2007 kanë transportuar 44.7 milionë tonë mall, nga e cila 29 milionë tonë janë pjesë e xhiros së mallrave.

IATA ka për qëllim ta ngrejë vetëdijen për rëndësinë e industrisë së avionëve për ekonominë kombëtare dhe botërore.

Kjo shoqatë i mbron interesat e kompanive ajrore nëpër botë dhe iu ndihmon në thjeshtëzimin e procedurave, unifikimin e rregulativës dhe rritjen e besimit të klientët, duke llogaritur reduktimin e harxhimeve dhe përmirësimin e efikasitetit të punës.

Përparësitë kryesore të kësaj organizate janë: siguria, e cila po përmirësohet vazhdimisht me përparimin e standardeve të sigurisë dhe minimizimin e ndikimit të komunikacionit ajror në ambientin jetësor.

Dobitë nga ekzistenca dhe funksionimi i këtij asociacioni, për shfrytëzuesit e shërbimeve të avionit është se kjo shoqatë mundëson thjeshtëzimin e procedurave të udhëtimit dhe dërgesës së mallit, me atë rast duke mbajtur një çmim të ulët.

Dobi kanë edhe kompanitë e avionëve, pasi IATA mundëson që të operojnë sigurtë, me efikasitet dhe me ekonomi me rregulla të sakta të caktuara.

Kjo organizatë paraqet edhe një lloj ndërmjetësuesi ndërmjet kompanive të avionëve dhe ndërmarrjeve shpeditere nëpërmjet standardeve neutrale të vëna për shërbimet e agjencive dhe sistemeve të centralizuara financiare.

Si rrjet i gjerë i kompanive nga industria e avionëve, kjo shoqatë siguron ekspertizë kualitative dhe zgjidhje të ndryshme të problemeve për kompanitë në këtë sektor. IATA kujdeset që qeveritë e ekonomive të ndryshme kombëtare të jenë të informuara në kohën e duhur për kompleksitetin e industrisë së avionëve si të sigurohen vendime më të mira afatgjate.

Anëtarësimin formal në IATA e bëjnë vetëm kompanitë e avionëve, megjithatë ekzistojnë edhe programe të ndryshme të kësaj shoqate, të cilat mundësojnë edhe partnerët e tyre të realizojnë interesa dhe të marrin pjesë në aktivitetet e shoqatës.

Kështu p.sh, aeroportet në bashkëpunim me kompanitë e avionëve mundësojnë përmirësim të efikasitetit të industrisë transportuese të avionëve.

Agjencitë për udhëtime dhe ndërmjetësime në bashkëpunim me kompanitë e avionëve mundësojnë përparim të shërbimeve turistike. Ndërmarrjet shpeditere ose agjentët kargo

mund të marrin IATA akreditim, që është e pranuar nga ana e anëtarëve të kësaj organizate.

Programi i IATA për partnerë strategjikë iu mundëson furnizuesve dhe dhënësve të shërbimeve, në bashkëpunim me kompanitë e avionëve, anëtare të kësaj organizate, të marrin pjesë në përgatitjen e zgjidhjeve për problemet, të cilat e preokupojnë industrinë e dhënë.

### **Unioni Ndërkombëtar për Rrugë dhe Transport - IRU**

Unioni Ndërkombëtar për Rrugë dhe Transport, që është themeluar në Gjenevë, Zvicër, më 23 mars 1948, është organizatë ndërkombëtare, e cila i përfaqëson interesat e industrisë së transportit rrugor nëpër botë.

Në këtë rrjet marrin pjesë 180 asociacione Kombëtare për transport rrugor nga gjithë bota, të cilët i paraqesin operatorët e mjeteve transportuese (autobusë, furgonë, taksi, kamionë etj.).

Mund të thuhet se IRU, edhe pse ka vizion të vërtetë global, vepron në mënyrë efektive edhe në nivel kombëtar deri edhe në nivel lokal nëpërmjet organizatave kombëtare, të cilat janë anëtare të tyre. Ky Asociacion ka për qëllim lehtësimin e transportit rrugor nëpër botë.

Nëpërmjet akademisë së vet (IRU academy) organizon trajnime, që bën promovimin e profesionalizmit në këtë sektor dhe përmirësohet kualiteti i shërbimeve të cilat ofrohen. Mundëson lirinë e zgjidhjes në mes llojeve të transportit për klientët, si dhe trajtim të barabartë në rregulativën e secilit në llojet e transportit. Në bashkëpunim me anëtarët, sigurohet zhvillimin e harmonizuar të transportit rrugor dhe promovohet shfrytëzimi i tij.

Kjo shoqatë e specializuar i përfaqëson interesat e industrisë transportuese rrugore në raport me qeveritë, institucioneve private dhe publike, si dhe para mediave. Gjithashtu, kjo organizatë promovon bashkëpunim dhe plotësim të llojeve të ndryshme të transportit.

Përveç shërbimeve të përmendura, të cilat i jep kjo shoqatë, e njëjta gjithashtu paraqet edhe garanci të TIR sistemit, themeluar në bazë të TIR konventës, sipas së cilës mundësohet lehtësim i tranzitit nëpër vende, të cilat e kanë pranuar këtë konventë, nëpërmjet lehtësimit të procedurave doganore.

Akti konstituiv i IRU e detyron organizatën të merret me pyetjet në lidhje me zhvillimin dhe me lehtësimin e transportit rrugor. Këto janë dy përbërësit kryesor nga programi për punë i kësaj organizate.

### **Unioni Ndërkombëtar i Hekurudhave - UIC**

UIC është organizatë botërore për bashkëpunim ndërkombëtar ndërmjet hekurudhave, e cila promovon transportin hekurudhor në nivel global. Është formuar në vitin 1922 dhe

përfshin 200 anëtarë nga 5 kontinente, në mes të cilëve: hekurudha, operatorë hekurudhorë, menaxherë për infrastrukturë, dhënës të shërbimeve hekurudhore, kompani për transport publik etj.

Gjithashtu, ky Union mban lidhje të afërta afariste me të gjithë pjesëmarrësit në transportin hekurudhor, duke përfshirë edhe subjektet afariste të degëve të tjera industriale, asociacionet hekurudhore dhe qeveritë publike.

Misioni kryesor i Unionit Ndërkombëtar të Hekurudhave është që, nëpërmjet përparimit të bashkëpunimit ndërkombëtar ndërmjet anëtarëve, ta promovojë transportin hekurudhor, me qëllim të përvetësimit të nxitjeve të sotme, si gatishmëria dhe zhvillimi, duke ndërtuar një sistem hekurudhor të fortë.

Qëllimet e UIC janë: lehtësim të shkëmbimit ndërkombëtar të përvojave ndërmjet anëtarëve (benchmarking), propozim për mënyra të reja për përmirësimin e paraqitjeve ekonomike të rrjetit hekurudhor, arritja e interoperativitetit, formimi i standardeve të reja botërore për hekurudhat (duke përfshirë edhe standardet e përbashkëta me modelet e tjera për transport), si dhe zhvillimin e të ashtuquajturës qendra mbikëqyrëse “centres of competence” (teknike, siguroese, menaxhment etj.).

Detyrat kryesore të UIC janë: ta përparojë bashkëpunimin teknik, sistemin hekurudhor dhe interoperativitetin përmes:

- Sjelljes e specifikave dhe standardeve nëpërmjet objekteve për standardizim.
- Vënien e platformave teknike me të cilat do të përmbahet puna e hekurudhave.
- Koordinim i projekteve për bashkëpunim ndërkombëtar të hekurudhave.
- Dhënien e rekomandimeve për anëtarët e saj.
- Arritje të marrëveshjeve me organizata ndërqeveritare dhe organizata të tjera tregtare interesi të cilëve ka të bëjë me pyetjet për transportin ose bashkëpunojnë me hekurudhat.

Në vitin 2007 janë formuar 6 shoqata regjionale të Unionit Ndërkombëtar të Hekurudhave (Azi, Afrikë, Evropë, Lindja e Mesme, Amerika Veriore dhe Amerika Jugore), të cilat duhet t’i zgjidhin pyetjet regjionale të anëtarëve të UIC.

Sot, ky Union është aktiv në plan global dhe rajonal në mbrojtje të interesave të subjekteve të hekurudhave nëpërmjet vënies së teknologjive dhe hulumtimeve, formimin e infrastrukturës, përparimin e xhiros së udhëtarëve dhe të mallrave, përmirësim i efikasitetit të transportit etj.

### **Organizata Ndërkombëtare Detare – IMO**

Organizata Ndërkombëtare Detare është formuar në vitin 1948, nga ana e Kombeve të Bashkuara, me qëllim që të koordinojë transportin ndërkombëtar detar, duke rënduar në siguri më të madhe. Kjo organizatë hyri në fuqi në vitin 1958.

Selia është në Londër, Britani e Madhe, prej ku promovohet bashkëpunim në mes qeverive dhe industrisë së anijeve, me qëllim përmirësimi i sigurisë në transportin detar dhe të ndalohet ndotja e limaneve dhe ujrave detare.

Me IMO udhëheqin Kuvendi i anëtarëve, i cili bën zgjedhjen e Këshillit të Anëtarëve nën mbikëqyrje të të cilës janë administrata dhe financat e organizatës. Puna e kësaj organizate detare zbatohet nëpërmjet 5 komiteteve, të cilët marrin përkrahje teknike nga 5 nënkomitetet e tyre.

Anëtarët e kësaj organizate, si pjesë e familjes së OKB, mund t'i vëzhgojnë interpretimet në IMO. Statusin e vëzhguesit mund ta marrin edhe organizatat joqeveritare të kualifikuara.

Organizata Ndërkombëtare Detare merr përkrahje edhe nga Sekretariati i përhershëm, ku janë të punësuar përfaqësues nga anëtarët e organizatës. Ky Sekretariat përbëhet nga Sekretari i Përgjithshëm, i cili zgjidhet vazhdimisht nga ana e Kuvendit edhe nga disa sektorë, siç janë: Sektori për siguri detare, Sektori për mbrojtje të mjedisit jetësor, Sektori për konferenca etj.

Në kuadër të IMO janë sjellë 60 instrumente ligjore, që paraqesin drejtim ligjor, me të cilin vendet anëtare do ta përmirësojnë sigurinë në det, do ta lehtësojnë tregtinë ndërmjet vendeve të larguara detare dhe do ta mbrojnë mjedisin jetësor. Më i njohur nga të gjitha këto akte ligjore është Konventa Ndërkombëtare për Siguri të Jetës në Det – SOLAS (Safety of Life at Sea).

### **Federata Ndërkombëtare e Asociacioneve të Shpeditërëve – FIATA**

Federata Ndërkombëtare e Asociacioneve të Shpeditërëve – FIATA është themeluar në vitin 1923 në Vjenë, Austri, nga ana e 16 organizatave kombëtare shpeditere, për shkak të promovimit të interesave të përbashkëta ekonomike dhe profesionale dhe për shkak të vënies dhe përmirësimit të standardeve në sektor.

Sot, FIATA është organizata më e madhe joqeveritare, joprofitabile në fushën e punës së shpeditërëve me ndikim të madh në këtë sektor në të gjithë botën.

Kjo shoqatë sot përfshin afër 40.000 ndërmarrje shpeditere dhe logjistike, të cilat quhen edhe si “arkitekt të transportit”, e ku janë punësuar më shumë se 10 milionë persona në mbi 150 vende të botës.

Në nenin 2 të statusit të kësaj organizate është shënuar që qëllimi i kësaj shoqate, si organizatë joprofitabile, është të jetëmbulues i asociacioneve kombëtare shpeditere, t'i mbrojë, promovojë dhe koordinojë interesat e tyre dhe të sektorit në plan ndërkombëtar veçanërisht në kuadër të: ruajtjes së kontakteve me organizatat dhe asociacionet kombëtare dhe mbikombëtare transportuese dhe komerciale; pjesëmarrje në punën e asociacioneve të tilla, federative, grupimeve ose filialet që punojnë në sferën e interesit të FIATA, si anëtare e tyre ose në formë tjetër të bashkëpunimit; rol aktiv në përcaktimin e

rregulativës ndërkombëtare afariste; promovim i imazhit dhe pranimi të industrisë shpeditere në raportet publike; botim i publikimeve dhe literaturë profesionale; zbatimin e trajnimeve dhe seminareve; promovimi i solidaritetit dhe real konkurrencës si shkëmbim i përvojave; zgjidhja e pyetjeve të përgjithshme dhe specifike nga lëmia e transportit.

Qëllimet kryesore të kësaj shoqate janë:

- Ta bashkojë industrinë shpeditere në të gjithë botën.
- T'i paraqesë, promovojë dhe mbrojë interesat e industrisë nëpërmjet pjesëmarrjes së këshilltarëve dhe ekspertëve në mbledhjet objektive ndërkombëtare, që merren me pyetjet e transportit.
- T'i njohë tregtarët gjerësisht, ekonominë dhe publikun me shërbimet, të cilat i ofrojnë shpediterët ndërkombëtarë nëpërmjet informacioneve, shpërndarjen e publikimeve etj.
- Ta përmirësojë kualitetin e shërbimeve, të cilat i ofrojnë shpediterët nëpërmjet zhvillimit dhe promovimit të dokumenteve shpeditere të unifikuara, kushtet standarde për tregti etj.
- Të asistojë gjatë zbatimit të trajnimit të shpediterëve, problemeve me sigurimin, transferit elektronik të të dhënave etj.

Trupa në kuadër të kësaj Federatë, nëpërmjet të cilës kryhen aktivitetet, janë: Kuvendi i Përgjithshëm, Këshilli Drejtues, Kryesia dhe grupet këshilluese dhe punuese. Kuvendi i Përgjithshëm vendos për pyetjet më kryesore, të cilat janë të lidhura me këtë shoqatë dhe i zgjedh organet tjera.

Në të janë të përfshirë të gjithë anëtarët e Federatës dhe mbledhet njëherë në vit, në Kongresin e FIATA.

Këtë shoqatë e udhëheqin Këshilli Drejtues, Sekretaria dhe Kryetari, të cilët i zgjedh Kuvendi i Përgjithshëm, para të cilit edhe përgjigjen. Institutet në kuadër të FIATA merren me pyetjet teknike, të cilat kanë të bëjnë me fusha të caktuara. Aktivitetet në institucionet bëhen nëpërmjet grupeve punuese, që takohen sipas nevojave dhe përgjigjen para institutit përkatës. Ekzistojnë tri institute në kuadër të Federatës Ndërkombëtare të Shpediterëve, edhe atë:

- Instituti i Avio Shpedicionit
- Instituti për Pyetje nga Dogana
- Instituti për Transport Multimodal

Për pyetjet, të cilat kanë të bëjnë me industrinë e përgjithshme të shpediterëve, ekzistojnë disa trupa këshilldhënëse, të cilët bashkëpunojnë me institutet dhe grupet e tyre punuese.



Këto trupa janë:

- Trupi këshilldhënës për materie të rrezikshme.
- Trupi këshilldhënës për informacione dhe teknologji;
- Trupi këshilldhënës për pyetje ligjore;
- Trupi këshilldhënës për trajnime profesionale dhe perfeksionizëm;
- Trupi këshilldhënës për marrëdhënie me publikun.

Për shkak të realizimit efikas të interesave rajonale, përparim në bashkëpunim dhe bashkim i aktiviteteve rajonale, si dhe zgjidhjen e problemeve rajonale, FIATA i ndan asociacionet shpeditore kombëtare në 4 rajone më të mëdha edhe atë; Evropë, Amerikë, Afrika dhe Lindja e Mesme, Azia dhe Pacifiku.

Anëtarë të Federatës Ndërkombëtare të Shpeditereve, të cilët do të kontribuojnë në realizimin e qëllimeve të saj në pajtim me statusin mund të jenë:

- Shoqatat Nacionale Shpeditere, të cilat e paraqesin tërë sektorin shpeditër të vendit. Kanë të drejtë ta përdorin logon e FIATA dhe kanë të drejtë ekskluzive të japin dokumente FIATA anëtarëve të tyre në vend. Në raste të veçanta, nëse një vend nuk ka shoqatë kombëtare shpeditere, statusin e tillë mund t'ia japin ndonjë anëtareje individuale derisa të formohet shoqata nacionale.
- Anëtarët grupor, paraqesin organizatat shpeditere ndërkombëtare prej një grup vendesh, grupe shpeditere ndërkombëtarë, të cilët paraqesin interesa të njëjta ose të ngjashme para FIATA, si dhe asociacione ndërkombëtare, anëtarët e të cilës janë aktiv në nënsektorët e industrisë shpeditere.
- Anëtarë individual, mund të jenë ndërmarrjet shpeditere dhe trupat ligjore, që janë në lidhje të ngushtë me sektorin shpeditër. Anëtarësimi i tyre është i mundur vetëm me leje të shkruar nga Shoqata Shpeditere Ndërkombëtare.
- Anëtarë të nderit, persona që kanë meritë të posaçme në përparimin e punës së shpeditereve dhe të FIATA. Këta anëtarë nuk kanë të drejtën e votës dhe nuk kanë të drejta tjera zgjedhore.

Vendimin për pranim ose përjashtim të anëtarëve në kuadër të kësaj shoqate e mban Kuvendi i Përgjithshëm, në bazë të kërkesës së kryesisë.

### **Dhënia e FIATA dokumenteve**

Një nga qëllimet kryesore të FIATA është dhënia e dokumenteve të standardizuara, me të cilat do të mundësohet manipulim më i thjeshtë, më i sigurtë dhe më racional me mallin në tregtinë ndërkombëtare. Vërtetimet shpeditere janë lloje të posaçme dokumentesh, të cilat janë të lëshuara nga FIATA dhe të cilat mund të përdoren në të gjithë botën.

Veçanërisht janë praktike kur organizohet xhiro e përbashkët e mallit dhe kur shpediteri nuk mund t'i prezentojë komitetit dokument të veçantë transportues, sepse disponon vetëm me një dokument për të gjithë dërgesën në vagon, në të cilën ka dërgesa nga më shumë dërgues dhe pranues. Vendi vendos vetë nëse do t'i përdorë vërtetimet e FIATA.

Vërtetimet shpeditere kanë formë saktësisht të caktuar me rubrika të vërtetuara. Në ato është shenja e FIATA dhe shenja e Shoqatës Shpeditere Nacionale. Të gjitha vërtetimet e kanë numrin rrjedhës dhe mbahet listë e veçantë kur, kujt dhe për çka është dhënë.

Në suaza të Federatës Ndërkombëtare të Asociacioneve Shpeditere janë dhënë më shumë lloje të dokumenteve dhe formulareve, të dhëna në tabelën më poshtë.

tabela: Dokumentet e FIATA:

1955	<b>FCR</b>	Forwarders Certificate of Receipt	Vërtetim shpediter për pranim	jeshil
1959	<b>FCT</b>	Forwarders Certificate of Transport	Vërtetim shpediter për transport	verdhë
1975	<b>FWR</b>	FIATA Warehouse Receipt	Vërtetim magazinimi	Portokall
1970	<b>FBL<sup>3</sup></b>	negotiable FIATA Multimodal Transport Bill of Lading	Fletëngarkesë bartëse për transport multimodal	I kaltër
1996	<b>FWB</b>	non-negotiable FIATA Multimodal Transport Waybill	Fletëngarkesë jobartëse për transport multimodal	bardh/ jeshil
1984	<b>FFI</b>	FIATA Forwarding Instructions	Instruksione shpeditere	bardha
1984	<b>SDT</b>	Shippers Declaration for the Transport of Dangerous Goods	Deklarata e dërguesit për transport të materieve të rrezikshme	bardh/ kuq
1997	<b>SIC</b>	Shippers Intermodal Weight Certificate	Vërtetim intermodal e dërguesit për peshën	bardh/ jeshil

Sipas rregullave të Rregullores për dhënien e dokumenteve në kuadër të Federatës Ndërkombëtare të Shpeditereve, autorizim për kontroll, shtypje dhe distribuim të dokumenteve FIATA kanë ekskluzivisht organizatat nacionale anëtare në këtë federatë.

Teksti i dokumenteve duhet të jetë në gjuhën angleze, franceze ose gjermane, ndërsa, nëse duhet patjetër si shtesë një nga këto gjuhë, mund të shtohet edhe tekst në gjuhën e shoqatës nacionale.

Në dokument duhet të qëndrojë shenja e vendit nga i cili vjen dokumenti, sipas shifrës për vendin e dhënë nga ana e Kombeve të Bashkuara (p.sh. për Austrinë – AT, për Japoninë JP, për Maqedoninë MK etj.).

<sup>3</sup> 1992–shtesë e FBL–multimodal në vend të transport i kombinuar (kaltër)

I nevojshëm është numri serik për të gjitha dokumentet, përveç formularëve SDT- SIC dhe FFI. Dokumentet mund të jepen nga ana e shoqatave kombëtare vetëm me lejim paraprak nga Sekretaria e FIATA.

Për shkak të kontrollës së shtypjes së këtyre dokumenteve, shoqatat kombëtare duhet të kenë regjistër të firmave anëtare, të cilat kanë pranuar dokumentin, ku janë shënuar numrat serik.

### **Përfundim**

Organizata Ndërkombëtare Shpeditere dhe Transportuese mund të formojë organizatat e specializuara kombëtare ose ndërmarrjet e kualifikuara, të cilat merren me shpedicion, logjistikë, transport ose përfaqësim në doganë, për shkak të interesave të përbashkëta ekonomike dhe ligjore.

Në suaza të këtyre shoqatave të specializuara zgjidhen disa pyetje të përbashkëta të caktuara nga lëmia e shpedicionit, logjistikës, transportit, tregtisë, doganës etj.

Si organizata më të rëndësishme shpeditere dhe transportuese, të cilat i rregullojnë raportet në mes subjekteve të kyçura në xhiron ndërkombëtare të mallit mund të ndahen:

Federate Ndërkombëtare e Asociacioneve Shpeditere – FIATA, Federata Ndërkombëtare e Menaxherëve Ndërkombëtarë, Organizata Botërore Shpeditere WFO, Asociacioni Ndërkombëtar për Transport Ajror - IATA, Unioni Ndërkombëtar për Transport Rrugor – IRU, Unioni Ndërkombëtar i Hekurudhave –UIC; Organizata Ndërkombëtare Detare – IMO; Asociacioni Evropian për Shërbime Shpeditere, Transportuese, Logjistike dhe Shërbime Doganore - CLECAT etj.

### **Literatura**

1. Stojanoski J., Trajkov A., Megjunarodna Shpedicija, FTG Ohër, 2008
2. FIATA Doc. 10/114
3. UNCTAD, Negotiations on Transport and Logistic Services: Issues to consider, UNCTAD/SDTE/TLB/2005/3, Geneva, 2006
4. Miladinovski S., Smiljkovski I., “Megjunaroden transport i Megjunarodno Osiguruvanje”, FTG, Ohër, 2006
5. Andrijanic I., Arzek Z., Prebezac D., Zelenika D., “Transportno i speditersko poslovanje”, Mikrorad DOO и Ekonomski fakultet, Zagreb, 2001
6. Arzek Z., “Transport i osiguranje”, Mikrorad DOO и Ekonomski fakultet, Zagreb, 1995

### **Internet**

1. <http://www.atag.org/>
2. <http://www.bifa.org/>
3. <http://www.ciffa.com/>
4. <http://www.fiata.com/>
5. <http://www.freightnet.com/>

6. <http://www.imo.org/>
7. <http://www.mifa.org.mk/>
8. <http://www.mz.com.mk/>
9. <http://www.otif.org/>
10. <http://www.uncitral.org/>
11. <http://www.iata.org/>
12. <http://www.clecat.org/>

# **Kapitulli III**

Turizëm dhe Hoteleri



**MSc. Eleina Qirici, Ph. D Student**

**MSc. Mamica Nene, Ph. D Student**

## **NDIKIMET E KRIZËS NË ZHVILLIMIN TURISTIK TË ZONAVE RURALE**

### ***Abstrakt***

Zonat rurale kanë shumë potenciale që duhet të menaxhohen sistematikisht, që të jenë një rast real për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe social. Edhe sikur tregu i “turizmit në rënie” nuk konkretizohet, thonë ekspertët, shumica e destinacioneve duhet të përballojnë të ardhurat e ulëta, duke siguruar që rajoni të zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme.

Në qoftë se recesioni bën që bizneset turistike të pushojnë punonjës, megjithatë, këto dhe industritë e tjera nuk pëlqejnë të sigurojnë mundësi punësimit shtesë, për shkak të rënies së kërkesës globale për artikuj të përdorimit të përditshëm.

Megjithëse origjina e krizës globale është e njëjtë, ndikimi i saj varion midis vendeve, pasi natyra e problemeve dhe masat që merren për zgjidhjen e krizës variojnë.

Kriza financiare, e cila po ndikon në ekonominë reale të vendeve të zhvilluara, por edhe në zhvillim, është një ngjarje që po diskutohet prej kohësh edhe në Shqipëri. Situata e krizës globale do të ndikojë në ekonominë rurale në përgjithësi dhe në tregun e turistëve në veçanti.

Çdo rajon ka nevojë për një analizë të kujdesshme të komponentëve për zhvillimin e turizmit për të përcaktuar nëse ka mundësi për zhvillimin e rajonit dhe se atraksionet e tij ndihmojnë në kryerjen e aktiviteteve turistike.

Sipas parashikimeve të Fondit Monetar Ndërkombëtar, recesioni do të vazhdojë edhe në vitin 2009, kështu që kjo do të ketë probleme edhe për Shqipërinë, sepse ajo lidhet me tregjet e vendeve evropiane dhe aziatike, të cilat kanë problem nga kriza.

Fjalët kyçe: ndikim, krizë financiare, zona rurale, të ardhura, remitanca.

### **Ndikimet në turizëm**

Mbi bazën e analizave të publikuara nga WTO ( Tourism Highlights, 2008 Edition), në 15 vitet e fundit fluksi i turistëve ndërkombëtarë, në termat e mbërritjeve në destinacione, është rritur me një rritje vjetore mesatare prej 5 për qind, duke demonstruar që turizmi është një nga sektorët më fitimprurës të ekonomisë dhe në Evropë përfaqëson 58 për qind të turizmit botëror.

Por, turizmi si një formë e aktivitetit human ka ndikime të forta. Këto ndikime janë shumë të dukshme në rajonet turistike, ku turistët janë të lidhur me mjedisin lokal, kulturën dhe shoqërinë.

Ndikimet e turizmit nuk mund të kategorizohen lehtë si sociale, mjedisore apo ekonomike, por tentojnë të kenë dimensione të ndërlidhura. Ndikimet e turizmit ndryshojnë sipas kohës që një destinacion zhvillohet (Butler, 1980).

Sipas Wall (1997), faktotët kryesorë që kontribuojnë në natyrën e ndikimeve janë tipi i aktiviteve turistike, karakteristikat e komunitetit pritës në destinacion dhe natyra e lidhjeve midis banorëve dhe turistëve. Faktorët kryesorë që ndikojnë në turizëm janë:

- Ku është i vendosur turizmi? (zonë rurale/ urbane, vend i zhvilluar? në zhvillim)
- Si është shkalla e zhvillimit të turizmit? (sa turistë janë përfshirë)
- Kush janë turistët? (kush është origjina e tyre? Janë turistë ndërkombëtarë apo të huaj?)
- Çfarë infrastrukture ekziston për turizmin? (rrugët, sistemi i kanalizimeve etj.).

Zonat rurale kanë shumë potenciale që duhet të menaxhohen sistematikisht, në mënyrë që të jenë një rast real për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe social.

Me fjalë të tjera, sukcesi i aktiviteve që lidhet me turizmin rural është i lidhur me kontekstin (karakteristika ekonomike, sociale, kulturore, mjedisore, historike – arkitekturore të zonës) e aftësisë organizative dhe produktive të territorit si një i tërë dhe firmave të veçanta, që përbëjnë ofertën lokale.

Është e nevojshme të ngrihen një sërë procesesh të riorganizimit lokal, që do të krijojnë kushtet për të realizuar një integrim të plotë midis nivelit kolektiv (i gjithë territori) dhe nivel biznesi (komponentë të veçantë të ofertës).

Industria turistike mbart potencial për vendet e varfëra, që të përmirësojnë jetët e banorëve të tyre, por në qoftë se turizmi ka përgjegjësi dhe nuk është në harmoni me mjedisin, ai mund të çojë në një zhvillim të pakontrolluar, degradim mjedisor dhe ndotje.

Turizmi, duke pasur karakter të cënueshëm, krizat e çdo natyre dhe çdo niveli kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, prodhon ndikime negative mbi tregun turistik.

Kriza globale do të ndikojë mbi ekonominë tonë, qoftë tregtare, financiare, bankare. Kjo përkthehet në një ulje të kërkesës për mallra dhe shërbime. Edhe sikur tregu i “turizmit në rënie” nuk konkretizohet, thonë ekspertët, shumica e destinacioneve duhet të përballojnë të ardhurat e ulëta, duke siguruar që rajoni të zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme.

Në qoftë se recesioni bën që bizneset turistike të pushojnë punonjës, megjithatë, këto dhe industritë e tjera nuk u pëlqejnë të sigurojnë mundësi punësimi shtesë, për shkak të rënies së kërkesës globale për artikuj të përdorimit të përditshëm.



Megjithëse origjina e krizës globale është e njëjtë, ndikimi i saj varion midis vendeve, pasi natyra e problemeve dhe masat që merren për zgjidhjen e krizës variojnë.

### **Si ndikon kriza në rajon?**

Në fillim të 2008, autoritetet shqiptare vendosen të mbështetnin turizmin si një levë strategjike për zhvillimin e vendit, duke u bazuar në mbështetjen financiare nga Organizata Botërore e Turizmit.

Politika e Shqipërisë mbi turizmin synon që të bëjë më të mirën në mjedisin, traditat rurale, veçanërisht në turizmin malor dhe turizmin kulturor. Hulumtimet tregojnë se faktori kryesor që shtyn shumicën e fermerëve të ndërmarrin aktivitete-biznesi janë nevojat ekonomike.

Sot ka një tendencë për pushime në zonat rurale, duke i bërë më aktive pushimet, e duke i lidhur me aktivitetet kulturore, pushuese dhe sportive. Por, ka edhe ndikime negative, që duhet të minimizohen nëpërmjet një planifikimi të kujdesshëm të turizmit rural.

Ekonomia shqiptare ka pasur rritje të kënaqshme gjatë dekadës së fundit, e regjistruar me një mesatare prej 5-6 për qind rritje në GDP. Por, si shumë vende të tjera në zhvillim, rritja ekonomike ka qenë e lidhur me nivelet e larta të deficitit, që janë financuar nga remitancat dhe investimet e huaja direkte.

Megjithatë, performanca e ekonomisë në tremujorin e fundit të 2008 dhe në muajt e parë të 2009, tregoi një ndikim të krizës financiare globale mbi ekonominë e vendit. Efekti i krizës financiare është shumë real, por shumë i ndryshëm në vende të ndryshme.

Por, Shqipëria dhe ekonomia e saj apo ndikohen nga kjo krizë e përgjithshme financiare? Dhënia e përgjigjes negative do të ishte një miopi ekonomike, sepse pavarësisht se jemi një vend i vogël dhe i paintegruar në ekonominë globale, kjo nuk do të thotë aspak se jemi jashtë kësaj krize.

Vendi ynë është i lidhur me tregjet e shumë vendeve evropiane dhe aziatike, që po tronditen nga kriza financiare dhe ekonomike.

Nga këto vende Shqipëria furnizohet me të gjitha llojet e ushqimeve, veshmbathjeve, pajisjeve shtëpiake, pajisje teknologjike dhe informative dhe çdo gjë tjetër.

Prandaj, ndikimet e krizës financiare nga vendet që furnizohet tregu shqiptar ndikojnë direkt edhe në çmimet e tregjeve tona.

Sa herë që ka lindur kriza e çmimeve të karburantëve në vendet e tjera, në Shqipëri ndikimi i rritjes së çmimeve të karburantit ka qenë shumë më e madhe se në ato vende. Nga ana tjetër, zonat rurale sigurojnë të ardhura të pakta dhe rritja e çmimeve ndikon shumë fort në ekonominë e zonave rurale.

Por, një problem që e trondit ekonominë shqiptare dhe veçanërisht ekonominë e zonave rurale është problemi i emigrantëve, që punojnë në Perëndim, veçanërisht në Itali, Greqi, Gjermani dhe Angli.

Emigrantët janë të parët që ndiejnë goditjet e krizës financiare. Tronditjet do të shkaktohen në tregun e punës, do të kenë si rrjedhojë një krizë të thellë sociale, me përplasje ndërjet vendasve dhe të huajve.

Kjo, sepse emigrantët janë krahu i punës më i ekspozuar ndaj zhvillimeve negative dhe vështirësitë e tyre ekonomike do të reflektohen në rënien e dërgesave pranë familjeve të tyre. Sipas studimeve, nënkuptohet që ky vit do të shënojë edhe një rënie të të ardhurave në vendin tonë, kur dihet se një pjesë e tyre sigurohet nëpërmjet fitimeve të emigrantëve.

Kjo situatë do të rëndojë edhe në zhvillimin e zonave rurale të rajonit tonë, sepse dihet që Korça është afër kufirit me Greqinë dhe një pjesë e konsiderueshme e popullsisë së aftë për punë punon në emigracion.

Një pjesë e konsiderueshme në zonën rurale të Korçës janë emigrantë, kështu që kjo do të ndikojë në uljen e të ardhurave në familjet rurale, sepse rreth 40 për qind e të ardhurave vijnë nga remitancat e emigrantëve.

Ekspertët e Bankës së Shqipërisë kanë evidentuar se nga të ardhurat e emigrantëve përfitojnë 189.736 familje, apo 26 për qind e familjeve në territorin shqiptar. Por, në këto situata të vështira, vihet re se 33.9 për qind e remitancave shkojnë për investime në destinacione dhe ulja e remitancave në kushtet e krizës globale sjell ulje të investimeve në vetë zonat rurale.

Patjetër që pasojat e krizës do të jenë kritike edhe për vendin tonë, sepse ne jemi një vend me të ardhura të ulta dhe do të jenë të vështira masat, që do të merren për t'i bërë ballë krizës. Një pjesë e konsiderueshme e popullsisë shqiptare do të bjerë sërish në nivelin e varfërisë, për shkak të kësaj krize dhe aq më tepër popullsia rurale që pret turistë.

Varësia e Shqipërisë nga lidhjet ekonomike me vendet fqinj Itali dhe Greqi vlerësohet si një nga problemet e vendit tonë sot.

Shqipëria është vendi me lidhje më të forta ekonomike me Bashkimin Evropian nga vendet e tjera të rajonit dhe partnerët tanë tregtarë janë të goditur nga kriza. Sipas parashikimeve të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), remitancat priten të ulen nga 11.5 për qind në 9.5 për qind, gjë që mund të jenë afërsisht 200 milionë euro më pak për konsumatorët shqiptarë.

Kështu, viti 2009 do të jetë një vit i vështirë për konsumatorët shqiptarë, për bizneset në investimet e tyre, për sistemin e kredive dhe të një sërë faktorëve të tjerë ekonomikë. Përfaqësues të Bankës Botërore sugjerojnë forcimin e politikave të duhura fiskale dhe mbështetje më të madhe buxhetore ndaj shtresave të varfra.

Në këto kushte, vështirësitë e zhvillimit të zonave rurale janë evidente, sepse vihet re:

- Rënie e dërgesave nga emigrantët, gjë që do të vështirësonte kryerjen e investimeve të nisura në këto zona nga investues privatë, anëtarë të komunitetit.
- Vështirësi në shitjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale, si pasojë e tkurrjes së tregjeve, rënies së eksporteve në përgjithësi dhe rënies së fuqisë blerëse.
- Tkurrje e marrjeve të kredive për ndërtime në fshat, veçanërisht për të rregulluar shtëpitë që do presin turistë.

Në zonat rurale, ekonomia është e varur zakonisht nga burimet natyrore, kurse turizmi rural merr forma të ndryshme, kështu që është e vështirë të japim një përcaktim ekstrakt.

Duke u mbështetur në studime, zhvillimi rural përcaktohet si një proces që drejton një rritje të kapacitetit të popullsisë rurale për të kontrolluar investimet e tyre, nëpërmjet një përdorimi të gjerë të përfitimeve, që siguron një kontroll i tillë.

Zhvillimi rural ndikohet nga shumë faktorë, duke përfshirë zhvillimin ekonomik, vlerat sociale dhe njohuritë.

Kështu, zhvillimi i qëndrueshëm shihet si një rrugë që rrit standartet e jetesës, që i lejon njerëzit të përfshijnë potencialin e tyre human, të kënaqen dhe të sigurojnë mirëqenie për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm.

Çdo rajon ka nevojë për një analizë të kujdesshme të komponentëve për zhvillimin e turizmit për të përcaktuar nëse ka mundësi për zhvillimin e rajonit dhe se atraksionet e tij ndihmojnë në kryerjen e aktiviteteve turistike.

Të shohim një panoramë të arritjeve të turistëve për vitet 2006-2008, ku rritja vjetore vazhdonte që prej 2006:

**Tab 1: Mbërritjet e turistëve**

Shqipëria	2006	2007	2008
Mbërritjet e turistëve	926 056	1098 765	1330138

Në 2008, 71 për qind e

mbërritjeve vijnë në rajon nga toka, 15 për qind nga ajri dhe 14 për qind nga deti.

Turizmi dhe sektorët e përfshirë do të gjenerojnë çdo vit 5.8 milionë vende pune në botë, 270 000 në Evropë dhe 3000 në Shqipëri.

Sot ka një tendencë për pushime në zonat rurale, me pushime aktive, duke i lidhur me aktivitetet kulturore, argëtuese dhe sportive. Por, ka edhe ndikime negative që duhet të minimizohen nëpërmjet një planifikimi të kujdesshëm të turizmit rural.

Turizmi sjell përfitime si në punësim, transformimin e bujqësisë, por zhvillimi i turizmit në zonat rurale ka qenë i ulët dhe ritmi i kthimit ekonomik në komunitete gjithashtu ka qenë i ulët:

- Disa prej faciliteteve si hotele i përkasin investitorëve nga qytetet, të cilët marrin shumicën e fitimeve;
- Të ardhurat në formën e taksave nuk shkojnë direkt në komunitetin rural, por kthehen në qeverinë vendore;
- Mundësitë e punësimit për popullsinë lokale janë të kufizuara.

### **Zhvillimi i zonave rurale në rajonin e Korçës dhe ndikimi i krizës**

Rajoni i Korçës shtrihet në juglindje të Shqipërisë me një sipërfaqe prej 3697 km katror. Afërsisht 58 për qind e sipërfaqes së qarkut përbëhet nga zona malore, 17 për qind nga zona kodrinore dhe vetëm 25 për qind nga zona fushore.

Turizmi në Korçë shihet si një degë plotësuese e ekonomisë, por që mund të sjellë të ardhura të konsiderueshme në qoftë se do të planifikohet me kujdes dhe do të ketë koordinim të të gjithë aktorëve të turizmit.

Fshatrat më të spikatura për zhvillimin e formave të turizmit rural janë Dardha, Voskopoja dhe Vithkuqi. Përmendim dhe fshatrat e tjerë si Boboshtica, Mborja që kanë mundësi të shfaqin forma të turizmit.

Këto zona karakterizohen nga atraktivitete të veçanta turistike me kushte për të pushuar dhe natyrë, që mund të kënaqë interesat më të mira.

Zhvillimi i turizmit në zonat rurale në Korçë përcaktohet nga atraktiviteti i tyre, varieteti i sipërfaqes së tokës, që lidhet me strukturën bujqësore, me metodat tradicionale të prodhimit bujqësor dhe ç'është më shumë me trashëgiminë kulturore.

Disa fshatra si Voskopoja, kryesisht për arsye klimatike, kanë praktikuar turizmin familjar dhe për më tepër periudha e tranzicionit ka ngritur mundësi të reja për thellimin dhe vazhdimin e kësaj tradite.

Turizmi i brendshëm dhe i jashtëm do të jetë pa dyshim një nga elementet kryesore për zhvillimin ekonomik- social të destinacionit turistik. Ai hap punë të reja veçanërisht për gratë e papuna, rrit të ardhurat e familjes dhe ulë varfërinë.

Gjithashtu, dinamika e turizmit mund të sjellë zhvillimin e degëve të tjera të ekonomisë rajonale si bujqësi, agroindustri, zeje, shërbime, ndërtim etj.

**Tab 2: Mbërritjet e turistëve në hotelet e qytetit të Korçës**

	2006	2007	2008
<b>1.KAPACITETI I HOTELEVE</b>			
Dhoma	169	175	217
Krevate	289	307	372
<b>2. MBËRRITJET E TURISTËVE</b>			
Turistë shqiptarë	8242	9450	12701
Turistë të huaj	803	642	1050
<b>3.NETË QËNDRIMI NË HOTELE</b>			
Turistë shqiptarë	8476	9933	13057
Turistë të huaj	642	1008	1422

Kjo situatë është vetëm për turistët që akomodohen në hotelet e qytetit, por ka shumë turistë që vijnë si vizitorë ditor nga qytetet e Shqipërisë, Greqia dhe Maqedonia.

Mbërritjet e turistëve në zonat rurale të Korçës janë rritur për periudhën 2006-2008, si në Voskopojë, por tani ka një rënie të mbërritjeve turistike për periudhën janar- mars.

Në 2007-2008, numri i turistëve shqiptarë ka qenë 4400-4600 dhe turistët e huaj 450-463. Në periudhën janar-mars vihet re një rënie e turistëve të brendshëm prej 10 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Përveç atraksioneve natyrore dhe pasurive biologjike, shfrytëzimi i trashëgimisë kulturore është një element i veçantë në zhvillimin e turizmit.

Kjo forcon identitetin kulturor të njerëzve nëpërmjet njohjes dhe përhapjes së objekteve historike, fetare dhe kulturore, si pjesë e kësaj trashëgimie.

Kjo do të zhvillojë edhe sektorët e tjerë, që lidhen me ruajtjen e materialeve historike dhe përhapjen e vlerave nga organizimi i vizitave turistike, festivaleve etj.

Analiza e kërkesës turistike në zonat malore bazohet tek analiza e destinacionit turistik dhe potencialeve të saj. Kjo kërkesë është studiuar në disa parametra, duke e ndarë klientelën turistike në “turistë domestikë dhe turistë të huaj”.

Kjo analizë është bërë me qëllim që të shihej kërkesa e klientelës dhe të adaptohej me ofertën turistike.

Në ditët e sotme ka një tendencë të turistëve për të lënë vendin e tyre në kërkim të një vendi të qetë, bukurive skenike, florës dhe faunës së pasur, por kur trashëgimia kulturore është e lidhur me të destinacioni bëhet më i plotë.

Tipi i turizmit, i bazuar në atraksionet natyrore, luan një rol të rëndësishëm në motivacionet e turistëve. Kështu, rreth 43 për qind e turistëve pëlqejnë vendet e bukura, florën dhe faunën, 20 për qind kënaqen me trashëgiminë kulturore apo 21 për qind me gastronominë. Por, ka edhe probleme në zonën rurale:

- Mungesa e aftësive menaxhuese: Shumica e fermerëve që përfshihen në aktivitetet turistike kanë mungesë të aftësive menaxhuese. Mungesa e aftësive është një problem, i cili zgjidhet nga stafi i qeverisjes lokale përgjegjëse për planifikimin dhe menaxhimin e turizmit.
- Marketingu: Shumica e fasiliteve të turizmit rural tentojnë të jenë të vogla dhe kjo i bën më të vështirë që të tregtohen te vizitorët potencialë.
- Infrastruktura: Pjesa më e madhe e fasiliteve rurale ka rrugë jo të mira. Mundësitë hyrëse mund të bëhen të vështira nga turmat.
- Sezoni turistik i limituar: Më shumë se qytetet, zonat rurale marrin shumicën e turistëve gjatë pikut të sezonit. Kjo kufizon numrin e ditëve në të cilën akomodimi dhe fasilitetet e tjera do të përdoren dhe ulin kthimin nga investimi.
- Kthim i varfër nga investimi: Kthimet nga kapitali i investuar në turizmin rural tentojnë të jenë të ulta dhe më të ulta se llojet e tjera të ndërmarrjeve tregtare. Në përgjithësi, fermerët këshillohen të mos investojnë në ndërtesat e reja dhe fasilite të shtrenjta.
- Mungesa e informacionit rreth çfarë duan vizitorët: Rruga më e mirë për të kuptuar dëshirat e vizitorëve është një pyetësor. Për të kuptuarit se çfarë pëlqejnë dhe nuk pëlqejnë konsumatorët e tyre do t'i ndihmojë për të zhvilluar një ndërmarrje të suksesshme.

Gjendja e mirë, kooperimi midis aktorëve të turizmit do të bëjë të mundur zhvillimin e mirëplanifikuar të turizmit të qëndrueshëm, pa probleme mjedisore. Duke përcaktuar kapacitetet e nevojshme turistike dhe menaxhuar flukset e turistëve do të jetë një zhvillim i qëndrueshëm i turizmit, tashmë një tendencë e re.

Planifikimi i kujdesshëm i turizmit në zonat rurale do të sjellë avantazhe për rritjen e mirëqenies të komunitetit.

## Rekomandime

### 1. Investime të zonave rurale:

- Vazhdimi i investimeve në zonat rurale për infrastrukturë dhe fasilite të turizmit, me qëllim që të përmirësohet jeta në këto zona.

Për shembull, do të vazhdojë investimi për infrastrukturën e fshatit Voskopojë me rreth 39 milionë lekë, me qëllim që të përmirësohen kushtet në këtë destinacion turistik dhe rruga e fshatit Dardhë me rreth 10 milionë lekë.

- Tërheqja e investimeve të huaja nga individë apo shoqata të ndryshme për investime në infrastrukturë. Të bëjë investime për të ngritur nivelin e mirëseardhjes në shtëpitë private, me qëllim që t'i aktivizojë ato për qëllime turistike.
- Me qëllim që të arrihen rezultate më të mira ekonomike, Korça duhet të investojë te njerëzit e saj për t'i edukuar dhe trajnuar ata që të përmirësojnë njohuritë e tyre.
- Përmirësimi i cilësisë së produktit turistik dhe shërbimeve që përfshijnë akomodimet e vizitorëve dhe gastronominë, për t'i bërë burime të vlefshme.
- Transformimi i shtëpive rurale në shtqpi pritëse nëpërmjet rikonstruksionit.
- Zgjidhja e shpejtë e problemeve të infrastrukturës, ujit dhe furnizimit me energji.

### 2. Për të vazhduar investimet duhen:

- Promovimi i destinacionit turistik, që konsiston në tipet e ndryshme të turizmit nëpërmjet konferencave, mbledhjeve për të tërhequr turistë të ndryshëm.

3. Përpjekjet për të zgjidhur varfërinë rurale kanë qenë të shumta, që nga zhvillimi i infrastrukturës, trajnimi dhe arsimimi, laramania e mundësive të jetës (përpjekje për t'u mësuar njerëzve aftësi të reja me shpresën që kjo do të sigurojë më shumë punësim dhe të ardhura), dhe turizmi rural.

4. Mbajtja e rolit tradicional të bujqësisë në fshat është esenciale. Duke ruajtur karakterin tradicional të zonave rurale përfiton mjedisi.

5. Qeveria duhet të ndihmojë zonat rurale me kredi për banorët e këtyre zonave dhe me ligje për rritjen e shpenzimeve publike dhe investimeve në bujqësi.

Ne duhet të investojmë në skema të vogla bujqësore, që ndjekin praktikatat tradicionale, investojnë në njerëzit dhe mjedisin që i mbështet ata dhe i ofron.

Të gjitha eksperiencat dhe kompetencat duhet të mblidhen në një sistem si projekt, me qëllim që të zbatohet një zhvillim i ri lokal i bazuar në turizëm të qëndrueshëm.

**Referenca:**

1. Tourism planning, basics, concepts, cases, Clare Gunn, (2002)
2. Sustainable tourism, David Weaver (2006)
3. Sustainable tourism: A global perspective, Rob Harris, Tony Griffin, Peter Williams, (2002)
4. Local environmental action planning, Municipality of Korça
5. Të dhëna nga Ministria e Turizmit (2008)



**MSc. Esmeralda Shkira, Ph.D student**

**MSc. Oriola Theodhori, Ph.D student**

## **MENAXHIMI I SEKTORIT TURISTIK NE SHQIPËRI PËR TË MINIMIZUAR EFEKTET NEGATIVE TË RECESIONIT**

### **Hyrje**

Ekonomia botërore njohu një nga krizat më të thella financiare sidomos gjatë pjesës të parë të vitit 2008. Ekonomia e vendeve më të zhvilluara ndodhen tashmë në recesion.

Ekonomia botërore po pëson rënie shumë të shpejta, ndërkohë që ekonomitë në zhvillim po përballen me një rritje shumë të ulët. Rezultati në vendet e zhvilluara pritet të bjerë në masën 0.5 për qind në gjysmën e dytë të vitit 2009.

Rritja e ekonomive në tranzicion llogaritet me një rënie prej 4.8 për qind për 2009. Vendet e zhvilluara kanë hyrë në një recesion të thellë gjatë 2009, dhe nga ana tjetër vendet në zhvillim do të kenë mjaft të vështirë për të menaxhuar situatën në termat e reduktimit të varfërisë dhe për të ruajtur stabilitetin politik dhe social.

Për t'i shpëtuar riskut të një recesionit të thellë dhe global do të ishte mirë zbatimi i një pakete stimuluese fiskale ndërkombëtare të koordinuar, e cila të jetë koherente dhe në përputhje me qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

Pasiguria ekonomike, inflacioni tek udhëtimet, kurset e shkëmbimit, do të ndryshojnë zgjedhjet në lidhjet me destinacionet turistike dhe mund të shkaktojnë shtyrje të vendimeve për udhëtime të brendshme dhe të jashtme. Edhe turizmi botëror është prekur nga recesioni.

Mirëqenia e turizmit varet shumë nga mirëqenia e ekonomisë botërore dhe anasjelltas. Nivelet e larta të recesionit global po shfaqen dukshëm dhe po ndikojnë në paraqitjen ekonomike të turizmit.

*Fjalët kyçe: recesion, strategjitë në turizëm.*

### **Turizmi botëror përballë recesionit**

Industria e turizmit duhet të përballlet me efektet e recesionit. Recesioni mund të vazhdojë edhe në gjashtëmujorin e dytë të 2009. Mbërritjet turistike ndërkombëtare arritën në 924 milionë në vitin 2008, me një rritje prej 2 për qind në krahasim me 2007.

Sipas WTO, gjysma e parë e vitit tregon rezultate të mira, por numri i mbërritjeve ndërkombëtare po ulët ngadalë dhe turizmi ndërkombëtar mund të qëndrojë stabil ose të bjerë pak në sezonin turistik 2009. Viti 2009 mund të sjellë lajme të mira në tri përballje kritike të udhëtimit:

1. Ekonomia mund të përmirësohet.
2. Çmimet e naftës kanë pësuar rënie.
3. Dollari po forcohet përkundrejt monedhave të tjera (veçanërisht ndaj monedhave të destinacioneve turistike jashtë).

Amerika dhe Evropa do të jenë zonat më të prekura në termat e të gjitha rezultateve të turizmit, përderisa pjesa më e madhe e tregjeve të tyre aktualisht ndodhen apo po hyjnë në recesion.

Në Azi dhe Paqësor rezultatet priten të jenë pozitive, megjithëse rritja do të vazhdojë të jetë shumë e ulët krahasuar me paraqitjen e këtij rajoni në vitet e mëparshme (të njëjtën gjë mund të themi për Afrikën dhe Lindjen e Mesme).

Të dhënat tregojnë se ekziston një shkallë e lartë pasigurie rreth parashikimeve të 2009 dhe gjithçka do të varet nga evoluimi i kushteve ekonomike.


Nëse ekonomia botërore fillon të tregojë shenja të një rigjenerimi të shpejtë, turizmi ndërkombëtar mund të rritet ngadalë në 2009, por në qoftë se ekonomia do të keqësohet më shumë, parashikimet aktuale duhet të korrigjohen në të kundërtën.

T'i referohemi tabelës të mëposhtme.

Parashikimi i mbërritjeve turistike ndërkombëtare (në milion) në mbarë botën dhe sipas rajoneve për vitet 1995-2020.

Rajonet	Mbërritjet turistike (në milion)			
	1995	2000	2010	2020
Evropa	335	390	527	717
Azia Lindore dhe Paqësori	80	116	231	438
Amerika	111	134	195	284
Afrika	20	27	46	75
Lindja e Mesme	14	19	37	69
Azia Jugore	4	6	11	19
<b>Bota</b>	<b>564</b>	<b>692</b>	<b>1,047</b>	<b>1,602</b>

Rajoni	Matjet për vitin 2008	Parashikimi për 2009
<b>Bota</b>	2-3 për qind	0-2 për qind
<b>Evropa</b>	1-2 për qind	0-2 për qind
<b>Azia and Paqësori</b>	2-3 për qind	0-2 për qind
<b>Amerika</b>	4-5 për qind	1-3 për qind
<b>Afrika</b>	3-5 për qind....?	2-6 për qind...?
<b>Lindja e mesme</b>	9-15 për qind	3-8 për qind...?



Burimi: Organizata Botërore e Turizmit e Kombeve të Bashkuara (UNËTO)

#### Ndikimet e recesionit në turizëm:

- Shpenzimet konsumatore në përgjithësi po limitohen (ose reduktohen) më shpejt sesa rezultati ekonomik.
- Shpenzimet turistike si pjesë të shpenzimeve të konsumatorëve priten të pakësohen (ose bien) edhe më shumë se shpenzimet mesatare.
- Reduktimi i mirëqenies në njëzërit, ulja e nivelit të të ardhurave, rritja e papunësisë dhe rënia e besimit konsumator mund të sjellë influenca të fuqishme mbi shpenzimet turistike.
- Shpenzimet turistike botërore po ngadalësohen dhe në bazë të aplikimit të koeficientit të shpenzimeve turistike në ekonominë perëndimore mund të tkurren edhe në termat e dollarit.
- Rënia e çmimit të naftës është zhvendosur pjesërisht, por kjo rënie është reflektim dhe e ndikuar nga ulja në kërkesën agregate.

- Shenjat e hershme të kthimit të një kërkese turistike mund të shfaqen në statistikat e numrit të vizitorëve të brendshëm në shtator 2008. Udhëtarët ndërkombëtarë janë duke reduktuar rezervimet e tyre dhe të dhënat e rezervimeve të hershme po ulen ndjeshëm krahasuar me vitet e mëparshme.


*Përcaktuesit kryesorë dhe influencat mbi aktivitetet e turizmit ndërkombëtar ndërmjet viteve 1995 dhe 2020 janë identifikuar si më poshtë:*

### **Forcat që do ndikojnë në turizm në të ardhmen:**

- Faktorët ekonomikë
- Faktorët politikë
- Vëmëndja kundrejt mjedisit social
- Faktorët teknologjikë
- Emergjencia e njohurive bazë sociale
- Ndryshimet demografike
- Ndryshimet në sistemet e vlerave
- Ndryshimi brenda një bote homogjene
- Kërkesa për stabilitet dhe siguri
- Presionet për migracion në masë
- Ndryshimi nga një shërbim te një eksperiencë ekonomike
- Vlerësimi i kohës së lirë
- Konkurrenca për kohën e lirë

### **Tendencat në Evropë**

- Rritja e turizmit në Evropë do të ndalojë gjatë muajve të verës.
- Evropa qëndroi në +2 për qind për tetë muajt e parë të 2008 (shumë poshtë nga 5 për qind, që ka qenë rritja në dy vitet e fundit).
- Kjo rënie nuk është përhapur në katër rajonet periferike të saj.
- Rritja lidhet me keqësimin e klimës ekonomike, mungesën e kredisë, fuqizimin e euros, rritja e kostos së naftës dhe rënia e fuqisë blerëse.
- Pritet që biznesi i udhëtimit dhe industria e takimeve do të jenë të parat që do ta vuajnë rënien.
- Mund të vihen në dyshim realizimi i uljes të kostove nga mbajtësit ajror.
- Për muajt e ardhshëm shihet një shpresë e vogël në rritjen e turizmit evropian.



### Shqipëria dhe recesioni

Rritja ekonomike e Shqipërisë në 2009 mund të qëndrojë ndërmjet 0 dhe 1 për qind. Ky është parashikim i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN). Shqipëria po ecën më mirë se sa ekonomitë e tjera në rajon, të cilat duhet të rigjallërohen vetë nga recesioni.

Tani është koha të bëjmë ndryshime dhe të adaptojmë politika. FMN ka sugjeruar kontroll të madh, duke ndaluar rritjen e rrogave dhe pensioneve dhe duke i mbajtur taksat në të njëjtin nivel. Viti 2009 tregon një vendosje komplekse, me një sërë sfidash përpara, jo vetëm për ekonominë reale, por edhe për politikën monetare, sektorin fiskal, sektorin e jashtëm të ekonomisë dhe sistemin financiar në vend.

Banka e Shqipërisë thekson se ekziston një risk i madh, që mund të ulë rritjen ekonomike në 2009. Biznesi shqiptar mund të jetë ende aktiv, largpamës dhe dinamik. Ekonomia shqiptare shfaq imunitet të admiruar ndaj këtyre zhvillimeve.

Në këtë kontekst puna e kujdeshme dhe sistematike e Bankës së Shqipërisë, si në termat e ruajtjes së balancës makroekonomike edhe në ruajtjen e stabilitetit financiar të sistemit bankar ka ofruar një kontribut të madh.

Në tetor të 2007, Qeveria shqiptare nxori Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) për periudhën 2007-2013. Qëllimet bazë të kësaj strategjie konsistojnë në:

1. Sigurimi i një ekonomie të qëndrueshme dhe të balancuar.
2. Zhvillimi dhe konsolidimi i një shteti demokratik.
3. Vendosja e rregullave, ligjeve dhe lufta kundër korrupsionit.
4. Integrimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian.
5. Dhënia e prioritetëve, politikave për përfshirjen e të rinjve.

Prioritetet e Ministrisë të Punës, Punëve Sociale dhe Oportuniteteve të barabarta për periudhën 2007-2013 janë ekspozuar nëpërmjet Strategjisë të Punësimit dhe Trajnimit Profesional, Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore, të cilat janë aprovuar në vitin 2007. Po kështu, edhe Strategjia Kombëtare e Migrimit, e cila është aprovuar në vitin 2004.

Objektivat kryesorë të Strategjisë së Punësimit dhe Trajnimit Profesional janë përqendruar kryesisht në promovimin e një politike aktive të punësimit nëpërmjet ndërtimit të një sistemi modern të shërbimeve të punësimit, duke përmendur këtu si objektiva themelore (objektivat 8-12):

- Zhvillimi i një politike aktive të punësimit;
- Fuqizimi i edukimit dhe trajnimit profesional, duke reduktuar në këtë mënyrë punësimin informal;
- Përmirësimi i kushteve të punës;
- Promovimi i një dialogu social.

### **Recesioni dhe sektori i turizmit në Shqipëri**

Ndonëse një destinacion jo shumë i njohur në Evropë në të kaluarën, Shqipëria tani mund të konsiderohet si një vend mjaft atraktiv me potenciale të pashfrytëzuara.

Çmimet e tokës (pronave) në Shqipëri janë 70 për qind më të ulëta se ato të vendeve të tjera të Evropës, duke përmendur këtu edhe vendet fqinje të Ballkanit si: Kroacia, Greqia apo Mali i Zi.

Në të njëjtën kohë kur shumë vende të Evropës kanë hyrë në recesion, (FMN) parashikoi një rritje prej 3.5 deri 4 për qind të GDP në Shqipëri gjatë vitit 2009.

Rritja e sektorit turistik sidomos vitet e fundit konfirmon edhe njëherë se Shqipëria është në rrugën e duhur përse i përket zhvillimit të turizmit dhe se turizmi është një gjenerator mjaft aktiv i zhvillimit të ekonomisë vendase.

Në qoftë se Shqipëria do të përdorë burimet dhe potencialet e saj në favor të turizmit atëherë zhvillimi do të pësojë një rritje më të madhe se sa ajo aktuale. Shqipëria sot zë një vend të rëndësishëm jo vetëm në aspektet apo sensin ekonomik dhe politik, por edhe si një destinacion turistik.

Le t'i referohemi tani statistikave të mëposhtme:

### Numri i turistëve që kanë vizituar Shqipërinë gjatë periudhës Janar-Gusht 2008.

Turistë/ vizitorë

Numuri total 2.089.583

Gjatë verës 2008

Totali 287.000


Vizitorët e huaj 984.083

Vizitorët ditorë 56.732

Visitorët që qëndrojnë edhe  
gjatë natës 927.351

Qëllimi i udhëtimit në përqindje  
(për qind)  
Pushime 85  
Biznes 6  
Vizitorë ditorë 6  
Të tjera 3

### Numri i turistëve të huaj në Shqipëri sipas viteve



Burimi i të dhënave: Agjencia Shqiptare e Biznesit dhe Investimeve.

Në qoftë se i referohemi statistiakve mund të themi se recesioni nuk ka pasur ndikim te sektori turistik për më tepër vihat re një rritje prej 20 për qind i numrit të turistëve të huaj për periudhën 2007-2008.

### Arsyet e kësaj rritjeje lidhen me elementet e mëposhtme:

- Recesioni në ekonominë shqiptare sipas shifrave dhe të dhënave është në fazat e para;
- Rritja i atribuohet edhe intesifikimit të përpjekjeve promovuese;
- Rritja e numrit të vizitorëve nga Maqedonia;
- Rritja e numrit të vizitorëve nga Kosova, të cilët kanë vështirësi në sigurimin e vizave për të bërë turizëm në vendet e tjera evropiane;
- Shqipëria ka potenciale turistike mjaft atraktive dhe vende të pashfrytëzuara nga vizitorët e brendshëm dhe të huaj;

Parashikimet në lidhje me numrin e turistëve të huaj për sezonin turistik 2009 tregojnë një rënie prej 10 për qind.

Kjo lidhet me një tërësi faktorësh, duke përmendur: Sektori i ndërtimit është prekur nga recesioni dhe ka rënë numri i investimeve në turizëm gjatë termujorit të parë të vitit 2009 dhe kjo rënie mendohet të vazhdojë edhe gjatë gjysmës të dytë të 2009;

Vendet fqinje janë prekur prej recesionit, duke përmendur Kosovën, që do të thotë një reduktim i numrit të turistëve nga Kosova; Vendet fqinje dhe vendet e tjera, ku ka një numr të lartë emigrantësh shqipëtarë janë prekur nga recesioni, që do të thotë përsëri një reduktim i numrit të turistëve.

### **Menaxhimi i sektorit turistik në Shqipëri**

Për të menaxhuar me efektivitet sektorin turistik, duke e konsideruar atë si një nga prioritetet bazë për zhvillimin e vendit, duhet të tregojmë një kujdes të veçantë për çështjet e mëposhtme:

- Përmbyshja e procesit të privatizimit.
- Përfshirja e Shqipërisë në nivelet e duhura në tregjet ndërkombëtare të investimeve të kapitalit.
- Ndërtimi dhe zhvillimi i një plani hapësinor për turizmin në Shqipëri.
- Një vëmendje e veçantë dhe e vazhdueshme duhet të tregohet për mbrojtjen ekologjike.
- Vendosija e standarteve dhe sigurimi i qëndrueshmërisë në afat të gjatë të potencialeve turistike.
- Edukimi dhe trajnimi i stafit të nevojshëm për menaxhimin e sektorit turistik.
- Krijimi i infrastrukturës të transportit dhe organizimi efektiv i shërbimeve të transportit.
- Ndërtimi i një oferte integrale dhe të integruar për destinacionin turistik.
- Rritja e nivelit të cilësisë së lehësisirave të akomoditeteve primare dhe sekondare dhe adaptimi i kriterëve kategorizuese, sipas standarteve ndërkombëtare të cilësisë.
- Futja e markave ndërkombëtare (zinxhirët hotelierë) në tregun shqiptar.
- Një shpërndarje më efektive dhe përdorimi i tendencave moderne të komunikimit dhe marketingut.

### **Strategjitë dhe taktikat**

1. Ndërtimi dhe ekzekutimi i një strategjie marke imponuese.
2. Zbatimi i një strategjie media të fokusuar dhe të disiplinuar.
3. Rritja e numrit të vizitorëve nëpërmjet intensifikimit të përpjekjeve të marketingut direkt.
4. Krijimi dhe thellimi i kredibilitetit nëpërmjet marrëdhënieve publike.
5. Përdorimi i strategjive të shitjeve direkte të targetuara.



6. Përdorimi i teknologjive web dhe strategjive ndërvepruese.
7. Tërheqja e vizitorëve nëpërmjet marketingut të ngjarjeve.
8. Zgjerimi dhe diversifikimi i përpjekjeve marketing.
9. Luajtja e një roli lidhësi aktiv në komunitet.
10. Ndërtimi i një programi menaxhimi financiar të qëndrueshëm.
11. Përdorimi i eksperiencës konsumatore sidomos gjatë promovimit të potencialeve turistike.
12. Intesifikimi i përpjekjeve marketing për rritjen e numurit të turistëve sidomos gjatë sezonit turistik

## Konkluzione

- Recesioni do të jetë prezent edhe në pjesën e dytë të viti 2009 në ekonominë botërore.
- Industria turistike mund të pësojë rritje të ngjalshme gjatë vitit 2010.
- Recesioni do të theksohet sidomos në gjysmën e dytë të vitit aktual në Shqipëri, ndërkohë që parashikohet një ndikim i ulët në sektorin turistik.
- Të dhënat tregojnë një rritje të booking nga ana e turistëve evropiane si rezultat i fushatës reklamuese të Shqipërisë online.
- Projektet e Qeverisë shqiptare janë fokusuar në menaxhimin e sektorit turistik, me qëllim që të reduktojnë efektet negative të recesionit.

## Literatura:

1. Flassbeck H and Spiecker F (2008). Fatale Fehlwahrnehmung. Financial Times Deutschland, 2 July.
2. IFSL (2008). Sovereign Wealth Funds. International Financial Services London, April
3. Klein MR and Makw (2008). Current quarter model of the United States. Forecast summary. Weekly update on the United States economy and financial markets. University of Pennsylvania, 30 June.
4. Krugman P (2008). A return of that 70s show? New York Times, 2 June.
5. UNCTAD (2007). Global and Regional Approaches to Trade and Finance. United Nations publication, New York and Geneva.
6. UNCTAD (2008). World Investment Report. United Nations publication, sales no. E.08.II.D.23.
7. UNCTAD (various issues). Trade and Development Report. United Nations publications, New York and Geneva. World Bank, Albania: *Labour market assessment*, Washington D.C. 2006.
9. Ministry of Labour, Social Affairs and Equal Opportunities, *Sectoral Strategy on Employment and Vocational Training (2007-2013)*, Tirana, 2007.
10. Republic of Albania, Strategy for Social Inclusion 2007-2013, November 2006.
11. Republic of Albania, Strategy for Social Inclusion 2007-2013, November 2006

Draft.



**MSc. Çiljeta Papakozma, Ph.D** Kandidate

## **NDIKIMI I RECESIONIT DHE DINAMIKA E INVESTIMEVE NË TREGJET TURISTIKE**

### **Abstrakt**

Zhvillimi i tregjeve shqiptare postkomuniste ka qenë i ngadalshëm dhe plot ngjarje. Për vite me radhë investitorët përfaqësoheshin me disa fondacione financiare, që ofronin kthim të lartë, por jo një investim të mirëfilltë. Turizmi ka të gjithë mundësitë për të stimuluar një revolucion të vërtetë ekonomik për Shqipërinë.

Kontributi i turizmit është rritur, duke siguruar një balanc pozitive për investimet e huaja në industrinë turistike dhe reflekton një imazh pozitiv për integrimin e vendit në Evropë. Industria turistike si sektorët e tjerë të ekonomisë, do të ndikohet nga kriza globale.

Në mënyrë që të mbrohet dhe të rritet ndikimi i turizmit në ekonominë tonë duhet të inkurajohet efektiviteti i menaxhimit të investimeve publike dhe private veçanërisht të investimeve të huaja.

Duke analizuar shanset, vështirësitë dhe pasojat me të cilat përballen investimet, do të përpiqem të japë një varietet strategjish, që parandalojnë efektet e recesionit në shkallën e investimeve.

Këto strategji duhet të mbështeten nga promovimi i investimeve dhe veçanërisht nga politikat fiskale dhe fasilitetet e ofruara në turizëm. Shtyllat kryesore ku mbështetet turizmi për të reduktuar riskun e recesionit janë: vizioni, ekspertiza dhe vullneti politik.

Fjalët kyçe: investime, recesion, investime publike, investime publike, promovim.

## Hyrje

Kriza aktuale është kriza më e thellë që po kalon sistemi kapitalist, që nga koha e lindjes së tij. Natyrisht që duke iu referuar historisë, mund të konstatojmë se krizat ekonomike e financiare, pavarësisht nga thellësia, kohëzgjatja apo shkalla e përhapjes kanë qenë bashkudhëtare të vazhdueshme të kapitalizmit.

Ndoshta kjo përbën dhe forcën apo "efikasitetin" e këtij sistemi. Kriza aktuale është me përmasa globale, duke mos mbetur vetëm në kornizat e një krize krediti apo financiare në përgjithësi. Natyrisht, vendet që priten të preken më shumë do të jenë vendet e varfra dhe ato me ekonomi të brishta.

Kjo krizë po prek me shpejtësi të gjithë ekonominë reale, e padyshim turizmin si sektor i rëndësishëm për ekonominë. Vështirësitë dhe problemet në këtë sektor do të lidhen ngushtë me rënien e masës së investimeve të huaja dhe atyre private, si dhe mungesën e një strategjie të mirëfilltë qeveritare.

Si duhet të promovohen dhe nxiten në këto kushte investimet në fushën e turizmit, në Shqipëri?

### **Zhvillimi i turizmit dhe ndikimi në ekonominë shqiptare**

Megjithë krizat e vazhdueshme social-ambientale të tranzicionit, Shqipëria ka ende mjaft potenciale të vlefshme për zhvillimin e një turizmi, që i siguron progres ekonomik dhe prosperitet social.

Shqipëria ka 450 km bregdet me rreth 24 zona për zhvillimin e turizmit. Gjysma e sipërfaqes të vendit tonë është zonë malore mbi 600 m mbi nivelin e detit, me 15 zona prioritare për zhvillimin e turizmit.

Shqipëria ka tre liqenj të mëdhenj e një sërë liqenj të vegjël artificialë. Ajo ka 13 Parqe Kombëtare dhe zona të ndieshme ekologjike pyjore. Vendi ka trashëgimi të pasur arkeologjike të periudhave të ndryshme, pa folur për manastire, kisha e kështjella mesjetare.

Shqipëria ka dy qytete muze dhe disa qendra të banura me cilësi të veçanta arkitektonike, pjesë të trashëgimisë botërore. Kultura shqiptare ka një larmi të pasur folklori, traditash, kostumesh popullore, punimesh artizanale. Njerëzit janë miqësorë e mikpritës, e përgjithësisht njohin gjuhët e huaja. Ajo që i ka munguar turizmit shqiptar është vizioni, ekspertiza dhe vullneti politik.

Turizmi në Shqipëri u dëmtua seriozisht, për shkak të vetë izolimit komunist. Në fillim të viteve 1990-të, edhe pse mungonte eksperiencia, u bënë përpjekje të mira për t'u orientuar nga pikëpamja institucionale drejt zhvillimeve të qëndrueshme të industrisë turistike.

Në këtë periudhë u krijuan organe në mbështetje të turizmit, u miratuan ligje dhe një sërë studimesh me orientim investimet.

Hartimi i një baze ligjore dhe shumë planeve të urbanistikës mundësoi që të ofroheshin investime serioze të huaja, të cilat vazhdojnë të ekzistojnë dhe sot.

Kjo u shoqërua me investime vendase kryesisht në bregdet dhe zona malore. Fatkeqësisht, ky hap u ndërpre gjatë vitit 1997 dhe faturën e këtyre ngjarjeve e pagoi veçanërisht sektori i turizmit.

Kjo provokoi shkatërime, pezulloi mjaft investime, për shkak të pasigurisë e humbjes së besimit. Struktura institucionale e turizmit u bë e paqëndrueshme, për shkak të pazareve politike.

Stabilizimi relativ i situatës në vend inkurajoi presionin e biznesit për investime dhe rritjen e presionit për të përsosur legjislacionin në mbështetje të turizmit.

Në disa raste kjo u shoqërua me ndërtime kaotike e mungesë të investimeve publike. Në vitet që pasuan situata u bë diçka më pozitive, por u pa si shumë e vështirë të thyhej imazhi i keq, që kishin krijuar turistët për Shqipërinë.

Situata në vend solli zhgënjimin e tyre, për shkak të mjedisit të ndotur, mungesës së infrastrukturës, kufizime të energjisë dhe ujit, mungesës së një fushate informuese për ofertat e turizmit shqiptar dhe problemet e imazhit të vendit në nivel mbarëkombëtar.

Turizmi, si sektor i ekonomisë në çdo vend, ka një peshë të konsideruar dhe në varësi të masës së zhvillimit të tij ai ndikon në rritjen ekonomike ose jo. Për Shqipërinë përlllogaritja e turizmit në ekonominë e vendit ka qenë jo shumë inkurajuese. Të ardhurat, që gjenerohen nga turizmi, zënë 600 milionë USD hyrje dhe pothuajse po kaq janë dhe daljet.

Pra, për fat të keq nuk mund të pretendojmë për një bilanc të pagesave pozitiv. Është fakt se Shqipëria promovohet në botë për potencialin e saj turistik, por gjeneron vetëm një sasi të vogël të ardhurash.

Kjo padyshim na tregon për një situatë problematike të masës së investimeve në turizëm. Duke qenë se turizmi është një pasuri kombëtare, përballë kësaj situatë kërkohen masa urgjente.

Turizmi nuk ka të bëjë vetëm me ministritë, por me një sërë institucionesh. Puna e tyre duhet parë e gërshetuar dhe me përpjekjet për të ndryshuar mentalitetet e popullsisë dhe për të aderuar vlerat e reja, që dikton shoqëria e re demokratike.

Nisur nga ajo që thamë, rekomandimi kryesor është rritja e masës së investimeve për zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm dhe harmonik. Parimi që duhet të udhëheqë është

zhvillimi i turizmit në të gjitha zonat e vendit dhe degët e tjera të ekonomisë, duke ruajtur dhe zhvilluar trashëgiminë. Kjo do të sigurojë:

- Ndryshim të imazhit në Evropë
- Hapje të vendeve të punës
- Rritjen e investimeve të huaja.

### **Vështirësia dhe problematika e nxitjes së investimeve në turizëm**

Politika turistike e ndjekur në Shqipëri ka luajtur një rol përcaktues në zhvillimin e turizmit. Deri në vitet 1990, zhvillimi i turizmit ka qënë i varur nga politika e përgjithshme e asaj periudhe.

Kjo politikë ishte penguese dhe mohuese e një turizmi të mirëfilltë në Shqipëri, siç ka ndodhur dhe në vende të tjera mesdhetare. Turimi ka qënë plotësisht monopol i shtetit dhe organizohej vetëm nga një institucion që ishte Albturizmi.

Në vitet 1995, do të investohej për të ndërtuar hotele turistike për pritjen e turistëve të huaj. Hapja e kufijve me Greqinë, Maqedoninë dhe me Malin e Zi do të mundësonte hyrjen e turistëve të huaj. Në vitin 1998 do të publikohej për herë të parë harta turistike e Shqipërisë, megjithëse një gjë e tillë ishte prezantuar në 1960 nga Albturizmi.

Në 1990 shqiptarëve ju njoh e drejta për t'u pajisur me pasaporta për udhëtime jashtë shtetit. Shqipëria zotëronte disa rrethana e kushte për të thithur investime të huaja, duke qënë se ka burime nëntokësore e mbitokësore, fuqi punëtore të kualifikuar e relativisht të mirë, si dhe pozitë të favorshme gjeografike.

Kjo, në fakt është e pamjaftueshme, sepse çdo investitor kërkon disa parakushte bazë, ku mund të përmendim rendin politik të stabilizuar, nivelin e ulët të kriminalitetit dhe krimin ekonomik, eliminimi i burokracive për të realizuar një investim direkt të huaj, një infrastrukturë teknike, e cila ka nevojë për përmirësime.

Pra, çdo investitor i huaj do të jetë i pranishëm kur të bindet në fakte konkrete dhe jo me deklaratata boshe.

Niveli vjetor i investimeve të huaja direkte në vendin tonë është në shifrat të ulëta. Ky nivel i ulët i investimeve shpjegohet nga:

- Fillimi me vonesë i tranzicionit në vend, krahasuar me vendet e tjera të Evropës Perëndimore.
- Mosnjohja dhe njohja e përciptë e Shqipërisë si pasojë e izolimit të gjatë.
- Infrastrukturë e dobët, probleme teknologjike, paqëndrueshmëri e lartë politike dhe kriminaliteti i madh ekonomik dhe fizik, pas viteve 1997.
- Mungesa e kuadrit ligjor ekzistues dhe zbatimi i tij i mangët në praktikë, pengesa dhe vështirësia në zbatimin e legjislacionit fiskal, si dhe korrupsioni dhe burokracia shtetërore.

Në këtë periudhë ajo çka mbetet një nga pengesat kryesore, jo vetëm për nxitjen e investimeve në sektorin e turizmit, por edhe në sektorë të tjerë, është paqëndrueshmëria relative politike apo krizat e ndryshme qeveritare.

Nga 291 milionë \$ të investuara nga të huajt, dëmet materiale llogariten në 50 milionë \$ ose rreth 17.2 për qind.

Deri në vitin 1996, investitorët e huaj ishin optimistë dhe prirja e investimeve të huaja ishin në rritje të vazhdueshme, duke u rritur në këtë mënyrë dhe numri i turistëve që vizitonin Shqipërinë, ku më shumë se 49 për qind e tyre vinin kryesisht për biznes.

Tre vjet nga pranvera e vitit 1997, këto investime ranë dukshëm (gati 50 për qind) dhe ende nuk kishte ndonjë rritje të tyre deri në vitin 2002.

Gjithmonë kemi pasur përballjen e dy faktorëve më kryesor, që kanë shërbyer si pengesë e pakalueshme për miliona dollarë, që do të hynin në Shqipëri nëpërmjet turizmit.

**Faktorë objektiv:** Vështirësitë që vijnë nga mungesa e infrastrukturës inxhinerike, teknike, urbane, që duan kohë për t'u përmirësuar.

**Faktorët subjektiv:** Korrupsioni, burokracia, kriminaliteti, që janë më të lehtë për t'u përmirësuar. Përmirësimi i faktorëve subjektiv do të ndikonte në mënyrë indirekte në rritjen e buxhetit financiar për përmirësimin e grupit të parë.

### **Kategoria e klientëve**

- Shqiptarë etnikë (kosovarët dhe ata nga Maqedonia) dhe emigrantë për pushime, tranzit, ekskursionë (80 për qind të të gjithë turistëve të huaj);
- Evropianë për biznes (20 për qind);
- Pushues vendas për fundjavë;
- Punonjës të organizatave të huaja që lëvizin me shërbim;
- Grupe të huaja turistike;
- Grupe të huaja për ekskursion ditore.

## **INVESTIMET MË TË RËNDËSISHME**

### **Investime shtetërore:**

1973-82 11 hotele.

### **Investime të huaja:**


- 1994 Hotel Rogner nga austriakët, financim EBRD;
- 1995 rinovim i Hotel Tirana, join venture shtet/ EBRD;
- 1995 Mak Albania, chateaux Linza , Mali i Robit;
- 2003 Hotel Sheraton, ndërtuar nga Al Karafili, kontrate menaxhimi.

**Investime vendase:**

- Pas 2000, renovim i hotel Butrintit dhe Adriatik.

**Transaksionet më të mëdha:**

Shitja e Hotel “International” dhe “Butrintit”.

**Sfidat e turizmit në recesion, promovimi i turizmit kusht për investime të efektshme**

Natyrisht, vendet që priten të preken më shumë nga kriza do të jenë vendet e varfra dhe ato me ekonomi të brishta, sepse në një ekonomi botërore shumë të globalizuar, efektet e krizës përhapen shpejt dhe është e natyrshme, që më të vegjlit dhe më të dobëtit pritet t'i ndjejnë më shumë ato.

Si efekte më të përgjithshme, që pritet të ndodhin në ekonomitë dhe procesin e zhvillimit, ekspertët parashikojnë një rritje të papunësisë, rritje të çmimeve të lëndëve të para e shërbimeve, shtrenjtim të kreditit në tregjet ndërkombëtare, uljes së mundësisë nga vendet e zhvilluara, që mbajnë të njëjtin nivel ndihmash për zhvillimin e vendeve të varfra, etj.

Kriza ekonomike globale rrezikon thellimin e varfërisë në Shqipëri dhe ky është konkluzioni i raportit të fundit të Bankës Botërore publikuar në faqen e saj të internetit.



Megjithatë, sipas këtij raporti, Shqipëria klasifikohet ndër vendet mesatare të rrezikuara nga efektet e krizës në vitin në vazhdim.

Mendohet se pasojat e krizës në Shqipëri do të jenë më të lehta për disa arsye:

- Shqipëria nuk është e përfshirë në tregjet financiare botërore.
- Stabilitet relativ i sistemit bankar në Shqipëri, politika strikte të kreditimit në vite.
- Në Shqipëri ekzistojnë kryesisht më tepër banka kursimi, sesa banka investimesh.

Cila do të jetë tendenca në periudhën 2009-2010? Si do t'i përgjigjen politikat e turizmit krizës ekonomike?

Funksionarët e Qeverisë shqiptare duket se nuk po vlerësojnë sa duhet pasojat e krizës më të madhe ekonomike botërore. Natyrisht, turizmi është sektori më i ndjeshëm ndaj krizës, sidomos për grupet me aftësi të kufizuara të pagesës, të cilat brenda 10 viteve të fundit kryesisht e vizitojnë Rivierën e Shqipërisë.

Stina e ardhshme do të jetë më e dobët se ajo e këtij viti. Tashmë është e qartë për disa grupe të punëtorëve turistikë, hotelierëve dhe qiradhënësve që të mos shpresojnë shumë dhe t'i ulin çmimet. Efektet e krizës kanë filluar të ndihen në disa drejtime:

- Është zvogëluar numri i tregtarëve të huaj, që vijnë në Shqipëri për biznes. Këtë e tregon numri i vizitorëve në hotelet më të mëdha që në tre muajt e fundit ka pasur rënie.
- Rënia e hyrjeve nga flukset turistike, nisur nga fakti se as të huajt dhe as shqiptarët me banim jashtë vendit nuk do të kenë përsëri të njëjtat të ardhura në dispozicion. Nevoja për të ngushtuar shpenzimet jo të domosdoshme do të prodhojë padyshim një rrudhje të hyrjeve turistike në vend dhe për rrjedhojë edhe një ngushtim të prurjeve financiare të këtij sektori në buxhetin e shtetit.
- Rënie e masës së investimeve direkte, të huaja dhe vendase në sektorin e turizmit, pasojë e krizës së rëndë financiare.

Por, duke e konsideruar krizën si një mundësi, specialistët janë në kohë të parashikojnë masa zbutëse, për ta kthyer këtë dobësi sektoriale me burim ndërkombëtar, në një pikë të fortë të ofertës vendase.

Së pari, e rëndësishme është që paketave turistike hyrëse (in-coming), që agjencitë shqiptare do të ofrojnë në treg përmes rrjetit të partnerëve ndërkombëtarë, t'u hiqet TVSH-ja, duke ulur të paktën 15 për qind çmimin e startit në ofertën pritëse për të vizituar Shqipërinë (shembull i suksesit Kroacia).

Kjo do të ketë të paktën tre efekte të menjëherëshme.

1. Do të gjenerojë një fluks më të organizuar të vizitorëve të huaj apo emigrantëve shqiptarë, të cilët blerjen turistike do të priren ta bëjnë në mënyrë të organizuar, për të përfituar nga oferta e moderuar.

Sjellja e klientelës në mënyrë të organizuar do të përqendrojë më mirë kërkesën turistike, duke rritur në mënyrë thelbësore cilësinë e ofertës turistike dhe duke gjeneruar përmirësime zinxhirore deri në nivel rajonal.

2. Kjo do të rrisë cilësitë e bashkëpunimit e operatorëve turistikë brenda tregut shqiptar, kur dihet se shumica e agjencive turistike kanë në librin e kontakteve 100 hotele turke dhe vetem 3 shqiptare.

Ky bashkëpunim do të harmonizojë shumë më shpejt interesat e sektorit dhe të operatorëve të tij, duke ndërtuar një vizion shumë më efektiv mbi parimin e përfitimit të dyanshëm.

Kjo prirje do të dinamizojë së pari ofertën e brendshme, duke faktorizuar ato potenciale deri më sot të shfrytëzuara mbi baza rastësore.

3. Kjo qasje do të prodhojë një konkurrencë më të lartë të Shqipërisë në tregun turistik rajonal, duke e bërë vendin më atraktiv në kushtet e mungesës së gatishmërisë së klientelës evropiane për të paguar çmime të larta për pushimet e tyre.

Kështu, me kosto të përmbajtura promovuese, Shqipëria do të arrijë të ketë më tepër vëmendje falë një oferte më fleksibile, duke e mbështetur këtë promovim mbi tipologjinë e gërshetuar të tureve si ato kulturore, ekzotike-mjedisore, malore- sportive, etj. Në fund të fundit shprehja më e mirë e fleksibilitetit të ofertës është çmimi.

Gjithashtu, ruajtja e nivelit të flukseve turistike hyrëse i shërben drejtpërdrejtë zgjerimit të shkallës së njohjes së vendit në arenën ndërkombëtare dhe ndërtimit të një imazhi realist dhe empirikisht të besueshëm, çka në kthim përkthehet me më shumë investime të huaja direkte dhe përqendrim më të mirë të vëmendjes ndërkombëtare.

Nëse Shqipëria adapton këtë qasje, është e sigurt se ajo do të ruajë rritjen e parashikuar turistike dhe do të ushqejë me të ardhura krejt zinxhirin dytësor të shërbimeve, që ndërliken me këtë sektor.

Së dyti, ne jemi një treg shumë i vogël dhe nuk mund të krahasohemi me tregjet më të mëdha turistike, të cilat mendojmë se mund të shfrytëzojnë efektet e shkallës. Prioritet do të kemi zhvillimin e turizmit rural, përmirësimin e infrastrukturës dhe lehtësirat që ofron legjislacioni shqiptar.

### **Mundësitë që duhet të ofrohen për turizmin**

- Krijimi dhe zbatimi i politikave fiskale nxitëse dhe lehtësuese për investimet e huaja sidomos gjatë periudhës të parë të veprimtimit të kompanisë, si dhe kontrollin e zbatimit korrekt të tyre në praktikë do t'i shërbente nxitjes dhe gjallërimit të këtyre investimeve.
- Legjislacioni në fuqi ofron një sërë lehtësirash si: çdo investitor përjashtohet nga detyrimet doganore për makineri-pajisje, përjashtohet nga tatimi për 5-vitet e para të fillimit të investimit, qira të ulta për pronat e shtetit, toka jepet me qira për 99 vjet, (4 herë nga 25 vjet), por kur pronat janë private shteti njihet mundësinë e blerjes të saj nga të huajt ose të bashkëpunimit.
- Rënia e fuqisë blerëse të lekut do të rritë mundësinë e ardhjes të turistëve të huaj e gërshetuar kjo dhe me “dashamirësin” e pritësve për të ulur çmimet. Kjo do të shoqërohet me rënie të numrit të turistëve vendas, që frekuentojnë Greqinë dhe Turqinë si vende pritëse.
- Rritja e sigurisë të investitorëve të huaj, si pasojë e hyrjes së Shqipërisë në NATO. Në mënyrë që të konkurrojnë në tregun botëror duhet që të ofrohen lehtësira në infrastrukturë të kombinuara me produkte origjinale, që kërkohen nga tregu, si hotele, fshatra turistike, turizëm tradicional rural dhe familjar, qendra kulturore dhe turne në zona arkeologjike.

Në një fazë të mëvonshme kur të sigurohet një stabilitet i plotë politik dhe ekonomik oferta mund të pasurohet me investime të llojeve të veçanta si: gjueti, ngjitje malore, eksplorime, rezidenca për përdorim privat.

Progresi kërkon gjithashtu zgjerim të tregut turistik, jo vetëm (Kosova, Maqedonia dhe emigrantët shqiptarë), por dhe një shtrirje në tregjet e vendeve të Evropës Juglindore, Bashkimit Evropian dhe Amerikës të Veriut (pa harruar tregun e brendshëm).

Segmente të tjera që meritojnë vëmendje janë: individë dhe grupe me interesa të veçanta ndaj udhëtimeve, kulturës dhe sporteve, vizitorë për biznese konferenca, individë që kërkojnë kualitet, vende të pastra e të sigurta dhe mjedis rigoroz të kontrolluar.

Natyrisht realizimi i këtij skenari nuk është i lehtë. Duhet të paramendohet të kapërcehen një sërë vështirësish ekzistuese, si dhe vështirësi të tjera, që janë dhe do të bëhen më prezente në kushtet e thellimit të krizës ekonomike mbarëbotërore. Për kushtet konkrete të Shqipërisë, disa probleme janë konsideruar si emergjente dhe para periudhës të krizës.

Ato lidhen me:

- Mungesë e infrastrukturë (rrugë në zonat turistike, furnizim 24 orësh energji dhe ujë, trajtim i mbeturinave dhe ujrave të zeza);
- Mungesa e kapaciteteve turistike dhe standarde akomoduese të varfra;
- Mungesa e nënsektorëve mbështetës dhe animatorët turistikë për kohën e lirë;
- Kulturë e ulët civile dhe shërbimi. Mungesë e ndergjegjësimit mjedisor;
- Probleme të pazgjidhura që lidhen me zgjidhjen e çështjes së pronësisë.

Korrigjimi i tyre kërkon plane të veçanta, koordinim të politikave dhe strategjive për marketimin e Shqipërisë si një vend normal dhe destinacion me interes turistik.

Kjo fillon me rritjen e buxhetit të shtetit, hapjen e zyrave të përfaqësimit jashtë, hartimi i një rrjeti të planifikuar të zyrave të informacionit brenda vendit dhe prezantimi intensiv në panairot ndërkombëtare.

Kjo do të shoqërohet dhe me prezencën intensive të vendit tonë në rrjete të njohura mediale si: CNN, BBC, Euronews, Financial Times.

Zgjidhja e këtyre problemeve hap pas hapi do të normalizojë situatën dhe do të rritë besimin e turistëve.

Duhet të krijohen të gjitha kushtet (kuadri ligjor dhe institucional), që biznesit privat t'i jepet prioritet për të kontribuar në zhvillimin e infrastrukturës dhe industrisë turistike përmes konsensioneve.

Hartimi dhe fillimi në disa zona i planeve urbanistike, lehtësirat fiskale, kredi dhe fonde të dhëna nga buxheti i shtetit kanë qenë shtysa kryesore e ndryshimit.

Së treti, në kushtet e krizave, kur politikat monetare nuk japin rezultat, zgjidhja do të vijë nga politikat e shtetit dhe ato marketing në fushën e turizmit. Gjithashtu, duhet që përmes politikave inteligjente të “zgjojmë” interesin edhe të atyre shqiptarëve, që në 3- vitet e fundit, duke mos gjetur kualitetet e nevojshme në atdhe, i shpenzonin kursimet e tyre në vende të tjera.

Vetëm kështu mund të shpresojmë të bëjmë një politikë thellësisht kombëtare dhe financiarisht të levërditshme për promovimin e tregut turistik shqiptar.

**MSc. Mamica Nene, Ph. D Student,**

**MSc. Eleina Qirici, Ph. D Student**

## **KRIZA EKONOMIKE DHE MODELET E INVESTIMEVE NË TREGUN TURISTIK NË SHQIPËRI**

### *Abstrakt*

Shqipëria është një vend i pasur me asete turistike dhe ka një pozitë të favorshme gjeografike, e cila i siguron mundësi për zhvillimin e turizmit në det, liqen dhe mal.

Ndryshimet në orientimin ekonomik të vendit sollen rritjen e investimeve në turizëm. Ky studim do të fokusohet në disa drejtime.

1. Modelet e investimeve në tregun turistik.
2. Kriza ekonomike dhe ndikimi i saj te numri i turistëve.

Numri i hoteleve është rritur, shërbimet lehtësuese në këtë sektor janë përmirësuar dhe numri i turistëve është rritur vit pas viti. Turizmi kulturor ka marrë një vëmendje të veçantë, sepse Shqipëria ka shumë vlera kulturore të shprehura në vendet arkeologjike, kishat e vjetra etj.

Ky studim do të tregojë jo vetëm rritjen e numrit të turistëve të huaj, por edhe trafikun e turistëve vendas. Zhvillimi i turizmit ka pasur një ndikim të rëndësishëm mbi punësimin direkt në ndërmarjet turistike si dhe te punësimi në sektorët e tjerë si transporti.

Industria e turizmit shpresohet të bëhet një prej burimeve më të mëdha të të ardhurave në vend. Pjesa e parë e studimit do të marrë në konsideratë pronësinë e tregut hotelier, menaxhimin, përfitimet gjithashtu edhe shërbimet që lidhen me turizmin.

Një vlerësim i një grupi turistik do të tregojë fuqitë dhe dobësitë e shërbimeve mbështetëse, të cilat kompozojnë industrinë turistike.

Tregu për biznesin hotelier dhe shërbimet turistike është në përgjithësi me konkurrencë të lartë, me një numër të madh aktorësh përmes lokaliteteve, kombësive të pronësisë dhe menaxhimit dhe nivelit të shërbimeve të siguruara.

Qeveria shqiptare ka ndërmarë disa aktivitete në lidhje me shërbimet turistike, të cilat përfshijnë përmirësimin e rrugëve ekzistuese dhe ndërtimin e rrugëve të reja, projekti më i madh është rruga Durrës - Kukës, inkurajimin e ngjarjeve ndërkombëtare të tilla si ato sportive, konferenca dhe festivale të muzikës dhe filmit, si dhe reklamimin në media ndërkombëtare si CNN.

Në pjesën e dytë studimi do të fokusohet te kriza ekonomike dhe ndikimi i saj te numri i turistëve, si dhe te mjetet promovionale për tërheqjen e investimeve të huaja direkte në turizëm.

Fjalët kyçe: struktura e tregut turistik, modelet e investimeve, zhvillimi i turizmit, shërbime turistike, FDI në turizëm.

### **Një vështrim i përgjithshëm mbi asetet turistike dhe zhvillimin e turizmit në Shqipëri**

Shqipëria është një vend i vogël, në perëndim të Gadishullit Ballkanik dhe është porti i Evropës Juglindore. Kufizohet me Greqinë në jug, Maqedoninë në lindje, Malin e Zi dhe Kosovën në veri dhe verilindje. Shqipëria ka një pozitë të favorshme gjeografike dhe për këto arsye është quajtur "Porta e Ballkanit".

Shqipëria është një vend mesdhetar, por ka disa karakteristika të veçanta, ku ndërthurren tiparet gjeografike dhe gjeologjike, peizazhi dhe relievi. Shqipëria është e pasur me pyje mesdhetare, ka shumë liqene, laguna, rezervate etj.

Bregdeti është i vogël, por ka plazhe të bukura rëre dhe shkëmbore. Si vend mesdhetar, ka kushte të favorshme për zhvillimin e turizmit, 457 km prej një totali prej 1094 km vijë kufitare kombëtare janë një bregdet i mrekullueshëm me zona të virgjëra dhe të paeksploruara, të cilat nxitin kuriozitetin, një natyrë perfekte dhe diversitetin e formave të relievit.

Pozicioni i favorshëm i Shqipërisë si lidhje e Lindjes me Perëndimin dhe arsyet e tjera të përmendura më lartë janë pse ekspertët ndërkombëtarë të turizmit e kanë konsideruar vendin tonë si një potencial të jashtëzakonshëm për zhvillimin e turizmit dhe në të njëjtën kohë me premisën për t'u bërë qendër unike e turizmit ekologjik evropian.

Shqipëria ka shumë objekte dhe dëshmi të vlerave kulturore, historike dhe artistike. Këto janë pjesë e trashëgimisë shqiptare dhe mbrohen me ligj.

Ndryshimet në orientimin ekonomik të vendit rezultuan në rritjen e investimeve në turizëm.

Vëmendja shtetërore ndaj industrisë së turizmit është rritur, duke e konsideruar turizmin si një nga sektorët që do të ndihmojë në rritjen ekonomike të vendit.

Këtij qëllimi i ka shërbyer edhe Hartimi i Strategjisë dhe Planit të Zhvillimit të Turizmit, datë 21.06.2006, si dhe Ligji i Ri për Turizmin Nr 9734 datë 14.05. 2007.

Ky ligj ka për qëllim përcaktimin e parimeve dhe rregullave, që veprojnë në fushën e turizmit si dhe vendosjen dhe zhvillimin e standardeve të shërbimeve turistike dhe të shërbimeve të tjera të lidhura me to.

Rritja e numrit të hoteleve, shërbimeve lehtësuese dhe përmirësimet e bëra në këtë sektor kanë bërë që numri i turistëve të rritet vit pas viti. Tabela 1 tregon numrin e hoteleve dhe kapacitetin e tyre.

Tabela 1: Hotelet dhe kapaciteti i tyre.

Vitet	2003	2004	2005	2006
Hotelet	199	170	220	251
Dhomat	4161	3368	3874	4266
Shtretërit	8420	6600	7642	8362

Burimi: INSTAT

Ashtu si u përmend edhe më lartë numri i turistëve ka ardhur në rritje. Sipas të dhënave të Drejtorisë së Policisë së Kufirit, Ministria e Brendshme 2006, numri i vizitorëve të huaj nga 309 mijë për vitin 2003, arriti në afro 1.110.000 për vitin 2007.

Gjithashtu, kohëzgjatja e qëndrimit në hotele si për rezidentët ashtu edhe për jorezidentët është rritur me rreth 15-16 për qind gjatë vitit 2007.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar diversifikimit të turizmit, duke kombinuar turizmin e diellit dhe të rërës, me turizmin e atraksioneve kulturore dhe natyrore apo edhe agroturizmin.

Një mundësi e tillë vjen nga fakti se megjithëse Shqipëria është një vend i vogël, ka mundësi që të ofrojë bregdetin dhe plazhet, kulturën antike, apo klimën malore, pra një larmi atraksionesh, në një afërsi të madhe.

Gjithsesi, kontributi i turizmit në ekonominë shqiptare është 11 për qind<sup>4</sup>, ndërsa e ardhura e turizmit në GDP llogaritet në 3.8-4 për qind ose rreth 45 miliardë lekë<sup>5</sup>.

Rritja e interesit për këtë sektor ka bërë që edhe të ardhurat bruto nga turizmi në tre vitet e fundit të shënojnë rritje. Table 2 jep të ardhurat bruto nga turizmi.

Table 2: Të ardhurat bruto nga turizmi.

Years	2004	2005	2006	2007
Të ardhurat (milion euro)	592	692	805	1 miliard

Burimi: Banka e Shqipërisë 2007.

<sup>4</sup> Këshilli Botëror i Turizmit dhe Udhëtimeve 2007

<sup>5</sup> Këshilli Botëror i Turizmit dhe Udhëtimeve 2007

## **Modelet e investimeve në tregun turistik**

Investimi është një prej kushteve prioritare për arritjen e suksesit në zhvillimin e turizmit. Legjislacioni aktual shqiptar mbron, stimulon dhe mbështet investimet në këtë sektor.

Përpara viteve 1990, industria e turizmit në Shqipëri ishte mjaft e dobët, për shkak të sistemit komunist. Niveli i cilësisë së shërbimeve ishte i ulët, stafi kishte mangësi në përgatitje dhe mungonte motivimi për të punuar më mirë.

Pas viteve 1990, sektori i turizmit mori një vëmendje të veçantë, duke u konsideruar si një nga sektorët që do të kontribuojë së tepërmi në rritjen ekonomike të vendit.

Sektorët që kanë pasur një rritje më të shpejtë dhe me investime të konsiderueshme janë ai i hoteleve dhe restoranteve. Ky sektor u karakterizua nga disa tendenca.

Tendenca e parë ishin investimet e kapitalit të brendshëm në ndërtimin e hoteleve, restoranteve dhe agjencive të udhëtimit.

Karakteristikë e këtyre investimeve ishte fakti se ato u realizuan si në qytetet kryesore ashtu edhe në zonat rurale. P.sh., në rajonin e Korçës në disa nga fshatrat turistike të tij, si në Voskopojë, Dardhë, Vithkuq janë ndërtuar disa hotele me investime nga investitorë vendas. Kapaciteti i tyre varion nga 15-30 dhoma.

Në zonat rurale sidomos ato malore, por edhe në zonat urbane, veçanërisht në bregdet, është zhvilluar edhe turizmi familjar, që konkurren në saje të çmimeve më të ulëta, por që preferohet më tepër nga turistët vendas, që vijnë për të pushuar nga një qytet i Shqipërisë në një tjetër.

Shtëpitë e pushimit familjar në zonat rurale japin me qira 1-2 dhoma me çmime 1000 lekë, ndërsa te hotelet në po këto zona çmimet lëvizin nga 3000- 4000 lekë.

Tendenca e dytë ishin investimet e huaja, drejt krijimit të hoteleve me 4 ose 5 yje, shumica me menaxhim të huaj, po aq sa edhe me blerjen e hoteleve të zotëruara nga shteti nën programin e privatizimit.

Një komponent kryesor i programeve të privatizimit të qeverisë në sektorin e turizmit ka përfshirë shitjen e aseteve të vetme ose paketave të aseteve për investitorët. Kryesisht investimet e huaja janë realizuar në formën e hoteleve dhe restoranteve.

Disa nga investimet më të mëdha në Shqipëri janë Hotel “Europa Park” me vlerë 22 milionë \$, ristrukturimi i Hotel “Tirana” me vlerë 12 milionë \$, Motel “Linza” etj. Roli i investimeve të huaja është shumë i rëndësishëm në sektorin turistik në të gjitha segmentet.



Një formë tjetër e rëndësishme investimi janë zinxhirët hotelierë, si në rastin e hoteleve “Sheraton”, “Rogner”, “Tirana International” etj., që operojnë në Tiranë, ku aplikohen në detaje procedurat e organizimit dhe menaxhimit.

Për të ndihmuar dhe nxitur investimet në turizëm në vitin 2005, u krijua Enti Kombëtar i Turizmit. Pas hyrjes në fuqi të Ligjit të Ri për Turizmin, ky institucion kishte më tepër kompetenca për të ndihmuar investitorët e sipërmarjeve turistike, që të paraqitnin programe bashkëkohore.

Nxitës të tjerë kishin të bënin me përjashtimet nga taksat për pajisjet e importuara për hotelet, transportin apo kredi nga bankat. Përveç iniciativave private, buxheti i shtetit ka akorduar fonde për fushën e turizmit, që janë rritur nga viti në vit. Këto paraqiten në tabelën 3.

Tabela 3: Fondet e buxhetit të shtetit për investime në fushën e turizmit.

Vitet	2006	2007	2008
Fondet (milione lekë)	10	25	37

Burimi: Strategjia sektoriale e zhvillimit të turizmit 2007-2013.

Një stimulim më të madh kanë pasur strukturat turistike kryesisht në zonat bregdetare, ku, sipas të njëjtit burim të cituar më lartë, janë rreth 96 të tilla, nga të cilat 51 janë ndërtuar në troje shtetërore jopublike dhe 45 në pronësi private.

Krahas hoteleve individuale rritje kanë pasur edhe nëngrupet e projekteve turistike si: fshatrat turistike apo komplekset turistike.

Duke iu referuar strategjisë sektoriale të zhvillimit të turizmit, në Shqipëri ka rreth 16 fshatra turistike dhe 18 komplekse turistike.

### **Tregu hotelier, menaxhimi dhe përfitimi**

Ashtu si u përmend edhe më lartë, numri i hoteleve të ndërtuara në Shqipëri ka pasur rritje.

Karakteristikë është fakti se numrin më të madh e zënë hotelet me 2 dhe 3 yje përkatësisht 25 për qind dhe 35.71 për qind, hotelet me 1 yll 14.29 për qind, ndërsa hotelet me 4 dhe 5 yje kanë një përqindje më të vogël, përkatësisht 14.29 për qind dhe 10.71 për qind<sup>6</sup>.

<sup>6</sup> Strategjia sektoriale e zhvillimit të turizmit 2007-2013

Këto fakte tregojnë që shërbimet hoteliere në Shqipëri duhet të bëjnë përpjekje të mëdha për të rritur standardin e cilësisë së tyre.

Nuk mjafton vetëm dëshira për të investuar, por duhen bërë edhe investime të studiuara mirë për sa i takon tipit të klientëve, që duam të tërheqim për të plotësuar më mirë kërkesat e tyre.

Një prej avantazheve konkurruese për të cilat përmendet Shqipëria nga World Economic Forum 2009, është pikërisht indeksi i çmimeve të hoteleve, ku në listën e 133 vendeve Shqipëria renditet e 48-ta.

### **Shërbimet në lidhje me turizmin**

Një vlerësim i grupeve turistike do të tregojë fuqitë dhe dobësitë, me të cilat përballlet industria turistike. Tregu për biznesin hotelier dhe shërbimet turistike është në përgjithësi më konkurruese të lartë, me një numër të madh aktorësh përmes lokaliteteve, kombësive të pronësisë dhe menaxhimit dhe nivelit të shërbimeve të siguruara.

Qeveria shqiptare ka ndërmarë disa aktivitete në lidhje me turizmin. P.sh. shërbimet e transportit janë zgjeruar me shërbime të autobusëve të sektorit publik dhe taxi private, ndërsa shërbimi i transportit hekurudhor është shumë pak i përdorshëm, për shkak të cilësisë shumë të ulët.

Përsa i takon shërbimit ajror investime të konsiderueshme janë bërë në Aeroportin e Rinasit në Tiranë, duke i dhënë këtij aeroporti pamjen e me standarde ndërkombëtare.

Aeroporti është përballja e parë e turistëve me Shqipërinë dhe sigurisht krijimi i një imazhi pozitiv që aty do të thotë shumë.

Megjithë investimet e konsiderueshme, që janë bërë në infrastrukturë, zhvillimi i turizmit nuk kërkon vetëm rrugët e autostradave, por edhe rrugët që lidhin fshatrat apo qytetet me njëri-tjetrin, të cilat duhet të kenë parametra të larta.

Në raportin e World Economic Forum 2009, në krahasimin e 133 vendeve të botës, renditja e Shqipërisë, sa i takon cilësisë së rrugëve, cilësisë së infrastrukturës hekurudhore dhe asaj të porteve, është në renditjen e 114. 108 dhe 124.

Pra, është një renditje që tregon se infrastruktura në Shqipëri ka nevojë për shumë përmirësime për të arritur parametra të lartë e që do t'i shërbejnë industrisë së turizmit.

Probleme të tjera lidhen edhe me sinjalistikën e rrugëve, shenjat dalluese apo orientuese, që tregojnë monumentet e kulturës. Tabela 4 paraqet fondet e shpenzimeve të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zhvillimin e Turizmit 2007-2010.

Tabela 4: Fondet e shpenzimeve të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Fondet e shpenzimeve të MRKS (mijë lekë)	2007	2008	2009	2010
Fondet e Buxhetit të shtetit për turizmin	49,000	84,00	91,750	97,650
Total				
Shpenzime për promovimin turistik	24,000	47,00	52,850	54,950
Shpenzime për investime	25,000	37,00	38,900	42,700

Burimi: Strategjia sektoriale e zhvillimit të turizmit 2007-2013.

Nga tabela duket që një pjesë e konsiderueshme e fondeve të buxhetit të shtetit për turizmin, për promovimin turistik dhe kjo shumë ka tendencë të rritet edhe në vitet e ardhshme.

Momenti i parë sigurisht ka të bëjë me ngritjen dhe krijimin e imazhit pozitiv për vendin, pozicionimin e Shqipërisë të vëmendja e turistëve ndërkombëtarë.

Ndërsa, shpenzimet për investime për vitet 2007-2013 kanë të bëjnë me ngritjen e zyrave të informacionit turistik dhe të sinjalistikës turistike.

Problemi këtu qëndron sesa efektive kanë qenë këto zyra të informimit për përmbushjen e funksionit të tyre, ashtu si duhet. Jo gjithmonë ato kanë qenë të afta të realizojnë shërbime me cilësi në drejtim të sigurimit të informimit për turistët, materialeve promovuese apo sugjerimeve, që mund t'ju japin atyre.

### **Kriza ekonomike dhe ndikimi i saj te numri i turistëve**

Kriza ekonomike pati ndikimin e saj në shumë vende të botës. Sipas mendimit të ekspertëve të ndryshëm të ekonomisë shqiptare dhe atyre të huaj, ndikimi i krizës ekonomike në Shqipëri është më i vogël.

Bizneset që e kanë ndier më tepër efektin e krizës janë industria e fasonëve, ku janë shkurtuar edhe një numër i madh i vendeve të punës.

Ndërkohë për industrinë turistike, duke ju referuar të dhënave të vitit të kaluar, turizmi ishte një nga sektorët, që pati një rritje të konsiderueshme. Ashtu si u përmend edhe më lartë, zhvillimi i turizmit në Shqipëri është konsideruar si një aktivitet i rëndësishëm, duke pretenduar që roli i tij në vitet e ardhshme të rritet edhe më shumë.

Turistët që kanë vizituar më shumë Shqipërinë janë shqiptarët nga Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi, si dhe emigrantët që punojnë dhe jetojnë jashtë vendit dhe që vijnë në Shqipëri për të kaluar pushimet me familjet e tyre.

Gjatë verës së vitit të kaluar, pati një fluks më të madh të turistëve nga Maqedonia dhe kjo për shkak të tensionit që u krijua me shtetin grek për çështjen e emrit të Maqedonisë.

Turistët maqedonas kanë preferuar më tepër bregdetin dhe kryesisht qytetin e Vlorës, ndërsa shqiptarët e Kosovës kanë pasur si më të preferuar plazhin e Durrësit. Duke i klasifikuar turistët, sipas qëllimit të tyre të udhëtimit, 85 për qind kanë qënë turistë për turizëm dhe kënaqësi, 6 për qind për të vizituar shokët, 6 për qind për biznes e tregti dhe 3 për qind për arsye të tjera.

Megjithatë, statistikat në Shqipëri jo vetëm për aktivitetet e turizmit, por edhe në fusha të tjera, kanë qënë jo gjithmonë të besueshme apo të sakta, madje edhe për të njëjtin problem.

Kjo ka ardhur si pasojë e metodave të përdorura për grumbullimin e të dhënave. INSTAT dhe Banka e Shqipërisë janë nga burimet kryesore për sigurimin e informatave.

Gjithsesi, Shqipëria mbetet një vend ende i panjohur si destinacion turistik. Kjo ka bërë që motoja kryesore e strategjisë për zhvillimin e turizmit të jetë “Shqipëria juaja për t’u zbuluar”.

Në këtë zbulim do të bëhet një prezantim i vlerave dhe resurseve të Shqipërisë, duke paraqitur atraksionet kulturore, historike, arkeologjike, jetën, kuzhinën dhe mikpritjen shqiptare.

Shqipëria është përpjekur të rritë numrin e turistëve edhe nëpërmjet inkurajimit për të qëndruar më gjatë në vend dhe ofrimit të shërbimeve të tregut, që të rriten shpenzimet mesatare për turistë.

Në Shqipëri ka edhe mjaft objekte me vlera kulturore dhe historike, të cilat përbëjnë pasurinë e trashëgimisë kulturore dhe mbrohen me ligj.

Qytetet muze të Gjirokastrës, Beratit, Zona arkeologjike e Durrësit, Pazari i vjetër i Krujës, Parku Nacional i Butrinit dhe të tjera vende, janë zona që përfaqësojnë vlerat arkeologjike dhe pasurinë kulturore, që paraqiten si mundësi për t’u vizituar nga turistët.

Gjithsesi, në tregun e Evropës Qendrore dhe Lindore Shqipëria zë rreth 0.6 për qind të kërkesës totale për turizëm<sup>7</sup>.

Investimi është një prej kushteve prioritare për suksesin në zhvillimin e turizmit. Legjislacioni shqiptar mbron, stimulon dhe mbështet investimet në këtë sektor. Këtij qëllimi i ka shërbyer edhe Komiteti i Zhvillimit Turistik, i cili inkurajon dhe lehtëson investimet në këtë industri.

Roli i Komitetit është t'ju sigurojë investitorëve asistencë, për identifikimin e mundësive, vlerësimin e projekteve të propozuara, përgatitjen e propozimeve për investitorët e brendshëm dhe të huaj dhe ndihmë në sigurimin e financimeve.

Të gjitha kërkesat nga investitorët duhet të bëhen sipas formës standarde të Komitetit. Duke qenë se konkurrenca për shërbimet turistike edhe nga vendet e rajonit është e lartë mbetet detyrë e rëndësishme:

- Forcimi i rregullimeve strikte për planifikimin dhe mbrojtjen e qyteteve historike, si dhe për të ruajtur balancën ekologjike në zhvillimin e zonave të reja bregdetare.
- Trajnimin e profesionistëve dhe personelit për të pasur një staf të trajnuar mirë, për t'u bërë menaxherë efektivë.
- Një promovim efikas duke përdorur një fushatë promociionale të studiuar mirë.

## **Konkluzione**

1. Turizmi në Shqipëri ka marrë një vëmendje të veçantë, duke i kushtuar rëndësi diversifikimit të tij, nëpërmjet turizmit të diellit dhe rërës, me turizmin e atraksioneve kulturore dhe natyrore apo edhe me agroturizmin.
2. Numri i turistëve ka ardhur në rritje.
3. Investimet në fushën e turizmit janë karakterizuar nga disa tendenca: Tendenca e parë ishin investimet e kapitalit të brendshëm në ndërtimin e hoteleve, restoranteve dhe agjencive të udhëtimit.

Tendenca e dytë ishte në investimet e huaja, drejt krijimit të hoteleve me 4 ose 5 yje, shumica me menaxhim të huaj, po aq sa edhe me blerjen e hoteleve të zotëruara nga shteti nën programin e privatizimit.

Një formë tjetër e rëndësishme investimi janë zinxhirët hotelierë.

4. Infrastruktura në Shqipëri ka nevojë për shumë përmirësime për të arritur parametra të lartë e që do t'i shërbejnë industrisë së turizmit.

---

<sup>7</sup> Keshilli Boteror i Turizmit dhe Udhëtimve 2007

**Rekomandime**

1. Të forcohen rregullat strikte për planifikimin dhe mbrojtjen e qyteteve historike, si dhe për t'ë ruajtur balancën ekologjike në zhvillimin e zonave të reja bregdetare.
2. Të bëhen përpjekje për trajnimin e profesionistëve dhe personelit për të pasur një staf të trajnuar mirë për t'u bërë menaxherë efektiv.
3. Për të realizuar një promovim sa më efikas duhet që të krijohet një temë e unifikuar kombëtare, duke pasur objektiva të qarta për segmentet e turistëve që duam të tërheqim.

## Literatura:

1. Albanian Guide.
2. Bank of Albania.
3. INSTAT 2006,2007.
4. Këshilli Botëror i Turizmit dhe Udhëtimeve 2007.
5. Report of World Economic Forum 2009.
6. Strategjia sektoriale e zhvillimit 2007-2013.